FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 11

Tiranë – E mërkurë, 17 janar 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 11.1.2024	Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2024–2026	1929
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 11.1.2024	Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Agjencia e Inteligjencës Financiare	2067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 11.1.2024	Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimi dhe pagesat	2071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024	Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026	2074
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 34 , datë 29.12.2023	Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme	2093
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 8, datë 11.1.2024	Për delegim kompetence	2109
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 862, datë 29.12.2023	Për delegim kompetence	2109
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 113, datë 11.12.2023	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 99, datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbra', të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbra' duke futur elemente *go-green* në to"', i ndryshuar	2110
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 114, datë 11.12.2023	Autorizim i ndihmës shtetërore "Bizneset ekoinovative"	2111

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 302, datë 23.10.2023	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës "Area" për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023".....	2113
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 303, datë 23.10.2023	Mbi licencimin e shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Teksoen 1"..	2115
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 304, datë 23.10.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë "Gealb Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1" dhe "Guri i Bardhë 2".....	2116
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 305, datë 23.10.2023	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga "HEC Gojan".....	2118
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 306, datë 23.10.2023	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	2119
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 621 (4264), datë 10.10.2023	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Suzana Tafili.....	2123
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 6145, datë 21.11.2023	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hasim Loshi.....	2123

VENDIM
Nr. 12, datë 11.1.2024

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË REFORMAVE EKONOMIKE (ERP) 2024–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2024–2026, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE 2024–2026
15 janar 2024

Tabela e përmbajtjes

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM POLITIK DHE OBJEKTIVAT
2. ZBATIMI I UDHËZIMEVE TË POLITIKAVE
3. KUADRI MAKROEKONOMIK
3.1 Zhvillimet e fundit ekonomike
3.2 Skenari makroekonomik afatmesëm
3.3 Skenarët alternativë dhe risqet
4. KUADRI FISKAL
4.1 Politikat strategjike dhe objektivat afatmesëm
4.2 Implementimi i buxhetit për vitin 2023
4.3 Planet buxhetore për vitin e dorëzimit të ERP-së
4.4 Perspektiva buxhetore afatmesme
4.5 Bilanca strukturore (përbërësi ciklik i deficitit, masat e njëhershme dhe të përkohshme, pozicioni fiskal)
4.6 Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore
4.7 Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm
4.8 Cilësia e financave publike
4.9 Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore
4.10 Qëndrueshmëria e financave publike
5. REFORMAT STRUKTURORE PARËSORE MË 2024–2026
Kapitali njerëzor dhe politikat shoqërore
Analiza e pengesave kryesore
Reformat strukturore
Qëndrueshmëria dhe elasticiteti
Analiza e pengesave kryesore
Reformat strukturore
Konkurrueshmëria
Analiza e pengesave kryesore
Reformat strukturore
Përmbledhje e masave të reformave
6. KOSTOJA DHE FINANCIMI I REFORMAVE STRUKTURORE
7. ÇËSHTJE INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E AKTORËVE TË INTERESIT
SHTOJCAT
Shtojca I
Shtojca II

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM POLITIK DHE OBJEKTIVAT

Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2024–2026 paraqet politikat kryesore makroekonomike dhe fiskale që synojnë të vendosin një ekuilibër optimal midis mundësive dhe rreziqeve, me qëllim që të mundësojnë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, rritje të punësimit dhe qëndrueshmërinë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, si dhe të mbrojtjes dhe forcimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonik të vendit. Për më tepër, ERP-ja përmbledh masat e reformave prioritare të qeverisë së Shqipërisë për periudhën afatshkurtër e afatmesme me qëllim rritjen e prodhimit vendës, nxitjen e investimeve të reja dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Qëllimi kryesor i kësaj qasje është të sigurojë një përfaqësim të vazhdueshëm të atyre reformave që janë ende në zbatim, duke siguruar kështu qëndrueshmëri në agjendën e reformave prioritare.

Ekonomia shqiptare prej vitit 2019 u impaktua nga disa ngjarje të jashtëzakonshme të njëpasnjëshme, si: tërmeti i vitit 2019, pandemia globale COVID-19 në fillim të vitit 2020 dhe së fundmi, kriza globale energjetike si pasojë e luftës Rusi–Ukrainë në vitin 2022. Deri më tani, fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre

goditjeve dhe deri më tani ekonomia jonë është përshtatur dhe ka performuar relativisht mjaft mirë, përfshirë edhe një rritje ekonomike mbi pritshmëritë fillestare për secilin prej këtyre viteve. Edhe përgjatë vitit 2023, ekonomia e vendit ka performuar relativisht mirë, pavarësisht kushteve më të shtrënguara të financimit si dhe ngadalësimit të kërkesës së huaj, dhe pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të mbrojtjes dhe forcimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Politika fiskale do vijojë të targetojë një trajektore graduale rënëse të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të targetohet në nivel pozitiv që prej vitit të ardhshëm 2024 dhe do të vijojë e tillë në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskalë në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do targetohen të jenë mbi 4.5 për qind e PBB-së në çdo vit buxhetor për periudhën 2024–2026 (mesatarisht 5.0 për qind në vit), ndërkohë që deficiti buxhetor për këtë periudhë targetohet në mesatarisht rreth 2.2 për qind në vit. Rrjedhimisht, bilanci korrent fiskal targetohet gjithmonë pozitiv, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal ("rregullin e artë" të buxhetit), konkretisht në mesatarisht rreth +2.7 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme 2024–2026.

Balanca primare parashikohet mesatarisht në rreth 0.6 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme vijuese 2024–2026. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku një rregull fiskal në LOB përcakton që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare duhet të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Në vitin 2024, balanca primare është projektuar me një suficit prej 0.2 për qind të PBB-së dhe të vazhdojë të zgjerohet më tej në normën prej 0.8 për qind në vitin 2025 dhe në 0.9 për qind në vitin 2026.

Si rrjedhojë, borxhi publik ndaj PBB-së do të vazhdojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin fiskal përkatës. Në vitin 2023, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 61.5 për qind të PBB-së nga rreth 64.5 për qind në vitin 2022 dhe pritet të vazhdojë të bjerë më tej në rreth 59.8 për qind në vitin 2024. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 58.9 për qind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 52.7 për qind deri në vitin 2031.

2. ZBATIMI I UDHËZIMEVE TË POLITIKAVE

Udhëzimi i politikave 1

1.1 *Të arrihet siç është parashikuar një balancë primare jonegative në vitin 2023 duke ofruar nëse është e nevojshme mbështetje për familjet dhe bizneset me qëllim për të zbutur ndikimin e çmimeve të larta të energjisë dhe të zbatohet plani buxhetor afatmesëm që synon uljen e raportit të borxhit publik dhe rritjen e suficit primar duke përdorur procesin e rregullt të rishikimit për amendamentet e buxhetit*

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) parashikon një balancë primare jonegative për vitin 2023, një përmirësim i qartë nga niveli negativ prej -1.8 për qind në vitin 2022. Në vitin 2024, balanca primare është projektuar në rreth 0.2 për qind të PBB-së dhe do të vazhdojë të zgjerohet më tej në normën prej 0.8 për qind në vitin 2025 dhe në 0.9 për qind në vitin 2026. Me një balancë primare të balancuar ndaj PBB-së që pritet në vitin 2023, rregulli fiskal që përcakton një balancë primare jonegative do të përmbushet një vit përpara afatit. Në LOB është përcaktuar se duke filluar nga viti buxhetor 2024 dhe për çdo vit pasardhës, balanca primare do të jetë jo më pak se zero (pra të paktën e balancuar ose pozitive). Gjithashtu, borxhi publik bruto i vlerësuar në KMF do të ndjekë trajektoren rënëse, në përputhje me rregullin fiskal përkatës. Në vitin 2024, borxhi publik pritet të bjerë me rreth 59.8 për qind të PBB-së nga rreth 61.5 për qind në vitin 2023 dhe pritet të vazhdojë të bjerë më tej në rreth 58.9 për qind në vitin 2026 dhe në rreth 52.7 për qind në vitin 2031.

1.2 *Mbani detyrimet e prapambetura të qeverisë së përgjithshme në çdo tremujor të 2023 në maksimum 2.5% të shpenzimeve totale dhe nën 2.4% të totalit të shpenzimeve në fund të 2023*

Prioriteti kryesor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në periudhën afatmesme mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Në vitet e fundit ky objektiv është arritur, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një trend rënës, edhe pse faktorë të tillë si tërmeti, pandemia, kriza globale energjetike, lufta në Ukrainë dhe luhatjet e çmimeve të lëndëve të para, kanë ndikuar

negativisht në "sjelljen" dhe ecurinë e reduktimit të mëtejshëm të totalit të stokut për vitin buxhetor 2023. Nga ana tjetër, vendosja e objektivave specifikë ndër vite (p.sh. Vlerësimi PEFA, Mirëqeverisja/PFM dhe ERP) kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll dhe reduktimin (edhe pse jo tërësisht të qëndrueshëm) të stokut të detyrimeve të prapambetura në vitet e fundit. Konkretisht:

- Vlerësimi PEFA

Stoku i detyrimeve të prapambetura vjetore nuk kalon 2% të totalit të shpenzimeve, në të paktën dy nga tre vitet e fundit fiskalë. Ky target, është arritur për 2022 dhe pritet të arrihet edhe për 2023.

- Mirëqeverisja / PFM

Targeti i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2023 është vendosur =/<2.4% (realizim i plotë) dhe =/<2.8% (realizim i pjesshëm). Pritshmëria për përmbushjen e këtij objektivi deri në fund të vitit 2023, është pozitive.

- ERP

Targeti i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2023 është vendosur në masën: =/<2.5% mbi bazë tremujore dhe <2.4% në nivel vjetor. Për periudhën 3M 2023 niveli rezultoi 1.83%, për periudhën 6M 2023 rezultoi 2.67% dhe për periudhën 9M 2023, niveli rezultoi 2.91%, megjithatë pritshmëritë për përmbushjen e objektivit mbi bazë vjetore janë pozitive deri në fund të vitit 2023.

Detyrimet e prapambetura kanë pasur një trend rritës, duke krahasuar stokun e tyre me periudhën paraardhëse. Megjithatë duhet theksuar se akti normativ nr. 5, datë 18.10.2023, i miratuar së fundmi, përbëhet nga rialokime buxhetore ndërmjet programeve, kryesisht në projekte të shpenzimeve kapitale, gjë që ndikon pozitivisht në pastrimin e një pjese të madhe të stokut të detyrimeve të prapambetura, me qëllim të përmbushjes së objektivit përfundimtar për vitin 2023. Grafiku më poshtë ilustron ecurinë e detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme nga viti 2018 deri në 9M 2023:

Grafiku 1: Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme, në milionë lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

.

Deri në fund të muajit shtator 2023, u regjistrua një stok kumulativ prej 20.33[1] miliardë lekë i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- *totali detyrimeve të prapambetura të qeverisjes qendrore rreth 12.51 miliardë lekë;*

- *totali detyrimeve të prapambetura të qeverisjes vendore rreth 7.82 miliardë lekë.*

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për 9M 2022, rezulton se:

- *Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 3.38 miliardë lekë më i lartë, ose një rritje me 19.9%- Konkretisht, detyrimet e prapambetura nga qeverisja qendrore janë rritur me rreth 2.22 miliardë lekë dhe detyrimet e prapambetura nga qeverisja vendore janë rritur me rreth 1.16 miliardë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

- *Për periudhën 9-mujore 2023, ashtu si në periudhën 9-mujore 2022, nuk rezultojnë detyrime për rimbursimin e TVSH-së.*

1.3. *Njoftoni vendimet për garancitë e reja shtetërore dhe huadhënien e subjekteve publike nëpërmjet një vlerësimi sistematik të riskut*

Stoku i borxhit të garantuar (të disbursuar dhe të papaguar), si dhe huatë e garantuara të nënshkruara dhe që pritet të disbursohen, përbëjnë riksun e buxhetit që rrjedh nga detyrimi kontingjent i këtyre garancive. Mundësitë e garancive që kërkohen janë të konsiderueshme dhe për këtë arsye ne përfshijmë fonde shtesë në kategoritë përkatëse buxhetore, si shpenzimet e interesit dhe zëri i shlyerjes së borxhit, që mund të nevojiten për të paguar nëse detyrimet e kredisë së garantuar nuk paguhen nga huamarrësit. Vlerësime të tilla zakonisht bëhen bazuar në sjelljen historike të përfituesve ose në kushtet e tyre financiare aktuale të njohura. Në këto kushte është krijuar një detyrim i akumuluar i subjekteve huamarrëse ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për të mundësuar arkëtimin e këtyre detyrimeve, që rrjedhin nga të dyja llojet e instrumenteve, garanci apo kredidhënie, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përfunduar së fundmi disa ndryshime ligjore për të angazhuar një strukturë specifike të specializuar me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.

Gjithashtu, parashikohet një analizë e përforcuar në dhënien e garancive dhe operacineve të reja në huadhënie, gjë që pritet të ndikojë në një performancë më të mirë të huamarrësve ndaj detyrimeve të tyre. MFE po kërkon të forcojë kapacitetet e analizës dhe vlerësimit të rreziqeve dhe ndikimeve buxhetore që rrjedhin nga garancitë dhe huadhëniet. Asistenca në këtë drejtim synohet të sigurohet përmes programit GDRM të Bankës Botërore, e cila po mbështet vazhdimisht aktivitetet e menaxhimit të borxhit dhe që pritet të ndihmojë edhe në zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës për dhënien e garancive dhe huadhënien, të mbështetur me një metodologji vlerësimi të formalizuar të fokusuar në administrimin e rrezikut të mundshëm në portofolin e ardhshëm.

Udhëzimi i politikave 2

2.1 *Të vazhdojnë masat për të rritur të ardhurat tatimore si pjesë e PBB në një mënyrë "miqësore" me rritjen, duke marrë parasysh rezultatet e një konsultimi të gjerë publik mbi politikat tatimore*

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (MTRS) është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shqipëria ka nisur zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave. Drafti i strategjisë u konsultua për një periudhë të gjatë kohore me të gjithë faktorët përkatës. Zbatimi i strategjisë u shty nga viti 2020 më 2022-in për shkak të: Pasojave të tërmetit të nëntorit 2019; Situatës pandemike COVID 19; Pasojat ekonomike të konfliktit Rusi–Ukrainë. Zbatimi nisi nga 1 janari 2022, pas miratimit në dhjetor 2021 të "Paketës Fiskale 2022", kryesisht me masat e rekomanduara nga FMN-ja në fushën e akcizave. Në kuadër të kësaj pakete, një sërë përjashtimesh nga akciza u eliminuan, si dhe u rritën akcizat për një sërë produktesh si duhani. Në dhjetor 2022 u miratua "Paketa fiskale 2023", e cila përmban masa të mëtejshme të parashikuara në Strategji, dhe në 3-mujorin e parë të 2023 u diskutua dhe u miratua në parlament ligji i ri "Për tatimin mbi të ardhurat", i cili përmban një seri masash të kësaj strategjie në fushën e tatimeve direkte.

Gjatë vitit 2023, është hartuar dhe është në proces miratimi ligji i ri "Për tatimin në pronë", i cili është pjesë e reformës së Strategjisë Afatmesme të

[1] Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe universiteteve.

të Ardhurave dhe synon përmirësimin e të ardhurave nga kjo taksë.

Zbatimi i strategjisë së MTRS në fushën e politikave tatimore do të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme, duke rishikuar taksat mbi pasurinë e paluajtshme dhe burimet e tjera të të ardhurave.

Zbatimi i masave të rekomanduara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të përfshira në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave në lidhje me administratën tatimore dhe doganore, ka filluar nga 1 janari i vitit 2022, ku arritja më e rëndësishme ishte zbatimi i sistemit të fiskalizimit, duke përfshirë *e-faturimin*, si rezultat i të cilit janë rritur të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Si rezultat i zbatimit në vitet 2022 dhe 2023 të masave (politika dhe administrata tatimore) të parashikuara në Strategji, të ardhurat tatimore në vitin 2023 parahikohet të jenë sa 26% e PBB-së, nga 25.2% që rezultuan në vitin. 2019 (viti bazë për matjen e efekteve të zbatimit të Strategjisë), ose +0,8% rritje e PBB-së.

Objektivi final i Strategjisë 2022–2026 është rritja e të ardhurave me +2.5% të PBB-së deri në fund të vitit 2026. Pra, në vitet e ardhshme 2024–2026 objektivi është rritja e të ardhurave me +1.7% të PBB-së. kryesisht nga përmirësimi i administratës tatimore dhe doganore.

2.2 *Plotësoni procedurat për të krijuar plotësisht National Single Project Pipeline (NSPP) dhe për të avancuar ndryshimet e nevojshme ligjore për të integruar plotësisht PPP-të në NSPP*

Në fund të vitit 2022 është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022, "Për procedurat e investimeve publike". Ndryshimet kryesore janë parashikuar për zgjidhjen e problemeve të identifikuara. Në shkurt 2023, baza ligjore u plotësua me udhëzimin e ministrit të Financave nr. 4, datë 20.2.2023, ku përcaktohet kufiri financiar i vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikën e sektorit, në bazë të të cilave metoda dhe procedura e vlerësimit të projektit. Sipas VKM-së për procedurat PIM, projektet e klasifikuara si jostrategjike dhe që kanë një vlerë totale të projektit nën kufirin e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, i paraqiten për vlerësim dhe miratim vetëm Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Këto projekte nuk janë pjesë e *listës unike* të projekteve me rëndësi kombëtare dhe procedurat e ndjekura për këto projekte investimi për identifikimin, përgatitjen dhe miratimin janë më të thjeshta. Ndërkohë për të gjitha projektet e tjera të klasifikuara si strategjike kërkohen analiza të thelluara për proceset e identifikimit të projektit, përgatitjes, dorëzimit të dokumenteve dhe vlerësimit deri në miratimin përfundimtar.Këto projekte dorëzohen për vlerësim në të njëjtën kohë në MFE dhe SASPAC. Për këto projekte kërkohen studime të plota fizibiliteti. Për projektet mbi 10 miliardë lekë (100 milionë dollarë), VKM-ja përcakton rishikimin e jashtëm të studimeve të fizibilitetit. Miratimi përfundimtar i projekteve të reja të investimit që do të financohen bëhet nga MFE vetëm në kuadër të procesit të përgatitjes së PBA-së.

Për sa i përket formës së financimit, përcaktohet se nëse PPP-ja konsiderohet si opsion, duhet të paraqiten argumente të qarta për të justifikuar këtë propozim duke e krahasuar këtë opsion me formën standarde të financimit. Gjithashtu, në përmbajtjen e studimit të fizibilitetit duhet të paraqiten të gjitha opsionet e financimit, të argumentuara në detaje. Për detyrimet e prapambetura është përcaktuar konkretisht: "Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare që lidhen me projektet e reja të investimeve publike, gjatë zbatimit të tyre nuk lejohet të shpërndahet më pak se 20% e vlerës së plotë të projektit përkatës në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore gjatë vitit të parë, më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të dytë dhe më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të tretë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në dokumentin e studimit të fizibilitetit dhe projektin e ri të miratuar nga PBA-ja 2023–2025".

Me qëllim zbatimin e duhur të VKM-së nr. 887, MFE me mbështetjen e Bankës Botërore organizoi një *workshop* me përfaqësues të ministrive të linjës, në fund të muajit mars. Përmbajtja e seminarit ishte një ndërveprim ndërmjet pjesës teorike me ndryshimet kryesore në VKM-në e re dhe ushtrimeve me shembuj konkretë. Në korrik 2023, referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 887 "Për procedurat e investimeve publike", është miratuar VKM nr. 447, datë 26.7.2023, ku është miratuar lista e NSPP-së. Departamenti i PIM-së po ndjek me përpikëri procedurat e VKM-së për përgatitjen e PBA-së 2024–2026 dhe buxhetin vjetor për vitin 2024.

2.3 *Rrisni shpenzimet në arsim, mbrojtje sociale dhe shëndetësi si përqindje e shpenzimeve totale dhe nxirrni udhëzime për mbledhjen e të dhënave mbi shpenzimet publike për Kërkim dhe Zhvillim*

Shpenzimet për arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale në vlera nominale janë në rritje nga viti 2018 deri në vitin 2024, të paraqitura në tabelën e shpenzimeve në milionë lekë sipas funksionit të qeverisë më poshtë.

Sektoret		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	AN 2023	2024
Arsimi	në milion lekë	44,131	46,208	44,760	46,079	47,914	51,605	55,684	54,150	58,402	62,966	69,016	78,894
	në % PBB	3.3%	3.3%	3.1%	3.1%	3.1%	3.2%	3.3%	3.3%	3.1%	2.9%	3.0%	3.2%
Shendetesia	në milion lekë	35,391	41,881	39,475	41,802	45,352	49,004	51,182	51,590	63,570	63,792	67,291	72,247
	në % PBB	2.6%	3.0%	2.8%	2.8%	2.9%	3.0%	3.0%	3.1%	3.4%	3.0%	2.9%	3.0%
Mbrojtja Sociale	në milion lekë	122,891	131,356	131,743	139,230	144,066	151,149	158,954	177,760	180,724	198,087	205,884	238,027
	në % PBB	9.1%	9.4%	9.2%	9.5%	9.3%	9.2%	9.4%	10.8%	9.7%	9.3%	8.9%	9.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Në përqindje ndaj PBB-së, sektorët ruajnë nivelet mesatare të financimit të marrë në vite. Për vitin 2024 rritja e sektorit të arsimit dhe shëndetësisë është e konsiderueshme pasi përfshinë dhe politikën e rritjes së pagave e cila parashikon rritje të ndjeshme të pagave mesatare për mësuesit dhe stafin mjekësor. Për shpenzimet që lidhen me funksionin e kërkimit dhe zhvillimit jemi duke punuar me INSTAT-in për hartimin e metodologjisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për shpenzimet publike për kërkim dhe zhvillim.

Udhëzimi i politikave 3

3.1 *Të vazhdohet të vlerësohen dhe të analizohen me kujdes zhvillimet në ecurinë e çmimeve, përfshi duke publikuar indikatorë shtesë për presionet e qëndrueshme inflacioniste, dhe të sigurohet një kurs shtrëngues i mjaftueshëm i politikës monetare në mënyrë që të ruhet stabiliteti i çmimeve në afat të mesëm, duke përfshirë edhe shtrëngim të mëtejshëm nëse gjykohet e nevojshme*

Banka e Shqipërisë mbetet e plotësisht angazhuar kundrejt përmbushjes së objektivit të saj kryesor të politikës monetare, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Presionet në rritje inflacioniste gjatë vitit 2022 kërkuan një normalizim gradual të qëndrimit të politikës monetare. Banka e Shqipërisë, e cila operon nën një regjim të shënjestrimit të inflacionit kombinuar me një kurs të lirë të këmbimit, rriti normën bazë të interesit nga një minimum historik prej 0.5% në 2.75% përgjatë vitit 2022, duke i komunikuar njëkohësisht tregjeve angazhimin e saj të palëkundur kundrejt kthimit të inflacionist në objektiv brenda një harku kohor të arsyeshëm. Banka e Shqipërisë vijoi me rritjen e normës bazë të interesit me 0.50 pikë përqindjeje përgjatë vitit 2023 për të adresuar qëndrueshmërinë e presioneve të brendshme inflacioniste. Norma e inflacionit pritet të ngadalësohet gradualisht dhe t'i afrohet objektivit të inflacionit prej 3% gjatë mesit të vitit 2024. Kjo trajektore faktorizon një tërheqje të mëtejshme ë stimulit monetar në ekonomi.

Banka e Shqipërisë përdor disa tregues të ndryshëm për të matur presionet e qëndrueshme inflacioniste, të cilat i shërbejnë kalibrimit më të mirë të politikëbërjes monetare. Aktualisht, ajo po publikon çdo muaj në web faqen e saj një matje të inflacionit bazë. Me qëllim përmirësimin e informacionit dhe analizës që udhëheq vendim-marrjen dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste, ajo planifikon publikimin e një grupi më të zgjeruar të matjeve të inflacionit gjatë vitit 2024..

3.2 *Të sigurohet një raportim transparent dhe i saktë i cilësisë së aktiveve dhe provigjionimin e përshtatshëm, të reduktohen më tej pengesat e mbetura për zgjidhjen e huave me probleme, veçanërisht duke zgjidhur bllokimin e ndërmjetësimit të përmbaruesve dhe të zvogëlohen boshllëqet e të dhënave në veçanti në lidhje me sektorin e pasurive të paluajtshme*

Në fund të shtatorit 2023, raporti i huave me probleme qëndroi në rreth 5.2%, pranë nivelit më të ulët në më shumë se një dekadë. Që nga zbatimi i strategjisë së zgjidhjes së huave me probleme në vitin 2015, raporti i huave me probleme ka rënë ndjeshëm duke liruar kapitalin e bankës dhe duke mbështetur rritjen e kredisë. Pavarësisht preferencës së saj për një raport të ulët të huave me probleme, BSH-ja nuk ka një prag të synuar pasi do të ishte joreale në një mjedis ekonomik dhe financiar që ndryshon vazhdimisht. Me zbatimin e IFRS 9 në të ardhmen e afërt, të dhënat në lidhje me kreditë me probleme, duke përfshirë raportin e huave me probleme, do të përputhen më mirë me standardet ndërkombëtare dhe më të krahasueshme me të dhënat nga juridiksionet e tjera. Për më tepër, përvoja e fituar gjatë viteve të fundit në menaxhimin

e huave me probleme, ka treguar se vendosja e kornizave efektive të zgjidhjes së huave me probleme është e rëndësishme jo vetëm për të reduktuar huat me probleme nga një nivel i lartë, por edhe për të ndihmuar në parandalimin e akumulimit të tyre në radhë të parë. Në këtë drejtim, qeveria do të angazhohet në mënyrë aktive në zgjidhjen e ngërçit përmbarimor, duke ulur kështu më tej pengesat për zgjidhjen e huave me probleme.

Për sa i përket reduktimit të boshllëqeve të të dhënave në sektorin e pasurive të paluajtshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi në datën 4 tetor 2023 rregulloren nr. 44 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet në prona të paluajtshme". Rregullorja përcakton rregullat për mbledhjen dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave mbi ekspozimet e bankave në lidhje me kreditimin dhe investimet në pasuri të paluajtshme, si dhe i jep Bankës së Shqipërisë të drejtën të përdorë disa nga këta tregues që lidhen me standardet e kredisë për pasuritë e paluajtshme, si instrumente të politika makroprudenciale për të adresuar rrezikun sistemik.

Në mënyrë më të detajuar, rregullorja përcakton:

- konceptet dhe termat për monitorimin dhe kontrollin e ekspozimeve të sektorit bankar në tregun e pasurive të paluajtshme (huadhënie ose investime, flukse ose aksione), duke përfshirë përdorimin e treguesve përkatës si kredia në vlerë, shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave etj.;
- proceset që bankat duhet të ndjekin për të mbledhur, organizuar dhe raportuar të dhënat përkatëse për ekspozime të tilla;
- e drejta e Bankës së Shqipërisë për të përdorur disa prej këtyre treguesve si instrumente makroprudenciale për të zbatuar kufizime sasiore dhe cilësore për ekspozime të tilla;
- mënyra se si Banka e Shqipërisë i përcakton dhe i shpall këta kufij.

Rregullorja përafron plotësisht rekomandimin përkatës të Bordit Evropian të Riskut Sistemik, nr. ESRB/2016/14, i ndryshuar me rekomandimin ESRB/2019/3, kur bëhet fjalë për ekspozime të tilla për sektorin bankar. Duke qenë se sektori bankar dominon ekspozimet e sistemit financiar në sektorin e pasurive të paluajtshme, mendojmë se rregullorja e sipërpërmendur kontribuon në adresimin e këtij segmenti të rekomandimit në masë të madhe. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 28 tetor 2023 (15 ditë nga botimi i saj në Fletoren Zyrtare) dhe bankat do të fillojnë raportimin në përputhje me të duke filluar nga marsi 2024.

3.3 *Nxitja e zbatimit të masave që synojnë promovimin e kursimit dhe huamarrjes në monedhën vendëse dhe kufizimin e përdorimit të monedhës së huaj në ekonominë reale, duke përfshirë edhe masat në përgjegjësinë e qeverisë në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit"*

Memorandumi i Bashkëpunimit i ngarkon BSH-së detyrimin për të ndjekur zhvillimet në treguesit kryesorë të niveleve të euroizimit dhe dollarizimit të sistemit financiar dhe transaksioneve financiare, përfshirë pagesat, huat dhe depozitat e publikut të gjerë. Analiza e treguesve financiarë publikohet dy herë në vit në faqen e BSH-së. Sipas raportit të fundit, të publikuar në gusht 2023, BSH-ja vëren një rritje të peshës relative të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, gjë që sugjeron ulje të rrezikut të likuiditetit nga aktiviteti në valutë, si dhe rënie të peshës së kredisë në valutë ndaj totalit të tepricës së kredisë. Ecuria e treguesve financiarë në valutë të shprehur në monedhën vendëse është ndikuar nga luhatjet e ndjeshme të kursit të këmbimit lek/euro dhe nga mbiçmimi rezultues i monedhës kombëtare, i shkaktuar nga një rritje e fortë e flukseve valutore nga turizmi dhe investimet e huaja direkte gjatë dy viteve të fundit. Rritja e flukseve hyrëse valutore solli një rritje të konsiderueshme të depozitave me afat dhe pa afat, si dhe rezultoi në një peshë më të madhe të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave. Ndonëse BSH-ja nuk ka ndërmarrë asnjë masë të re për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare që nga viti 2018, ajo mbetet e angazhuar për të vazhduar përpjekjet e saj dhe mirëpret çdo masë në kompetencën e qeverisë dhe agjencive të tjera kombëtare në këtë drejtim.

Udhëzimi i politikave 4

4.1 *Zhvilloni shërbime mbështetëse për bizneset për të krijuar një mjedis biznesi për të ushqyer tranzicionin e gjelbërimit të NVM-ve, për të përshpejtuar më tej digjitalizimin e SME-ve dhe tregtinë elektronike, për të ofruar politika të fuqishme parandalimi të falimentimit për NVM-të në rrezik dhe për të siguruar një zbatim koherent dhe të parashikueshëm të ligjit të pronës*

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022–2025 DPBP ka ndërmarrë një reformë ligjore në fushën e pronësisë industriale, duke hartuar një ligj të veçantë për çdo objekt të pronësisë industriale.

Aktualisht janë përgatitur dy projektligjet, konkretisht Projektligji për Markën Tregtare dhe Projektligji për Patentat dhe Modelin e Shërbimeve. Është dorëzuar drafti përfundimtar dhe e gjithë paketa në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për dy projektligjet. Jemi në pritje që Ministria e Financave dhe Ekonomisë t'i prezantojë në proces konsultimi publik.

- **Krijimi i Këshillit Konsultativ për NVM-të**

Zgjerimi i gamës dhe cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të biznesit duhet të ndihmojë në përmirësimin e konkurrencës së SME-ve. Përmbajtja e ofertave bazohet në nevojat e kompanive, të cilat dalin nga gjendja e tregut si dhe tendencat aktuale. Kjo përfshin kryesisht temat e promovimit të eksportit, digjitalizimit dhe zhvillimit të biznesit të gjelbër.

Megjithatë, për të zhvilluar dhe forcuar më tej këto shërbime biznesi në mënyrë të strukturuar dhe sistematike, në vitin 2023 do të ngrihet një Këshill Konsultativ për SME-të, i cili do të japë mendime dhe këshilla për mbështetjen e SME-ve, gjithashtu me përfshirjen e përfaqësuesve nga sektori privat, institucionet financiare si dhe përfaqësues të shoqatave të biznesit.

- **Studimi mbi Ekonominë e Gjelbër dhe Dialogun e Gjelbër**

Me mbështetjen e projektit GIZ (Proseed) u përgatit një studim "Studimi i fushëveprimit të ekonomisë së gjelbër në Shqipëri". Studimi identifikoi dy sektorë strategjikë kyç për gjelbërimin e ekonomisë së Shqipërisë. Sektorët e përzgjedhur janë:

i. Energjitë e rinovueshme (përqendrimi i energjisë diellore): koncepti i tranzicionit të gjelbër në sektorin e energjisë i referohet kalimit nga lëndët djegëse fosile në burimet e rinovueshme të energjisë si burim primar i energjisë. Ka shumë prova që energjia diellore kontribuon në rrjetin e energjisë së pastër, nuk lëshon ndotës dhe diversifikon energjinë e pastër duke reduktuar varësinë e energjisë nga importet dhe luhatjet e çmimeve. Për më tepër, tranzicioni i gjelbër do të përfshijë paralelisht masat e efikasitetit të energjisë, të tilla si përdorimi i rrjeteve inteligjente dhe pajisjeve me efikasitet të energjisë për të reduktuar konsumin e përgjithshëm të energjisë.

ii. Tekstile/veshje/prodhim këpucësh: është një sektor i lidhur ndërkombëtarisht dhe i mirorganizuar me një nivel të lartë formaliteti dhe shumë NVM që punojnë në këtë sektor dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare. Ky nënsektor intensiv i industrisë së prodhimit, lejon një shtrirje të madhe dhe lejon mundësinë për të punuar përgjatë zinxhirëve të furnizimit relativisht të mirëorganizuar për të promovuar një tranzicion të drejtë. Ekziston po aq një potencial i lartë për të lokalizuar aktivitetet dhe për të kontribuar kështu në markimin e industrisë shqiptare. Për sa i përket përshpejtimit të tranzicionit të gjelbër në sektorin e tekstilit, nevojiten veprime të caktuara për të reduktuar përdorimin e kimikateve dhe ngjyrave të dëmshme në prodhimin e tekstilit dhe promovimin e qarkullimit në tekstile duke reduktuar mbetjet dhe duke përdorur materiale më të qëndrueshme.

Rekomandimet e studimit: Tranzicioni në një ekonomi të gjelbër në Shqipëri ofron një sërë përfitimesh të përbashkëta ekonomike duke përfshirë rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit, aksesin në tregje me vlerë më të lartë, vende pune "të gjelbra", tërheqjen e IHD-ve dhe mbështetjen e donatorëve. Megjithatë, nuk është një proces automatik. Kërkon përpjekje të përqendruara nga të gjitha palët e interesuara në drejtim, të:

- zhvillimi dhe zbatimi i përzierjes së duhur të politikave për të nxitur investimet në teknologjitë e gjelbra;
- ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme publike;
- ofrimi i asistencës teknike dhe financiare për sektorin privat duke adoptuar modele të gjelbra të biznesit dhe metoda të qëndrueshme prodhimi.
- Zbatimi i "Zgjidhjeve digjitale dhe të gjelbra për MSME-të" (Connect IT, PREMA, ERP/CRM tools) 12/2022 – në vazhdim

Menaxhimi efikas i burimeve fitimprurëse – MEBF: MEBF është një metodologji që motivon kompanitë të realizojnë një nga "katër përfitimet":

- rritja e efikasitetit ekonomik;
- përmirësimi i performancës mjedisore dhe klimatike;
- rritja e kapaciteteve organizative;
- menaxhimi efektiv i rreziqeve dhe çështjeve sociale;
- 25 biznese kanë përfunduar me sukses të paktën 1 sfidë;
- 14 trajnerë janë tashmë të certifikuar dhe të disponueshëm në tregun shqiptar.

Lidhja e nismës së IT-së (në bashkëpunim me komponentin e BE-së për Inovacion): Lidhja e

studentëve dhe MSME-ve për të digjitalizuar proceset e biznesit (p.sh. faqet e internetit, aplikacionet, prania digjitale në internet, CRM, tregtia elektronike etj.).

Gjatë ciklit 1 të Connect IT 2.0 (termi i vjeshtës 2022):

- 26 MSME zbatuan me sukses masat digjitale (nga të cilat 18 ishin përfitues të CoSolve 19)

- Mbi 110 studentë nga 2 universitetet kryesore publike (AMU Durrës, FEUT i Universitetit të Tiranës) u përfshinë në projekt.

Gjatë ciklit 2 të Connect IT 2.0 (termi pranveror 2022):

- 25 MSME aktualisht po integrojnë zgjidhje digjitale

- Janë përfshirë mbi 120 studentë nga 4 universitete të tjera (Universiteti Politeknik i Tiranës – FTI, Universiteti Polis, Universiteti Epoka dhe Universiteti Metropolitan i Tiranës).

- Zbatimi i Marrëveshjes Financiare: Grantet për inovacione të gjelbra dhe digjitale 11/2022 – në vazhdim

Marrëveshja financiare për themelimin e Njësisë për Zbatimin e Projektit ProSEED 2.0 (PIU) është nënshkruar në 11/2022 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe GIZ, si agjenci zbatuese e projektit.

Nëpërmjet Marrëveshjes Financiare, 450,052.70 euro do të menaxhohen nga Njësia për Implementimin e Projektit (PIU) ProSEED 2.0 në MEF për mbështetjen e granteve për bizneset. Grantet do të jepen për sipërmarrësit inovativë dhe startup-et ekzistuese. Nisma synon dhënien e deri në 75 grante për sipërmarrësit.

PIU është krijuar zyrtarisht në MFE dhe është duke punuar në thirrjen e parë për grante.

E-Commerce

Një grup pune për hartimin e Planit të Veprimit për tregtinë elektronike është ngritur në vitin 2022 me urdhër të MFE-së. Përfaqësimi është nga institucione të ndryshme. Grupi i punës ka disa detyra.

Është përgatitur draftstruktura e programit lehtësues, miratuar nga shoqata e tregtisë elektronike. Aktualisht po mblidhen komente, sugjerime dhe kontribute në lidhje me hartimin e masave të Planit të Veprimit.

- **Nisja e "Progamës së gatishmërisë/ promovimit të eksportit" (sipas "Politikës së eksportit shqiptar 2023–2027)**

MFE po punon për hartimin e Programit të Eksportit 2024-2027 me bashkëpunim dhe konsultim me palët e interesuara private dhe publike. Puna për programin e eksportit duhet të vazhdojë dhe të vijojë konsultimet për t'u pasuruar me rekomandime deri në finalizim.

Rezultatet kryesore të programit Cosolve (deri në mars 2023):

- 707 pjesëmarrës në shërbime këshillore (rreth 35% janë biznese të udhëhequra nga gratë);

- 299 biznese morën një grant CoSolve (d.m.th. 42% e pjesëmarrësve të trajnimit);

- 84% e MSME-ve u shprehën se rregullimet e biznesit ndihmuan në stabilizimin e biznesit (Rd.1 përfitues, N=198);

- 89% e MSME-ve rritën punësimin që nga pjesëmarrja në CoSolve-19 (656 persona të punësuar rishtas ose përsëri).

- Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë përgjegjëse për Zhvillimin e Biznesit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Sa i përket Drejtorisë përgjegjëse për Zhvillimin e Biznesit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është miratuar Struktura e re e MFE-së dhe nga prilli 2023, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Biznesit ka tre sektorë, sektorin e konkurrencës, sektorin e programeve dhe projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik dhe Sektori i Analizave, Monitorimit dhe Promovimit. Numri i përgjithshëm i personelit në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit të Biznesit është 10 punonjës. Ky konfigurim i ri i strukturës i jep një tjetër frymëmarrje politikave të promovimit të biznesit.

Përfaqësuesit e departamentit të lartpërmendur në MFE, përmes mbështetjes së programit GIZ të Qeverisë Gjermane, po planifikojnë të organizojnë një vizitë studimore në tetor 2023 për politikëbërësit dhe institucionet vartëse (përfshirë AIDA-n dhe dhomat e tjera të tregtisë) në Rajonin e Kryeqytetit Gjerman, me objektivin kryesor për të forcuar kapacitetet për hartimin e strategjive koherente të transformimit strukturor dhe masave përkatëse të politikave. Pjesëmarrësit do të njihen me hartimin e strategjisë përkatëse dhe proceset e zbatimit për të shkëmbyer përvojë, për të ndërtuar marrëdhënie me praktikuesit e politikës industriale gjermane dhe për të identifikuar mësimet e nxjerra bazuar në shembuj konkretë.

- **Trajnim për ofrimin e "Shërbimit pas kujdesit" në AIDA**

Për të ruajtur përmirësimin dhe shtrirjen e Rrjetit të Kujdesit pasues dhe Programit të Shërbimit të Investitorëve në nivel vendor, 15 anëtarë të stafit të AIDA-s morën seanca trajnimi për të zhvilluar partneritet me bashkitë Vorë, Kavajë dhe Kamzë dhe për të ofruar këshillim investimi për 35 biznese të përzgjedhura. Trajnimi forcoi kapacitetet dhe ndikoi në përpjekjet reformuese të qeverisë shqiptare.

Në periudhën 2022–2023, me kontributin e RisiAlbania, gjithsej 612 biznese (42% në pronësi të grave) nga tre sektorët e agrobiznesit, turizmit dhe TIK-ut përfituan akses në shërbime të reja, standarde dhe tregje të reja. Nga këto, 80 biznese u certifikuan sipas standardeve të reja ndërkombëtare të cilësisë.

Në TIK, 361 biznese përfituan nga shërbimet e e-commerce, zgjidhjet digjitale të ndërmarrjeve dhe shërbimet e sigurisë kibernetike. Në turizëm, 101 biznese përfituan shërbime me standarde cilësore, shërbime të zhvillimit të produkteve dhe marketingut. Në agrobiznes, 150 biznese përfituan nga shërbimet e certifikimit të partnerëve sipas standardeve të cilësisë, gjurmueshmërisë, marketingut të eksportit dhe bujqësisë me kontratë.

Si rezultat i këtyre shërbimeve, bizneset në të tre sektorët rritën të ardhurat shtesë neto nga shitjet me 756,296 euro dhe krijuan 766 vende të reja pune (427 gra).

Platforma "Business to Business".

Platforma Business to Business (B2B) është një rrjet aktiv që ofron mundësi për bashkëpunime dhe investime të suksesshme mes bizneseve. Kjo platformë është një mekanizëm lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime të frytshme dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit.

Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, në datën 18 shtator 2023, publikohen 1092 profile të kompanive shqiptare, me qëllim që kompanitë të jenë të dukshme për partnerët e mundshëm për të bërë biznes.

Fushata "Made in Albania".

"Made in Albania" është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve "Made in Albania". Fushata ka nisur në korrik 2020 dhe deri më 18 shtator 2023, 260 produkte vendore janë publikuar dhe promovuar në faqen e internetit të institucionit dhe rrjetet sociale. Në kuadër të nismës për promovimin e produkteve "Made in Albania", Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve publikoi "Zgjidh Local", katalogun e parë të produkteve "Made in Albania".

Publikimi i broshurave informative

Gjatë vitit 2023, AIDA ka publikuar dy udhërrëfyes të rinj, përkatësisht:

1. Udhëzues për ndërkombëtarizimin e MSME-ve shqiptare (Certifikimet).

2. Një udhëzues i shkurtër mbi pjesëmarrjen e drejtë për MSME-të shqiptare

Panairet kombëtare dhe ndërkombëtare

Një nga funksionet e AIDA-s është të mbështesë dhe lehtësojë pjesëmarrjen në panairet kombëtare dhe ndërkombëtare për MSME-të shqiptare. Gjatë vitit 2023, AIDA mori pjesë në panairet e mëposhtme:

Panairet kombëtare:

- Panairi "Ditët e Bujqësisë", 27–29 prill 2023, Lushnjë, Shqipëri.

- "Food and Drinks Expo 2023" Expo City, 23–25 maj 2023, Tiranë, Shqipëri.

Panairet Ndërkombëtare:

- Panairi "Food Expo", 18–20 mars 2023, Athinë, Greqi.

- "MACFRUIT Expo", 3–5 maj 2023, Rimini, Itali.

- "ISPO MUNICH FAIR 2023", 28–30 nëntor 2023, Munih, Gjermani.

Platforma e qasjes në financa

AIDA, në kuadër të "Rritjes së aksesit në financa për MSME-të" (BIDS 2021-2027), me mbështetjen e BERZH-it ka krijuar platformën "Access to Finance" për t'i shërbyer MSME-ve kompanitë shqiptare, të cilat duan të zgjerohen dhe investojnë në aktivitet duke përfituar nga mundësitë financiare që ofron tregu, me grante, kredi apo iniciativa të tjera financimi.

Platforma "Qasja në financa" u lançua në maj 2021 dhe është pritur në domenin AIDA. Në këtë platformë MSME-të mund të gjejnë informacion të përditësuar mbi instrumentet financiare që janë në dispozicion për t'i mbështetur nga qeveria shqiptare dhe donatorët. Informacionet e përditësuara për thirrjet e ndryshme për aplikime nga SME-të shqiptare mirëmbahen dhe menaxhohen nga AIDA (www.aida.gov.al).

Gjatë vitit 2023, platforma u pasurua me funksionalitete të reja që përfshijnë:

- një ndarje e qartë midis granteve dhe "skemave të tjera financimi";
- një hapësirë e dedikuar për ekspertët ku aplikantët mund të gjejnë lehtësisht dhe të kontaktojnë ekspertin që u nevojitet;
- një hapësirë e dedikuar për dëshmitë e suksesit;
- një hapësirë e dedikuar për komente/sugjerime.

Statistikat e platformës

Platforma përditësohet në baza javore dhe publikohen mesatarisht 3-4 thirrje në muaj. Në mënyrë tipike, thirrjet që fokusohen në veprimet që lidhen me inovacionin, teknologjinë dhe arsimin janë më të vizituarat. Deri më 18 shtator 2023, në platformë janë publikuar 116 thirrje për aplikim dhe ueb-faqja kryesore është vizituar gjithsej 61,408 herë.

Përdoruesit më të shpeshtë vijnë nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia, Franca dhe Kosova. Mosha mbizotëruese e përdoruesve është 25-34 vjeç (33,5%) dhe 18-24 vjeç (27,5%). Nuk ka asnjë hendek të madh për sa i përket gjinisë, ku 54.15% e përdoruesve janë meshkuj dhe 45.85% femra.

4.2 *Rritni elasticitetin e energjisë dhe diversifikimnt drejt tranzicionit të energjisë së gjelbër për të zbatuar Agjendën e Gjelbër, veçanërisht për energjinë elektrike, eficiencën e energjisë dhe acquis për klimën*

Shqipëria ka transpozuar tashmë plotësisht rregullat e tregut të energjisë elektrike që rrjedhin nga Paketa e Tretë e Energjisë e BE-së dhe ka arritur një progres të mirë në zbatimin praktik të tyre nëpërmjet zhvillimeve legjislative, reformave sektoriale dhe hapjes graduale të tregut të energjisë elektrike. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes janë plotësisht të ndara dhe veprojnë të pavarur nga çdo interes i tregut në prodhimin dhe/ose furnizimin me energji elektrike.

Tregu konkurrues i balancimit dhe shërbimeve ndihmëse është tashmë në funksionim i organizuar nga operatori i sistemit të transmetimit OST sh.a. në zbatim të rregullave të tregut të miratuara nga ERE. Zgjerimi i shkallës së tregtimit të energjisë elektrike me bazë tregu pritet të rrisë likuiditetin e kufizuar deri tani të saj. Të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike në Shqipëri kanë të drejtë të zgjedhin dhe të ndërrojnë furnizuesin e tyre. Hapja graduale e tregut të energjisë elektrike pritet të rezultojë në hapjen e plotë të tregut në vitin 2024. Bursa shqiptare e energjisë ALPEX e krijuar nga operatorët e sistemit të transmetimit të Shqipërisë OST dhe Kosovës u ndez në 12 Prill 2023.

Shqipëria po përgatitet për transpozimin dhe zbatimin e modelit të ri të tregut të energjisë elektrike të përpunuar nën Paketën e Energjisë së Pastër të BE-së dhe kodet e rrjetit të energjisë elektrike, duke adresuar rregullat e tregut të brendshëm të energjisë elektrike – p.sh., direktiva 2009/944, rregullorja (BE) 2019/943 dhe rregullorja (BE) 2019/941 do të transpozohet plotësisht deri në vitin 2024.

Pesha e burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin e energjisë në Shqipëri arriti në 45.01% në vitin 2020, duke tejkaluar objektivin e vendit prej 38%. Shqipëria është një nga tri Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, e cila ka arritur objektivin e saj për energjitë e rinovueshme për vitin 2020. Vendi vazhdon të jetë kryesuesi për sa i përket zbatimit të ankandeve për projektet e burimeve të rinovueshme.

Ligji për burimet e rinovueshme të energjisë (BRE) në përputhje me direktivën e energjisë së rinovueshme (BE) 2018/2001, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, në mars 2023 (ligji nr. 24/2023, datë 23.3.2023, "Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme. Burimet). Ligji i ri sjell një sërë risive në sektorin e energjisë elektrike, duke përfshirë atë që një komunitet i energjisë së rinovueshme ka të drejtën të prodhojë, konsumojë dhe shesë energji të rinovueshme dhe të ofrojë agregim, duke përfshirë marrëveshjet e blerjes së energjisë. Ai shfuqizon skemat e mbështetjes së ushqimit në tarifat, në mënyrë që të gjitha masat mbështetëse të jepen nëpërmjet procedurave konkurruese. Regjimi aktual ligjor dhe rregullator në fushën e burimeve të rinovueshme të energjisë është pjesërisht në përputhje me Direktivën (BE) 2018/2001.

Ligji nr. 24/2023 hoqi skemat mbështetëse në formën e tarifave nxitëse administrative për njësitë e vogla gjeneruese të rinovueshme deri në 2 MW dhe impiantet e erës deri në 3 MW.

Mbështetja për prodhuesit prioritarë do të jepet nëpërmjet një procesi konkurrues dhe skemave mbështetëse të bazuara në treg. Mbështetja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme mund të marrë formën e: një marrëveshje për blerje energjie (PPA), një kontratë për diferencën (CfD) ose një kontratë për premium (CfP).

MIE mund të vendosë që procesi konkurrues të jetë teknologjik neutral ose specifik për teknologjinë bazuar në potencialin afatgjatë të një teknologjie të

caktuar, nevojën për të arritur diversifikimin ose burimet e energjisë, kufizimet e rrjetit dhe stabilitetin e rrjetit, dhe kostot e integrimit të sistemit.

Koncepti i vetëkonsumatorëve të burimeve të rinovueshme i krijuar në Shqipëri me ligjin nr. 24/2023 po zgjeron fuqizimin e klientëve finalë.

Komuniteti i energjisë së rinovueshme, i krijuar me Ligjin nr. 24/2023, do të ketë të drejtë: të prodhojë, konsumojë, ruajë, ndajë, shesë energji të rinovueshme dhe të sigurojë agregim, duke përfshirë edhe marrëveshjet e blerjes së energjisë nga burimet e rinovueshme; të hyjë në të gjitha tregjet e përshtatshme të energjisë, drejtpërdrejt ose përmes grumbullimit, në mënyrë jodiskriminuese dhe të mbështesë si prodhues prioritar në përputhje me ligjin nr. 24/2023.

Vetëkonsumatorët e burimeve të rinovueshme kanë një kapacitet maksimal prej 500 kW. Ata kanë të drejtë të gjenerojnë, konsumojnë, ruajnë dhe shesin prodhimin e tyre të tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, individualisht ose nëpërmjet grumbulluesve, duke përfshirë përmes marrëveshjeve dypalëshe, furnizuesve të energjisë elektrike dhe marrëveshjeve të tregtisë nga kolegët.

Skema e kompensimit të vetë-konsumatorëve të burimeve të rinovueshme bazuar në metodologjinë e faturimit neto nga 1 janari 2024.

Shqipëria iu bashkua nismës së Komunitetit të Energjisë për të krijuar një sistem rajonal për garancitë e origjinës. Regjistri kombëtar elektronik për garancitë e origjinës në Shqipëri u krijua dhe mund të përdoret sapo rregullatori i energjisë, si organi i caktuar lëshues, të nënshkruajë një marrëveshje të drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit.

Shqipëria përparoi me zbatimin e kërkesave për eficiencën e energjisë për ndërtesat, trajnimin e ekspertëve për auditimin e energjisë dhe lëshimin e certifikatave të performancës energjetike të ndërtesave.

Stimujt për efiçencën e energjisë janë në fuqi, duke përfshirë një skemë të subvencionimit të familjeve për instalimin e ngrohësve diellorë të ujit dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë për ndërtesat arsimore dhe publike. Në tetor 2022, qeveria prezantoi objektivat e detyrueshëm të kursimit të energjisë 15% për sektorin publik, ndërsa Bashkia e Tiranës po mbështet gjithashtu banorët vendës me grante deri në 50% të kostove të izolimit për shtëpitë e tyre. Disa masa zbatuese janë miratuar në përputhje me parimin eficiienca e energjisë së pari.

Shqipëria ka miratuar një version të parë të Planit të saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

4.3 *Zbatoni brenda vitit 2024 objektivat e miratuar për klimën dhe energjinë bazuar në Planet Kombëtare të Energjisë dhe Ndryshimeve Klimatike, si pjesë e udhërrëfyesit të dekarbonizimit 2030, dhe sigurohuni që Operatori i Energjisë së Rinovueshme të jetë funksional deri në fund të vitit 2023, në përputhje me ligjin për energjitë e rinovueshme që u miratua më 23.3.2023*

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2020–2030 është miratuar nga Këshilli i Ministrave (KM nr. 872, datë 29.12.2021) dhe, ndër të tjera, përcakton objektivat dhe masat e Shqipërisë për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, eficiencën e energjisë dhe dekarbonizimin. deri në vitin 2030. Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë në dhjetor 2022 miratoi objektivat e energjisë dhe klimës për vitin 2030. Këta objektiva të rinj do të integrohen në një NECP të përditësuar, të planifikuar të miratohet deri në vitin 2024. Në NECP të rishikuar, synohet të reduktohet konsumi final i energjisë me 9.4% (krh. 8.4%), për të rritur pjesën e energjisë së rinovueshme në finale. konsumi i energjisë në 59.4% (krh. 54.) 4%, ndërsa objektivi i reduktimit të emetimeve të GS mbetet në 18.7%.

Shqipëria arriti objektivin e saj për një peshë prej 39% të burimeve të rinovueshme në konsumin total të energjisë finale për vitin 2022, bazuar në planin kombëtar të veprimit të konsoliduar të energjisë së rinovueshme (PKREAP). Zbatimi për dy fermat diellore fotovoltaike (PV) me një kapacitet total të instaluar prej 240 MW është në vazhdim (Karavasta 140 MW dhe Spitalla 100 MW). Një ankand në impiantet e erës, me një kapacitet të instaluar nga 10 MW deri në 75 MW. Kontratat e fazës së parë janë dhënë në qershor të vitit 2023, ndërsa në korrik 2023 është zhvilluar faza e fundit e ofertave ekonomike dhe tre ofertuesve iu është dhënë gjithsej 222.5 MW në kapacitet.

Pjesëmarrja në Programin Evropian – Programi i Tregut të Vetëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proces finalizimi të Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në "Programin e Tregut të Përbashkët për periudhën 2021-2027" të Unionit.

Programi i Tregut Unik (SMP) 2021–2027 financohet nga BE për të ndihmuar Tregun e Përbashkët të arrijë potencialin e tij të plotë dhe të sigurojë rimëkëmbjen e Evropës nga pandemia COVID-19.

Kostoja totale e pjesëmarrjes së Shqipërisë në program është 487,322 euro.

Udhëzimi i politikave 5

5.1 *Inkurajoni bashkëpunimin ndërmjet organizatave kërkimore të bizneseve novatore dhe akademisë, siç parashikohet në Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, duke vazhduar rritjen e financimit të shkencës dhe kërkimit, dhe duke krijuar kushtet për zhvillimin e programeve të inkubacionit të biznesit*

Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit të integruar shkencor në nivel ndërkombëtar, krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjisë për bashkëpunim ndërmjet komunitetit kërkimor, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike, si dhe promovimin e kultura e shkencës dhe inovacioni në arsim për të siguruar një qasje didaktike me theks në praktikat dhe projektet kërkimore, janë synimet afatmesme dhe afatgjata (2024–2030) të politikës në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Politika synon ngritjen e kapaciteteve për gjenerimin dhe transferimin e teknologjive nëpërmjet realizimit të objektivave (qëllimeve) specifikë, të cilët janë:

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve qendrore dhe vendore, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (Modeli i katërfishtë heliks);
- Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes për transferimin ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).
- Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik;
- Forcimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë.

Ky objektiv i politikës pasqyron SDG 9 "Industria, inovacioni dhe infrastruktura – sipas të cilit vendet janë të përkushtuara për të ndërtuar një infrastrukturë elastike, duke promovuar industrializimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe duke nxitur inovacionin". Në veçanti, ky synim pasqyron objektivat 9.5 të SDG 9, në kontekstin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm 2015–2030 për të inkurajuar maksimizimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e aftësive teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, në veçanti vendet në zhvillim, nga duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e inovacionit dhe rritjen e ndjeshme të numrit të studiuesve shkencorë dhe shpenzimet publike dhe private për kërkimin dhe zhvillimin.

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve qendrore dhe vendore, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (Quadruple Helix Model) vazhdon të mbetet një sfidë për Shqipërinë. Megjithatë, gjatë periudhës 2020-2022, ka pasur një sërë përpjekjesh që synojnë krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet katër aktorëve kryesorë të përfshirë në skemë. Kështu, gjatë vitit 2021 ka nisur zbatimi i një projekti për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë në kuadrin e programit Erasmus+ të titulluar "Ndërmjetësuesit nga universiteti në shoqëri në Shqipëri: Bashkëprodhimi i njohurive dhe kërkimit që ka rëndësi" (Projekti USIA). Ky projekt mblodhi së bashku universitete, organizata të shoqërisë civile, institucione publike dhe organizata biznesi për të përmirësuar një mjedis aftësues të arsimit të lartë që mbështet bashkëpunimin universitar me shoqërinë për të bashkëprodhuar njohuri dhe kërkime me një ndikim jo vetëm akademik, por edhe të zbatueshëm në zhvillimin e Shqipërisë në dritën e integrimit evropian dhe sfidat e shumta aktuale. Në të njëjtën kohë, projekti synonte të forconte kapacitetet institucionale dhe burimet njerëzore në universitetet në Shqipëri nëpërmjet krijimit të transferimit të dijes dhe Brokerimit të inovacionit që lidh universitetin me biznesin, qeverinë, shoqërinë civile dhe median në mënyrë të institucionalizuar dhe të qëndrueshme.. Gjithashtu, projekti krijoi dhe zgjeroi një rrjet Quadruple Helix dhe platformë online e cila do të ofronte rrjetëzim, ndërmjetësim, ngritje kapacitetesh, mbështetje dhe vlerësim për aktorët akademikë dhe joakademikë. Projekti u dha përparësi grave në akademi, kërkime dhe inovacion.

Kuadri i politikave në sektorin e arsimit të lartë inkurajon rritjen e bashkëpunimit dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta midis katër aktorëve (IAL,

biznesi, shoqëria civile dhe qeveria) në kuadër të promovimit të Modelit Katërfishtë Helix në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe teknologjisë dhe risi. Deri më tani, në kuadër të bashkëpunimit sipas këtij modeli, si produkt i projektit, janë krijuar ose forcuar 5 qendra transferimi njohurish dhe inovacioni në 5 IAL; Janë financuar dhe kanë filluar zbatimi 5 projekte pilot të bashkëpunimit universitet-biznes, si dhe janë ngritur 5 laboratorë pilot.

Megjithatë, mbetet sfidë arritja e bashkëpunimit sa më efektiv dhe produktiv ndërmjet këtyre aktorëve, bazuar në disa faktorë si: infrastruktura dhe fondet për kërkime janë të kufizuara; mungojnë stimujt për të bashkëpunuar me bizneset; Ekziston një ndjenjë e përgjithshme mosbesimi në lidhje me cilësinë e kërkimit shkencor si dhe kapacitete të kufizuara për të thithur inovacionin, mungesë njohurish e të gjithë aktorëve në lidhje me mekanizmat dhe mundësitë e financimit etj.

Në vitin 2023, NASRI-ja hapi thirrjen e parë për projekte të përbashkëta akademike-biznes në fushën e inovacionit. Me vendimin nr. 11, datë 21.7.2023, "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të teknologjisë dhe inovacionit të ardhur si bashkëpunim i universiteteve me biznes/industri, për vitin 2023", të Bordit të Administrimit, 10 projekte të përbashkëta. u themeluan (shuma totale 170 000 euro).

Masat e parashikuara në Strategjinë e re Kombëtare për Kërkimin, Shkencën dhe Inovacionin 2023–2030 (në mbledhjen e datës 20 shtator 2023, Këshilli i Ministrave vendosi të miratojë "Strategjinë Kombëtare për Kërkimin, Shkencën dhe Inovacionin 2023–2030 dhe planin e veprimit për zbatimin e tij"), për realizimin e këtij qëllimi dhe objektivat e tij specifikë, janë:

- krijimi i skemave novatore për bashkëfinancimin e programeve kërkimore-shkencore që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale sociale;
- informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit;
- promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (modeli Quadruple Helix);
- hartimi i udhëzimeve (përfshirë protokollet dhe procedurat) për projekte të përbashkëta;
- forcimi i kapaciteteve të IAL-ve, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore dhe vendore për hartimin e projekteve të përbashkëta;
- forcimi i kapaciteteve të strukturave vlerësuese të projekteve kërkimore-shkencore për përfaqësimin e biznesit në këto struktura.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Institucioni Udhëheqës i PROGRAMIT EU4INNOVATION FAZA 2-të (2023–2026), financuar nga: Marrëveshja Financiare IPA III 2021 (10 mil Euro), donatorë të tjerë: GIZ (1.2 mil euro), SIDA (0.55 mil euro).

Palë të tjera të interesuara: ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes; Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare për Kërkime Strategjike dhe Inovacion; ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; Zyra e Kryeministrit; SASPAC.

FAZA 2-të PROGRAMI I INOVACIONIT EU4 do të fokusohet në: - Zhvillimin e kapaciteteve me fokus në ekosistemin e bizneseve fillestare dhe inovacionit, - Përmirësimin e aksesit në financim për bizneset fillestare dhe organizatat mbështetëse të inovacionit përmes granteve, - Promovimin dhe zbatimin e Qasja Quadruple Helix dhe Programi Horizon Europe Promovimi i Shqipërisë si një ekosistem i start-up-eve dhe inovacionit dhe një destinacion i mirë për të bashkuar inovatorët dhe sipërmarrësit ndërkombëtarë dhe vendës, - Krijimi i Institutit të parë Evropian të Komunitetit të Inovacionit dhe Teknologjisë, në Tiranë. Ky projekt është në zbatim.

5.2 *Kryeni një pilotim të Garancisë për Rininë dhe analizoni performancën e tij, dhe paralelisht rishikoni dhe rregulloni strukturën funksionale dhe operacionale të Agjencisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (AKPA) për të përshtatur ofrimin e shërbimeve të garancisë për rininë dhe për të zhvilluar një sërë ofertash cilësore*

Kanë filluar përgatitjet për Pilotimin e Skemës së Garancisë Rinore bazuar në modelin e BE-së për të ndihmuar të rinjtë të integrohen në tregun e punës (të fokusuar te të rinjtë as në punësim, arsim apo trajnim NEET. Plani Kombëtar i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024 është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe parashikohet që në vitin 2023 të kryhet një fazë pilot dhe më tej për ta nisur në të gjithë vendin në vitet në vijim, mbështetur nga programi i BE-së IPA III. Në këtë kuadër, u miratuan përmirësimet dhe ndryshimet në ligjin nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" që u konsideruan të nevojshme për zbatimin e kësaj skeme.

Pilotimi i skemës së garancisë rinore do të bëhet në tri qarqe: Tiranë, Shkodër Vlorë, më 2023–2024. Ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me mbështetjen e projektit EU-IPA për Përfshirjen Sociale, ka trajnuar stafin e zyrave të punësimit për fazën pilot. Për fazën pilot janë vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit 100 milionë lekë.

Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AKPA kanë ndërmarrë një sërë masash për fillimin e pilotimit.

- Miratimin bazën ligjore ku përfshihet garancia për rininë;
- AKPA-ja ka hartuar planin pilot të garancisë rinore 2023–2024;
- U krijua dhe u plotësua faqja e internetit "Garancia rinore";
- Është hartuar një program statistikor për monitorimin e fazës së pilotimit;
- Është hartuar dokumenti operativ për trajnimin e stafit për pilotimin e garancisë rinore;
- Stafi i zyrës në tri rajonet e përzgjedhura është trajnuar;
- Miratua një program për mësimin e profesionit në vendin e punës.

Plani pilot përcakton të gjitha fazat dhe kontributin e institucioneve të ndryshme, për zhvillimin dhe koordinimin e politikave të punësimit, arsimit dhe sociale për të rinjtë, duke synuar heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive që të rinjtë të hyjnë në tregun e punës dhe të kenë një sukses në zhvillimin e tyre profesional.

Kjo do të bëhet përmes katër ndërhyrjeve:

1. Hartëzimi – mbledhja periodike e informacionit më të detajuar mbi kushtet ekonomike dhe sociale dhe rrugën arsimore të të rinjve.

2. Kontaktimi – kontaktimi me të rinjtë është procesi i identifikimit, lidhjes dhe përfshirjes së tyre në mjediset ku ata ndodhen, nëpërmjet ofrimit të programeve të personalizuara, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, shkollat dhe institucionet në nivel vendor.

3. Përgatitja – faza përgatitore fillon me regjistrimin e të rinjve si punëkërkues të papunë dhe përcaktimin e statusit NEET dhe përfundon me nisjen konkrete të ofertës për punësim, arsim apo trajnim, të cilat janë përcaktuar paraprakisht.

4. Ofertat – garancia rinore parashikon katër rrugë të mundshme për përfituesit e rinj: punësimi dhe vetëpunësimi; arsimi; trajnim i vazhdueshëm dhe mësim profesioni në vendin e punës.

- Bashkëpunimi me institucionet dhe partnerët

1. Identifikimi i të rinjve do të kryhet nëpërmjet: Sistemit të Shërbimeve të Punësimit; portali "Garancia Rinore"; rrjetet lokale (të rinjtë nga NE, Shërbimi Social Shtetëror, braktisësit e shkollës); kontaktimi përmes OJQ-ve; INSTAT-i.

2. Kontaktimi dhe aktivizimi do të bëhet përmes: Zyrës së Punësimit; këshillat rinorë vendorë; Oferta Garancia Rinore; OJF-të.

- Shërbimi i punësimit dhe dhënia e ofertës pas dy fazave të para do të bëhet nëpërmjet:
- intervistës;
- hartimit të Planit Individual të Punësimit;
- sigurimit të informacionit për tregun e punës dhe konsultimi i portalit të punësimit puna.gov.al;
- këshillimit për punësim/Orientim në karrierë;
- referimit ose menaxhimi i Integruar i rastit (kryesisht për grupe të veçanta);
- ofrimit i aftësive të buta dhe aftësive digjitale;
- identifikimit dhe ofrimit të ofertave cilësore për të siguruar daljen e të rinjve nga Skema e Garancisë Rinore.

5.3 *Përdorni rezultatet e Observatorit të Tregut të Punës për të përmirësuar rëndësinë e tregut të punës të arsimit dhe formimit profesional (AFP), investoni në cilësinë e tij dhe të siguroni bashkëpunimin me sektorin privat; fokusohuni në ndërtimin e aftësive të të rinjve dhe të rriturve, me një fokus të veçantë në aftësitë digjitale për të mbështetur zgjerimin e sektorit të komunikimit dhe teknologjisë*

Observatori i Tregut të Punës është krijuar përmes bashkëpunimit me UNDP-në dhe është duke u konsoliduar. Observatori mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat administrative të gjeneruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Observatori aktualisht po përpunon dhe shfaq të dhëna sipas profesionit, gjinisë dhe rajonit.

Ky instrument ka nisur të gjenerojë sinjale në tregun e punës, duke treguar një përmirësim të situatës, pasi ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të personave të punësuar në tatimet apo personave të regjistruar si ndjekës të praktikave profesionale. Të dhënat kanë dhënë sinjale për përmirësim të mjedisit të tregut të punës si dhe rritje të formalizimit. Ky instrument, i cili vazhdon të zhvillohet dhe përmirësohet, pritet të menaxhohet plotësisht nga institucionet publike përgjegjëse për tregun e punës.

Duke iu referuar të dhënave të tregut të punës, si observatori apo instrumente të tjera si gjurmimi i të diplomuarve/certifikatave të AFP-së, qeveria shqiptare, MFE dhe AKSHP kanë ndërmarrë së fundmi disa politika që synojnë të adresojnë nevojat e tregut të punës për aftësi. Në këtë kuadër, në fillim të vitit 2022, bazuar në kërkesat e tregut rajonal të punës, është hartuar një program i ri për nxitjen e punësimit (PATP) lidhur me ofrimin (nëpërmjet *outsourcing*) të trajnimeve të avancuara në fushën e TIK-ut dhe kryesisht programimit. Ky program mbështet punëkërkuesit e papunë me mbulim tarifash 100% dhe punëkërkuesit me mbulim tarifash 50%. Ky program ka filluar të zbatohet në vitin 2023 dhe ka rezultuar mjaft i suksesshëm. Gjatë periudhës janar-tetor 2023, këtë program e kanë ndjekur 953 punëkërkues dhe 126 punëkërkues të papunë.

Gjithashtu duke pasur parasysh aftësitë e kufizuara digjitale të një pjese të konsiderueshme të punëkërkuesve të papunë të regjistruar, AKSHP përmes qendrave publike të formimit profesional po zbaton kurrikulën digjitale (kurs afatshkurtër).

Ky kurs ofrohet pa pagesë për punëkërkuesit e papunë. Kurrikula "Kompetenca digjitale" trajton 5 kompetencat bazë digjitale sipas Kornizës së Kompetencave Digjitale të BE-së 2.0. Ai është i ndarë në 2 nivele dhe u shërben të gjithë qytetarëve, punëkërkuesve që duan të zhvillojnë njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit. Deri në tetor 2023, me këtë kurs janë trajnuar rreth 1875 punëkërkues të papunë.

Duke iu referuar dinamikës së tregut të punës, kërkesës së lartë të bizneseve për fuqi punëtore të kualifikuar dhe rezultateve shumë pozitive të punësimit të maturantëve nga shkollat profesionale, aktualisht po zhvillohet një fushatë agresive sensibilizuese për rritjen e numrit të regjistrimeve në shkollat e mesme profesionale.

Në fillim të vitit 2023, me urdhrin nr. 23, datë 27.1.2023, u ngrit një grup pune ndërinstitucional, me përfaqësues nga MFE-ja, MAS-i, AKSHE-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, i cili synonte të identifikonte sfidat dhe rritjen e pjesëmarrjes në Arsimin Profesional.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, për rritjen e mundësive për regjistrim në shkollat e Arsimit Profesional, u ndryshua Urdhri për transferimin e nxënësve në sistemin parauniversitar, për të mundësuar kalimin e nxënësve nga gjimnazi në shkollat arsimore profesionale.

Synohet të ketë një rritje të qëndrueshme të regjistrimeve në AP, vit pas viti, si një nga mënyrat për të mbushur hendekun midis kërkesave të tregut të punës dhe fuqisë punëtore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 është ndërmarrë edhe një nismë tjetër që synon rritjen e vizibilitetit dhe tërheqjes së Arsimit Profesional, siç është ngritja e rrjetit të profesionistëve.

Në maj 2023 u krijua faqja zyrtare e rrjetit të parë të profesionistëve në Shqipëri. AFPro është një platformë që bashkon studentë, mësues, sipërmarrës dhe biznese, profesionistë të rinj dhe politikëbërës, në një komunitet të fortë dhe të qëndrueshëm.

Në qershor 2023, u krijua një faqe e dedikuar për AFP-në http://aftesi.al/. Kjo faqe zyrtare është krijuar për të ndihmuar të gjithë studentët që dëshirojnë të marrin informacion të detajuar rreth AFP-së në Shqipëri.

Udhëzimi i politikave 6

6.1 *Deri në vitin 2024, të krijohet një mekanizëm për indeksimin vjetor të përfitimeve të "Ndihmës ekonomike" për të siguruar përshtatshmërinë e tyre bazuar në vlerësimin e kryer*

Qeveria po shqyrton rritjen e shumës së përfitimit për fëmijët, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, duke rritur masën me qëllim ndjekjen e arsimit dhe zhvillimin e kapitalit human.

6.2 *Siguroni qëndrueshmëri të shërbimeve të krijuara rishtazi dhe inkurajoni krijimin e shërbimeve të reja në kuadër të rritjes së alokimit për Fondin Social Kombëtar, veçanërisht në bashkitë që ofrojnë numrin më të vogël të shërbimeve sociale dhe me burime më të ulëta*

Fondi total i akorduar në kuadër të Fondit Social, brenda vitit buxhetor 2023 është 300 milionë lekë (34 shërbime sociale në 33 bashki (12 shërbime të reja dhe 22 shërbime ekzistuese të kujdesit social, tashmë të financuara gjatë viteve 2020–2022) dhe 15 shërbime të specializuara në 7 rajone). Bashkitë pa asnjë shërbim të kujdesit social ose me burime më të ulëta financiare, vazhdojnë të kenë prioritet gjatë procesit të vlerësimit.

Në Buxhetin Afatmesëm 2024–2026, në kuadër të Programit të Përkujdesit Social, Fondi Social pritet të rritet me 7% në vitin 2024, duke financuar të paktën 12 shërbime të reja sociale.

6.3 *Vazhdoni bashkëpunimin me AKPA-në për Strategjinë e Daljes së "Ndihmës ekonomike" për t'i referuar përfituesit në shërbimet e ofruara nga AKPA-ja, dhe në*

veçanti të analizojë dhe adresojë arsyet e refuzimit për të marrë oferta punësimi ose trajnimi

Zbatimi i Strategjisë së Daljes po vazhdon me bashkëpunimin e fortë me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim. Janë përditësuar të gjitha profilet e individëve në moshë pune dhe referuar pranë AKPA-së. Nga janari 2023 janë punësuar dhe regjistruar në formimin profesional rreth 3045 individë.

3. KUADRI MAKROEKONOMIK

3.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

Ekonomia shqiptare ka vazhduar të rritet gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Ritmi mesatar i rritjes vjetore rezultoi rreth 3%, e ndarë në 2.8% në tremujorin e parë dhe 3.2% në të dytin. Ekonomia shqiptare ka vazhduar të zgjerohet, pavarësisht ambientit të huaj ekonomik sfidues dhe kushteve të shtrënguara në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në vend. Normat e rritjes së ekonomisë kanë rezultuar janë relativisht më të zbutura krahasuar me vitin e mëparshëm, por mbeten pranë nivelit të rritjes potenciale të ekonomisë

Grafik 3.1.1: Rritja reale e PBB-së gjatë periudhës 2010 – gjysma e parë e vitit 2023



*Burimi: INSTAT. *Të dhëna gjysmë-përfundimtare. **Të dhëna paraprake.*

Aktivitetet e "shërbimeve" dhanë kontributin kryesor në rritjen ekonomike për tremujorin e parë. Ky kontribut llogaritet në rreth 2.1 pikë përqindje. Kontributet kryesore kanë buruar nga degët e "Pasurive të paluajtshme" dhe "Administrata publike dhe mbrojtja". Kontributet e shërbimeve në tërësi rezultojnë më të ulëta krahasuar me vitin e mëparshëm për shkak të ngadalësimit të normave të rritjes në degën e "Tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor".

Aktivitetet prodhuese kontribuuan me rreth 1.0 pikë përqindjeje në rritjen ekonomike të së njëjtës periudhë. Ndikimet kryesore pozitive lidhen me degën e "Ndërtimit" e cila vazhdon të japë një mbështetje të rëndësishme në rritje. Nga ana tjetër, kontributet e industrisë janë pakësuar, duke u tkurrur gjatë tremujorit të dytë të vitit. Kjo lidhet me ecuri jo të mirë si të industrisë nxjerrëse ashtu edhe të asaj përpunuese reflektuar, me rënien e eksportit të mallrave. Kontributet nga "Bujqësia" rezultuan të papërfillshme.

Grafik 3.1.2: Rritja reale e PBB-së: dekompozimi në kontribute nga kahu i prodhimit (në pp).



*Burimi: INSTAT. *Të dhëna gjysmë-përfundimtare. **Të dhëna paraprake.*

Tabelë 3.1.1: Kontributet në PBB nga kahu i prodhimit dhe kërkesës agregate, tremujore (në p.p).

Kontribut në rritjen e PBB-së (në pikë përqindje)	2022**				2023**	
	T1	T2	T3	T4	T1	T2
sipas sektorëve:						
Bujqësi, pyje, peshkim	0.0	0.1	0.0	-0.15	0.1	0.0
Industri, energji dhe ujë	0.9	0.4	0.5	0.7	0.3	-0.3
Ndërtim	1.9	-0.3	1.0	1.7	0.4	1.4
Shërbime	3.5	2.9	3.2	2.3	2.3	1.9
Taksa minus subvencione mbi produktet	1.0	0.1	0.3	-0.1	-0.4	0.2
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	7.2	3.2	4.9	4.4	2.8	3.2
sipas shpenzimeve:						
Konsum Privat	6.0	6.6	6.2	3.1	2.7	3.1
Konsum Publik	-0.6	-0.9	-0.4	-0.3	0.4	0.9
Investime	3.3	-1.1	1.7	2.8	1.6	2.4
Eksporte neto	0.0	-4.5	-7.8	-1.3	-0.5	-1.7
Inventarë dhe mospërputhje statistikore	-1.5	3.2	5.3	0.1	-1.3	-1.5
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	7.2	3.2	4.9	4.4	2.8	3.2

*Burimi: INSTAT. **Të dhëna paraprake.*

Kërkesa e brendshme u rrit me 5.1% në terma vjetorë gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, duke mbetur mbështetësi kryesor i rritjes ekonomike. Kontributet pozitive ishin me bazë të gjerë në terma të nënkomponentëve të saj. "Konsumi privat" u zgjerua me 3.7%, "Konsumi publik" me 6.8% dhe "Investimet" me 9.2%. Përgjatë tremujorëve, ecuria e investimeve ka rezultuar më e luhatshme krahasuar me përbërësit e tjerë të kërkesës së brendshme. Ato u rritën me 7.1% në tremujorin e parë, mbështetur kryesisht nga investimet publike; dhe u përshpejtuan në 11.0% gjatë tremujorit të dytë, të drejtuara nga rigjallërimi i investimeve private. Kjo trajektore e ecurisë së investimeve private pasqyron përshpejtimin e aktivitetit të ndërtimit gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Kërkesa e huaj është mbështetur nga rritja e shpejtë e eksportit të shërbimeve për gjysmën e parë të vitit 2023. Rritja e tyre reale rezultoi 13.7%, e nxitur nga zgjerimi i shërbimeve hyrëse të turizmit. Nga ana tjetër, eksporti i mallrave është pakësuar me 19.5% në terma realë në reflektim të ecurisë jo të mirë të industrisë. Në tërësi, eksportet u rritën me 2.9%. në terma realë. Megjithatë, deficiti tregtar është zgjeruar me 4.3% në terma realë si pasojë e rritjes më të shpejtë të importeve (4.6%). Kjo ecuri përkthehet në një ndikim negativ të eksporteve neto në rritjen ekonomike.

Grafik 3.1.3: Rritja reale e PBB-së nga kahu i shpenzimeve



*Burimi: INSTAT. *Të dhëna gjysmë-përfundimtare. **Të dhëna paraprake.*

Treguesit e tregut të punës kanë vazhduar të përmirësohen gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Punësimi është rritur mesatarisht me 3.5%. Rritja e punësimit është mbështetur kryesisht nga sektori i shërbimeve. Në të njëjtën kohë, vihet re një rritje e mëtejshme e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe rënie e normës së inaktivitetit. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, norma e papunësisë ka zbritur në 10.7% në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023, nga niveli 10.8% në fund të vitit të kaluar. Norma e papunësisë qëndron shumë pranë nivelit më të ulët të regjistruar (10.6% në tremujorin e tretë të vitit 2022).

Zhvillimet pozitive në tregun e punës janë pasqyruar në rritje të pagave. Rritja e pagave pasqyron kushtet e shtrënguara të punësimit dhe vështirësitë në rritje të bizneseve për gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar. Rritja e pagave është mbështetur si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik. Në rastin e sektorit privat, rritja mesatare e pagave për gjysmën e parë të vitit 2023, rezultoi 12.2%, nivel i ngjashëm krahasuar me vitin e mëparshëm. Kontributet sektoriale kanë rezultuar përgjithësisht me bazë të gjerë. Pagat janë rritur edhe në sektorin publik me 14.8% për gjysmën e parë të vitit dhe 20.5% për tremujorin e dytë. Rritjet e larta të pagës kombinuar me norma në rënie të inflacionit, kanë ndikuar në përshpejtimin e rritjes së pagës reale. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, paga reale në ekonomi është rritur me 7.5%, nga 1.5% gjatë vitit 2022.

Grafik 3.1.4: Treguesit e tregut të punës





Burimi: INSTAT (2023)

Rritja e fortë e pagës reale nga njëra anë dhe ngadalësimi i rritjes ekonomike në terma vjetorë nga ana tjetër, kanë çuar në rritje më të shpejtë të *Kostos së punës për njësi*[2]. Ky i fundit u përshpejtua në rreth 5.5% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, kundrejt 1.9% një vit më parë.

Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua me 27.3% në terma vjetorë gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, duke pasqyruar flukset në rritje të turizmit dhe remitancave. Raporti i tij ndaj PBB-së nominale ka arritur në nivelin më të ulët historik, në rreth 3.3% të PBB-së në gjashtë muajt e parë të këtij viti, nga 6.0% më 2022. Megjithëse rënia e eksportit të mallrave gjatë periudhës ka ndikuar në zgjerimin e deficitit tregtar në mallra, suficiti i lartë i eksportit të shërbimeve ka udhëhequr vijimin e përmirësimit të vazhdueshëm strukturor të pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Stoku i borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë zbriti në 52.2% ndaj PBB-së nominale në tremujorin e dytë të vitit 2023, nga niveli 60.3% një vit më parë.

Leku ka vijuar të forcohet gjatë vitit 2023, duke theksuar tendencën mbiçmuese të vërejtur në vitet e mëparshme. Kursi eur/lek filloi të bjerë në mënyrë të qëndrueshme duke nisur që prej tremujorit të dytë të vitit. Ritmi i mbiçmimit të lekut kulmoi në muajin korrik, gjatë të cilit një euro u tregtua mesatarisht me 103.2 lekë, me një ndryshim vjetor prej 12.1%. Ky mbiçmim u korrektua lehtësisht në muajin gusht. Në periudhën gusht-tetor kursi eur/lek është shfaqur më i stabilizuar, duke u luhatur rreth mesatares 106.1, ose 9.4% më poshtë se një vit më parë. Mbiçmimi i fortë i lekut vitin e fundit është diktuar nga vijimësia e përmirësimeve strukturore të sektorit të jashtëm të ekonomisë dhe nga reduktimi i primeve të rrezikut. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, prurjet e larta valutore në sektorin e turizmit, rritja e fortë e remitancave dhe rritja e qëndrueshme të IHD-ve kanë ndikuar në arritjen e një mase financimi prej 170% të deficitit korrent me flukse financiare joborxh krijuese.

Inflacioni mesatar për 10-mujorin e parë të vitit 2023, shënoi 4.9%, me një rënie prej 2.6 pikësh përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Inflacioni zbriti në 3.8% në muajin tetor, vlera më e ulët e regjistruar nga fillimi i konfliktit në Ukrainë. Ngadalësimi i inflacionit ka qenë relativisht i shpejtë në gjysmën e parë të vitit, i ndikuar nga pririja rënëse e çmimeve të lëndëve energjetike dhe të ushqimeve të përpunuara në tregjet globale dhe të efekteve lehtësuese nga mbiçmimi i monedhës vendëse në tregun valutor. Krahas këtyre zhvillimeve, efekte reduktuese në inflacion, janë gjeneruar nga baza e lartë krahasuese e një viti më parë. Ritmet rënëse të inflacionit rezultuan më të zbutura në tremujorin e tretë të vitit, pasi ngadalësimi i inflacionit të importuar ishte më i përmbajtur se në gjysmën e parë të vitit 2023.

Presionet inflacioniste nga ambienti i brendshëm, kanë mbetur të larta, të ndikuara nga zgjerimi i kërkesës së brendshme. Në të njëjtën kohë, qëndrueshmëria e lartë e tyre është nxitur nga rritja me bazë të gjerë sektoriale e pagave në kushtet e një tregu pune të shtrënguar. Këto zhvillime kanë gjetur pasqyrim në ruajtjen e niveleve historikisht të larta të inflacionit të shërbimeve, të inflacionit të brendshëm dhe të atij bazë. Profili i inflacionit në vend është i ngjashëm me atë të ekonomive të rajonit dhe të BE-së, i diktuar kryesisht nga ngadalësimi i çmimeve të naftës dhe të ushqimeve në tregjet e huaja. Kontributet nga kategoritë e karburanteve dhe të ushqimeve të përpunuara në formimin e inflacionit total gjatë 10-mujorit të parë të vitit 2023 zbritën në 0.9 nga rreth 4.0 pikë përqindjeje në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kategoria "Ushqime të papërpunuara" kontribuoi më shumë se sa vitin e kaluar në formimin e inflacionit të 10-mujorit të parë të vitit 2023 (përkatësisht 2.2 dhe 1.5 pikë përqindjeje). Çmimet e komponentëve të tjerë më të qëndrueshëm të inflacionit, ku përfshihen shërbime, strehim dhe mallra konsumi afatgjatë, zgjeruan kontributet përkatëse duke arritur në 1.6 pikë përqindjeje, kundrejt 1.3 një vit më parë. Në veçanti, çmimet e shërbimeve mbetën në nivele të larta, për shkak të kërkesës së shtuar në sektorin e turizmit dhe të shërbimeve të lidhura me të, si edhe për shkak të rritjes së kostove të punës pesha e të cilave është relativisht e konsiderueshme në shërbime. Ndërkohë që kategoria e artikujve me çmime të rregulluara, pati ndikime të neglizheshme në

[2] Treguesit përafrues për produktivitetin e punës, kostot e punës për njësi dhe pagën mesatare bazohen mbi të dhënat e Llogarive Kombëtare, Punësimit dhe Pagave dhe vlerësohen për sektorin privat pa degën e Bujqësisë (INSTAT, publikimet më të fundit për 2023Q2).

inflacion, për shkak të mos-ndryshimit të çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë.

Në terma të komponentëve kryesorë, formimi i inflacionit u mbizotërua nga kontributet e komponentëve bazë dhe të brendshëm, pavarësisht ngadalësimit gjatë 10-mujorit të parë të vitit 2023. Vlerat e tyre mbetën të larta dhe qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste kontribuoi në një normë inflacioni mbi objektiv. Inflacioni bazë vjetor në terma mesatarë zbriti në rreth 5.7% gjatë 10-mujorit të parë të vitit 2023, kundrejt nivelit 6.1% të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Reduktimi pasqyroi rënien e çmimeve të disa ushqimeve të përpunuara. Inflacioni bazë neto[3] dhe inflacioni i brendshëm shfaqën ecuri të ngjashme gjatë periudhës 10-mujore të këtij viti. Inflacioni bazë neto, filloi ciklin ngadalësues më vonë dhe më gradualisht se inflacioni bazë dhe ai total. Ai rezultoi mesatarisht pranë vlerës 3.8% apo rreth 1.3 pikë përqindjeje më lart se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Inflacioni i brendshëm rezultoi rreth 4.7% kundrejt 4.4% një vit më parë. Vlerat dhe prirjet e komponentëve të mësipërm të inflacionit tregojnë se inflacioni i shërbimeve dhe i mallrave me afat të gjatë përdorimi kanë mbajtur të larta dhe mbi objektiv presionet inflacioniste në ekonomi. Kontributet më të larta nga shërbimet lidhen me sezonin e mirë dhe të zgjatur turistik në vend gjatë vitit 2023. Si rezultat, kontributet e inflacionit të brendshëm dhe bazë janë zgjeruar gradualisht në nivelin mesatar prej rreth 77% gjatë 10-mujorit të parë të vitit 2023.

Trajektorja e inflacionit parashikohet të vijojë kahun rënës, për shkak të presioneve më të moderuara nga çmimet e huaja dhe të mbiçmimit të kursit të këmbimit. Presionet inflacioniste pritet të zbuten më tej nën ndikimin e ciklit normalizues të politikës monetare dhe prirjes rënëse të pritjeve inflacioniste afatmesme.

Grafik 3.1.5: Inflacioni sipas IÇK-së dhe kontributet nga kategoritë kryesore



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

[3] Inflacioni bazë neto, veç përjashtimeve të artikujve të shportës së IÇK-së që bëhen në matjen kryesore të tij, eliminon edhe nën-grupet e ushqimeve të përpunuara, inflacioni i të cilave u përshpejtua ndjeshëm gjatë vitit 2022, ndërkohë që në periudhat paraardhëse ai ka demonstruar luhatshmëri të ulët. Pas përjashtimit të tyre, inflacioni bazë neto matet mbi 44.6% të shportës së IÇK-së, ndërkohë që matja kryesore e tij realizohet mbi 69.2% të shportës së IÇK-së.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga kushte të mira likuiditeti dhe prime të kontrolluara e në rënie rreziku gjatë vitit 2023. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë treguar pririe rënëse, duke zvogëluar diferencën me normën bazë, si dhe diferencat midis maturiteteve. Reduktimi i shpejtë i inflacionit dhe forcimi i kursit të këmbimit krijuan kushtet për një kurs të përmbajtur të normalizimit të qëndrimit të politikës monetare krahasuar me vitin 2022. Efekti pozitiv i këtyre zhvillimeve te pritjet dhe te pasiguria më e ulët për të ardhmen e afërt ndikuan në zvogëlimin e luhatshmërisë së interesave dhe përmirësimin e përgjithshëm të primeve të kërkuara. Për pasojë, normat e interesit të letrave me vlerë kanë qenë në kahun rënës dhe diferencat e tyre nga norma bazë janë zvogëluar. Kështu interesi i BTH 12-m që prej muajit qershor është luhatur pranë mesatares 3.14%, me një diferencë minimale kundrejt normës bazë. Niveli i ulët i tij është diktuar edhe nga zhvendosja e financimit të qeverisë nga maturitetet afatshkurtra në maturitete të mesme e të gjata.

Normat e interesit të depozitave tregojnë për një tejçim të ngadaltë të rritjeve të normës bazë, nën presionin e ulët për likuiditet. Nga ana tjetër, *normat e interesit të kredisë* kanë mbetur përgjithësisht të pandryshuara, ose kanë shënuar rënie në segmente të caktuara. Ecuria e qëndrueshme e interesave të kredisë reflekton si rritjen e ngadaltë të kostove të fondeve të bankave, ashtu dhe reduktimin e përgjithshëm të primeve të rrezikut. Norma e interesit të kredisë së bizneseve është zvogëluar në 6.4% në tremujorët e dytë dhe të tretë të vitit 2023 nga 7.3% në tremujorin e parë të tij. Në mënyrë të ngjashme kanë lëvizur edhe interesat e kredisë për individë. Pasi kulmuan në 8.0% në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, ato kanë zbritur gradualisht deri në 6.7% në tremujorin e tretë të këtij viti. Këto nivele të normave të interesat janë më lart se nivelet mesatare të viteve 2020-2021 përpara fillimit të rritjes së normës bazë, por ato mbeten ende nxitëse për kërkesën për kredi.

Kredia për sektorin privat ka ardhur në ngadalësim gjatë vitit 2023. Zgjerimi i saj vjetor mesatar rezultoi 7.9% deri në tremujorin e tretë nga 12.3% gjatë vitit 2022. Ecuria e kredisë gjatë vitit është karakterizuar nga një ngadalësimi i fortë i kredisë në valutë. Sipas segmenteve, ky ngadalësimi i atribuohet më së shumti kreditimit të dobët ndaj bizneseve për qëllime likuiditeti. Rritja e vazhduar e kërkesës së brendshme dhe rritja e fortë e sektorit të turizmit këtë vit, ka përmirësuar likuiditetin e bizneseve, të cilët kanë preferuar të shlyejnë një pjesë të kredive ekzistuese.

Financimi i bizneseve dhe i individëve ka qenë kryesisht në lekë gjatë vitit 2023, me përjashtim të tremujorit të parë. Kështu, rritja vjetore e këtij portofoli, pasi preku nivelet minimale prej 4.3% në muajin shkurt, u përshpejtua duke arritur një zgjerim vjetor prej 10% në muajin shtator. Kjo ecuri është ndikuar ndër të tjera nga normat më të ulëta të interesit për kreditë në lekë. Në të njëjtën kohë, rritja e shpejtë e normave të interesit të kredisë në euro ashtu edhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit kanë shtyrë bizneset dhe individët të zhvendosin një pjesë të portofoleve të kredive të tyre nga valuta në lekë. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, struktura valutore e portofolit të kredisë është zhvendosur drejt lekut. Në fund të muajit shtator kredia në lekë zinte rreth 55% të totalit të kredisë për sektorin privat, ose 4p.p më shumë se në vitin 2022.

Kredia për individët ka shfaqur rritje të qëndrueshme gjatë vitit, duke u rritur mesatarisht me 13.5%, lehtësisht më poshtë se rritja prej 15 % më 2022. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, krahasuar me një vit më parë, vihet re ngadalësimi i normave të rritjes si për kredinë hipotekore (në 15%), ashtu edhe për atë për konsum (në 9.3%). Këto zhvillime janë ndikuar si nga një kërkesë e lartë e individëve për financimin e konsumit dhe të investimeve në banesa, ashtu edhe nga kushtet favorizuese të ofertës për kredi. Kjo e fundit është ndikuar kryesisht nga një konkurrencë e lartë mes bankave për këtë segment.

Grafik 3.1.6: Kredia dhe depozitat për sektorin privat





Burimi: Banka e Shqipërisë

Fondet e bankave janë rritur me rreth 9.3% përgjatë vitit 2023. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vend ka mbështetur rritjen e fondeve të bankave në valutë, me rreth 15.6% në nivel vjetor. Kjo e fundit ka reflektuar si kursimet më të larta të individëve ashtu edhe rritjen e likuiditetit të bizneseve. Depozitat në lekë janë zgjeruar me rreth 2.4% për gjatë gjithë vitit 2023. Kjo ecuria është ndikuar më së shumti nga ecuria e dobët e shpenzimeve të qeverisë si dhe nga likuiditeti i lartë i grumbulluar prej qeverisë në depozitë pranë Bankës së Shqipërisë. Në muajin shtator, depozitat pranë bankave dominohen nga fondet në valutë të cilat përbëjnë rreth 55% të totalit, ose 1p.p më shumë se në fundin e vitit 2022.

3.2 Skenari makroekonomik afatmesëm

Sektori real

Ekonomia vendit ka përballuar një sërë goditjesh relativisht mirë përgjatë tre viteve të fundit, tërmetin e nëntorit 2019, pandeminë globale më 2020 dhe më pas krizën energjetike evropiane që filloi më 2022 të shkaktuar nga lufta në Ukrainë. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, me -3.3 për qind, dukshëm më i butë se sa pritej fillimisht, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, me 8.9 për qind. Momenti pozitiv i rritjes ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2022, duke çuar në një rritje vjetore prej 4.9 për qind, nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme e mbështetur veçanërisht nga shpenzimet konsumatore dhe rritja e investimeve. Përgjatë vitit 2023, ekonomia e vendit ka vijuar performancën pozitive, pavarësisht kushteve më të shtrënguara të financimit si dhe ngadalësimit të kërkesës së huaj, dhe pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për nëntëmujorin e parë të vitit 2023 ka shënuar një rritje prej rreth 3.25 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, sipas vlerësimit të fundit të disponueshëm nga INSTAT. Kjo rimëkëmbje mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është e pranishme pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime ka çuar në një zgjerim të aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që vëllimi i aktivitetit në sektorin e bujqësisë ka mbetur relativisht i pandryshuar.

Sipas optikës të kërkesës agregate, në nëntëmujorin e parë të vitit 2023 vlerësohet thuajse të gjithë komponentët e kërkesës agregate janë rritur. Rritja përgjatë kësaj periudhe është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe nga investimet si dhe nga ecuria mjaft e mirë e eksporteve të shërbimeve (veçanërisht turizmi). Në vijim, kërkesa e huaj neto ka pasur një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike në nëntëmujorin e parë të vitit, si dhe pritet një kontribut pozitiv për tremujorin e fundit të vitit, duke pasur parasysh sezonin turistik mjaft pozitiv që patëm këtë vit.

Më konkretisht, për nëntëmujorin e parë të vitit 2023, konsumi final total shënoi rritje prej 3.9 për qind, ndërsa konsumi privat shënoi rritje prej 3.24 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Formimi i kapitalit fiks bruto (gjithsej investimet) për nëntëmujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje prej 6.67 për qind.

Rritja ekonomike parashikohet në 3.5 për qind për vitin 2023 dhe në nivelin 3.7 për qind për vitin 2024, nisur nga kushtet pozitive ekonomike, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e sektorit të turizmit

dhe aktivitetit të ndërtimit. Gjatë periudhës afatmesme 2024–2026, rritja pritet të vazhdojë të qëndrojë afër 3.9 për qind, e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Gjithashtu, kërkesa e huaj neto pritet të ketë një efekt neto lehtësisht pozitiv. Eksportet si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht të lidhura me turizmin) pritet të kenë një ecuri të mirë, por në të njëjtën kohë edhe importet pritet të kenë rritje, dhe për rrjedhojë kontributi neto i kërkesës së huaj në periudhën afatmesme pritet të jetë lehtësisht pozitiv përsëri. Më konkretisht, konsumi final për periudhën afatmesme (2024–2026) parashikohet të rritet në terma realë me rreth 3.4 për qind mesatarisht në vit, duke kontribuar me një mesatare prej 2.9 pp në vit në rritjen e përgjithshme. Ndërkohë që investimet parashikohen të rriten në terma realë me një mesatare prej 3.4 për qind në vit, me një kontribut mesatar në rritjen e PBB-së prej 0.8 pp në vit.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2024–2026 parashikohen të rriten në terma realë me një mesatare prej 5.2 për qind në vit, me një kontribut mesatar pozitiv prej 1.9 pp në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën afatmesme parashikohen të rriten me 3.7 për qind, me një kontribut mesatar negativ në rritjen totale me rreth -1.7 pp në vit. Për rrjedhojë, kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen e përgjithshme me një mesatare prej 0.2 pikë përqindjeje në vit.

Grafiku 3.2.1: Rritja reale (në %)



Grafiku 3.2.2: Kontributet në rritje (në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Tabelë 3.2.1: Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës

	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Konsumi Final (a+b+c)	**-2.8**	**5.1**	**5.5**	**1.6**	**3.4**	**3.4**	**3.4**	**-2.6**	**4.7**	**4.9**	**1.4**	**2.8**	**2.9**	**2.8**
Konsumi Final i Popullatës	-3.3	4.7	7.4	1.3	2.6	3.5	3.1	-2.6	3.8	5.6	1.0	2.0	2.6	2.3
Konsumi Final i Administratës Publike	1.5	7.8	-4.7	3.9	9.0	2.6	5.6	0.2	0.9	-0.6	0.4	0.9	0.3	0.6
Konsumi Individual	2.0	11.3	-3.2	1.7	9.9	3.4	6.4	0.1	0.6	-0.2	0.1	0.5	0.2	0.3
Konsumi Kolektiv	1.0	4.7	-6.1	5.9	8.2	2.0	4.9	0.1	0.3	-0.4	0.3	0.4	0.1	0.3
Konsumi i Institucioneve Jo-	-17.3	0.2	-20.3	1.0	1.5	1.5	1.3	-0.1	0.0	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	**-1.4**	**19.2**	**6.5**	**7.6**	**2.6**	**2.8**	**4.9**	**-0.3**	**4.4**	**1.6**	**1.8**	**0.6**	**0.7**	**1.1**
Publik	27.6	20.5	-14.7	19.0	-3.8	-3.8	3.8	1.5	1.5	-1.2	1.2	-0.3	-0.2	0.2
nga e cila qeveria qendrore	35.6	23.9	-17.4	20.8	-6.0	-5.4	3.4	1.6	1.5	-1.2	1.1	-0.4	-0.3	0.2
Privat	-10.8	18.6	16.6	3.7	5.1	5.2	5.2	-1.8	2.9	2.7	0.7	0.9	0.9	0.9
Kërkesa e brendshme (1+2)	**-2.5**	**7.8**	**5.8**	**2.9**	**3.2**	**3.3**	**3.7**	**-2.9**	**9.0**	**6.5**	**3.2**	**3.5**	**3.6**	**4.0**
Eksporti neto^ (a-b)	**-1.3**	**-0.7**	**26.3**	**-2.1**	**-3.2**	**-3.8**	**-0.8**	**0.2**	**0.1**	**-3.5**	**0.2**	**0.3**	**0.3**	**0.1**
Eksportet e mallrave e shërbimeve	-27.9	52.0	7.5	2.9	5.9	5.5	4.2	-8.7	11.8	2.4	1.1	2.1	2.0	1.5
Eksportet e mallrave	-2.6	50.2	16.5	-5.6	6.4	4.7	5.3	-0.2	3.0	1.4	-0.6	0.6	0.5	0.5
Eksportet e shërbimeve	-34.6	52.7	4.2	6.4	5.7	5.8	3.7	-8.6	8.8	1.0	1.7	1.5	1.6	1.0
Importet e mallrave e shërbimeve	-19.8	31.5	13.1	1.9	4.0	3.7	3.3	-8.9	11.7	5.9	0.9	1.8	1.7	1.5
Importet e mallrave	-6.4	29.0	8.6	0.0	4.5	3.8	3.4	-1.9	8.2	2.9	0.0	1.4	1.2	1.1
Importet e shërbimeve	-45.2	39.3	26.7	6.6	3.0	3.4	3.0	-7.0	3.46	3.0	0.9	0.4	0.5	0.4
Ndryshimet e gjendjeve	**-55.7**	**60.4**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**-0.4**	**0.2**	**0.0**	**0.0**	**0**	**0**	**0**
Mospërputhje statistikore	**33.4**	**44.1**	**6988**	**0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**-0.2**	**-0.4**	**1.9**	**0.0**	**0**	**0**	**0**
PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO (3+4+5)	**-3.3**	**8.9**	**4.9**	**3.5**	**3.7**	**3.9**	**4.0**	**-3.3**	**8.9**	**4.9**	**3.5**	**3.7**	**3.9**	**4.0**

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë rreth të njëjtit trend të mesatares së tyre historike, pasi efektet e goditjeve do të zbehen. Konkretisht, shërbimet pritet të rriten në terma realë me 4.5 për qind mesatarisht në vit gjatë periudhës 2024–2026, me kontributin më të lartë në rritje edhe për shkak të peshës së tyre më të madhe me një mesatare prej 2.2 pp. në vit; industria me një mesatare vjetore prej 4.5 për qind, duke kontribuar mesatarisht me 0.5 pp. në vit; Bujqësia pritet të rritet me 2.4 për qind mesatarisht në vit gjatë periudhës 2024–2026, me një kontribut mesatar prej 0.5 pp. në vit; Ndërtimi me 2.8 për qind me një kontribut mesatar vjetor prej 0.3 pp në vit.

Grafiku 3.2.3: Rritja reale (në %)



Grafiku 3.2.4: Kontributet në rritje (në p.p.) sipas komponentëve të ofertës



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 3.2.2: Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës

	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1.3	1.8	0.1	-0.2	2.4	2.2	2.7	0.2	0.3	0.0	0.0	0.4	0.4	0.5
Industria nxjerrëse	-27.5	7.1	5.6	2.1	5.1	5.4	5.4	-0.8	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Industria përpunuese	-4.1	11.1	7.1	-3.7	4.1	4.7	4.7	-0.3	0.7	0.4	-0.2	0.2	0.3	0.3
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kon	9.6	10.0	2.1	7.4	3.9	4.2	4.2	0.2	0.2	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të m	-11.3	14.5	1.2	1.1	2.9	2.8	2.8	-0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Ndërtimi	1.2	18.0	10.7	7.4	3.1	2.6	2.6	0.1	1.6	1.0	0.7	0.3	0.3	0.3
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve	-2.0	4.6	7.2	2.3	4.1	5.2	5.4	-0.2	0.5	0.8	0.3	0.5	0.6	0.6
Transporti dhe magazinimi	-18.1	20.5	12.4	4.1	4.4	5.4	5.3	-0.6	0.6	0.4	0.1	0.1	0.2	0.2
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	-26.1	26.1	19.2	20.1	7.2	7.5	7.5	-0.7	0.5	0.5	0.5	0.2	0.2	0.2
Informacioni dhe komunikacioni	-1.8	9.8	9.6	7.8	3.3	3.6	3.6	-0.1	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	0.3	11.4	9.1	3.6	4.2	4.4	4.4	0.0	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2.9	5.8	11.2	11.2	3.4	3.2	3.2	0.2	0.4	0.6	0.6	0.2	0.2	0.2
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	-11.6	-1.2	3.5	0.9	4.6	4.0	4.0	-0.4	0.0	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1
Shërbime administrative dhe mbështetëse	-7.6	12.7	4.2	1.1	4.6	4.7	4.7	-0.3	0.4	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1
Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrues	2.7	4.6	-9.4	5.6	4.1	3.6	3.6	0.1	0.2	-0.4	0.2	0.2	0.1	0.1
Arsimimi	1.1	4.2	5.3	4.3	4.7	4.5	4.5	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	2.5	16.4	5.7	3.7	3.7	4.6	4.6	0.1	0.5	0.2	0.1	0.1	0.2	0.2
Arte, argëtim dhe çlodhje	-6.1	29.7	2.2	21.4	4.9	4.3	4.3	0.0	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
Aktivitete të tjera shërbimi;	-7.0	2.5	-2.4	5.4	4.7	5.2	5.2	-0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	**-2.9**	**8.2**	**5.3**	**3.7**	**3.7**	**3.9**	**4.0**	**-2.6**	**7.2**	**4.6**	**3.3**	**3.3**	**3.4**	**3.5**
Taksa neto mbi produktet	-5.9	14.0	2.1	1.4	3.8	3.9	4.1	-0.7	1.7	0.3	0.2	0.5	0.5	0.5
PBB ME ÇMIMET E TREGUT	**-3.3**	**8.9**	**4.9**	**3.5**	**3.7**	**3.9**	**4.0**	**-3.3**	**8.9**	**4.9**	**3.5**	**3.7**	**3.9**	**4.0**

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rritja ekonomike është shoqëruar me rritje të punësimit dhe ulje të shkallës së papunësisë. Si sektori i prodhimit ashtu edhe ai i shërbimeve kanë përfituar nga këto zhvillime, duke siguruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afatmesme.

Tregu i punës ka treguar elasticitet përballë goditjes pandemike, mbështetur edhe nga masat e qeverisë. Pas rimëkëmbjes së kërkesës, punësimi filloi të përmirësohej në vitin 2022. Rritja e punësimit ishte me bazë të gjerë, e dëshmuar në industri, ndërtim dhe shërbime. Të dhënat më të fundit të INSTAT-it sipas anketës tremujore të forcave të punës (ATFP) në tremujorin e tretë 2023, tregojnë se shkalla zyrtare e papunësisë për grup-moshat 15-64 vjeç është 11.0 për qind, krahasuar me 10.8 për qind që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë. Sa i përket grup-moshës së punës 15 vjeç e lart, shkalla zyrtare e papunësisë në tremujorin e tretë 2023 ishte 10.5 për qind. Numri i të papunëve në moshë pune (15-64 vjeç) në tremujorin e tretë të vitit 2023 ishte 156,329 persona.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej 0.3 për qind në vit gjatë periudhës 2024–2026. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe. Papunësia pritet të vazhdojë rënien graduale duke arritur në 9.5 për qind në vitin 2026.

Grafiku 3.2.5: Punësimi (rritja vjetore në %)



Grafiku 3.2.6: Norma e papunësisë (në %)



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit dhe inflacioni

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve. Politika monetare operon nën një regjim inflacioni të shënjestruar, me objektivin të caktuar në 3.0% në afatin e mesëm. Instrumenti kryesor për arritjen e objektivit është norma e interesit e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me afat maturimi një javor. Banka e Shqipërisë aplikon një regjim kursi këmbimi të lirë, ku vlera e kursit të këmbimit përcaktohet nga lëvizje të kërkesës dhe ofertës në tregun valutor. Banka ruan të drejtën të ndërhyjë në treg për arsye që lidhen me rregullimin e rezervës valutore dhe për të shmangur çrregullime të pajustifikuara në tregun valutor të cilat rrezikojnë përmbushjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Ndërhyrjet kryen me anë të ankandeve dhe zhvillohen sipas një kalendari të publikuar më parë.

Presionet inflacioniste kanë rezultuar në rënie gjatë vitit 2023, të udhëhequra nga ngadalësimi i inflacionit të çmimeve të ushqimeve dhe rënia e çmimit të lëndëve energjitike në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, presionet e brendshme inflacioniste kanë rezultuar më të

qëndrueshme, si rezultat i zgjerimit të kërkesës së brendshme dhe i kostove të shtuara të prodhimit nga rritja e shpejtë e pagave. Mbiçmimi i fortë i kursit të këmbimit të Lekut ndaj monedhave kryesore ndërkombëtare gjatë vitit 2023 ndihmoi në zbutjen e ndikimit të presioneve të huaja inflacioniste në çmimet finale në vend. Me qëllim ankorimin e pritjeve inflacioniste dhe rikthimin e inflacionit në objektiv në harkun kohor afatmesëm, Banka e Shqipërisë ka vijuar të ndjekë kurs normalizues të politikës monetare. Norma bazë e interesit është rritur nga niveli minimal historik prej 0.50% në muajin mars të vitit 2022 në 3.25% muajin nëntor të vitit 2023. Në reflektim të reduktimit të impulsit monetar, kushtet monetare stimuluese kanë ardhur në zvogëlim të vazhdueshëm.

Banka e Shqipërisë pret që inflacioni të vijojë trajektoren rënëse dhe të konvergojë gradualisht drejt objektivit në vitin 2024. Ky parashikim është i kushtëzuar nga shtrëngimi i mëtejshëm i politikës monetare. Duke vlerësuar se rreziqet për inflacionin janë rritur, Banka e Shqipërisë i ka komunikuar publikut se do të vijojë ndjekjen e kursit normalizues të politikës monetare, por duke theksuar në të njëjtën kohë që pjesa më e madhe e normalizimit tashmë është kryer. Për rrjedhojë, dhe duke marrë në konsiderate pasiguritë e larta që burojnë nga ekonomia e huaj dhe nga tensionet gjeopolitike, intensiteti i normalizimit të politikës monetare do të jetë i varur nga të dhënat e përftuara dhe vlerësimet e kryera në vijim. Zbatimi i një politike të kursit të lirë të këmbimit ka ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste nga çmimet e larta në partnerët tanë kryesor tregtar. Kombinimi aktual i politikave makroekonomike ndihmon në një balancim më të mirë të ofertës dhe kërkesës agregate. Politika fiskale pritet të ndjekë një trajektore konsoliduese dhe, si e tillë, ajo mbështet kursin normalizues të politikës monetare. Ky kombinim i politikave makroekonomike merr parasysh edhe ruajtjen e stabilitetit financiar si kusht i domosdoshëm për një zgjerim të aktivitetit ekonomik me ritme të qëndrueshme në afat të mesëm e të gjatë. Në këtë kontekst, rreziqet e tregut financiar janë të përmbajtura.

Sektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria e tij afatmesme

Zhvillimet në bilancin e pagesave dhe tregtinë e mallrave

Gjysma e parë e vitit 2023 ka shfaqur përmirësime të mëtejshme në bilancin e pagesave. Deficiti korrent u ngushtua në terma vjetorë me 27.3% duke shënuar nivelin 3.2% ndaj PBB-së nominale, nga 5.3% në gjysmën e parë të vitit 2022. Përmirësimet e deficitit korrent janë drejtuar nga zgjerimi i flukseve turistike dhe i remitancave. Nga ana tjetër, deficiti tregtar në mallra është përkeqësuar si pasojë e rënies së eksporteve, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Kursi real efektiv i këmbimit[4] ka ndjekur një trajektore mbiçmuese që prej fundit të vitit 2015, nxitur nga përmirësimet strukturore të sektorit të jashtëm, rritja e produktivitetit, si dhe reduktimi i primeve të rrezikut. Pasi kulmoi në vitin 2018 në 7.5%, forcimi vjetor i lekut në terma realë efektiv u moderua, duke u luhatur në një mesatare prej 2.6% gjatë periudhës 2019–2022. Mbiçmimi real efektiv është përshpejtuar sërish në vitin 2023, duke arritur në 11.9% në tremujorin tretë të vitit e në 12.5% në muajin tetor. Mbiçmimi më i shpejtë i tij gjatë vitit të fundit është nxitur nga prurje të larta valutore nga shërbimet e turizmit, nga remitancat dhe nga IHD-të. Ai ka prekur kryesisht konkurrueshmërinë e atyre sektorëve eksportues që janë çmim-pranues dhe që u përballën me rënie të kërkesës së huaj gjatë këtij viti.

Flukset e tregtisë në mallra dëshmojnë për tkurrje të flukseve si për eksportet ashtu edhe për importet. Gjatë 10 muajve të parë të vitit 2023, eksportet e mallrave në terma nominalë janë pakësuar me 8.6%. Kjo ecuri pasqyron kryesisht rënien e çmimeve ndërkombëtare përfshirë efektin e forcimit të kursit të këmbimit. Gjithashtu, tkurrja ka prekur edhe sasitë e eksportuara për disa kategori industriale sikurse tekstilet, metalet dhe mineralet në pasqyrim të konjukturave jopozitive për këto kategori. Rënia e çmimeve ndërkombëtare ka shkaktuar edhe rënie të importit të mallrave.

[4] Kursi Real Efektiv i Këmbimit llogaritet si indeks i peshuar me tregtinë sipas 5 partnerëve kryesorë tregtarë: Italia, Greqia, Gjermania, Kina dhe Turqia. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton nënçmim të monedhës vendase.

Grafik 3.2.1: Hapja tregtare, eksportet, importet dhe IHD neto si përqindje ndaj PBB-së



Grafik 3.2.2: Ndryshim vjetor i kursit real efektiv të këmbimit (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT (2023)

Sipas dekompozimit të eksporteve shqiptare sipas Përpjesëve Konstante të Tregut (PKT)[5] për vitin 2022, rritja e eksporteve botërore ka qenë faktori kryesor pas rritjes së eksporteve shqiptare drejt vendeve të BE-15, pasuar nga konkurrueshmëria dhe shpërndarja e tregut. Për sa i përket eksporteve shqiptare drejt vendeve të CEFTA, konkurrueshmëria ka luajtur rolin kryesor pas rritjes së eksporteve, pasuar nga rritja e eksporteve botërore. Dy komponentët e tjerë kanë pasur gjithashtu impakt pozitiv.

Tabelë 3.2.1: Dekompozimi i eksporteve shqiptare sipas metodologjisë së PKT (milionë euro)

	2022	
	BE-15	CEFTA
Rritja e eksporteve botërore	466.4	114.0
Struktura sipas kategorive	5.5	18.1
Shpërndarja e tregut	138.9	84.8
Konkurrueshmëria	267.2	251.9
Total	877.9	468.8

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, UN Comtrade

Suficiti i rritur në shërbime ka qenë faktori kryesor pas përmirësimit të deficitit korrent gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Flukset e udhëtimit (turizmi) kanë vazhduar të rriten me ritme të shpejta (37.4% në terma vjetorë). Si rrjedhojë, eksportet e shërbimeve u rritën me 30.7% gjatë së njëjtës periudhë. Situatë e ngjashme paraqitet edhe në rastin e importit të shërbimeve. Nën drejtimin e shërbimeve dalëse turistike, të cilat u rritën me 23.1% gjatë gjysmës së parë të vitit, importet e përgjithshme të shërbimeve u zgjeruan në 26.9%. Si pasojë e efektit më të fortë eksportues, suficiti i llogarisë së shërbimeve është rritur me 35.5% gjatë gjysmës së parë të vitit 2023.

Deficiti i të ardhurave parësore u zvogëlua në terma vjetorë me 3.2% gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Kjo lidhet me një efekt më të fortë të të ardhurave hyrëse nga kompensimi i punonjësve. Paralelisht, edhe të ardhurat dalëse të investimeve kanë ardhur në rritje, por nuk kanë qenë në gjendje të kompensojnë të ardhurat e punës. Në rastin e të ardhurave dytësore, teprica është zgjeruar në terma vjetorë me 12.5% në pasqyrim të rritjes së remitancave me 17.8%.

Ecuria pozitive pritet të vazhdojë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023. Për të gjithë vitin 2023, deficiti korrent ndaj PBB-së pritet në nivelin 4.8%. Eksportet e shërbimeve dhe remitancat do të vazhdojnë të mbështesin përmirësimet e sektorit të jashtëm. Nga ana tjetër, zhvillimet jo të mira të tregtisë së mallrave pritet të vazhdojnë edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023.

Investimet e huaja direkte neto kanë vazhduar të rriten gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, por me ritme më të ngadalta krahasuar me vitin e mëparshëm. Rritja vjetore për gjysmën e parë të vitit 2023 ishte 1.8% për flukset hyrëse neto dhe 7.2% për flukset hyrëse. Sektori financiar ka qenë

[5] Shih http://go.worldbank.org/KQCHUD4JN0 për një diskutim mbi PKT-të.

mbështetësi kryesor pas rritjes së IHD-ve gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht rritjes më të ngadaltë, pritet që flukset e IHD-ve të intensifikohen gjatë tremujorëve në vazhdim. Investimet e portofolit kanë pasqyruar rritje të detyrimeve ndaj jorezidentëve kryesisht gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023. Kjo lidhet me emetimin e Eurobond-it pikërisht në këtë tremujor.

Zhvillimet në borxhin e jashtëm

Stoku i borxhit të jashtëm shënoi EUR 10,2 miliardë në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023, me një rritje prej 3.2% në terma vjetorë. Zgjerimi i stokut lidhet kryesisht me emetimin e Eurobond-it në tremujorin e dytë të vitit 2023. Nga ana tjetër, si pasojë e përshpejtimit të rritjes së PBB-së dhe mbiçmimit të shpejtë të kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros në tremujorin e dytë të vitit 2023, raporti i borxhit ndaj PBB-së ra në 52.2% nga niveli 60.3% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Borxhi afatgjatë përbën rreth 91.0% të totalit të borxhit të jashtëm dhe përbëhet kryesisht nga hua afatgjata ndaj qeverisë së përgjithshme dhe ndaj sektorëve të tjerë. Borxhi afatshkurtër përbën 9.0% të totalit dhe përbëhet kryesisht nga "monedha dhe depozita" të korporatave depozit-marrëse dhe "kredi tregtare".

Treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë janë përmirësuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 për shkak të eksporteve dhe të ardhurave fiskale në rritje. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve ra nga 136.8% një vit më parë në nivelin 115.1% në tremujorin e dytë të vitit 2023. Për të njëjtat periudha krahasuese, raporti i borxhit të jashtëm ndaj të ardhurave fiskale ra nga 213.9% në 183.0%. Raporti i stokut të borxhit të jashtëm të qeverisë së përgjithshme ndaj të ardhurave fiskale ra në nivelin 91.7% në tremujorin e dytë të vitit 2023, kundrejt 105.2% një vit më parë. Treguesit e likuiditetit paraqiten gjithashtu të përmirësuar duke dëshmuar për prani të presione të ulëta nga detyrimet afatshkurtra.

Grafik 3.2.3: Borxhi i jashtëm ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve (majtas) dhe ndaj të ardhurave fiskale (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në skenarin bazë për vitin 2023, borxhi i jashtëm bruto pritet të zbresë në 50% të PBB-së me rënie 4 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2022. Ky vlerësim nënkupton një zgjerim më të ngadaltë të borxhit të jashtëm për shkak të huamarrjes më të ulët si nga sektori publik ashtu edhe ai privat. Gjithashtu, aktiviteti ekonomik pritet të rritet me ritëm më të shpejtë krahasuar me borxhin në terma nominalë, duke mundësuar kështu raporte më të ulta të stokut të borxhit ndaj PBB-së. Në të ardhmen, pritet një zvogëlim gradual i raportit të borxhit të jashtëm ndaj PBB-së, kryesisht si pasojë e konsolidimit të pritur fiskal.

Projeksioni sipas skenarit bazë është i rrethuar nga pasiguri. Për këtë arsye disa skenarë risku përfshihen në analizën e ndjeshmërisë së borxhit të jashtëm. Në këtë rast, simulohen efekte të diferencuara të goditjeve ndaj normës së interesit dhe ndaj kursit të këmbimit. Në skenarin e parë, norma mesatare e interesit që paguhet për borxhin e jashtëm rritet në mënyrë të përhershme me dy devijime standarde përgjatë horizontit parashikues. Në skenarin e dytë, monedha vendëse merr një goditje

nënçmuese jopermanente prej 10% krahasuar me skenarin bazë për vitin 2023. Rezultatet e simulimit tregojnë për një ndjeshmëri më të madhe të borxhit të jashtëm bruto ndaj një nënçmimi prej 10% të monedhës. Devijimet e raportit të borxhit ndaj PBB-së në fund të horizontit parashikues krahasuar me skenarin bazë, janë rreth 3 pikë përqindjeje në rastin e goditjes së normave të interesit dhe rreth 6 pikë përqindjeje në rastin e nënçmimit të kursit të këmbimit.

Grafik 3.2.4: Borxhi i Jashtëm Bruto ndaj PBB-së sipas skenarit bazë dhe skenarëve të riskut: Goditje në norma interesi (majtas) dhe goditje si nënçmim real (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në stokun e rezervës[6]

Banka e Shqipërisë mban rezerva ndërkombëtare sipas dy kritereve të mjaftueshmërisë: (1) mbulim i të paktën 4 muajsh importe mallrash dhe shërbimesh dhe (2) të paktën 100% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto. Këto kritere shërbejnë si prag minimal, ndërkohë që Banka e Shqipërisë optimizon nivelin e rezervës duke marrë parasysh rreziqet potenciale në të ardhmen, si dhe kostot që lidhen me mbajtjen e rezervës. Në shtator të vitit 2023, stoku i rezervës ndërkombëtare bruto ishte 5.73 miliardë euro, ose rreth 28% ndaj PBB-së. Ky nivel është i mjaftueshëm[7] për të mbuluar 7.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe më shumë se 3 herë borxhin e jashtëm afatshkurtër[8]. Të dy kriteret pritet të qëndrojnë dukshëm mbi nivelet minimale të mjaftueshmërisë gjatë periudhës afatmesme.

Grafik 3.2.5: Projeksionet e rezervës ndërkombëtare të shprehura si muaj import mallrash dhe shërbimesh (majtas) dhe ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[6] Raportet e rezervës ndaj borxhit afatshkurtër, janë rillogaritur sipas rishikimeve në statistikat e borxhit afatshkurtër.
[7] Bazuar në parashikimet e importeve dhe borxhi të jashtëm afatshkurtër për T3-2023.
[8] Në borxhin e jashtëm afatshkurtër është përfshirë edhe një vlerësim për borxhin e jashtëm afatshkurtër publik.

Sektori financiar

Sistemi bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe provat e rezistencës të kryera rregullisht sugjerojnë se ai do të mbetet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të buta deri në të moderuara makroekonomike dhe financiare në një horizont afatmesëm. Kreditë dhe depozitat kanë vazhduar të rriten, por ritmet vjetore të rritjes gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023 kanë qenë më të ulëta krahasuar me periudhën 2020-2022. Të rregulluara për lëvizjet e kursit të këmbimit, ritmet e rritjes së kredive dhe depozitave në valutë do të jenë të krahasueshme me ritmet e larta të vërejtura në vitet 2021 dhe 2022. Një normë më e ngadaltë e rritjes së kreditimit krahasuar me depozitat ka rezultuar në një rënie të moderuar të ndërmjetësimit financiar me një raport kredi ndaj depozitave që ka zbritur në 46% në shtator 23 nga 55% më 2021.

Me rritjen e normave të interesit, bankat kanë raportuar një përkeqësim të lehtë të cilësisë së kredisë. Të ardhurat nga interesi për kreditë dhe letrat me vlerë janë rritur më shpejt se shpenzimet e interesit për depozitat dhe letrat me vlerë, dhe rezultati financiar i sektorit bankar është përmirësuar ndjeshëm. Rezultati neto i bankave në fund të shtatorit 2023 (+ 23 miliardë lekë) ishte rreth. 80% më i lartë krahasuar me atë të së njëjtës periudhë të vitit 2022. Rreziqet e agreguara në hartën e stabilitetit financiar tregojnë se rreziqet e jashtme dhe të brendshme janë zbutur dhe mbeten relativisht të ulta.

Të gjithë indikatorët e bankave subjekt i kuadrit rregullator, sugjerojnë se ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të likuiditetit dhe të tregut mbetet i kufizuar dhe shumë poshtë kufijve kritikë. Pavarësisht nivelit të ulët të raportit të huave me probleme ndaj totalit të huave, sektori bankar dhe Banka e Shqipërisë janë të shqetësuar lidhur me transformimin potencial të rrezikut të normës së interesit në rrezikun e kredisë, si rrjedhojë e rritjes së kostove të pagesës së kredisë për kredimarrësit. Ky këndvështrim bazohet në faktin që normat e interesit të tregut po rriten në linjë me rritjen e normës bazë të interesit, dhe që më shumë se 70% e portofolit të kredisë së bankave është me normë të ndryshueshme. Megjithatë, ushtrime specifike të provës së rezistencës sugjerojnë se tepricat ekzistuese të kapitalit të bankave janë të mjaftueshme për të përballuar efektet e rritjes së mëtejshme të normave të interesit sipas skenarëve të supozuar.

Treguesit e sektorit financiar

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023*
Totali i aktiveve të sektorit bankar (milion EUR)	10,768	11,398	12,380	13,156	14,980	16,426	18,011
Kapitali i huaj i sektorit bankar (%)	81.4	80.8	78.4	69.4	68.8	66.2	64.9
Rritja e kredisë (%, mp)	-0.1	-1.7	3	6.1	6.9	11.2	2.5
Rritja e depozitave (%, mp)	1	-1.2	2.5	5.8	8.5	9.6	4.6
Raporti kredi ndaj depozita (fp)	54.9	53.9	55.6	54.7	54.8	47.1	46.4
Diferenca e normave të interesit (%, fp)	5.1	5.1	5	4.9	4.1	4.5	4.7
Kredi me normë të ndryshueshme ndaj totalit të kredisë (%)	72.6	71.6	77.4	73.8	74.7	75.3	75.9
Treguesit e shëndetit financiar (fp, %)							
- raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave	13.2	11.1	8.4	8.1	5.7	5.0	5.2
- kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17	18.7	18.7	18.7	18.5	18.8	19.6
- aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	30.2	34.2	35.7	34.8	33.3	29.6	29.9
-kthimi nga kapitali	15.7	13	13.5	10.7	12.9	12.3	16.2
- kredia në valutë ndaj totalit të kredisë	56.4	56.1	51.2	50.3	51.1	51.4	47.5
- pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	6.7	7.8	7.4	8.4	9.2	5.0	7.8
- pozicioni neto i hapur i normave të interesit ndaj kapitalit rregullator	-1.5	2.4	2.9	4.3	5.8	3.0	1.4

** Shtator 2023- periudha e fundit e raportimit*

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së ra me 9 p.p. në terma vjetorë në 92%, duke qenë se ritmi i zgjerimit të aktiveve të sistemit financiar ishte më i vogël krahasuar me normën e rritjes ekonomike, duke reflektuar edhe ndikimin e mbiçmimit të monedhës vendëse. Të gjitha segmentet e sistemit financiar, me përjashtim të fondeve të investimeve, kanë raportuar rritje të bilanceve të tyre gjatë periudhës. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vazhdon të dominojë me gati 91% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërkohë që ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj aktivitetit të sektorit bankar mbetet e lartë.

Aktivet e sistemit financiar ndaj PBB-së

Autoriteti mbikëqyrës	**Banka e Shqipërisë**			**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**			**Madhësia e sektorit financiar**
Sistemi financiar	Sektori bankar	IFJB	SHKK-të dhe Unioni	Kompanitë e sigurimit	Fondet e pensionit	Fondet e investimit	
2011	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		**91.0**
2012	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	**95.4**
2013	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	**100.2**
2014	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	**102.7**
2015	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	**102.0**
2016	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	**105.5**
2017	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	**103.4**
2018	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	**98.8**
2019	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	**97.9**
2020	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	**107.5**
2021	95.5	4.1	0.7	2.2	0.2	4.2	**107.0**
2022	87.8	3.8	0.7	2.0	0.3	1.9	**96.5**
2023	83.6	3.7	0.6	2.0	0.3	1.9	**92.2**

*Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT-i, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; *Qershor 2023*

Bilanci i bankave u rrit me 3% në vit deri në fund të shtatorit 2023. Nga ana e aktiveve rritja erdhi nga investimet më të larta në letra me vlerë dhe nga reduktimi i fondeve të provigjioneve. Stoku i ekspozimeve të investimeve të thesarit dhe ato ndërbankare u tkurr me 1%, ndërsa rritja vjetore e tepricës së kredisë ishte 1%. Rreth 35% e letrave me vlerë të bankave janë letra me vlerë në valutë të emetuara nga jorezidentë. Pjesa e mbetur prej 65% janë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare, nga të cilat letrat me vlerë të emetuara në monedhë kombëtare zënë rreth 80% të totalit të ekspozimit. Aktivet në valutë zënë rreth 53% të totalit të aktiveve dhe mbetën të pandryshuara gjatë 12 muajve deri në shtator 2023. Pretendimet e bankave vendëse ndaj jorezidentëve zënë rreth 22% të totalit të aktiveve dhe janë rritur me 7% në vit. Aktivet dhe detyrimet e bankave në valutë janë të krahasueshme në madhësi, ndërsa pretendimet ndaj jorezidentëve janë rreth 11 herë më të larta se detyrimet ndaj jorezidentëve dhe sektori bankar shqiptar mbetet një huadhënës neto kundrejt jorezidentëve.

Burimi kryesor i financimit të bankave vendëse është në formën e depozitave, të cilat në fund të muajit shtator shënuan vlerën 1,560 miliardë lekë dhe u rritën me 4% në terma vjetorë. Rritja e depozitave gjatë periudhës 12-mujore deri në shtator 2023 është mbështetur nga rritja e fortë e depozitave me afat dhe pa afat në valutë të mbajtura nga individët dhe sektori i biznesit, si dhe nga një rritje modeste e llogarive rrjedhëse në monedhë vendëse të sektorit privat. Mjedisi i zgjatur i normave të ulëta të interesit ka favorizuar një rritje më të shpejtë të depozitave pa afat dhe llogarive rrjedhëse deri në vitet 2020–2021, por në vitet 2022–2023 pesha e depozitave me afat në stokun e përgjithshëm të depozitave është stabilizuar rreth 43%. Megjithëse normat e interesit për depozitat në monedhën vendëse janë disi më të larta se ato të depozitave në valutë, rritja e depozitave me afat u lidh me zgjerimin e depozitave me afat të individëve në valutë. Flukset

më të larta valutore nga jashtë kanë mbështetur gjithashtu një rritje të moderuar të llogarive rrjedhëse të bizneseve në valutë.

Në fund të shtatorit 2023, stoku i tepricës së kredisë ishte 720 miliardë lekë, ose vetëm 1% më i lartë se një vit më parë. Rritja e tepricës së kredisë e shprehur në monedhë vendëse është ndikuar negativisht nga mbiçmimi i ndjeshëm i monedhës vendëse në terma vjetorë. E rregulluar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e stokut të kredisë arrin në 5%. Vëllimi i kredive të reja të dhëna nga bankat midis tremujorëve T4-22 dhe T3-23 ishte i krahasueshëm, megjithëse pak më i ulët në krahasim me vëllimin e kredive të reja në 4 tremujorët e mëparshëm, por zgjerimi i stokut të kredive u ndikua negativisht nga ngadalësimi i shlyerjeve të kredive performuese. Rritja më e lartë vjetore është vërejtur te kredia për individë, kredia në monedhë vendëse dhe kredia afatgjatë. Rritja e portofolit të kredisë për individë është mbështetur nga zgjerimi i stokut të kredisë konsumatore dhe i stokut të kredisë për blerje pasurish të paluajtshme rezidenciale. Rreth 54% e stokut të kredive të mbajtura nga sektori i biznesit është përdorur për financimin e investimeve në blerjen e pasurive të paluajtshme dhe pajisjeve. Për tre tremujorë radhazi, deri në T3-2023, bankat kanë raportuar kushte më të relaksuara të kreditimit dhe kushteve të kreditimit për individët dhe bizneset, të mbështetur nga një perspektivë makroekonomike më optimiste. Kjo qasje ka ndihmuar në rritjen e kërkesës për kredi veçanërisht në sektorin e individëve. Kërkesa për kredi pritet të mbetet e qëndrueshme gjatë tremujorit të fundit të vitit. Në tremujorin e katërt, bankat presin të shtrëngojnë kushtet e kredisë për individët dhe të mbajnë të pandryshuara ato për sektorin e biznesit.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar, në nivelin 19.6%, mbetet shumë mbi minimumin rregullator dhe është rritur me 0.4 p.p. nga shtatori 2022 deri në shtator 2023, për shkak të një rënie më të shpejtë të aktiveve të ponderuara me rrezik krahasuar me rënien e lehtë të kapitalit rregullator. Rezultati neto i sektorit bankar në fund të shtatorit 2023 ishte pozitiv (22,7 miliardë lekë), kështu që fitimet e bankave u dyfishuan pothuajse në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022, si rezultat i rritjes së të ardhurave neto nga interesi dhe humbjeve dukshëm më të ulëta nga investimet në instrumente financiare. Shpenzimet e veprimtarisë dhe provigjioneve janë rritur. Rritja e fitimeve neto është raportuar nga shumica e bankave, ku një bankë ka shënuar një rezultat të vogël negativ. RoA dhe RoE u rritën në 1.6% dhe 16.2% nga 1% dhe 9.4% në shtator 2022, por rritja ishte më e moderuar në krahasim me muajin shtator të vitit 2021. Pothuajse i gjithë fitimi neto u krijua nga aktiviteti i bankave në valutë, për të cilin bankat kanë regjistruar shpenzime të veprimtarisë dukshëm më të ulëta (3 herë më pak) krahasuar me aktivitetin në monedhë vendëse. Gjatë vitit 2023, bankat kanë vazhduar të rrisin shpenzimet e tyre për provigjionet e huave 'të humbura', në një nivel që ishte më i lartë se ai i vitit 2022 dhe dukshëm më i lartë se vlera e raportuar në vitin 2021. Rezultatet e provës së rezistencës për harkun kohor 2023-2025, tregon se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike, megjithëse disa banka mund të kenë nevojë të rrisin kapitalin e tyre të paguar.

Cilësia e kredisë të bankave tregon një përkeqësim të lehtë në shtator 2023, ku raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive (RKP) u rrit në 5.24% nga 5.1% në shtator 2022. Ky zhvillim reflekton një rritje më të shpejtë të stokut të kredive me probleme krahasuar në rritjen e tepricës totale të kredisë, veçanërisht në disa portofolë specifikë kredie si kreditë në monedhë vendëse, kreditë afatgjata, kreditë për sektorin e biznesit dhe kreditë për sektorët e tregtisë, bujqësisë dhe turizmit. Rritja e stokut të kredive me probleme është ndikuar nga zhvendosja e kredive me cilësi më të lartë drejt klasave më pak performuese dhe një vëllim më i ulët i fshirjeve dhe shlyerjeve brenda portofolit të kredive me probleme. Struktura e kredive me probleme dominohet nga kategoria e kredive të humbura (54%), ndërsa kreditë e dyshimta dhe ato nën standard zënë 14% dhe 33% të totalit të tepricës së kredive me probleme.

Mbikëqyrja makroprudenciale

Në vijim të miratimit të dokumentit të Strategjisë së Politikës Makroprudenciale (2017), i cili përcakton një kuadër të përgjithshëm operacional për zbatimin e politikës makroprudenciale në Shqipëri, Banka e Shqipërisë miratoi Rregulloren "Mbi shtesat makroprudenciale të kapitalit" (2019). Kjo rregullore përcakton metodën e vendosjes së shtesës konservuese të kapitalit (KONS), shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe shtesës së kapitalit për rrezikun sistemik (STRUK) për bankat që kryejnë aktivitet në Shqipëri. Të gjitha

këto shtesa duhet të plotësohen me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë (KBN1); aplikohen si shtesa ndaj kërkesave të detyrueshme për kapital që janë kërkesat për 'Shtyllën I + Shtyllën II + MREL[9]' dhe shprehen si raport në përqindje ndaj ekspozimeve të peshuara me rrezik. Rregullorja parashikon një zbatim gradual të shtesave makroprudenciale të kapitalit. Sipas Rregullores zbatimi i plotë i shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit do të realizohet në vitin 2024.

Pasqyrë e hyrjes graduale në fuqi të shtesave makroprudenciale të kapitalit

Shtesat makroprudenciale të kapitalit	2020	2021	2022	2023	2024 e në vazhdim
Shtesa konservuese e kapitalit (KONS)	0.5%	1%	1.5%	2%	2.5%
SPEKUNC* {Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC: 0-2.5%)}	0.625%	1.25%	1.875%	2.5%	3%
Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST)	0.5%	{0.5%; 1%}	{0.5%;1%;1.5%}	{0.5%;1%;1.5%;2	{0.5%;1%;1.5%;2 %; 2.5%}
ASTRUK** {Shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik (STRUK: 1-3%)}	1%	{1%; 1.5%}	{1%; 1.5%; 2%}	{1%; 1.5%; 2%; 2.	{1%; 1.5%; 2%; 2.5%; 3%}

Burimi: Banka e Shqipërisë

Duke filluar nga viti 2020 bankat kanë filluar të përmbushin kërkesat për kapital të lidhura me shtesat KONS dhe SIST. Ndërkohë që instrumenti KUNC është aktiv dhe operacional, norma e tij është e barabartë me zero që nga shpallja për herë të parë e kësaj norme, sipas vendimit të Guvernatorit që publikohet në fund të çdo tremujori. Banka e Shqipërisë shpall listën e bankave sistemike dhe shtesat përkatëse SIST një herë në vit në fund të tremujorit të parë. Në vitin 2022 lista u shkurtua në 4 banka nga 5 të përcaktuara si banka sistemike një vit më parë. Zbatimi i shtesave KUNC dhe SIST mbështetet nga metodologjitë shoqëruese që janë publikuar në faqen e Bankës së Shqipërisë. Përmbushja e kërkesave për shtesat e kapitalit sipas Rregullores nga ana e bankave vlerësohet çdo tremujor nga Banka e Shqipërisë në bazë të një pakete të posaçme raportimi dhe raportit përkatës. Shtesa për rrezikun sistemik nuk është ende operacionale, por në të ardhmen ajo mund të përdoret si një mjet makroprudencial për të adresuar rrezikun sistemik strukturor.

Me synimin për të monitoruar çdo cënueshmëri ndaj stabilitetit financiar që vjen nga ekspozimet në sektorin e pasurive të paluajtshme, BSH sapo ka miratuar (më 4 tetor 2023) një akt që do të rregullojë raportimin e të dhënave përkatëse nga sektori bankar. Rregullorja "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet në prona të paluajtshme" ka hyrë në fuqi më 28 tetor 2023 dhe është në përputhje të plotë me rekomandimin e ESRB-së të vitit 2014 dhe me versionin e ndryshuar të tij të vitit 2019. Bankat do t'i japin BSH-së informacion mbi ekspozimet e tyre ndaj pasurive të paluajtshme duke filluar nga marsi 2024. Rregullorja do t'i japë gjithashtu BSH-së kompetencën për të kalibruar dhe zbatuar masat me bazë kredimarrësin si instrumente makroprudenciale në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Kuadri i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në sektorin bankar

- Planifikimi dhe vlerësimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme

[9] Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara që lidhet me zbatimin e Ligjit për "Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë", nr. 133/2016.

Ligji "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë" i jep Bankës së Shqipërisë kompetencën si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vend. Ky mandat ligjor synon të sigurojë një ndërhyrje e jashtëzakonshme të organizuar të bankave në paaftësi paguese, duke shmangur ndikimin e tyre negativ në ekonominë reale, minimizim të përdorimit të parave e taksapaguesve si dhe mbrojtje të depozitave të siguruara dhe të aktiveve të klientëve.

Si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë vitit 2022 Banka e Shqipërisë, ka përfunduar ciklin e plotë të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat që operojnë në tregun bankar shqiptar. Secilës bankë i është dërguar një përmbledhje e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke u fokusuar në analizën strategjike të biznesit të bankës, "kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara" (MREL), që banka duhet të përmbushë për të përthithur humbjet dhe për t'u rikapitalizuar në rast ndërhyrjeje të jashtëzakonshme, si dhe vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë përditësoi ciklin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2023. Gjatë këtij viti, ajo riorganizoi në dy pjesë mbledhjen e informacionit për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe iu kërkoi bankave të dërgonin grupin e parë të formularëve të informacionit (që përmbanin të dhëna cilësore) deri në fund të muajit prill 2023 dhe grupin e dytë të formularëve, që përmbanin të dhëna sasiore, (Struktura e detyrimeve) deri në fund të muajit korrik 2023. Gjithashtu, në kuadër të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për ciklin e vitit 2023 është realizuar identifikimi dhe vlerësimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike si dhe vlerësimi i interesit publik për të gjitha bankat.

Për sa i përket kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara, pas hyrjes në fuqi të rregullores 78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara", Banka e Shqipërisë vendosi për herë të parë objektivin e ndërmjetëm për plotësimin e MREL në fund të vitit 2021, për të gjitha bankat. Në bazë të rregullores 78/2020 plotësimi i kërkesës për MREL do të realizohet brenda një periudhe 6-vjecare. Objektivi i parë i ndërmjetëm ishte dhjetori vitit 2022, ndërsa objektivi përfundimtar është dhjetori i vitit 2027. Sipas të dhënave të periudhës shtator 2023, bankat janë në përmbushje të objektivit të ndërmjetëm të MREL të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën e saj në fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka. Dy prioritetet për ciklin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2023 lidhen me likuiditetin dhe financimin në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe vazhdimësinë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në këtë kuadër, ajo ka kryer ekzaminimin vjetor në vend pranë bankave, duke synuar rritjen e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në vijim të këtij ekzaminimi, Banka e Shqipërisë përgatiti raportet individuale për secilën bankë me fokus arritjen e aftësisë së bankës për të zbatuar ndërhyrjen e jashtëzakonshme, sipas strategjisë dhe instrumentit të përzgjedhur në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë raport, Banka e Shqipërisë ka lënë një sërë rekomandimesh që duhet të përmbushen nga secila bankë, për të minimizuar pengesat e mundshme dhe për të rritur aftësinë e tyre për zbatimin e planit.

Banka e Shqipërisë është ftuar nga Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme – SRB, për të marrë pjesë në mbledhjet e Kolegjeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për dy grupe bankare me filiale që operojnë në Shqipëri, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet dy institucioneve në tetor të vitit 2018. Sipas kësaj marrëveshjeje, institucionet shkëmbejnë informacion në lidhje me subjektet bankare që operojnë në Shqipëri dhe BE, duke mundësuar një planifikim efikas të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për subjektet me veprimtari ndërkufitare.

- Kuadri rregullativ dhe metodologjik

Në zbatim të dispozitave të rregullores nr. 78/2020 "Për kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara", Banka e Shqipërisë ka përditësuar dokumentin metodologjik për ciklin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2023, për të përcaktuar mënyrën e llogaritjes së MREL-it për bankat. Kjo metodologji, mbështetet në dokumentin "Politika e MREL të SRB", e vitit 2020.

- Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Niveli i synuar i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që duhet të arrihet deri në vitin 2027 është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar e llogaritur si diferenca midis aktiveve dhe kapitalit të të gjitha bankave të licencuara në Shqipëri. Në bazë të vlerësimit më të fundit, niveli i synuar shënon aktualisht 8 miliardë lekë. Në përputhje me kërkesat ligjore, bankat paguajnë kontribute vjetore në Fond me qëllim përmbushjen e nivelit të synuar të Fondit. Sipas pasqyrave financiare të certifikuara të vitit 2022, Fondi shënonte 3.5 miliardë lekë. Gjatë muajit prill të gjitha bankat kryen pagesën e kontributit vjetor në Fond për vitin 2023, në nivelin 896.2 milionë lekë.

Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht ecurinë e aktiveve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, bazuar në raportimet tremujore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si Administrator i Fondit mbështetur në politikën e investimit në fuqi. Politika e investimit është hartuar dhe ndjek parimet e aktiveve likuide, të rrezikut të ulët për letrat me vlerë të borxhit dhe kthimit të arsyeshëm nga investimet.

Gjatë periudhës 2024–2026, Banka e Shqipërisë do ta përqendrojë aktivitetin e saj në këto fusha kryesore:

- Cikli vjetor i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka e Shqipërisë do të përditësojë për çdo vit planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për secilën bankë. Gjatë periudhës 2024–2026, planet vjetore do të përqendrohen në rritjen në vazhdimësi të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka. Me qëllim identifikimin dhe adresimin e pengesave të mundshme për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, do të hartohen plane veprimi për secilën prej tyre, duke u fokusuar në:

- fuqizimin e qeverisjes së bankave me fokus ndërhyrjen e jashtëzakonshme,
- identifikimin e stafit kritik përgjegjës për vazhdimësinë e funksioneve kritike,
- sigurimin e përshtatshmërisë së informacionit dhe sistemit të informacionit,
- hartimin e planeve të kontigjencës për vazhdimësinë operacionale dhe financiare në ndërhyrje e jashtëzakonshme;
- përmbushjen e nivelit të synuar të kërkesave minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara.

Banka e Shqipërisë do të monitorojë dhe mbështesë fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka, nëpërmjet një komunikimi aktiv dhe ekzaminimeve të rregullta, me qëllim operacionalizimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

- Kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara

Banka e Shqipërisë do të përditësojë rregullisht metodologjinë për përcaktimin e kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara - MREL, duke marrë parasysh kërkesën për kapital në fuqi për çdo vit, deri në plotësimin përfundimtar të kërkesës minimale. Gjatë periudhës 2024-2027, sektori bankar do të përmbushë gradualisht kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara.

- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik

Banka e Shqipërisë është e angazhuar të harmonizojë praktikat dhe kuadrin rregullator e metodologjik në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme me zhvillimet në legjislacionin Evropian. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të zgjerojë punën e saj në operacionalizimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme e mbështetur nga institucione ndërkombëtare, si EBRD dhe FinSAC.

- Monitorimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Përsa i përket Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë do të llogarisë nivelin e synuar dhe kontributin vjetor nga bankat dhe do të sigurojë mbledhjen e kontributeve vjetore për të përmbushur objektivin deri në vitin 2027, siç përcaktohet në kuadrin ligjor dhe rregullator. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të monitorojë investimin e mjeteve financiare të Fondit, në përputhje me politikën e investimit në fuqi.

3.3 Skenarët alternativë dhe risqet

Skenari bazë vlerësohet të ketë probabilitet më të lartë për t'u materializuar. Megjithatë parashikimi i skenarëve alternativë – duke supozuar se një pjesë e risqeve të ndryshme, që rrethojnë skenarin bazë mund të materializohen – është një komponent i rëndësishëm i planifikimit të financave publike. Në mënyrë që të rritet cilësia e planifikimit dhe të ketë një menaxhim më efikas të fondeve publike në çdo situatë që ka një probabilitet të caktuar për të ndodhur, më poshtë paraqiten shkurtimisht dy

skenarë alternativë, në mënyrë specifike një skenar "pesimist" dhe një skenar "optimist". Secili nga skenarët alternativë supozon që një grup risqesh negative (në rastin e një skenari "pesimist") ose risqesh pozitive (në rastin një skenari "optimist") do të materializohen. Ky grup risqesh supozon devijime nga parashikimet në skenarin bazë për treguesit kryesorë makroekonomikë, duke përfshirë kreditimin e ekonomisë, ecurinë e ekonomisë së Eurozonës me efektet që ka në eksportin e mallrave dhe të shërbimeve, në remitanca, në flukset e kapitaleve të huaja, si dhe në kursin e këmbimit, normën e interesit, ritmin dhe ndikimin e reformave të politikave strukturore të planifikuara për periudhën afatmesme etj.

Për thjeshtësinë e analizës (modelimit), efekti i përgjithshëm neto i të gjitha risqeve të supozuara, negative ose pozitive, jepet si një goditje fillestare në terma të një variabli të vetëm, "rritjes ekonomike reale". Pra, skenarët alternativë bazohen në supozime të ndryshme të rritjes ekonomike nga skenari bazë për secilin vit 2024–2026. Në këtë seksion, si dhe në seksionin tjetër përkatës 4.7 (Analiza e ndjeshmërisë), në mënyrë që të kemi një pamje më gjithëpërfshirëse dhe të dobishme dhe qasjen e përballimit të secilit skenar alternativ, ne zgjasim horizontin e kohës së simulimit deri në vitin 2026. Tabela e mëposhtme paraqet supozimet e "rritjes reale" në skenarët alternativë, rritjen nominale të derivuar dhe nivelin nominal të PBB-së, si dhe disa supozime të tjera (implikimet e supozuara) mbi disa variabla kryesorë fiskalë që shpjegohen në seksionin 4.7. Më shumë rëndësi i japim skenarit "pesimist" dhe përballimit të mundshëm të implikimeve të tij, si dhe prezantojmë në mënyrë asimetrike një goditje më të madhe negative në këtë skenar krahasuar me madhësinë e kundërt të goditjes pozitive që prezantojmë në atë "optimist". Supozojmë se në skenarin "pesimist" rritja reale e PBB-së do të jetë 1.5 p.p. më e ulët për çdo vit (2024–2026) se sa parashikimet përkatëse të rritjes në skenarin "bazë". Ndërsa në skenarin "optimist" supozojmë se rritja reale do të jetë 0.5 p.p. më i lartë për çdo vit se sa ajo që parashikojmë përkatësisht në skenarin "bazë".

Tabelë 3.3.1: Supozimet alternative për secilin skenar

	2018	2019	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Rritja reale e PBB (%)									
Bazë	4.0	2.1	-3.3	8.9	4.9	3.5	3.7	3.9	4.0
Pesimist							2.2	2.4	2.5
Optimist							4.2	4.4	4.5
Rritja nominale e PBB (%)									
Bazë	5.6	3.4	-2.6	12.7	15.2	8.1	5.3	5.1	5.2
Pesimist							3.5	3.2	3.4
Optimist							5.8	5.6	5.7
PBB nominale (në miliard Lek)									
Bazë	1,636.7	1,691.9	1,647.4	1,856.2	2,138.3	2,311.7	2,434.3	2,557.7	2,690.5
Pesimist							2,392.0	2,469.7	2,552.8
Optimist							2,446.0	2,582.4	2,729.5
Totali i të ardhurave (% e PBB)									
Bazë	27.5	27.2	25.9	27.5	26.8	28.0	27.8	27.8	27.8
Pesimist							27.3	27.3	27.3
Optimist							27.8	27.8	27.8
Rritja vjetore e totalit të të ardhurave (%)									
Bazë	4.5	2.3	-7.5	20.0	12.1	13.0	4.5	5.0	5.4
Pesimist							0.8	3.2	3.5
Optimist							5.2	5.5	5.9
Totali i të ardhurave (në miliard Lek)									
Bazë	449.9	460.3	425.9	511.0	572.8	647.2	676.1	709.8	747.9
Pesimist							652.4	673.0	696.8
Optimist							680.6	718.0	760.1
Norma efektive e interesit të borxhit publik (%)									
Bazë	3.5	3.3	3.2	3.0	3.0	3.9	4.4	4.8	5.3
Pesimist							4.4	4.8	5.3
Optimist							4.4	4.8	5.3
Norma nominale e këmbimit, në fund të vitit (Lek/Euro)									
Bazë	123.5	122.2	123.5	120.8	114.9	110.0	110.0	110.0	110.0
Pesimist							110.0	110.0	110.0
Optimist							110.0	110.0	110.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

4. KUADRI FISKAL

4.1 Politikat strategjike dhe objektivat afatmesëm

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurt dhe optimale të konsolidimit fiskal, të materializuar në parametrat më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë. Ndërsa në vitin 2020 dhe 2021, si kundërpërgjigje kryesore me qëllim amortizimin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), u ndërmor një politikë fiskale mjaft ekspansioniste. Për rrjedhojë, në vitin 2021 deficiti i përgjithshëm buxhetor arriti në rreth 4.6% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 74.5% të PBB-së, pra me rreth 8.7 pp më i lartë krahasuar me fundin e 2019-ës. Gjithashtu, me synimin për të ruajtur sa më shumë të paprekur besueshmërinë e financave publike në perceptimin e tregjeve, në korrik 2020 u ndërmor një nismë tjetër ligjore, duke futur një rregull të ri fiskal në LOB. Ky rregull fiskal i ri, i cili është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e KE-së dhe parimet kryesore të acquis të BE-së, bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Në rishikimet e buxhetit për vitin 2022 u krijua hapësira e nevojshme fiskale për të akomoduar elementë të ndryshëm, me qëllim për të zbutur ndikimin e krizës për aspekte të ndryshme sociale dhe ekonomike. PBB-ja e lartë nominale dhe rritja e fortë e të ardhurave të shoqëruara me përmirësime administrative në mbledhjen e tatimeve e ulën deficitin fiskal në 3.7 për qind në vitin 2022. Njëkohësisht, progres i konsiderueshëm u regjistrua në uljen e borxhit publik në raport ndaj PBB-së, që u ul në 64.5 për qind në fund të 2022-it, një rënie e dukshme nga 74.5 për qind e raportuar më 2021, dhe veçanërisht nën nivelin parapandemik dhe para tërmetit prej 65.8 për qind të regjistruar më 2019.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Politika fiskale do targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv që prej vitit 2024 dhe do të vijojë e tillë në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskalë në LOB. Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do targetohen të jenë rreth 5.0 për qind e PBB në çdo vit buxhetor. Shpenzimet kapitale parashikohen përkatësisht në 5.3 për vitin 2024 dhe 4.8 për qind për vitet 2025 dhe 2026. Defiçiti buxhetor për vitin 2024 planifikohet të jetë në nivelin 2.5 për qind të PBB-së nga rreth 2.2 për qind i pritshëm për vitin 2023. Balanca primare pritet të jetë pozitive në rreth 0.2 për qind, në një përmirësim nga niveli neutral (jo negativ) që pritet për vitin 2023. Balanca korrente fiskale (diferenca midis investimeve publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin 2024, në nivelin prej 2.8 për qind të PBB-së nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 3.7 për qind në vitin 2023, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal ("rregullin e artë" të buxhetit).

Për periudhën afatmesme 2024–2026, deficiti buxhetor parashikohet mesatarisht në rreth 2.2 për qind në vit. Më konkretisht bilanci i përgjithshëm fiskal synohet në -2.5 për qind për 2024, dhe -2.1 për qind për vitet 2025 dhe 2026. Balanca primare parashikohet mesatarisht në rreth 0.6 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme vijuese 2024–2026. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku në LOB përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Në vitin 2024, balanca primare është projektuar në rreth 0.2 për qind të PBB-së dhe do të vazhdojë të zgjerohet më tej në normën prej 0.8 për qind në vitin 2025 dhe në 0.9 për qind në vitin 2026. Bilanci korrent fiskal synohet mesatarisht në rreth +2.7 për qind në vit gjatë periudhës afatmesme 2024–2026. Më konkretisht, bilanci korrent fiskal është parashikuar përkatësisht në 2.8 për qind për vitet 2024 dhe 2025 dhe 2.6 për qind për vitin 2026.

Si rrjedhojë, borxhi publik ndaj PBB-së do të vazhdojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin fiskal përkatës. Në vitin 2023, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 61.5 për qind të PBB-së nga rreth 64.5 për qind në vitin 2022 dhe pritet të vazhdojë të bjerë më tej në rreth 59.8 për qind në vitin 2024. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet

të bjerë në rreth 58.9 për qind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 52.7 për qind deri në vitin 2031.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE[10]

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936/2008, të ndryshuar, KMF 2024–2026 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të produktit të brendshëm bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, KMF 2024–2026 ***targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.***

2. Vlera e produktit të brendshëm bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva ekonomike botërore" (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, KMF 2024–2026 ***bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të FMN të raportit "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook), të tetorit 2023.***

Parashikimet nominale të MFE dhe FMN **(miliardë lekë)**

	2021	2022	2023 *Para.*	2024 *Para.*	2025 *Para.*	2026 *Para.*
MFE	1,856.2	2,138.3	2,311.7	2,434.3	2,557.7	2,690.5
FMN - Perspektiva Ekonomike Botërore	1,856.2	2,138.3	2,312.5	2,476.6	2,639.3	2,811.8
Diferenca MFE - FMN	**0.0**	**0.0**	**-0.8**	**-42.3**	**-81.5**	**-121.3**
(diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)						

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, Kuadri 2024–2026 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar *"Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj."* ***një kontigjencë prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale***.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit, ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, Kuadri 2024–2026 ***nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme***.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – "rregulli i artë") të LOB-it, deficiti i targetuar në Kuadrin 2024–2026 ***është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.*** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.7 për qind të PBB-së në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor që prej vitit 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

[10] *1. Linku për raportin "WEO" – https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2023/10/10/world-economic-outlook-october-2023*

Në përputhje me këtë dispozitë, Kuadri 2024–2026 **targeton një balancë primare pozitive në vitin 2024 me 0.2 për qind, 0.8 për qind në vitin 2025 dhe 0.9 për qind në vitin 2026**.

4.2. Implementimi i buxhetit për vitin 2023

Ecuria e treguesve kryesorë të të ardhurave për periudhën janar–shtator 2023

Të ardhurat totale tatimore për periudhën janar–shtator 2023, janë 440,4 miliardë lekë, 8.6% ose 35 miliardë lekë më shumë se 9-mujori i vitit 2022. Nga totali i të ardhurave, të ardhurat e arkëtuara nga "tatimet dhe doganat" (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 9-mujorin 2023, u realizuan në vlerën 415 miliardë lekë, 9.2% ose 35,1 miliardë lekë më shumë se 9-mujori 2022 dhe 2.8% ose 11,2 miliardë lekë më shumë se plani fillestar 9-mujor i vitit 2023.

Tabela 4.2.1: Të ardhurat totale nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 9M 2023	Plan fillestar 9M 2023	Diferenca fakt / Plan fillestar 9 M 2023	
			vlera	%
Totali i TVSH-së neto	143,569	151,256	-7,687	-5.1%
Tatimi mbi fitimin	44,935	35,527	9,408	26.5%
Akciza	43,114	43,575	-461	-1.1%
Tatimi mbi të ardhurat personale	43,819	37,232	6,587	17.7%
Totali i taksave kombëtare	30,315	37,820	-7,505	-19.8%
Taksa doganore	6,700	6,315	385	6.1%
TOTALI TAKSA + DOGANA	**312,452**	**311,725**	**727**	**0.2%**
Kontributet e mbledhura	102,551	92,099	10,452	11.3%
TOTALI DPD + DPT (Kontribute)	**415,003**	**403,824**	**11,179**	**2.8%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ecurinë pozitive 9-mujore kundrejt planit fillestar janë:

- Fiskalizimi, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.
- Zgjerimi i aktivitetit ekonomik, duke u mbështetur nga performanca e mirë e sektorit privat.
- Rritja e të ardhurave nga kontributet si rezultat i rritjes së pagës minimale dhe maksimale mbi të cilën llogariten kontributet, reformës në fushën e pagave si rezultat i së cilës janë rritur pagat, rrjedhimisht edhe kontributet e sigurimeve të sektorit publik, si dhe për shkak të reduktimit të informalitetit në fushën e deklarimit të pagave nga sektori privat

Të ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 9-mujorin e vitit 2023 ka arkëtuar 159.8 miliardë lekë, me një ulje krahasuar me vitin 2022, në masën 4.6 miliardë lekë ose 2.8% më pak dhe me mosrealizim kundrejt planit fillestar në masën 7.8%.

Tabela 4.2.2: Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 9M 2023	Plan 9M fillestar 2023	Diferenca fakt / Plan fillestar 2023	
			vlera	%
TVSH në import	107,725	120,040	-12,315	-10.3%
Akciza	43,114	43,575	-461	-1.1%
Renta minerare	2,276	3,492	-1,216	-34.8%
Taksa doganore	6,700	6,315	385	6.1%
TOTAL DPD	**159,815**	**173,422**	**-13,607**	**-7.8%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga "TVSH"-ja në import janë realizuar në vlerën 107.7 miliardë lekë, me mosrealizim në masën 10.3% kundrejt planit fillestar të periudhës. Të ardhurat nga TVSH në import janë impaktuar ndjeshëm në vitin 2023 nga ndryshimet e forta të kursit të këmbimit, të cilat kanë ulur bazën e llogaritjes së TVSH-së për mallrat e importit. Rritja e TVSH-së për shkak të rritjes së volumeve të importit të mallrave nuk ka kompensuar uljen e ndjeshme të TVSH-së për shkak të zvogëlimit të bazës së llogaritjes së TVSH-së si rezultat i zhvlerësimit të euros dhe dollarit.

Të ardhurat nga "Akciza" janë realizuar në vlerën 43.1 miliardë lekë, me mosrealizim kundrejt planit fillestar në masën 1.1%.

Të ardhurat nga "Renta Minerare" në eksport janë realizuar në vlerën 2.3 miliardë lekë, me mosrealizim në masën 34.8% kundrejt planit fillestar. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto kanë pësuar ulje si rezultat i uljes së sasisë së prodhimit të naftës bruto e cila për 9-mujorin 2023 është 6.2% më pak se viti i kaluar me efekt -159 milionë lekë, por në të njëjtën kohë edhe ulja e çmimit për njësi të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare nga 5.7 lekë në 4.07 lekë, ka sjellë një efekt -688 milionë lekë.

Ndërkohë të ardhurat nga renta minerare kanë pësuar ulje edhe pse sasia e prodhimit të mineraleve të eksportuara për 9-mujorin 2023 është rritur 12.6% më shumë se vitin e kaluar me efekt 93.6 milionë lekë, por në të njëjtën kohë edhe ulja e çmimit për njësi të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare nga 0.59 lekë në 0.39 lekë, ka sjellë një efekt -281 milionë lekë.

Të ardhurat nga "Taksa Doganore" janë realizuar në vlerën 6.7 miliardë lekë, me realizim në masën 6.1% më shumë se plani fillestar i periudhës. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produket si material ndërtimi (38%), veshjet e këmbës dhe të kokës (27%), detergjent, parfumeri (13%).

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (duke përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT) për periudhën Janar-Shtator 2023 janë 255.2 miliardë lekë, me një realizim 110.8% të planit fillestar vjetor dhe 18.4% ose 39.7 miliardë lekë më shumë se të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tabela e mëposhtme tregon të dhëna të detajuara mbi performancën tatimore.

Tabela 4.2.4: Të ardhurat e mbledhura nga DPT (në milionë lekë)

Lloji i taksës	Fakt 9M 2023	Plan fillestar 9M 2023	Diferenca fakt / Plan fillestar 2023	
			vlera	%
TVSH NETO	**35,844**	**31,216**	**4,628**	**14.8%**
TVSH e mbledhur	50,437	44,516	5,921	13.3%
Rimbursimi i TVSH-së	14,594	13,300	1,294	9.7%
Tatimi mbi fitimin	**44,935**	**35,527**	**9,408**	**26.5%**
Tatimi mbi të ardhurat personale	**43,820**	**37,232**	**6,588**	**17.7%**
Taksat nacionale	**28,039**	**34,328**	**-6,289**	**-18.3%**
Total	**152,637**	**138,303**	**14,334**	**10.4%**
Kontributet	102,551	92,099	10,452	11.3%
TOTAL DPT+ kontribute	**255,187**	**230,402**	**24,785**	**10.8%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat neto nga TVSH janë në vlerën 35.8 miliardë lekë, me një realizim 114.8% kundrejt planit fillestar dhe 7.4 miliardë lekë ose 26 % më shumë se 9-mujori 2022. Në periudhën janar–shtator 2023, shuma e TVSH-së së rimbursuar është 14.6 miliardë lekë, 7% ose 950 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022 si dhe 1.3 miliardë lekë ose 9.7% më shumë se plani i rimbursimit të TVSH-së për 9-mujorin 2023. Sektorët me kontributin më të madh në të ardhurat nga TVSH-ja, krahasuar me 9-mujorin 2022, janë:

- Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 14.2 miliardë lekë me rritje në të ardhura 13% ose 1.6 miliardë lekë më shumë e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 8.6 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 28% ose 1.9 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 6.7 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 24% ose 1.3 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 982 milionë lekë me një rritje në të ardhura 44% ose 298 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit.
- Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 12.6 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 15% ose 1.7 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.

Grafiku 4.2.5: Ecuria e TVSH-së gjatë 9-mujore ndër vite (në milionë lekë)



Grafiku 4.2.6: Rimbursimet e TVSH-së për periudhën 9-mujore ndër vite (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Të ardhurat nga "Tatimi mbi fitimin" janë realizuar në vlerën 44,9 miliardë lekë, me realizim 26.5% më ose 9,4 miliardë lekë më shumë se plani fillestar i periudhës. Nga analiza e tatimit mbi fitimin sipas sektorëve krahasuar me një vit më parë rezulton:

- Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 16.5 miliardë lekë me rritje në të ardhura 13% ose 1.9 miliardë lekë më shumë e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 10.2 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 28% ose 2.3 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 7.5 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 24% ose 1.5 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën janar–shtator 2023 janë 1.1 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 45% ose 352 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit.

Grafiku 4.2.7: Ecuria e tatimit mbi fitimin ndër vite për një periudhë 9-mujore (në milionë lekë)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Tatimi mbi të ardhurat personale është arkëtuar në vlerën 43,8 miliardë lekë, 9,7 miliardë lekë ose 28.5% më shumë se 9-mujori 2022, si dhe 6,6 miliardë lekë ose 17.7% më shumë se plani fillestar i 9-mujorit 2023. Peshën kryesore për periudhë janar–shtator 2023 në tatimin mbi të ardhurat personale e kanë zërat kryesore si:

- Sektori i shërbimit me gjenerimin më të lartë në të ardhura për periudhën me vlerë 17.2 miliardë lekë për vitin 2023 ose sa 69% e totalit të arkëtuar.

- Sektori i tregtisë me të ardhura 2.6 miliardë lekë ose sa 11% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i prodhimit me të ardhura 3.3 miliardë lekë ose sa 13% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i transportit me të ardhura 761 milionë lekë ose sa 3% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i Ndërtimit me të ardhura 1 miliardë lekë ose sa 4% e totalit të arkëtuar.

Grafiku 4.2.8: Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale gjatë viteve për periudhën 9-mujore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

- Të ardhurat nga "taksat nacionale" janë realizuar në vlerën 28 miliardë lekë, me mosrealizim në masën 18.3% të planit fillestar të periudhës. Peshën kryesore në të ardhura e zë taksa e qarkullimit me 51%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit me 15 %, ndërsa taksa e ambalazhit + taksa e karbonit + tatimi për lojërat e fatit me rreth 18%.
- Ndikim të rëndësishëm në arkëtime nga taksat nacionale për 9-mujorin 2023 kanë rezultuar:
- Taksa e qarkullimit me të ardhura në masën 14.7 miliardë lekë me një rritje nga viti i kaluar me 970 milionë lekë ose 7.1% më shumë se 9-mujori i vitit 2022.
- Të ardhurat nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit u realizua në masën 4.4 miliardë lekë me një rritje nga viti i kaluar me 349 milionë lekë ose 8.6% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.
- Taksa e karbonit u realizuan në masë 1.9 miliardë lekë me një rritje nga viti i kaluar me 125 milionë lekë ose 7.2% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.

Grafiku 4.2.9: Ecuria e taksës kombëtare ndër vite për periudhën 9-mujore (në milionë lekë)

Burimi: Ministria e Finacave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga "Kontributet e DPT-së" janë realizuar në vlerën 102,6 miliardë lekë, me realizim në masën 11.3% më shumë se plani fillestar i periudhës. Të ardhurat e kontributeve të sigurimeve sipas sektorve për periudhë janar–shtator 2023 rezulton:

- Sektori i shërbimit me gjenerimin më të lartë në të ardhurat nga kontributet me vlerë 61.1 miliardë lekë.
- Sektori i tregtisë me të ardhura 15.8 miliardë lekë.
- Sektori i prodhimit me të ardhura 16.3 miliardë lekë.
- Sektori i ndërtimit me të ardhura 6.4 miliardë lekë.
- Sektori i transportit me të ardhura 3 miliardë lekë.

Grafiku 4.2.10: Ecuria e Kontributeve të sigurimeve ndër vite për periudhën 9-mujore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Ecuria e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar–shtator 2023

Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën nëntëmujore të vitit 2023, arritën në rreth 425.9 miliardë lekë, me një realizim në masën 92.3 për qind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ky zë ka rezultuar 3.9 për qind më i lartë ose rreth 16.03 miliardë lekë më shumë. Në *terma vjetorë*, shpenzimet e përgjithshme për periudhën 9-mujore të vitit 2023 u realizuan në masën 61 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet korente, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, rezultuan në rreth 379.5 miliardë lekë ose 98 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 10.6 për qind më i lartë ose rreth 36.4 miliardë lekë më shumë. Në *terma vjetorë,* shpenzimet korente për periudhën 9-mujore të vitit 2023 janë realizuar në masën 69.4 për qind të planit vjetor.

Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 9-mujor janë përkatësisht:

- Shpenzimet për subvencione: 127.8 për qind të planit të periudhës dhe 70.3 për qind të planit vjetor.
- Shpenzimet e tjera sociale: 105.5 për qind të planit të periudhës dhe 72 për qind të planit vjetor.
- Shpenzimet e personelit: 102 për qind të planit të periudhës dhe 74.7 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet e personelit, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, përfaqësuan 19.1 për qind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 72.4 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 9-mujore, në masën 102 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë është 16.7 për qind më i lartë ose rreth 10.4 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e personelit rezultojnë 74.7 për qind të planit vjetor.

- Shpenzimet për paga për periudhën 9-mujore të vitit 2023 u realizuan në masën rreth 61.7 miliardë lekë ose 104.1 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 ky zë rezulton 16.5 për qind më i lartë ose rreth 8.8 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet për paga rezultojnë 77.1 për qind të planit vjetor.
- Shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën rreth 10 miliardë lekë ose rreth 100.4 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën

periudhë të vitit 2022, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë 14.9 për qind më të larta ose rreth 1.3 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë rreth 74.5 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet për interesa, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, kanë përfaqësuar 9.2 për qind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 34.8 miliardë lekë ka rezultuar në masën 89 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë ka rezultuar 16 për qind më i lartë ose rreth 4.8 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet për interesa rezultojnë 57 për qind të planit vjetor.

Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, kanë shënuar një realizim në masën rreth 42.4 miliardë lekë ose 97.5 për qind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 65.1 për qind të planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë ka rezultuar 10.2 për qind më i lartë, ose rreth 3.9 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet për subvencione, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, arritën nivelin rreth 1.1 miliardë lekë, me një realizim në masën 127.8 për qind të planit të periudhës dhe 70.3 për qind të planit vjetor. Ndërkohë që, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 shpenzimet për subvencione rezultojnë 27.7 për qind më të larta ose 244 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për fondet speciale për periudhën 9-mujore të vitit 2023 rezultuan në nivelin rreth 161.4 miliardë lekë, me një realizim prej 98.4 për qind kundrejt planit të periudhës ose 71.3 për qind të planit vjetor. Përkatësisht:

- Shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 122.3 miliardë lekë, me një realizim në masën 102.5 për qind të planit të periudhës ose 75.7 për qind e planit vjetor.

- Shpenzimet për sigurime shëndetësore u realizuan në masën rreth 38 miliardë lekë, me një realizim në masën 98.1 për qind të planit të periudhës ose 69.8 për qind e planit vjetor.

- Shpenzimet për kompensimin e pronarëve u realizuan në masën rreth 1.02 miliardë lekë, me një realizim në masën 28 për qind të planit të periudhës ose rreth 22.7 për qind e planit vjetor.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan rreth 8 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore 978 milionë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 203 milionë lekë më të ulëta.

Shpenzimet e tjera sociale, për periudhën 9-mujore të vitit 2023 rezultuan në nivelin rreth 21.6 miliardë lekë, me një realizim prej 105.5 për qind kundrejt planit të periudhës ose 72 për qind të planit vjetor. Përkatësisht:

- *Shpenzimet për papunësinë* për periudhën 9-mujore të vitit 2023 janë realizuar në masën 636 milionë lekë ose 94.1 për qind e planit të periudhës dhe 70.7 për qind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 15.1 për qind, ose 84 milionë lekë më shumë.

- *Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë* (PAK) për periudhën 9-mujore të vitit 2023 u realizuan në masën rreth 17.8 miliardë lekë duke rezultuar 100.7 për qind e planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, ato janë realizuar në masën 68.4 për qind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 3.5 për qind ose 593 milionë lekë më shumë.

- *Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik*, për periudhën 9-mujore të vitit 2023 u realizuan në masën 842 milionë lekë duke rezultuar 146.7 për qind e planit të periudhës ose 84.2 për qind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje prej 47.7 për qind ose 272 milionë lekë më shumë.

- *Shpenzimet për bonusin e lindjeve* për periudhën 9-mujore të vitit 2023 u realizuan në masën 2.4 miliardë lekë duke rezultuar 149 për qind e planit të periudhës ose 109 për qind e planit vjetor me ndryshime. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 4.3 për qind ose 100 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për pushtetin vendor, për periudhën 9-mujore të vitit 2023, kanë arritur në masën rreth 45.7 miliardë lekë duke përbërë 12 për qind të shpenzimeve korrente. Këto shpenzime janë realizuar në masën 94.5 për qind të planit të periudhës ose 69.7 për qind të planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 ky nivel rezulton 18.8 për qind më i lartë ose rreth 7.2 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet kapitale, për periudhën 9-mujore të vitit 2023 kanë një realizim në masën rreth 46.4 miliardë lekë ose 71.2 për qind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Krahasuar me të

njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë rezulton 9 për qind më i ulët ose rreth 4.6 miliardë lekë më pak. Konkretisht:

- Financimi i brendshëm për periudhën 9-mujore të vitit 2023 është realizuar në masën rreth 33 miliardë lekë ose 110.2 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë rezulton 31.4 për qind më i lartë ose rreth 7.9 miliardë lekë më shumë.

- Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 404 milionë lekë ose 68.2 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë rezulton 25 për qind më i ulët ose 134 milionë lekë më pak.

- Financimi i huaj ka shënuar një realizim prej rreth 7.9 miliardë lekë ose 26.8 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ky zë rezulton 32 për qind më i ulët ose rreth 3.7 miliardë lekë më pak.

Në terma vjetorë, për periudhën 9-mujore të vitit 2023 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i shpenzimeve kapitale në masën 37.4 për qind të planit vjetor. Konkretisht:

- Financimi i brendshëm është realizuar në masën 45.7 për qind të planit vjetor.

- Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 40.4 për qind të planit vjetor.

- Financimi i huaj është realizuar në masën 17.3 për qind të planit vjetor.

Fondi i rindërtimit për periudhën 9-mujore të vitit 2023 është realizuar në masën rreth 5 miliardë lekë, duke rezultuar 100 për qind e planit të periudhës dhe e planit vjetor 2023. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2022 ky nivel rezulton 63.4 për qind më i ulët ose rreth 8.7 miliardë lekë më pak.

Niveli i suficitit për periudhën 9-mujore të vitit 2023 rezultoi në rreth 51.4 miliardë lekë nga rreth 8.5 miliardë lekë suficit i planifikuar për këtë periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, niveli i suficitit ka rezultuar rreth 35.1 miliardë lekë më shumë.

4.3. Planet buxhetore për vitin e dorëzimit të ERP-së

Programimi i të ardhurave të buxhetit për vitin 2024 mbështet objektivat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e të ardhurave, dhe kryesisht atyre që gjenerohen nga sistemi tatimor, me qëllim mbështetjen e shpenzimeve publike për arsimin, shëndetsinë, mbrojtjen sociale, rritjen e rrogave e pensioneve, investimeve në infrastrukturë, bujqësi, energji dhe drejtime të tjera të cilat gjenerojnë zhvillim dhe të ardhura. Njëkohësisht, programimi i drejtë i të ardhurave synon të mbështesë planifikimin e niveleve të duhura të deficitit buxhetor, atij primar, si dhe mbajtjen në kontroll dhe reduktimin gradual të borxhit publik.

Ky program bazohet në përmirësimin e politikave tatimore dhe administrimit fiskal, duke zgjeruar bazën e tatimit dhe minimizuar informalitetin në ekonominë e vendit. Programi i të ardhurave merr në konsideratë gjithashtu faktorët që mund të impaktojnë zhvillimet ekonomike në vitin 2024 përfshirë edhe risqet e mundshme që mund të shfaqen (inflacioni, kursi i këmbimit të monedhave dhe ndikimi I tyre mbi importet dhe eksportet, çmimet, investimet, energjia elektrike etj.). Në programimin e të ardhurave nga tatimet, doganat dhe kontributet e sigurimeve për vitin 2024, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e pritshëm të rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve mbi këto të ardhura, politikat e reja fiskale si dhe efektet e përmirësimit të administrimit tatimor e doganor, përfshirë luftën ndaj informalitet, e shoqëruar kjo me përmirësime ligjore, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2024

Të ardhurat nga "TVSH-ja" parashikohet të jetë rreth 211.2 miliardë lekë, 11.2 miliardë lekë ose 5.6 % më shumë se pritshmëria për vitin 2023. Burimet e rritjes së TVSH-së në vitin 2024 përfshijnë:

- Rritjen e të ardhurave nga TVSH që gjeneron rritja ekonomike shtesë dhe indeksi i çmimeve;

- Fokusimi për rritjen e të ardhurave nga sektorë në ekspansion si turizmi, akomodimi dhe gjithë sektorët e tjerë të zinxhirit ekonomik që furnizojnë turizmin;

- Përmirësimin e administrimit të TVSH-së nga sistemi i fiskalizimit dhe kosolidimi i faturimit elektronik.

Të ardhurat nga "tatimi mbi fitimin" programohen të jenë +3 miliardë ose 6% më shumë krahasuar me të pritshmin e vitit 2023 (të zhveshur nga faktori *one–off*, taksa e veçantë mbi prodhuesit e energjisë elektrike). Parashikimi i tatimit mbi fitimin korporativ për vitin 2024, bazohet në:

- Deklarimin në mars të vitit 2024 të bilanceve financiare të vitit 2023, vit në të cilin, bazuar edhe në parametrat ekonomikë të identifikuar si rritja e

qarkullimit, operatorët ekonomikë kanë realizuar të ardhura dhe fitime të larta, çka do reflektohet në pagesat e detyrimeve të tatimit mbi fitimin nga industri të tilla si turizmi, ndërtimi etj kanë pasur rritje dhe fluks të ardhurash.

- Forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.

- Efektet e paketës fiskale 2024.

Të ardhurat nga "akciza" programohen 63.6 miliardë lekë, + 4.6 miliardë lekë ose +7.8 % më shumë se i pritshmi i vitit 2023. Faktorët kryesorë në parashikimin e të ardhurave nga akciza lidhen me:

- rritja e nivelit të akcizave për shkak të indeksimit dhe zbatimit të skemës së rritjes për duhanet;

- rritjen e sasive të importit, prodhimit vendës dhe konsumit të mallrave të fortë si karburante, cigare, pije alkoolike, verë, birrë etj., kjo edhe për shkak të rritjes shumë të madhe të fluksit të turistëve në vend;

- forcimin e luftës kundër informalitetit, nëpërmjet kontrollit rigoroz të subjekteve të akcizës;

- reduktimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë;

- efekteve të paketës fiskale që parashikojnë rritjen e akcizës së cigareve sipas grafikut dhe indeksimin e akcizës së produkteve të tjera sipas metodologjisë në fuqi.

Të ardhurat nga "tatimi mbi të ardhurat personale" parashikohen 65.2 miliardë lekë, me rritje prej +9.2 miliardë lekë ose +16.4% më shumë se pritshmëritë për vitin 2023. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë:

- efektet e reformës së pagave në sektorin shtetëror, rritja e të cilave do të gjenerojë të ardhura shtesë nga tatimi mbi pagat;

- rritjen e numrit të punëmarrësve dhe pagës mesatare në sektorin privat, i cili për shkak të lëvizjeve është i detyruar të ndjekë ritmin e rritjes së pagave në sektorin shtetëror;

- rritjen e të ardhurave nga kategori të tjera si tatimi mbi dividentët, tatimi mbi qiradhënien, tatimi nga bizneset e shërbimeve profesionale etj.;

- rritjen e të ardhurave nga futja në skemën e taksimit të të ardhurave nga turizmi dhe akomodimi të subjekteve që nuk janë të regjistruara dhe deklaruara si njësi akomoduese.

Të ardhurat nga "taksa nacionale dhe të tjera" programohen në nivelin 44.3 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2024 janë +8% ose + 3.3 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2023, efekte që pritet të vijnë nga rritja ekonomike në tërësi, taksat e reja të licencimit të lojërave të fatit, rritja e konsumit të karburanteve që gjeneron taksat e qarkullimit dhe karbonit etj.

Të ardhurat nga "taksa doganore" në vitin 2024 programohet 9 miliardë lekë, me rritje + 0.2 miliardë lekë ose 2.5% më shumë se i pritshmi për vitin 2023. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Të ardhurat gjithsej nga "kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore" janë programuar të jenë 156,7 miliardë lekë, rritje krahasuar me vitin 2023 për + 13.3 miliardë lekë, ose + 9.3%. Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike të projektuar me efekt në punësim dhe kontribute;

- efekteve nga rritja e pagave dhe kontributeve si rezultat i zbatimit të reformës së pagave në administratë;

- forcimit të kontrollit të punës në të zezë, nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;

Parashikimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2024

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2024 programohet në nivelin 737.4 miliardë lekë ose 30.3% e PBB-së.

Shpenzimet e personelit për vitin 2024, reflektojnë koston aktuale të administratës publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave (nisur në 1 prill 2023). Fondi për vijimin e rritjes së pagave duke filluar nga 1 korrik 2024 është planifikuar në shumën 11 miliardë lekë dhe përfshin rritjen e pagës për punonjësit e sistemit shëndetësor, arsimorë, punonjësit me grada dhe nëpunësit e administratës publike. Shpenzimet totale për pagat në administratën publike janë planifikuar në masën 119.8 miliardë lekë ose 4.9% e PBB-së.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 66.2 miliardë lekë ose 2.7% të PBB-së, duke përfshirë në të dhe një rezervë prej 5.3 miliardë lekë për të mitiguar risqet e mundshme nga luhatjet e normave të interesit, kursit të këmbimit etj.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2024 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar

në masën 63.45 miliardë lekë ose rreth 2.6% e PBB-së. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, mirëmbajtja e sistemeve të IT, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për arsimin e sportin.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2024, janë parashikuar në masën 71.25 miliardë lekë, me një rritje prej 10.4% më shumë se buxheti i vitit 2023. Këto shpenzime për vitin 2024, zënë 2.9% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 është 2.5 miliardë lekë më shumë ose rreth 12% më e lartë dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale), është 12.1 miliardë lekë më shumë ose rreth 92% më e lartë. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2024, 24.3 miliardë lekë, do të shtohen edhe fondet prej 10.7 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, si dhe 1.5 miliardë lekë transfertë sektoriale për rritjen e pagave. Në total, në vitin 2024, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 36.6 miliardë lekë.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 249 miliardë lekë ose 10.2% e PBB-së. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2024, parashikohet në masën 178 miliardë lekë ose 7.3% e PBB-së. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej 4.1 miliardë lekë dhe 3.6 miliardë lekë për bonusin e fundvitit për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e skemës së sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2024 janë parashikuar në masën 58 miliardë lekë ose 2.4% e PBB-së.

Së fundi, *shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve*, parashikohen në total në masën 5 miliardë lekë ose 0.2% e PBB-së.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 800 milionë lekë.

- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 26.25 miliardë lekë ose 1.1% e PBB-së.

- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1.2 miliardë lekë ose 0.05% e PBB-së.

- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.2 miliardë lekë ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 1.85 miliardë lekë duke u rritur krahasuar me një vit më parë. Këto shpenzime shkojnë për mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, për nxitjen e punësimin, për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2024, planifikohet në masën 2.5 miliardë lekë, dhe përdoret për raste të paparashikuara.

Investimet publike për vitin 2024 janë planifikuar në masën 5.3% e PBB ose 129.4 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 7 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2024 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm dhe do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.

4.4 Perspektiva buxhetore afatmesme

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet e njohura të projeksionit, dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë, tatim apo kontribut. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për periudhën 2024–2026 e në vijim në lidhje me rritjen ekonomike nominale të projektuar, indeksin e çmimeve të parashikuar, lëvizjet e mundshme të kursit të këmbimit të monedhave, fluksin e pritshëm dhe analizën e importeve të grup produkteve kryesore, si dhe analizat e serive kohore për çdo taksë. Parashikimet e të ardhurave marrin në konsideratë gjithashtu edhe efektet e politikave fiskale që do të implementohen, si dhe efektet e projektuara për rritjen e të ardhurave bazuar në aktivitetet dhe operacionet që do zbatohen në kuadrin e përmirësimit të administrimit tatimor dhe doganor.

Në planifikimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë sasitë dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit dhe prodhimit vendës që gjenerojnë deri në 90% të vlerës së të ardhurave totale, si dhe tendenca

e ecurisë së tyre të pritshme në vijim. Treguesit kryesorë për projektimin e të ardhurave përfshijnë:

- Rritjen ekonomike nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare. Rritja ekonomike e projektuar është kalkuluar që të impaktojë zërat e tatimeve, taksave dhe kontributeve, duke aplikuar koeficientin e elasticitetit si tregues i reflektimit të rritjes ekonomike mbi të ardhurat buxhetit;
- Indeksi i projektuar i çmimeve i cili është reflektuar në ata zëra tatimesh që kalkulohen sipas metodës *add valorem;*
- Kursin e pritshëm të vlerësuar të këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me lekun, me qëllim kalkulimin e bazës së llogaritjes së detyrimeve tatimore për mallrat e importit dhe eksportit;
- Çmimet në bursë të mallrave me peshe si karburantet, energjia, mineralet etj., të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në të ardhurat e buxhetit;
- Vlerësimet mbi bazën e analizave të sasive të pritshme të importit dhe eksportit të mallrave.

Për vitet 2025 –2026, *shpenzimet e përgjithshme buxhetore* rezultojnë në rënie në përqindje ndaj PBB-së, pjesë kjo e politikës së nisur në kuadër të konsolidimit fiskal me objektiv madhor uljen e borxhit publik dhe ruajtjen e parametrave të tjerë makroekonomikë në nivele të qëndrueshme. Konkretisht, këto shpenzime rezultojnë në vitin 2025 në masën 29.8% e PBB-së dhe në vitin 2026 në masën 29.9% e PBB-së.

Shpenzimet e personelit ruajnë nivelin mesatar prej 4.9% të PBB dhe përgjatë 2025-2026 dhe nuk kanë të parashikuar politika të reja pagash. Në vitin 2026, parashikohet 3 miliardë lekë politikë e re selektive për rritjen e pagave për sektorët prioritarë në masën 0.1% të PBB-së, si dhe indeksimi i pagave të administratës publike me inflacionin duke planifikuar një fond prej 0.2% të PBB-së për këtë qëllim.

Shpenzimet për interesa planifikohen të rriten me 0.1 pikë përqindje në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024. Ndërsa më 2026, këto shpenzime rriten me 0.3 pikë përqindje krahasuar me 2025-n. Kjo rritje e shpenzimeve për interesa pritet si pasojë e rritjes së normave të interesit në tregun e jashtëm dhe atë vendës përgjatë viteve 2022 dhe 2023. Ndikimi në shpenzimet për interesa pritet të zgjasë edhe gjatë viteve në vijim për shkak të zëvendësimit të letrave me vlerë të maturimit me norma më të ulëta interesi, me letra me vlerë të emetuara ose kredi të disbursuara në mjedis me norma interesi të rritura. Në këtë drejtim Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka parashikuar një tendencë rënëse pothuajse graduale të rritjes së shpenzimeve për interesa ndaj PBB-së nga 0.4% në vitin 2023, në 0.3% (2024), 0.1% (2025), 0.2% (2026), 0.1% (2026) deri në 0% në vitin 2028.

Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes planifikohen të ulen në vitet 2025 në 2.6% të PBB krahasuar me 2.7% të PBB të planifikuar në vitin 2024. Kjo për shkak të heqjes së politikave one-off që parashikohen të realizohen në vitin 2024 nga ky zë.

Shpenzime për fondet sociale qëndrojnë në nivele të qëndrueshme me mesatarisht 10.2% e PBB për vitet 2025-2026 dhe nuk priten të realizohen politika të reja për këtë periudhë me impakt të lartë në buxhet.

Shpenzimet për buxhetin vendor ruajnë trendin dhe në vitin 2025-2026 duke kulmuar në 3% të PBB në vitin 2026.

Shpenzimet për investime për periudhën 2025-2026 rezultojnë në rënie me 4.8% të PBB krahasuar me 5.3% të PBB të planifikuar në vitin 2024, duke shpjeguar pjesërisht kështu dhe zërin kryesor ku është realizuar reduktimi i shpenzimeve në kuadër të objektivit të konsolidimit fiskal.

Në përfundim, për vitet 2025-2026, sikurse sqarohet dhe më sipër nuk kemi politika të reja të parashikuara për t'u financuar të cilat tejkalojnë 0.1% të PBB-së, por do të vijojmë me akomodimin e efekteve të politikave ekzistuese të ndërmarra deri tani. Politika e rritjes së pagave do t'i kushtojë buxhetit të shtetit në masën 39.1 miliardë lekë, efekt që materializohet i plotë duke filluar nga viti 2025 e në vijim.

- Nevojat afatmesme për financim të qeverisë qendrore

Në periudhën afatmesme, nevojat për financim të qeverisë qendrore do të realizohen duke përdorur si huamarrjen e brendshme ashtu edhe atë të jashtme. Burimet e brendshme të huamarrjes do të vazhdojnë të jenë kontribuesi kryesor për të mbajtur nën kontroll riskun e kursit të këmbimit (duke ulur në afat të mesëm raportin e borxhit në valutë/ borxhit total dhe duke ruajtur këtë tregues nën kufirin prej 50% të përcaktar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit). Pavarësisht

pritshmërive pozitive në aktivitetin e institucioneve jofinanciare, huamarrja e brendshme do të vazhdojë të mbështetet më së shumti në sektorin bankar. Instrumentetet afatshkurtra do të synohen kryesisht në masën e nevojshme për rifinancimin e titujve afatshkurtër ekzistues, ndërkohë që instrumentet afatgjata do të përdoren për sigurimin e financimit të ri përveçse për rifinancimin e titujve afatgjatë që maturohen. Në çdo rast plani i huamarrjes do të drejtohet edhe nga interesi i investitorëve ndaj llojit të instrumenteve. Struktura e huamarrjes së brendshme do të mbetet deri diku fleksibël për sa i përket përzgjedhjes së instrumenteve, në varësi të kushteve të tregut (niveli i kërkesës, normat e interesit etj.), në mënyrë që të sigurohet një raport i përshtatshëm midis kostos dhe risqeve.

Në periudhën afatmesme, burimet e jashtme të huamarrjes do të kontribuojnë në optimizimin e kostos së portofolit të borxhit, pasi një pjesë e konsiderueshme e kësaj huamarrjeje pritet të realizohet nëpërmjet kredive që do të merren nga kreditorët shumëpalësh dhe dypalësh, gjë që i ofron qeverisë kushte më të favorshme financiare sesa tregu. Huamarrja e jashtme nga burime dypalëshe dhe shumëpalëshe do të përdoret kryesisht për financimin e projekteve prioritare të qeverisë dhe reformave të ndërmarra nga qeveria. Gjithashtu, do të synohen burimet private të financimit nga tregjet ndërkombëtare të kapitalit, më së shumti për të menaxhuar risqet e rifinancimit në vitet e pikut të maturimeve, për të menaxhuar detyrimet e borxhit në valutë. Kjo do të mundsojë dhe mbajtjen e huamarrjes së brendshme brenda niveleve të pranueshme për të shmangur efektin *Crowding Out*, si dhe shmangien e presionit në normat e interesit që do të ndodhte në rastet e financimit në një nivel që do të ishte përtej kapaciteteve normale, të tregut të brendshëm.

4.5 Bilanca strukturore *(përbërësi ciklik i deficitit, masat e njëhershme dhe të përkohshme, pozicioni fiskal)*

Vlerësimi i PBB-së potenciale dhe hendekut të prodhimit

Teknika e filtrimit HP u përdor për të vlerësuar një seri kohore të PBB-së potenciale. Filtrimi HP është aplikuar në rritjen ekonomike aktuale vjetore me çmime konstante, duke marrë parasysh vlerat më të përshtatshme të parametrit lambda në rastin e të dhënave vjetore, përkatësisht: $\lambda = 100$; $\lambda = 30$; $\lambda = 6.5$ Rritja e PBB-së potenciale u nxor më pas si një mesatare e serive të filtrimit HP bazuar në këta tre parametra të ndryshëm të lambdas. Bazuar në rritjen potenciale të përfituar, u nxor më pas niveli i PBB-së potenciale dhe në përputhje me të u llogarit dhe niveli i output-it. Parashikimet më të fundit të MFE-së deri në vitin 2031 janë përdorur për t'u marrë me problemin e të dhënës së fundit që shfaq teknika e filtrimit HP.

Hendeku i prodhimit, e përcaktuar zyrtarisht si $G_t = \frac{GDP_{t,aktual} - GDP_{t,potencial}}{GDP_{t,potencial}}$ është paraqitur në anën e majtë të figurës së mëposhtme. Ndërsa rritja potenciale përkatëse kundrejt asaj aktuale paraqitet në anën e djathtë.

Grafik 4.5.1 Hendeku i prodhimit (majtas) dhe rritja aktuale dhe potenciale (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomise (2023)

Rezultatet ekonometrike tregojnë se prodhimi aktual mbeti nën potencial gjatë periudhës 2003–2006, gati duke e mbyllur hendekun më 2007 përpara se të rritej në një nivel dukshëm pozitiv në vitin 2008. Zhvendosja pozitive në hendekun e prodhimit vazhdoi gjatë viteve 2009–2012, duke u zvogëluar gradualisht për shkak të rritjes aktuale më të ulët krahasuar me rritjen potenciale, e ndikuar nga efektet negative të krizës financiare globale.

Pavarësisht elasticitetit të Shqipërisë në absorbimin e ndikimit fillestar të krizës financiare globale më 2009, duke shmangur një recesion të rëndë të përjetuar nga shumë vende të tjera, vendi dëshmoi një dobësim të konsiderueshëm të rritjes aktuale ekonomike. Kjo rënie ishte e dukshme jo vetëm në krahasim me nivelet e para krizës, por edhe në lidhje me rritjen e mundshme të saj. Viti 2013 shënoi normën më të ulët të rritjes, që përkon me zhvendosjen e hendekut të prodhimit në territor negativ, një tendencë që vazhdoi deri në vitin 2016, duke arritur nivelin më të ulët në vitin 2015. Hendeku i prodhimit u kthye lehtësisht pozitiv në vitin 2017, pësoi një intensifikimi të theksuar më 2018, dhe mbeti i fuqishëm në vitin 2019, pavarësisht rritjes aktuale më të ulët, veçanërisht në tremujorin e fundit kur vendi u përball me ndikimin e tërmetit të nëntorit. Viti 2020 dëshmoi një pikë kthese të rëndësishme, e nxitur kryesisht nga pandemia COVID-19, e cila shkaktoi një recesion të mprehtë prej rreth -3.3 për qind. Kjo rënie reflektoi, deri diku, edhe ngadalësimin e dukshëm të rritjes aktuale të vërejtur në vitin 2019. Për rrjedhojë, hendeku i prodhimit arriti pikën më negative në dekada, duke regjistruar rreth -5.4 për qind të PBB-së potenciale.

Një tkurrje më pak e rëndë më 2020 sesa pritej fillimisht, e shoqëruar me rimëkëmbjen e fortë më 2021, e shënuar nga një rritje aktuale prej 8.9 për qind dhe rritje e qëndrueshme e fuqishme në 4.9 për qind për vitin 2022, veçanërisht në mes të një sezoni turistik mjaft pozitiv dhe pavarësisht sfidave që rrjedhin nga oferta globale dhe kushtet e goditjeve tregtare, kanë rezultuar në mbylljen thuajse të plotë të hendekut të prodhimit në vitin 2021. Hendeku mbeti vetëm pak në territor negativ dhe vlerësohet të jetë zhvendosur lehtë në territor pozitiv në vitin 2022.

Në vitin 2023, ndikimi kompensues i kushteve financiare dukshëm më të shtrënguara dhe efektet gërryese të inflacionit në të ardhurat reale, të kundërbalancuar veçanërisht nga një sezon i fuqishëm turistik, rezultuan në një projeksion rritjeje dukshëm më të lartë se ai fillestar (3.5 për qind kundrejt 2.6 përqind). Ky projeksion bie pak më poshtë se rritja e mundshme përkatëse e vlerësuar prej 3.9 për qind, duke çuar në një prodhim që konvergon në thelb me potencialin, duke shfaqur një hendek minimal pozitiv të prodhimit prej 0.4 për qind. Duke parë në periudhën afatmesme (2024–26) në këtë skenar bazë makroekonomik dhe fiskal, rritja e parashikuar përputhet ngushtë me rritjen e mundshme të vlerësuar prej rreth 4 për qind, duke rezultuar në një hendek të prodhimit praktikisht neutral për periudhën.

Vlerësimi i elasticitetit dhe ndjeshmërisë së buxhetit ndaj hendekut të prodhimit

Pasi u hoqën faktorët që kanë pasur ndikime vetëm në një periudhë të caktuar, u vlerësuan elasticitetet e të ardhurave dhe të shpenzimeve edhe me metodën e disagregimit (sipas qasjes së OECD-së 2005) dhe me metodën agregate (sipas qasjes së FMN-së 2010). Elasticiteti i përgjithshëm nga secila metodë ishte 1.029, dhe 1.445.[11]

Të ardhurat totale u rregulluan për efektet e ciklit, duke aplikuar mbi to elasticitetin mesatar të përfituar nga të dyja qasjet, i cili është:

$$\varepsilon_{R,Y} = mesatare\ (1.029, 1.445) = 1.237$$

Për sa u përket elasticiteteve të shpenzimeve, ato nuk ishin të ndryshme nga niveli zero. Analiza e regresionit na prodhoi elasticitete të shpenzimeve me shenjë negative, sipas të dyja metodave, por asnjëra prej tyre nuk ishte statistikisht e rëndësishme, duke na treguar se koeficienti i elasticitetit është i barabartë me zero:

$$\varepsilon_{G,Y} = 0$$

Si rezultat, shpenzimet totale nuk u rregulluan për efekte ciklike. Aplikimi direkt i formulës së ndjeshmërisë për bilancin e buxhetit ndaj hendekut

[11] Për shkak të mungesës së të dhënave dhe serive relativisht të shkurtra, në rastin e metodës së disagregimit disa prej elasticiteteve/koeficienteve të vlerësuar nuk ishin të rëndësishëm në nivelet konvencionale dhe u vendosën disa supozime.

të prodhimit (ose i ashtuquajtur elasticitet i pjesshëm) na dha vlerën e mëposhtme:

$$\sigma_B = r(\varepsilon_{R,Y} - 1) - g(\varepsilon_{G,Y} - 1)$$
$$= 0.253(1.237 - 1)$$
$$- 0.264(0 - 1) = 0.323$$

Ku $r = 0.253$ është norma mesatare e të ardhurave totale ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për 5 vitet e fundit (2018 – 2022); $g = 0.264$ është norma mesatare e shpenzimeve primare ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për të njëjtën periudhë. Parametri i vlerësuar i ndjeshmërisë së buxhetit (σ_B) na thotë se për çdo pikë përqindje negative (pozitive) të hendekut të prodhimit, bilanci i përgjithshëm fiskal primar do të përkeqësohet (përmirësohet) me 0.323 pikë përqindjeje të PBB-së potenciale.

Llogaritja e bilancit fiskal të rregulluar ciklikisht dhe vlerësimi i ndikimit të pritshëm të politikës fiskale në ekonomi.

Bazuar te hendeku i vlerësuar i prodhimit *(OG)* dhe parametri i ndjeshmërisë së buxhetit (σ_B) komponenti ciklik i bilancit fiskal primar (CPB) në terma të PBB-së potenciale është llogaritur, si:

$$CBT_t = \sigma_B * OG_t$$

ku stabilizatorët automatikë (AS) janë përkufizuar si ndryshimi i CPB-së të dyja viteve rresht, pra:

$$AS_t = CPB_t - CPB_{t-1}$$

Bilanci primar i rregulluar ciklikisht (CAPB) llogaritet si diferencë mes bilancit primar fiskal aktual (PB) dhe komponentit të tij ciklik (CPB):

$$CAPB_t = PB_t - CPB_t$$

Bilanci i përgjithshëm i rregulluar ciklikisht (CAB) del pasi bilancit primar të rregulluar ciklikisht i hiqen shpenzimet për interesat (INT) te bilanci primar i rregulluar ciklikisht:

$$CAB_t = CAPB_t - INT_t$$

Impulsi fiskal (FI) në terma të PBB-së potenciale është ndryshimi i bilancit primar të rregulluar ciklikisht çdo vit, relativisht me vitin e kaluar:

$$FI_t = CAPB_{t-1} - CAPB_t$$

Për të vlerësuar qëndrimin e politikës fiskale, duke faktorizuar në drejtimin e impulsit fiskal (shtrëngim ose lehtësim) dhe hendekut të prodhimit (negativ ose pozitiv), ne kryejmë një vlerësim të drejtpërdrejtë nëse politika ka qenë prociklike, kundërciklike ose neutrale gjatë periudhave të caktuara. Analiza jonë shtrihet nga viti 2001 dhe përfshin horizontin kohor të ardhshëm trevjeçar të EPR-së aktuale, duke u shtrirë deri në vitin 2026. Qëndrimi fiskal vlerësohet për intervale katërvjeçare, duke marrë parasysh boshllëqet kumulative të prodhimit dhe impulset fiskale. Rezultatet e detajuara empirike janë paraqitur në grafikun dhe tabelat vijuese.

Grafik 4.5.2 Qëndrimi i politikës fiskale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Tabelë 4.5.1 Qëndrimi i politikës fiskale

Year	Output Gap (OG)	Actual Overall Fiscal Balance (B)	Actual Primary Fiscal Balance (PB)	Cyclical Primary balance (CPB)	Cyclically Adjusted Primary balance (CAPB)	Interest Expenditures (INT)	Cyclically Adjusted Ovearall Balance (CAB)	Automatic Stabilizers (AS)	Fiscal Impulse (FI)	Fiscal stance relative to output gap, cumulative in 4-years intervals		
										OG	FI	Fiscal stance
1999	1.4	-9.6	-1.7	0.4	-2.2	7.9	-10.0	-	-			
2000	0.4	-8.0	-2.1	0.1	-2.2	5.9	-8.1	-0.3	0.1			
2001	1.5	-7.2	-3.0	0.5	-3.5	4.2	-7.6	0.3	1.2			
2002	-0.5	-6.2	-2.2	-0.2	-2.0	4.1	-6.1	-0.6	-1.5			
2003	-1.1	-5.0	-0.6	-0.3	-0.3	4.4	-4.7	-0.2	-1.7	-4	-4	Pro-cyclical, skewed toward fiscal consolidation
2004	-1.4	-5.2	-1.3	-0.4	-0.9	3.9	-4.7	-0.1	0.6			
2005	-1.5	-3.5	-0.3	-0.5	0.2	3.2	-3.0	0.0	-1.1			
2006	-1.0	-3.4	-0.5	-0.3	-0.2	2.9	-3.0	0.1	0.4			
2007	-0.2	-3.5	-0.9	-0.1	-0.8	2.7	-3.5	0.3	0.7	3	5	Pro-cyclical, skewed toward fiscal expansion
2008	2.5	-5.6	-2.7	0.8	-3.5	2.9	-6.4	0.9	2.7			
2009	1.9	-7.1	-3.9	0.6	-4.5	3.2	-7.7	-0.2	1.0			
2010	2.1	-3.1	0.3	0.7	-0.4	3.4	-3.8	0.1	-4.1			
2011	1.8	-3.5	-0.4	0.6	-0.9	3.2	-4.1	-0.1	0.5	4	-3	Counter-cyclical
2012	0.7	-3.4	-0.3	0.2	-0.5	3.1	-3.7	-0.4	-0.4			
2013	-0.6	-5.0	-1.7	-0.2	-1.6	3.2	-4.8	-0.4	1.0			
2014	-1.1	-5.2	-2.3	-0.4	-1.9	2.9	-4.8	-0.2	0.4			
2015	-1.3	-4.1	-1.4	-0.4	-0.9	2.7	-3.6	-0.1	-1.0	-2	-1	Pro-cyclical, skewed toward fiscal consolidation
2016	-0.6	-1.8	0.7	-0.2	0.8	2.5	-1.6	0.2	-1.8			
2017	0.5	-2.0	0.1	0.2	-0.1	2.1	-2.2	0.3	0.9			
2018	1.7	-1.6	0.6	0.5	0.1	2.2	-2.1	0.4	-0.2			
2019	0.9	-1.9	0.2	0.3	-0.1	2.1	-2.1	-0.3	0.2	-3	2	Counter-cyclical
2020	-5.4	-6.7	-4.6	-1.8	-2.9	2.1	-4.9	-2.0	2.8			
2021	-0.5	-4.6	-2.7	-0.2	-2.5	1.9	-4.4	1.6	-0.4			
2022	0.5	-3.7	-1.8	0.2	-2.0	1.9	-3.8	0.3	-0.5			
2023	0.2	-2.2	0.0	0.1	-0.1	2.2	-2.3	-0.1	-1.9	1	-3	Counter-cyclical
2024	0.0	-2.5	0.2	0.0	0.2	2.7	-2.5	-0.1	-0.3			
2025	-0.1	-2.1	0.8	0.0	0.8	2.8	-2.0	0.0	-0.6			
2026	-0.1	-2.1	0.9	0.0	1.0	3.1	-2.1	0.0	-0.1			

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Tabelë 4.5.2 Politika fiskale në raport me ciklet ekonomike

Fiscal stance	Unit	Number of years	
		2000 - 2023	2024 - 2026
Cumulative output gap *v.s.* Cumulative fiscal impulse --> Overall fiscal stance			
Cumulative output gap	p.p. of GDP	-1	0
Cumulative fiscal impulse	p.p. of GDP	-2	-1
Overall fiscal stance		Pro-cyclical, skewed toward fiscal consolidation	Neutral

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Kolona e fundit e tabelës 4.5.1 jep një vlerësim cilësor të qëndrimit fiskal gjatë intervaleve katërvjeçare. Ky vlerësim merr parasysh boshllëqet kumulative të prodhimit dhe impulset fiskale të vlerësuara përkatëse për çdo periudhë. Bazuar në këto matje dhe lidhjen e tyre, del në përfundimin nëse qëndrimi i politikës fiskale gjatë çdo intervali katërvjeçar ishte "kundërciklik", "neutral" apo "prociklik". Në rastet kur qëndrimi fiskal identifikohet si "prociklik", shtohet një kualifikim dytësor, që tregon nëse ky prociklikalitet anonte më shumë drejt "konsolidimit fiskal" apo "zgjerimit fiskal".

Për shembull, gjatë viteve 2002–2005, si hendeku kumulativ i prodhimit ashtu edhe impulset fiskale ishin negative (të dyja në -4 p.p.), duke e kategorizuar qëndrimin e politikës fiskale si "prociklike". Për më tepër, duke qenë se impulset fiskale kumulative ishin tkurrëse (negative), ajo cilësohet më tej si "prociklike dhe e anuar drejt konsolidimit fiskal". Po kështu, për periudhën 2014–2017, qëndrimi fiskal karakterizohet edhe si "prociklik dhe i prirur drejt konsolidimit fiskal", duke pasqyruar situatën e viteve 2001–2004. Në të kundërt, gjatë viteve 2006–2009, politika fiskale ende identifikohet si "prociklike", por me një kualifikim "të prirë drejt zgjerimit fiskal".

Ky dallim lind si nga hendeku kumulativ i prodhimit ashtu edhe nga impulsi fiskal që kanë shenja pozitive gjatë këtij intervali. Në të kundërt, intervalet 2010–2013, 2018–2021 dhe 2022–2025 kategorizohen si me një qëndrim "kundërciklik" të politikës fiskale, siç tregohet nga shenjat e kundërta të boshllëqeve të prodhimit kumulativ dhe impulset fiskale përkatëse për këto periudha.

Duke aplikuar një metodologji të qëndrueshme vlerësimi, Tabela 4.5.2 ofron një vlerësim që përfshin të gjithë periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2023, ku të gjitha vlerësimet bazohen në statistikat aktuale ose pothuajse aktuale, duke përfshirë parashikimet për vitin 2023. Për më tepër, ajo mbulon horizontin e mundshëm afatmesëm të përshkruar në programin 2024–2026, duke u mbështetur në projeksionet përkatëse të variablave makroekonomikë dhe objektivat e politikës fiskale. Për periudhën e përgjithshme 2000–2023, qëndrimi fiskal karakterizohet si "prociklik dhe i prirur drejt konsolidimit fiskal", duke reflektuar një hendek të prodhimit kumulativ të vlerësuar negativ prej -1 p.p. dhe një impuls fiskal kumulativ të vlerësuar negativ njëkohësisht prej -2 p.p. Në të kundërt, për periudhën e ardhshme afatmesme (2024–2026), me hendekun kumulativ të vlerësuar të prodhimit të mbyllur në zero, qëndrimi fiskal konsiderohet "neutral", pavarësisht nga shenja (pozitive ose negative) ose madhësia e vlerësimit përkatës të impulseve fiskale kumulative.

4.6. Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore

Menaxhimi i borxhit të qeverisjes qendrore

Menaxhimi i borxhit të qeverisjes qendrore është përballur me sfida të rëndësishme gjatë viteve të fundit për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i vitit 2019, përhapja e pandemisë COVID-19 dhe kriza e fundit e shkaktuar nga konflikti Rusi–Ukrainë. Megjithatë, portofoli i borxhit është mundësuar të menaxhohet me sukses gjatë kësaj periudhe në përputhje me objektivat makro-fiskalë, nevojat për financim të qeverisë dhe objektivat strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit.

Borxhit i qeverisjes qendrore

Në fund të muajit shtator 2023, borxhi i qeverisjes qendrore u vlerësua në nivelin 1,392.9 miliardë lekë e cila do të përbënte 60.3%[12] e PBB-së të pritshme për 2023, duke u ulur me 4.2 pp krahasuar me fundin e vitit 2022, dhe me 14.2 pp krahasuar me fundin e vitit 2021. Në terma nominalë, stoku i borxhit të qeverisjes qendrore është rritur me 14.5 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2022, nga ku 17.6 miliardë lekë korrespondojnë me rritje të borxhit të brendshëm dhe -3.1 miliardë lekë korrespondon me ulje të borxhit të jashtëm. Në vitet në vijim, raporti i borxhit ndaj PBB-së do të planifikohet më i ulët se niveli i parashikuar për vitin e kaluar, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor.

Tabela 4.6.1: Stoku total i borxhit të qeverisë qendrore 2018–shtator 2023

	2018	2019	2020	2021	2022	Sht 2023
Stoku Total (I+II)	**1,106,568.8**	**1,112,044.2**	**1,224,038.2**	**1,382,624.9**	**1,378,421.5**	**1,392,884.0**
I. Stoku i Borxhit të Brendshëm	**580,310.3**	**597,290.0**	**644,087.8**	**702,255.5**	**732,653.9**	**750,252.3**
Shtetëror	565,092.5	582,135.6	630,791.1	678,880.9	712,779.4	732,994.5
Garanci	15,217.8	15,154.4	13,296.7	23,374.7	19,874.5	17,257.7
II. Stoku i Borxhit të Jashtëm	**526,258.5**	**514,754.2**	**579,950.4**	**680,369.3**	**645,767.6**	**642,631.8**
Shtetëror	496,804.2	488,055.8	544,434.4	648,847.9	613,421.2	615,505.4
Garanci	29,454.3	26,698.4	35,516.0	31,521.4	32,346.4	27,126.4
PBB	**1,636,731.3**	**1,691,903.4**	**1,647,431.1**	**1,856,172.3**	**2,138,339.2**	**2,311,672.8**
Stoku Total/PBB	67.6%	65.7%	74.3%	74.5%	64.5%	60.3%
Stoku I Borxhit të Brendshëm/PBB	35.5%	35.3%	39.1%	37.8%	34.3%	32.5%
Stoku I Borxhit të Jashtëm/PBB	32.2%	30.4%	35.2%	36.7%	30.2%	27.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

[12] *PBB e përdorur referuar Draft Kuadrit Makrokonomik dhe Fiskal datë 2.11.2023.*

Për sa i përket përbërjes së portofolit të borxhit të qeverisë qendrore sipas instrumenteve, më shumë se 70% e peshës vazhdon të mbahet nga instrumentet e tregtueshëm (bono thesari, obligacione dhe eurobond). Pesha e instrumenteve të tregtueshme vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit kryesisht për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, por edhe për shkak të rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm për arsye të nevojave të larta për financim gjatë viteve të fundit duke filluar nga viti 2020.

Grafiku 4.6.1: Përbërja e borxhit të qeverisë qendrore (2018–shtator 2023)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Për sa i përket strukturës së maturimit, në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, referuar të dhënave të nëntëmujorit të vitit 2023, peshën më të madhe e mbajnë titujt afatmesëm (2-5 vite). Në përputhje me objektivin strategjik për rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve afatshkurtër është reduktuar me 1.5 pp ndërkohë që pesha e titujve me afat të gjatë maturimi (mbi 5 vite) ka shënuar rritje në krahasim me atë të fundit të vitit 2022 me rreth 1.9 pp. Ndërkohë borxhi i jashtëm përbëhet kryesisht nga kredi afatgjata, si dhe instrumente afatgjata (eurobond 5, 7 dhe 10-vjeçare të emetuara në tregjet ndërkombëtare).

Grafiku 4.6.2: Përbërja e borxhit të qeverisë (2018–shtator 2023)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Nevojat për financim

Gjatë viteve të fundit, huamarrja është realizuar në përputhje me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e stabilitetit të marrëdhënies ndërmjet raporteve të kostos dhe risqeve, krahas nevojave të rritura për financim.

Huamarrja gjatë periudhës janar–shtator 2023 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2023 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2023. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit

ekzistues, si dhe financimi i deficitit. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 367.2 miliardë lekë, nga të cilat 81.6% (ose 299.7 miliardë lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 18.4% (ose 67.5 miliardë lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Grafiku 4.6.3: Financimi total 2018–2023



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Gjatë periudhës janar–shtator 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 299.7 miliardë lekë, nga të cilat 183.7 miliardë lekë i përkasin titujve afatshkurtër dhe 116.1 miliardë lekë titujve afatgjatë. Huamarrja gjatë këtij nëntëmujori ka qenë në përputhje me Planin e Huamarrjes së vitit 2023. Financimi neto ka rezultuar në vlerën 22.2 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, huamarrja neto është rritur konsiderueshëm, pasi në vitin 2022 huamarrja reflektoi hezitimin e investitorëve për të investuar në obligacione shtetërore, për shkak të pasigurisë së ardhshme dhe pritshmërive për rritje të normave së interesit, ndikuar nga pasojat e konfliktit Rusi–Ukrainë.

Tabela 4.6.2: Huamarrja e brendshme (janar–shtator 2023)

Huamarrja e Brendshme	Janar-Shtator 2023		
	Emetime *(në miliardë Lekë)*	Maturime *(në miliardë Lekë)*	Financimi Neto *(në miliardë Lekë)*
Instrumenta Afatshkurtër	**183.7**	**187.5**	**-3.9**
B. Thesari	183.7	187.5	-3.9
Instrumenta Afatgjatë	**116.1**	**90.0**	**26.1**
Obligacione 2V	37.4	37.7	-0.3
Obligacione 3V	20.8	16.8	4.0
Obligacione 5V	29.4	27.2	2.3
Obligacione 7V	14.1	8.3	5.8
Obligacione 10V	10.0		10.0
Obligacione 15V	4.4		4.4
Financimi i Brendshëm Total	**299.7**	**277.5**	**22.2**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Për sa i përket huamarrjes së huaj, në fund të muajit shtator 2023, huamarrja e jashtme bruto arriti në 67.5 mld lekë. Peshën kryesore në huamarrjen e huaj gjatë këtij nëntëmujori e mban Eurobondi. Në qershor 2023, Republika e Shqipërisë emetoi eurobondin e saj të gjashtë, në vlerën 600 milionë euro, me maturim pesëvjeçar, me kupon 5.9%, yield 6.125% dhe me një ofertë përfundimtare (final book) prej mbi 1.3 miliardë euro.

Tabela 4.6.3: Huamarrja e jashtme

Huamarrja e Huaj Bruto	sht.22		sht.23	
	Në miliardë Lekë	*në %*	*Në miliardë Lekë*	*në%*
Hua për Projekte Financimi	7.3	30.4%	4.37	6.5%
Mbështetje Buxhetore	16.8	69.6%	0.32	0.5%
Eurobond	0.0	0.0%	62.77	93.0%
Disbursimet Total	**24.2**	**100.0%**	**67.5**	**100.0%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Kostoja dhe risqet

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të mirëmenaxhimit të borxhit ka vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve aktuale të tregut. Në ndryshim nga viti 2022, ku për shkak të kushteve të shtrënguara të tregjeve treguesit e riskut nuk ecën në drejtim të objektivave strategjikë, gjatë periudhës janar-shtator 2023, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjikë afatmesëm duke shfaqur përmirësim në të gjithë treguesit, krahasuar me fundin e vitit 2022.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme.

Në fund të muajit shtator 2023 treguesit e riskut të portofolit të borxhit të brendshëm kanë mundur të shënojnë përmirësim krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 si edhe me fundin e vitit 2022. Jetëgjatësia e borxhit është rritur duke arritur në nivelin prej 832 ditë (2.31 vite) në fund të muajit shtator 2023 krahasuar me 814 ditë në fund të muajit qershor 2023 (2.26 vite) dhe 780 ditë në muajin dhjetor 2022 (2.17 vjet). Ndërkohë, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti, ka shënuar përmirësim krahasuar me fundin e vitit 2022, gjithashtu ka shënuar përmirësim krahasuar dhe me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Ky tregues është ulur nga 51.93% në fund të muajit mars 2023 në 50.9% në qershor 2023 dhe në 47.6% në fund të muajit shtator 2023, si edhe qëndron nën nivelin prej 47.9% që ishte në fund të vitit 2022. Ky tregues paraqitet në vlera të larta për shkak të vlerës së lartë (rreth 42 mld lekë) të titujve referencë 3- dhe 5-vjeçare që do të maturohen në tremujorin e parë të vitit 2024. Për të zbutur këtë vlerë maturimi të konsiderueshme, janë përfshirë në planin e emetimeve në tregun e brendshëm përgjatë vitit 2023 edhe një numër transaksionesh blerje mbrapsht të titujve referencë në fjalë.

Për sa i përket riskut të normave të interesit, është rritur koha mesatare në rifiksim nga 2.17 vite në dhjetor 2022 në 2.25 vite në muajin mars 2023, 2.27 vite në muajin qershor 2023 dhe 2.33 në muajin shtator 2023. Treguesit e riskut të portofolit të borxhit të brendshëm, pas një përkeqësimi të përkohshëm si pasojë e kushteve të tregjeve në vitin 2022, janë duke u rikthyer drejt objektivit strategjik në periudhën afatshkurtër.

Tabela 4.6.4: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror

	Risku	2018	2019	2020	2021	2022	sht.23	Objektivi Afatmesëm 2026
Risku i Rifinacimit	Borxhi që maturohet brenda 1 viti	49.40%	47.70%	44.80%	46.60%	47.90%	47.60%	**Maks. 40%**
	KMM	2.17	2.19	2.18	2.2	2.17	2.31	**Min 2.5 Vite**
Risku i Normave të Interesit	Borxhi që rifiksohet brenda 1 viti	54.30%	50.90%	46.70%	48.00%	49.00%	48.40%	**Maks. 43%**
	ATR	2.06	2.11	2.14	2.19	2.17	2.33	**Min 2.5 Vite**
Risku i Kursit të Këmbimit	Borxhi në valutë/Totali	47.70%	45.60%	47.40%	49.80%	46.80%	46.40%	**Maks. 50%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në treguesit e riskut, duke pasur parasysh mjedisin e ri të normave të rritura të interesit në vitin 2022, të ndikuar nga Lufta Rusi–Ukrainë, hezitimi i investitorëve për të investuar në obligacionet e qeverisë dhe bazën e investitorëve që nuk është shumë e diversifikuar, borxhi i brendshëm mbetet i ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit dhe riskut të rifinancimit. Në këtë drejtim, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, menaxhimi i borxhit do të vazhdojë të ndërmarrë aktivitete që synojnë zbutjen e mëtejshme të këtyre risqeve. Me synimin për stabilitet të mëtejshëm të portofolit të borxhit, strategjia e re e afatmesme e menaxhimit të borxhit, e përditësuar në vitin 2022, ka përcaktuar disa objektiva më ambiciozë krahasuar me strategjinë paraardhëse për sa i përket riskut të normës së interesit, riskut të rifinancimit dhe riskut të kursit të këmbimit, të cilat jepen në tabelën e mësipërme.

Kostoja mesatare për borxhin e brendshëm në fund të muajit shtator 2023 rezultoi në nivelin 4.62%, duke u rritur me 57 bp krahasuar me fundin e vitit 2022 ku u vlerësua në nivelin 4.05%. Rritja ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së normave të interesit dhe për rrjedhojë zëvendësimit të titujve me norma interesi të ulëta që maturohen, me tituj me norma interesi më të larta. Gjithashtu në portofolin e borxhit të huaj, për shkak të rritjes së normave në tregjet ndërkombëtare, kostoja mesatare në vitin 2023 parashikohet të rezultojë në vlerën 3.4%, duke u rritur me 100bp krahasuar me fundin e vitit 2022 (2.4%).

Grafiku 4.6.4: Shërbimi i borxhit 2018–2026

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Duke marrë në konsideratë deklaratat dhe vendimet e fundit të Rezervës Federale dhe BQE, këto institucione mund të vijojnë ndjekjen e politikave monetare shtrënguese edhe për të paktën vitin 2023 dhe kjo mund të vijojë edhe në fillimin e vitit 2024, si rrjedhojë mund të pritet një rritje e mëtejshme e normave të interesit në tregun e huaj. Në këto kushte, kostot për njësi të borxhit të huaj dhe atij të brendshëm, pritet të shënojnë rritje të mëtejshme krahasuar me vitin 2023.

Zhvillimi i normave të interesit

Normat mesatare të ponderuara të instrumenteve të borxhit të brendshëm në shtator 2023 kanë shënuar rritje krahasuar me fundin e vitit 2022, pothuajse në të gjitha kategoritë e instrumenteve, e ndikuar kjo nga rritja e normave të interesit, kryesisht gjatë vitit 2022, dhe për rrjedhojë zëvendësimit të titujve me norma interesi më të ulëta të cilat maturohen, me tituj të emetuara në kushtet me norma interesi të rritura. Në muajin mars 2023 Banka e Shqipërisë mori vendimin të rrisë normën bazë të interesit dy herë gjatë vitit 2023, duke arritur në nivelin në nivelin 3.25% nga 2.75% që ishte në fund të vitit 2022.

Grafiku 4.6.5: Yield-i mesatar i ponderuar për letrat me vlerë të qeverisë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022

Detyrimet kontigjente

Në fund të muajit shtator 2023, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 44.4 miliardë lekë ose 416 milionë euro (1.9% e PBB-së), duke shënuar një rënie me 7.8 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2022. Garancitë në tregun e brendshëm zënë rreth 38.9% të stokut total të borxhit të garantuar ose 17.3 miliardë lekë, ndërsa garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 61.1% të stokut të borxhit të garantuar ose 27.1 miliardë lekë.

Grafiku 4.6.6: Portofoli i borxhit të garantuar (2018–shtator 2023)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Nga totali i stokut të garancive, mbi 75% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë, sidomos gjatë krizës më të fundit me të cilën ky sektor u përball.

Në periudhën afatmesme, niveli i borxhit të garantuar është planifikuar të mbahet nën nivelin 5% të PBB-së. Për të reduktuar riskun që vjen nga detyrimet kontingjente që rrjedhin nga garancitë shtetërore, stoku i borxhit të garantuar përfshihet 100% në stokun e borxhit publik. Një rregull i tillë është përcaktuar në ligjin organik të buxhetit si një masë për të minimizuar rrezikun e aktiviteteve jashtë-buxhetore.

Për të kontrolluar/reduktuar riskun që vjen nga garancitë shtetërore dhe për të përfituar nga avantazhet e përdorimit të instrumentit të garancisë, kriteret e mëposhtme synohen të zbatohet për dhënien e garancive shtetërore në periudhën afatmesme:

- Garancitë qeveritare mund t'u lëshohen ndërmarrjeve shtetërore, të cilat kanë ndërmarrë një iniciativë reformuese me ndikim në forcimin e gjendjes së tyre financiare;
- Garancitë qeveritare mund të lëshohen për financimin e projekteve investuese;
- Garancitë qeveritare mund të lëshohen gjithashtu për të mbështetur masat që mund të merren në rast të një krize të sistemit financiar;
- Garancitë qeveritare mund të lëshohen për qëllimin e ristrukturimit të portofolit të garancive qeveritare duke zëvendësuar kreditë afatshkurtra përmes atyre afatgjata.

4.7 Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm

Ky seksion paraqet ndikimet e pritshme në kuadrin fiskal, si dhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale dhe ato buxhetore sipas secilit skenar. Kjo është në përputhje me të dy skenarët alternativë makroekonomikë të paraqitur në seksionin 3.3.

Në rastin e skenarit makroekonomik "pesimist", i cili supozon një rritje ekonomike dukshëm më të ulët për çdo vit krahasuar me skenarin "bazë", do të ishte e arsyeshme dhe e përshtatshme për të supozuar efikasitet më të ulët të mbledhjes së taksave për një numër të komponentëve kryesorë të taksave. Ndërsa, efektiviteti më i lartë i mbledhjes së taksave mund të pritet nëse do të ndodhë skenari makroekonomik "optimist". Prandaj, për të llogaritur ndryshimet e mundshme në performancën e mbledhjes së të ardhurave nën secilin skenar alternativ, si dhe për të llogaritur "një efekt të përgjithshëm neto" të stabilizuesve automatikë, në rastin e skenarit pesimist ne afektojmë "raportin e të ardhurave totale ndaj PBB-së "me një të tretën e goditjeve përkatëse (në p.p) të prezantuara në "rritjen reale" për çdo vit dhe në mënyrë asimetrike e afektojmë këtë variabël me një të dhjetën në rastin e skenarit "optimist".

Ndërsa në secilin skenar alternativ mbajmë të njëjtin supozim të normave efektive të interesit si në skenarin bazë (të përcaktuara si shpenzime interesi në vitin "t", të pjesëtuar me stokun e borxhit në vitin "t-1"), ne llogaritim ndryshimet në nivelet e shpenzimeve të interesit, për shkak të huamarrjes më të lartë ose më të ulët sipas secilit skenar.

Kursi i supozuar nominal i këmbimit mbetet, gjithashtu, identik në të gjithë skenarët. Duhet të theksohet se materializuar në buxhetin e çdo viti ekziston, gjithashtu, një kontigjencë (ligjërisht i detyrueshëm sipas përcaktimeve në LOB) me rreth 0.3 për qind të PBB-së që do të mbulonte çdo shpenzim më të lartë interesi, për shkak të ndonjë rritjeje në normat e interesit ose zhvlerësimit të kursit të këmbimit.

Pajtueshmëria me rregullat fiskale në LOB dhe, rrjedhimisht, politika fiskale e përgjithshme konsoliduese ruhet në çdo skenar makroekonomik. Sidoqoftë, objektivi sasior i deficitit fiskal vjetor ndryshon në secilin skenar, duke reflektuar kryesisht një përgjigje kundërciklike ndaj dinamikave të ndryshme të supozuara të ciklit ekonomik, sa herë që është e mundur në përputhje me rregullat fiskale. Më konkretisht, parashikohet një zbutje e objektivit të deficitit fiskal në rastin e skenarit "pesimist" dhe një konsolidim fiskal më i fortë në rastin e skenarit "optimist".

Në skenarin "pesimist", zbutja e politikës fiskale, krahasuar me skenarin "bazë", do të materializohej deri në masën që të gjithë parametrat kryesorë të financave publike (p.sh. raporti i borxhit ndaj PBB-së, bilanci primar dhe bilanci aktual) do të mbeten në të njëjtën kohë, në përputhje me të gjitha rregullat përkatëse fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit. Rregullimet (masat) e nevojshme të shpenzimeve për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat fiskale sipas skenarit "pesimist" kryhet në "shpenzimet e kapitalit me financim të brendshëm", si dhe në "shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes".

Më konkretisht, ulja mesatare vjetore e shpenzimeve kapitale gjatë viteve 2024–2026, sipas skenarit "pesimist" kundrejt "bazës" është 21.2 miliardë lekë ose 0.7 për qind e PBB-së mesatarisht për çdo vit. Nën skenarin "pesimist", niveli mesatar vjetor i totalit të shpenzimeve kapitale gjatë 2024–2026 bie në 4.3 për qind të PBB-së nga 5.0 për qind e PBB-së së planifikuar në skenarin "bazë". Shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes gjatë viteve 2024–26 zvogëlohen me një mesatare prej 8.3 miliardë lekësh në vit krahasuar me skenarin bazë, ose mesatarisht me 0.2 për qind të PBB-së në vit.

Në skenarin "optimist" të gjithë zërat diskrecionalë të shpenzimeve në terma nominalë supozohen identikë si në skenarin "bazë" dhe të gjitha të ardhurat e papritura reflektohen si një bilanc i përgjithshëm fiskal më i lartë (d.m.th. deficit më i ulët) për çdo vit, krahasuar me skenarin "bazë".

Në mënyrë që të shërbejë në mënyrë adekuate të gjitha nevojat e shërbimit të buxhetit dhe borxhit (d.m.th. nevojat e financimit) gjatë horizontit kohor prej pesë vjetësh (përfshirë 2026), tre zëra financimi, përkatësisht "huamarrja e brendshme neto", "ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA" dhe "stoku i likuiditetit në TSA" janë optimizuar njëkohësisht në secilin

skenar alternativ, më e rëndësishmja në atë "pesimist". Ndërsa, huamarrja e huaj neto, si në huamarrjen tregtare, ashtu edhe në atë koncesionale, në të dy skenarët alternativë mbeten saktësisht të njëjtë si në skenarin "bazë".

Një supozim i nënkuptuar në rastin e skenarit "pesimist" të paraqitur këtu është se, së pari, inflacioni do të mbetet në përputhje me objektivin e politikës monetare dhe inflacioni i pritur do të mbetet i mirë ankoruar dhe së dyti, qëndrimi i politikës monetare do të mbetet përgjithësisht lehtësues, por gjithsesi plotësisht brenda në kornizë konvencionaleve, pa ndonjë përdorim të paketës "jokonvencionale". Ndërsa, vetëm në një skenar tjetër "shumë ekstrem pesimist", që do të thotë vetëm në rast të një krize të rëndë ekonomike, e cila seriozisht do të rrezikonte stabilitetin makroekonomik dhe perspektivën afatgjatë, mund të supozohet se mund të përdoret çdo mundësi e disponueshme dhe e përshtatshme e instrumentit të veçantë "jokonvencional" i politikës monetare, vetëm si një mundësi e fundit dhe në një rast të tillë, me sa duket nën një koordinim dhe mbikëqyrje shumë të ngushtë të institucioneve ndërkombëtare partnere. Në të njëjtën kohë, do të ishte mjaft e arsyeshme të supozohet se në një skenar të tillë "shumë ekstrem pesimist", një gamë më e gjerë dhe më e thellë e rregullave/masave/reformave të financave publike mund dhe duhet të ndërmerren, dhe ndoshta të shtrihet në të gjithë sektorin publik dhe në mallrat/shërbimet publike.

Grafikët dhe tabelat vijuese paraqesin implikimet kryesore fiskale të skenarëve alternative.

Grafik 4.7.1 Dinamika e treguesve kryesorë në skenarë të ndryshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Tabelë 4.7.1A Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore për secilin skenar (miliardë lekë)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Të ardhurat totale									
Bazë	449.9	460.3	425.9	511.0	572.8	647.2	676.1	709.8	747.9
Pesimit							652.4	673.0	696.8
Optimist							680.6	718.0	760.1
Shpenzimet totale									
Baza nga e cila:	476.1	491.9	536.3	596.3	651.0	698.3	737.4	762.4	805.6
Shpenzimet korrente nga të cilat:	397.3	416.9	421.4	461.1	500.0	544.4	605.5	634.7	672.9
Operacionale & Mirëmbajtje	45.5	47.2	48.9	59.4	68.5	75.9	67.1	65.9	67.7
Interesat	36.5	35.1	34.4	35.8	39.6	51.1	66.2	72.7	83.0
Shpenzimet kapitale nga të cilat:	78.4	75.0	101.7	128.0	112.1	136.6	129.4	123.0	127.8
Financim i brendshëm	52.2	51.5	60.6	72.8	64.6	87.1	78.4	72.5	73.4
Financim i jashtëm	26.2	23.5	24.5	25.7	18.7	32.6	44.0	48.5	52.4
Fondi i rindërtimit			16.6	29.5	28.9	17.0	7.0	2.0	0.0
Pesimist nga e cila:							717.4	716.8	752.0
Shpenzimet korrente nga të cilat:					500.0	544.4	597.5	618.0	641.9
Operacionale & Mirëmbajtje					68.5	75.9	59.1	57.9	58.7
Interesat					39.6	51.1	66.2	64.0	65.9
Shpenzimet kapitale nga të cilat:					112.1	136.6	117.4	94.0	105.3
Financim i brendshëm					64.6	87.1	66.4	43.5	50.9
Financim i jashtëm					18.7	32.6	44.0	48.5	52.4
Fondi i rindërtimit					28.9	17.0	7.0	2.0	0.0
Optimist nga e cila:							744.7	769.6	807.4
Shpenzimet korrente nga të cilat:					500.0	544.4	607.8	636.8	669.7
Operacionale & Mirëmbajtje					68.5	75.9	67.1	65.9	67.7
Interesat					39.6	51.1	68.5	74.8	84.7
Shpenzimet kapitale nga të cilat:					112.1	136.6	134.4	128.0	132.8
Financim i brendshëm					64.6	87.1	83.4	77.5	78.4
Financim i jashtëm					18.7	32.6	44.0	48.5	52.4
Fondi i rindërtimit					28.9	17.0	7.0	2.0	0.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Tabelë 4.7.2A Parametrat kryesorë fiskalë dhe zërat e financimit për secilin skenar (miliardë lekë)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Deficiti i përgjithshëm									
Bazë	-26.2	-31.5	-110.4	-85.3	-78.2	-51.1	-61.3	-52.6	-57.7
Pesimit							-65.0	-43.7	-55.2
Optimist							-64.1	-51.6	-47.3
Finacimi i deficitit të përgjithshëm									
Bazë nga e cila:	26.2	31.5	110.4	85.3	78.2	51.1	61.3	52.6	57.7
Huamarrja e brendshme neto	19.6	17.8	48.4	48.7	26.2	25.0	50.0	50.0	40.0
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA	-30.5	16.6	14.7	-72.7	41.5	-28.4	16.8	0.5	-8.3
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:	33.1	-9.4	60.9	104.0	-9.5	48.5	-15.5	2.1	26.1
Financimi i projekteve	21.2	20.5	17.2	14.6	11.1	20.6	29.0	33.0	37.1
Eurobond	62.5	0.0	80.3	78.5	0.0	65.7	0.0	65.7	54.8
Mbështetje buxhetore	0.9	1.6	23.8	42.5	17.1	25.5	6.6	11.8	6.6
Ripagesat	-51.7	-29.8	-61.7	-33.2	-38.4	-63.9	-52.1	-109.5	-73.4
Flukse të tjera	4.1	6.5	-13.7	5.3	20.1	6.0	10.0	0.0	0.0
Pesimist nga e cila:							65.0	43.7	55.2
Huamarrja e brendshme neto							49.9	33.6	18.5
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA							20.6	8.0	10.7
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:							-15.5	2.1	26.1
Financimi i projekteve							29.0	33.0	37.1
Eurobond							0.0	65.7	54.8
Mbështetje buxhetore							6.6	11.8	6.6
Ripagesat							-52.1	-109.5	-73.4
Flukse të tjera							10.0	0.0	0.0
Optimist nga e cila							64.1	51.6	47.3
Huamarrja e brendshme neto							45.8	42.0	22.5
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA							23.8	7.5	-1.3
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:							-15.5	2.1	26.1
Financimi i projekteve							29.0	33.0	37.1
Eurobond							0.0	65.7	54.8
Mbështetje buxhetore							6.6	11.8	6.6
Ripagesat							-52.1	-109.5	-73.4
Flukse të tjera							10.0	0.0	0.0
Balanca primare									
Bazë	10.3	3.6	-76.0	-49.5	-38.6	0.1	4.9	20.1	25.2
Pesimit							1.2	20.3	10.7
Optimist							4.4	23.2	37.4
Balanca korrente									
Bazë	52.2	43.4	-8.7	42.7	33.9	85.6	68.1	70.4	70.1
Pesimit							52.4	50.2	50.1
Optimist							70.3	76.4	85.5
Borxhi publik									
Bazë	1,107.3	1,112.6	1,224.5	1,383.0	1,378.6	1,420.6	1,454.5	1,516.6	1,585.7
Pesimit							1,454.4	1,500.2	1,547.7
Optimist							1,450.3	1,504.4	1,556.0
Stoku i likuiditetit në llogarinë unike të thesarit (TSA)									
Bazë	49.4	16.2	7.8	72.6	14.5	42.9	26.1	25.6	33.9
Pesimit							39.0	31.0	20.3
Optimist							43.7	36.2	37.5
Borxhi publik NET nga gjendja e stokut të likuiditetit në TSA									
Bazë	1,057.8	1,096.5	1,216.7	1,310.3	1,364.1	1,377.7	1,428.4	1,491.0	1,551.8
Pesimit							1,415.5	1,469.2	1,527.4
Optimist							1,406.7	1,468.3	1,518.6

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

Tabelë 4.7.1B Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore për secilin skenar (% e PBB-së)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Të ardhurat totale									
Bazë	27.5	27.2	25.9	27.5	26.8	28.0	27.8	27.8	27.8
Pesimit						28.0	27.3	27.3	27.3
Optimist						28.0	27.8	27.8	27.8
Shpenzimet totale									
Bazë nga e cila:	29.1	29.1	32.6	32.1	30.4	30.2	30.3	29.8	29.9
Shpenzimet korrente nga të cilat:	24.3	24.6	25.6	24.8	23.4	23.6	24.9	24.8	25.0
Operacionale & Mirëmbajtje	2.8	2.8	3.0	3.2	3.2	3.3	2.8	2.6	2.5
Interesat	2.2	2.1	2.1	1.9	1.9	2.2	2.7	2.8	3.1
Shpenzimet kapitale nga të cilat:	4.8	4.4	6.2	6.9	5.2	5.9	5.3	4.8	4.8
Financim i brendshëm	3.2	3.0	3.7	3.9	3.0	3.8	3.2	2.8	2.7
Financim i jashtëm	1.6	1.4	1.5	1.4	0.9	1.4	1.8	1.9	1.9
Fondi i rindërtimit			1.0	1.6	1.4	0.7	0.3	0.1	0.0
Pesimist nga e cila:						30.2	30.0	29.0	29.5
Shpenzimet korrente nga të cilat:						23.6	25.0	25.0	25.1
Operacionale & Mirëmbajtje						3.3	2.5	2.3	2.3
Interesat						2.2	2.8	2.6	2.6
Shpenzimet kapitale nga të cilat:						5.9	4.9	3.8	4.1
Financim i brendshëm						3.8	2.8	1.8	2.0
Financim i jashtëm						1.4	1.8	2.0	2.1
Fondi i rindërtimit						0.7	0.3	0.1	0.0
Optimist nga e cila:						30.2	30.4	29.8	29.6
Shpenzimet korrente nga të cilat:						23.6	24.8	24.7	24.5
Operacionale & Mirëmbajtje						3.3	2.7	2.6	2.5
Interesat						2.2	2.8	2.9	3.1
Shpenzimet kapitale nga të cilat:						5.9	5.5	5.0	4.9
Financim i brendshëm						3.8	3.4	3.0	2.9
Financim i jashtëm						1.4	1.8	1.9	1.9
Fondi i rindërtimit						0.7	0.3	0.1	0.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Tabelë 4.7.2B Parametrat kryesorë fiskalë dhe zërat e financimit në secilin skenar (% e PBB-së)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023 Vler.	2024 Para.	2025 Para.	2026 Para.
Deficiti i përgjithshëm									
Bazë	-1.6	-1.9	-6.7	-4.6	-3.7	-2.2	-2.5	-2.1	-2.1
Pesimit						-2.2	-2.7	-1.8	-2.2
Optimist						-2.2	-2.6	-2.0	-1.7
Finacimi i deficitit të përgjithshëm									
Bazë nga e cila:	1.6	1.9	6.7	4.6	3.7	2.2	2.5	2.1	2.1
Huamarrja e brendshme neto	1.2	1.1	2.9	2.6	1.2	1.1	2.1	2.0	1.5
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA	-1.9	1.0	0.9	-3.9	1.9	-1.2	0.7	0.0	-0.3
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:	2.0	-0.6	3.7	5.6	-0.4	2.1	-0.6	0.1	1.0
Financimi i projekteve	1.3	1.2	1.0	0.8	0.5	0.9	1.2	1.3	1.4
Eurobond	3.8	0.0	4.9	4.2	0.0	2.8	0.0	2.6	2.0
Mbështetje buxhetore	0.1	0.1	1.4	2.3	0.8	1.1	0.3	0.5	0.2
Ripagesat	-3.2	-1.8	-3.7	-1.8	-1.8	-2.8	-2.1	-4.3	-2.7
Flukse të tjera	0.2	0.4	-0.8	0.3	0.9	0.3	0.4	0.0	0.0
Pesimist nga e cila:						2.2	2.7	1.8	2.2
Huamarrja e brendshme neto						1.1	2.1	1.4	0.7
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA						-1.2	0.9	0.3	0.4
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:						2.1	-0.6	0.1	1.0
Financimi i projekteve						0.9	1.2	1.3	1.5
Eurobond						2.8	0.0	2.7	2.1
Mbështetje buxhetore						1.1	0.3	0.5	0.3
Ripagesat						-2.8	-2.2	-4.4	-2.9
Flukse të tjera						0.3	0.4	0.0	0.0
Optimist nga e cila						2.2	2.6	2.0	1.7
Huamarrja e brendshme neto						1.1	1.9	1.6	0.8
Ndryshimi i stokut të likuiditetit në TSA						-1.2	1.0	0.3	0.0
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:						2.1	-0.6	0.1	1.0
Financimi i projekteve						0.9	1.2	1.3	1.4
Eurobond						2.8	0.0	2.5	2.0
Mbështetje buxhetore						1.1	0.3	0.5	0.2
Ripagesat						-2.8	-2.1	-4.2	-2.7
Flukse të tjera						0.3	0.4	0.0	0.0
Balanca primare									
Bazë	0.6	0.2	-4.6	-2.7	-1.8	0.0	0.2	0.8	0.9
Pesimit						0.0	0.0	0.8	0.4
Optimist						0.0	0.2	0.9	1.4
Balanca korrente									
Bazë	3.2	2.6	-0.5	2.3	1.6	3.7	2.8	2.8	2.6
Pesimit						3.7	2.2	2.0	2.0
Optimist						3.7	2.9	3.0	3.1
Borxhi publik									
Bazë	67.7	65.8	74.3	74.5	64.5	61.5	59.8	59.3	58.9
Pesimit						61.5	60.8	60.7	60.6
Optimist						61.5	59.3	58.3	57.0
Stoku i likuiditetit në llogarinë unike të thesarit (TSA)									
Bazë	3.0	1.0	0.5	3.9	0.7	1.9	1.1	1.0	1.3
Pesimit						1.9	1.6	1.3	0.8
Optimist						1.9	1.8	1.4	1.4
Borxhi publik NET nga gjendja e stokut të likuiditetit në TSA									
Bazë	64.6	64.8	73.9	70.6	63.8	59.6	58.7	58.3	57.7
Pesimit						59.6	59.2	59.5	59.8
Optimist						59.6	57.5	56.9	55.6

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023

4.8 Cilësia e financave publike

Cilësia e financave publike në Shqipëri ka qenë në proces reformimi duke filluar nga viti 2014, me miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014–2020, ndjekur nga Strategjia e MFP 2019–2022. Përmirësimet e financave publike ndër vite dëshmojnë ecurinë e reformës gjatë këtyre viteve. Strategjia e rishikuar e MFP-së 2019–2022 adreson një sërë sfidash që vendi ynë duhet të trajtojë në rrugën e tij drejt Bashkimit Evropian. Strategjia e MFP-së synon të mbështesë një ekonomi më të zhvilluar, me shërbime më të mira për qytetarët; synon rritjen e përgjegjshmërisë, eficiencës dhe disiplinës fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike. Me mbështetjen e kësaj Strategjie, qeveria shqiptare pret të përmirësojë buxhetimin me bazë gjinore dhe në këtë mënyrë të ndërmarrë një hap të prekshëm në rritjen e mundësive të barabarta mes meshkujve dhe femrave për zhvillimin e vendit tonë dhe për transformimin shoqëror. Strategjia i mundëson qeverisjes vendore të ofrojë shërbime më të mira dhe më transparente për qytetarët dhe u jep atyre mundësinë të kenë fjalën e tyre në planifikimin dhe shpenzimin e parave publike, përgjegjshmërinë, efikasitetin dhe disiplinën fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019–2022 ka përfunduar në dhjetor të vitit 2022. Raporti vjetor i progresit të raportit të MFP-së ofron një vlerësim të kritereve të pranueshmërisë së MFP-së për Bashkimin Evropian (BE) për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të përshtatshëm për të përmirësuar menaxhimin e financave publike si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Prandaj, për shkak të këtyre roleve të rëndësishme, MFE-ja po ndjek fazat e kalendarit për hartimin dhe miratimin e strategjisë së re të MFP-së. Ky dokument do të përcaktojë drejtimet dhe prioritetet për të garantuar një sistem financash publike që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Vazhdimi i reformave të MFP-së është thelbësor për të rritur efektivitetin e shpenzimeve buxhetore dhe për të krijuar një mjedis më produktiv për shpenzime në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Strategjia do të mbulojë periudhën 2023–2030, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), ku kjo e fundit do të përafrohet me Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Strategjia e MFP-së do të ketë planin e saj të veprimit, që mbulon një periudhë 3-vjeçare, duke përfshirë aktivitete afatshkurtra dhe produkte në kohë. Janë duke u ndjekur tri faza për përgatitjen e strategjisë së re të MFP-së si: Faza I - Hartimi, konsultimi dhe miratimi i dokumentit të "Menysë së sfidave"; faza II – Hartimi dhe kostimi i Strategjisë së Re të Menaxhimit të Financave Publike; faza III – Fillimi dhe miratimi i Strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike.

Sa i përket fazës së parë, janë shqyrtuar raportet ndërkombëtare të vlerësimit, si dhe raportet e brendshme dhe janë identifikuar dobësitë dhe sfidat në fushën e financave publike. Janë mbajtur takime me të gjitha njësitë përkatëse të përfshira në MFP, në të cilat janë diskutuar gjetjet dhe prioritetet, të cilat janë paraqitur në dokumentin "Menyja e sfidave". Dokumenti "Menyja e sfidave" u konsultua me të gjitha palët e interesuara, përfshirë partnerët për zhvillim dhe integrim dhe organizatat e shoqërisë civile, dhe u miratua në Komitetin Drejtues të MFP-së të mbajtur në korrik 2023.

Në lidhje me fazën e dytë, metodologjia për përgatitjen e Strategjisë së re të MFP-së është hartuar bazuar në metodologjinë IPSIS, metodologjinë SIGMA/OECD dhe praktikat më të mira (kombëtare dhe ndërkombëtare). Metodologjia u diskutua dhe u miratua në Komitetin Drejtues të mbajtur në korrik 2023. Gjithashtu, projekt-urdhri i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030 dhe plani i veprimit" u nda dhe u konsultua me të gjithë aktorët e përfshirë dhe u miratua me urdhrin e Kryeministrit nr. 195, datë 8.11.2023. Lidhur me procesin e hartimit të dokumentit të MFP-së, MFE me mbështetjen e Asistencës Teknike po zhvillon takime të dedikuara me njësitë përgjegjëse për secilin komponent të MFP-së me qëllim të përcaktimit të vizionit për vitin 2030 dhe masave që do të përfshihen në Planin e Veprimit të MFP-së 2023–2026. Një draft version i parë i dokumentit të strategjisë MFP pritet të finalizohet brenda dhjetorit 2023.

Ndërsa, gjatë fazës së tretë, draft strategjia do të kalojë për konsultim dhe paketa e plotë do t'i

dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave. Strategjia e miratuar do të ndahet me të gjitha palët e interesuara dhe do të publikohet në faqen e internetit të MFE-së.

4.9 Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore

Strategjia e MFP-së përshkruan ndryshimet e parashikuara në qeverisjen fiskale të vendit, domethënë në set masash, rregullash dhe institucionesh që mbështesin drejtimin e politikës fiskale dhe kush duhet të bëjë çfarë për të sjellë risi në proceset e menaxhimit të financave publike. Strategjia ofron rezultate specifike, të matshme, të arritshme, realiste, në kohë (SMART) për secilin nga objektivat specifikë, të cilat janë të detajuara së bashku me ndërhyrjet (komponentët). Secili objektiv specifik përfshinte një përshkrim të progresit që nga viti 2014 së bashku me mësimet e nxjerra dhe prioritetet deri në vitin 2022. Ndërhyrjet kryesore ishin të lidhura drejtpërdrejtë me rezultatet si dhe janë identifikuar aktorët kyçë për të garantuar linja të qarta të llogaridhënies. Gjithashtu, ishin të identifikuara qartë produktet për secilin komponent brenda objektivit specifik. Strategjia 2019-2022 ishte e riorganizuar në shtatë objektiva specifikë:

- Objektivi specifik 1: Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur;

- Objektivi specifik 2: Planifikim i mirintegruar dhe efikas;

- Objektivi specifik 3: Mbledhja e të ardhurave;

- Objektivi specifik 4: Zbatim efikas i buxhetit;

- Objektivi specifik 5: Transparencë e financave publike;

- Objektivi specifik 6: Kontrolli i brendshëm efektiv;

Objektivi specifik 7: Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike.

4.10 Qëndrueshmëria e financave publike

Zbatimi i reformës së MFP-së shërben si udhërrëfyes për Shqipërinë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike. *Objektivi i përgjithshëm* i Strategjisë së reformës së MFP-së është të arrijë një buxhet më të balancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të reduktuar të borxhit përmes menaxhimit financiar më të fortë dhe proceseve të kontrollit dhe auditimit dhe ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë. Ky dokument strategjik në fushën e menaxhimit të financave publike shërben si një udhërrëfyes në:

- reduktimin e borxhit publik;

- shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;

- mobilizimin e vazhdueshëm të mbledhjes së të hyrave tatimore dhe doganore;

- përmirësimin e projekteve të investimeve publike, duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe koncensionet;

- sigurimi i një lidhjeje më të mirë ndërmjet politikave strategjike dhe Programit Buxhetor Afatmesëm;

- një angazhim më i strukturuar dhe në kohë me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit;

- rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të institucioneve supreme të auditit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka dhënë një fokus të veçantë reformës së MFP-së: duke filluar me formulimin e Strategjisë së MFP-së, zbatimin e reformës ndër vite, monitorimin dhe raportimin dhe vlerësimin. MFE-ja ka krijuar një dialog vjetor për politikat e MFP-së të udhëhequr nga qeveria me të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë BE-në, Institucionet Financiare Ndërkombëtare kryesore dhe vendet partnere, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

5. REFORMAT STRUKTURORE PARËSORE MË 2024–2026

Kapitali njerëzor dhe politikat shoqërore

Analiza e pengesave kryesore

Punësimi dhe tregu i punës

Shqipëria ka vazhduar progresin e konsiderueshëm drejt garantimit që si burrat ashtu edhe gratë të kenë akses në mundësi të shtuara punësimi. Pas pandemisë, e cila ndikoi negativisht në tregun e punës, një trend pozitiv vërehet gjatë viteve 2022–2023 në të gjithë treguesit e tregut të punës. Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për popullsinë 15–64 vjeç në tremujorin e dytë 2023 është 75.8%. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 3.0% më e lartë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës është rritur me 0.1%. Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç në tregun e punës në vitin 2022 është 65% me një rritje prej 4,4% krahasuar me vitin 2020. Ndërsa gjatë tremujorit të dytë 2023, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 67.4% me një rritje prej 2.7 p.p. krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022. Shkalla e punësimit është përmirësuar ndjeshëm veçanërisht te gratë nga 53.8 në 2021 në 58.9% më

2022 dhe hendeku gjinor në punësim ka ardhur duke u ulur nga 14.4% më 2021 në 14.2% më 2022, megjithatë, hendeku gjinor në punësimi mbetet problematik.

Shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart në tregun e punës në vitin 2022 është 10.9, që është 0.8 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2020. Në tremujorin e dytë të vitit 2023, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 10.7% me një rënie prej 0.4 p.p. krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022 dhe me 0,1 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e parë 2023.

Niveli i punësimit dhe shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve ka ardhur në rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Shkalla e punësimit për të rinjtë 15-24 vjeç për vitin 2022 ishte 29.0 me një rritje prej 2.6 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe përqindja e pjesëmarrjes 38.6 me një rritje prej 2.3 p.p. krahasuar me vitin 2021. Megjithatë të dyja shifrat mbeten të ulëta në krahasim me shkallën e punësimit dhe pjesëmarrjes së pjesës tjetër të popullsisë. Shkalla e papunësisë është në rënie të vazhdueshme, por ende mbetet në pjesën tjetër të popullsisë së rritur.

Për sa i përket përqindjes së të rinjve as në punësim, as në arsim apo trajnim (NEET) në vitin 2022 ishte 25.2 me një rënie prej 0.9 p.p. krahasuar me vitin 2021. Norma NEET ishte 5.2 p.p. më e lartë për gratë (27.8%) sesa për burrat (22.6%) më 2022. Një përqindje e lartë e të rinjve as në punësim, as në arsim dhe trajnim NEET është në Shqipëri dhe është pothuajse dyfishi i mesatares së BE-27.

Arsimi dhe shkathtësitë

Arsimi

Prioriteti kryesor i sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri është krijimi i kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë kompetenca, të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse, për të përballuar me sukses sfidat e jetës dhe të tregut të punës. Politikat aktuale për arsimin parauniversitar në Shqipëri dhe Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026, në koherencë me politikat europiane, shpallin si fushë prioritare fuqizimin e nxënësve me aftësitë e nevojshme që sigurojnë përmbushjen e tyre si individë, përmbushjen e përgjegjësive sociale dhe përgatitjen për tregun e punës.

Kurrikula e bazuar në kompetenca e zbatuar që nga viti 2014 në arsimin parauniversitar është e orientuar drejt së ardhmes dhe kompetencat kryesore mbi të cilat është ndërtuar u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë aftësitë e menaxhimit të karrierës.

	- Aftësitë dhe trajnimet e shoqërisë civile dhe ngritja e kapaciteteve për hekurudhat HBMC, BERZH, HSH/MIE Workshope me komunitetin dhe organet lokale, dhe 4 universitetet, në finalizim janë AT të Projektit. Kjo synon të mbështesë tranzicionin e rajonit në një ekonomi digjitale dhe të sjellë përfitimet e transformimit digjital, si rritja më e shpejtë ekonomike, më shumë vende pune dhe shërbime më të mira të transportit hekurudhor.	4
	- Zhvillimi përmes planifikimit efikas dhe më të mirë të integruar dhe rishikimi i politikave strategjike synohet nëpërmjet programimit më të mirë të buxhetit afatmesëm, siç është programi buxhetor. Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike që ndikojnë në aktivitetet hekurudhore, ka ndikimin e vlerësimit të menaxhimit të financave publike (MFP) në hekurudhat në Shqipëri, të mirëadministruara, të menaxhuara dhe të kontrollit të brendshëm përkatësisht.	5
	- Në qasjen e dyfishtë transformimi digjital dhe tranzicioni i gjelbër, asistencë teknike për përgatitjen e strategjisë së ITS për Shqipërinë (transporti hekurudhor dhe detar), MIE, HSH, ADP, DPD, STII, RID etj. The ITS 08 -Prezantimi i rezultateve për hekurudhat dhe detin 3 dhe 4 në MIE datë 16.06.2023 projekti i takimit tematik është në vazhdim, për t'u pajisur me ndikimet e pritshme në Zonën e Projektit Rehabilitimi Durrës-Tiranë-TIA.	5
	- Projekti Harmotrack (Harmonizimi i përshkrimit dhe vlerësimit të cilësisë së linjës hekurudhore)/ HARMOTRACK, MIE, DIH, HSH/MIE, UAMD Adhurimet vazhdojnë të punojnë paketat për ngritjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë, do të bëjnë	4

	monitorimin e Fazat e mirëmbajtjes së gjeometrisë së binarëve hekurudhor në fazën e funksionimit si në nenin 3 të ligjit për marrëveshjen e projektit.	
	- Vlerësimi i tregut hekurudhor në Ballkanin Perëndimor për sa i përket kapaciteteve, politikave, nivelit ekonomik dhe teknik të zhvillimit të segmenteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve, mbledhja e të dhënave për monitorimin e tregut hekurudhor të Ballkanit Perëndimor sipas Rregullores (BE) 2015/1100 Komuniteti i Transportit, i përfaqësuar nga MIE, HSH konsistonte në mbledhjen e të dhënave për transportin hekurudhor dhe GTZH u krye me pyetësorë për të marrë mendime/sugjerime nga palët e interesuara si agjencia zbatuese.	4
	Vendimi më i ri i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 26.7.2023 për miratimin e Dokumentit të Politikave Përparësore 2024–2026, me reforma afatmesme dhe afatgjata të qeverisë shqiptare dhe prioritete afatshkurtra/afatmesme, ndër të tjera, përfshirë:	4

Masa e reformës 16: Qeverisje dhe shërbime më të mira detare dhe detare		**Faza e zbatimit të reformës**
Aktivitetet e planifikuara për 2023	Certifikimi i operatorëve të turizmit detar. (MTE)	
	Promovimi i sektorit të turizmit detar. (MTE)	
	Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore. (MTE, GDM)	
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse është i pjesshëm ose aspak		

Masa e reformës 17: Mbështetja e zbatimit të reformës kurrikulare parauniversitare dhe trajnimit të mësuesve		**Faza e zbatimit të reformës**
Aktivitetet e planifikuara për vitin 2023	Trajnimi i 1000 mësuesve të klasës së dytë dhe monitorimi i vazhdimësisë së punës për zbatimin e programit të gjuhës angleze.	
	Përfundimi i procesit të harmonizimit të kurrikulave të trajnimit fillestar të mësuesve të IAL-ve bazuar në kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe me kurrikulën e ofruar në arsimin parauniversitar.	
	Diskutimi dhe finalizimi i draftit të sistemit të karrierës së mësuesit bazuar në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë.	
	Forcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorët e kurrikulës në nivel të Zyrave Arsimore Vendore.	
	Trajnimi i 700 drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit të mesëm të ulët mbi zhvillimin e arsimit të Arteve dhe Artizanatit udhëzues gjithashtu udhëzues për orientimin në karrierë në arsimin bazë.	
	Hartimi dhe miratimi i kornizës për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor.	
	Hartimi i programit të ri dhe trajnimi i 100 mësuesve në zbatimin e programit TIK për klasën e parë dhe të dytë.	
	Zbatimi i TALIS 2024 për instrumentet e vrojtimit pilot.	
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse është i pjesshëm ose aspak	Aktualisht janë trajnuar 1444 mësues për zbatimin e programit të gjuhës angleze në klasat e para dhe të dyta, për zbatimin e arsimit të kombinuar në gjuhën angleze në klasat e para dhe të dyta, si dhe për teknika efektive të mësimit të gjuhës angleze. për fëmijët në klasat e para. dhe e dyta.	5=zbatimi i plotë
	Ka përfunduar përgatitja e dokumenteve për procesin e harmonizimit të kurrikulave të trajnimit fillestar të mësuesve të IAL-ve bazuar në kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe me kurrikulën e ofruar në arsimin parauniversitar. Tashmë është autonomia e universiteteve për të zbatuar këto dokumente	4=zbatimi është avancuar
	Jemi në fazën e përgatitjes së dokumentit për kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit	3=zbatimi në vazhdim e sipër me disa rezultate fillestare
	Zbatimi i Programit Kombëtar "Art, zeje, sport" në 200 shkollat e përfshira në program. Deri më tani janë trajnuar 250 koordinatorë nga njësitë arsimore dhe shkollat vendore. Trajnimi vazhdon	4=zbatimi është avancuar
	Hartimi dhe miratimi i kornizës për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor. Është në proces drafti.	3=zbatimi në vazhdim e sipër me disa rezultate fillestare
	Hartimi i programit të ri dhe trajnimi i 100 mësuesve në zbatimin e programit TIK për klasën e parë dhe të dytë. Ajo është bërë.	5=zbatimi i plotë
	Zbatimi i TALIS 2024 për instrumentet e vrojtimit pilot. Bëhet sipas kërkesave të TALIS 2024	5=zbatimi i plotë

Masa e reformës 18: Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim		**Faza e zbatimit të reformës**
Aktivitetet e planifikuara për 2023	Transformimi i shkollave speciale në qendra burimore.	
	Ofrimi i mësuesve ndihmës shtesë për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesit që njohin gjuhën shqipe të shenjave për nxënësit që nuk dëgjojnë.	
	Trajnimi i 61 drejtues të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës dhe mësues ndihmës.	
	Trajnimi i rrjeteve profesionale të punonjësve të shërbimit psikosocial.	
	Racionalizimi i rrjetit shkollor.	
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse është i pjesshëm ose aspak	MAS-i po punon për transformimin e shkollave/instituteve speciale në qendra burimore që mbështesin edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre social. Me miratimin e ndryshimeve të fundit në ligjin 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", u vazhdua me ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore për transformimin e arsimit të veçantë. shkollat në qendra burimore. Po punohet për finalizimin e aktit nënligjor për qendrat burimore.	3 = zbatimi në vazhdim e sipër me disa rezultate fillestare
	250 mësues të tjerë ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara janë punësuar në shkollat e zakonshme gjatë vitit të kaluar. Kemi ende mungesë mësuesish ndihmës që dinë gjuhën e shenjave.	4=zbatimi është avancuar
	MAS-i në bashkëpunim me agjencinë e sigurimit të cilësisë në sistemin parauniversitar realizuan trajnimin e 61 drejtuesve të rrjeteve profesionale në qershor 2023.	5= zbatimi i plotë
	Për vitin akademik 2022-2023 shërbimi psikosocial në arsimin publik parauniversitar (klasat 1-12) kishte gjithsej 771 specialistë (508). psikologë+263 punonjës socialë).	5= zbatimi i plotë

Masa e reformës 19: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale të mësuesve		**Faza e zbatimit të reformës**
Aktivitetet e planifikuara për 2023	Hartimi dhe miratimi i programit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe zbatimi i tij në klasën e dytë.	
	Trajnimi i mësuesve të TIK-ut për zbatimin e programit në klasën e dytë.	
	Hartimi i materialit mbështetës për mësuesit për të përfshirë aftësitë e kodimit dhe zbatimin e tij në vitin 2023 në klasën e dytë.	
	Hartimi i materialit mbështetës për nxënësit për të përfshirë aftësitë e kodimit dhe zbatimin e tij në vitin 2023 në klasën e dytë.	
	Trajnimi i 1200 menaxherëve profesionistë të rrjetit me temë "Siguria e studentëve në internet".	
	Trajnimi i 1200 drejtuesve të rrjeteve profesionale për zbatimin e standardeve profesionale të mësuesve si dhe për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor si pjesë e arsimit të kombinuar.	
	Investim në rritjen e numrit të pajisjeve digjitale në shkolla.	
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse është i pjesshëm ose aspak	Është miratuar programi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe zbatimi i tij në klasën e dytë.	5=zbatimi i plotë
	Rreth 100 mësues të TIK-ut janë trajnuar për zbatimin e programit në klasën e dytë.	5=zbatimi i plotë
	Manuali mbështetës për mësuesit është hartuar për të përfshirë aftësitë e kodimit dhe zbatimin e tij në vitin 2023 në klasën e dytë.	5=zbatimi i plotë
	Manuali për nxënësit po hartohet për të përfshirë aftësitë e kodimit dhe zbatimin e tij në vitin 2023 në klasën e dytë.	5=zbatimi i plotë
	Manuali "Siguria e nxënësve në internet" po përgatit 341 mësues po trajnohen për edukimin mediatik dhe informativ në arsimin formal	3=zbatimi në vazhdim e sipër me disa rezultate fillestare
	570 drejtues të rrjeteve profesionale në arsimin e mesëm të lartë dhe 510 mësues në arsimin fillor po trajnohen për zbatimin e standardeve profesionale të mësuesve si dhe për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor si pjesë e arsimit të kombinuar.	4=zbatimi është avancuar
	Investim në rritjen e numrit të pajisjeve digjitale në shkolla.	MAS

SHTOJCA II

Masat e reformës ERP 2024–2026	Sfidat kryesore strukturore (Vlerësimi i Komisionit i ERP 2023-2025)	Udhëzimet e politikave ERP 2023	Paketa e Zgjerimit 2023	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm 2020-2030	Marrëveshja e Gjelbër Evropiane / Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor	Agjenda Digjitale Evropiane / Agjenda Digjitale e Ballkanit Perëndimor	Projektet IPA mbështesin këtë reformë
Zhvillimi i infrastrukturës broadband për ekonominë digjitale	N/A	N/A	Sipas raportit të fundit të Komisionit të BE-së (Raporti i Shqipërisë 202 3) Shqipëria është përgatitur mesatarisht në fushën e transformimit digjital dhe medias, duke prioritizuar si masat më të rëndësishme që duhen marrë: - të plotësojë shtrirjen e numrit të urgjencës 112 në të gjithë vendin; - miratojë legjislacionin përkatës për zbatimin e Kodit të ri Evropian të Komunikimeve Elektronike dhe miratimin e ligjit për sigurinë kibernetike për të siguruar përafrim më të afërt me Direktivën e BE-së mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin (NIS II); të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore për performancën digjitale dhe konkurrencën digjitale.	Lidhja digjitale është e lidhur ngushtë me qëllimet e SDG, të tilla si Objektivi 9 (Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura) dhe në veçanti me objektivin 9.c për të rritur ndjeshëm aksesin në teknologjitë e komunikimit të informacionit (TIK) dhe të përpiqet të sigurojë akses universal dhe të përballueshëm në internet në vendet me më pak zhvillim. Pa infrastrukturë digjitale në ditët e sotme, ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë zgjidhje të shkallëzueshme për SDG. TIK-të janë gjithashtu të lidhura me SDG17, objektivi 17.8, me SDG 5, barazia gjinore, objektivi 5.b. rëndësia e aftësive të TIK-ut njihet edhe në SDG 4 (Arsimi cilësor, objektivi 4.b).	Infrastruktura digjitale, zhvillimi dhe shtrirja e infrastrukturës kombëtare me brez të gjerë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është një nga pikat kryesore të Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor të miratuar nga Komisioni Evropian më 6 tetor 2020. Ky plan ka nënvizuar se nevoja për investime për rrjete broadband në Ballkanin Perëndimor është rreth 3.6 miliardë euro. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane vlerëson se "teknologjitë digjitale janë një mundësi kritike për arritjen e qëllimeve të qëndrueshmërisë së Marrëveshjes së Gjelbër në shumë sektorë të ndryshëm".	Objektivat për zhvillimin e brezit të gjerë janë në përputhje me Agjendën Digjitale të BE-së, pjesë e prioriteteve të Strategjisë SEE-2020 nën shtyllën e rritjes inteligjente, gjithashtu pjesë e MAP-REA të WB6 të miratuar në Samitin e Triestes më 12 korrik 2017.	
Masa: Rehabilitimi i rrjetit hekurudhor shqiptar dhe ndërlidhja për një transport të qëndrueshëm	*N/A*	N/A	Nën perspektivën e zgjerimit dhe strategjinë e paketës WB6 konsiston në Lidhshmërinë në transport të fokusuar në zhvillimin e infrastrukturës për rrugë, hekurudha dhe IWW në përputhje me përmirësimin e prioriteteve të TEN-ve dhe gjelbërimin e infrastrukturës hekurudhore kontribuojnë	Projekti aplikon ITS me ERTMS "1" me nivelin e ardhshëm "2", në ndërvepruesshmërinë hekurudhore HSH. Faza e ndërtimit dhe funksionimit është nën TSI-të, me standarde evropiane dhe ndërkombëtare si në komitetin ndërkombëtar të unionit UIC, ku Shqipëria është anëtare e projektit që	Marrëveshja e Gjelbër dhe Lëvizshmëria e zgjuar dhe e Qëndrueshme, prioriteti kryesor në këtë drejtim mbetet rivitalizimi i rrjetit hekurudhor. Strategjia Rajonale Hekurudhore dhe plani i saj i veprimit synojnë ta bëjnë hekurudhat një alternativë të besueshme dhe të qëndrueshme për transportin rrugor. Bruksel,	Investimi në lidhjen me brez të gjerë: Infrastruktura e mirë digjitale është thelbësore për përhapjen e brezit të gjerë në Ballkanin Perëndimor. Sipas Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), 30 milionë euro grante të BE-së janë vënë në dispozicion për vendosjen e infrastrukturës me brez të	6 AT-të e BE-së po mbështesin projektin në kuadër të zbatimit të acquis nga IPA III për krijimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve dhe sistemeve të nevojshme hekurudhore. Një program vjetor pune në kuptim të nenit 110(2) të Financës Rregullore, masat e planeve të veprimit vjetor dhe

			në zgjidhjet e lëvizshmërisë inteligjente në përputhje me agjendën e Gjelbër. Prioriteti është zbatimi përmes flamurëve (1, 2) dhe 3 të EIP-it, duke u fokusuar përkatësisht në lidhjen e veriut dhe jugut, lindjen dhe perëndimin dhe në lidhjen e rajoneve bregdetare. Sipas Brukselit, 12.10.2022, COM(2022) 528 final{SWD(2022) 338 final}	aplikon temën në tregun e transportit dhe SRG deri në vitin 2030, me hekurudhë. Projekti është përfshirë. Sistemi i monitorimit të pistave dhe niveli ECTS "1", me rehabilitim të planifikuar me punën 30-mujore Ky investim strategjik përfiton gjithashtu nga financimi i BE-së në kuadër të planit ekonomik dhe investues evropian dhe intermodal nga porti i Durrësit-aeroporti i Rinasit dhe hekurudhat shqiptare.	6.10.2020, SWD (2020) 223 final, Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Duke shoqëruar Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve. Një plan ekonomik dhe investues për Ballkanin Perëndimor, {COM (2020) 641 final}. Projekti do të jetë operacional në një linjë hekurudhore të elektrizuar në lidhje me operacionet miqësore me mjedisin sipas VSM, VNM, LAP, VNMS dhe planit mjedisor social, shëndetit dhe sigurisë (ESAP). Objektet mjedisore janë domosdoshmëri për t'u realizuar në lidhje me COP për konventën e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet janë studiuar dhe zbatuar sipas kësaj mase reforma për rehabilitimin e hekurudhave.	gjerë në rajon për të mobilizuar investimet strategjike dhe për të nxitur rritjen socio-ekonomike. Një paketë asistence teknike e miratuar tashmë për Shqipërinë në kuadër të WBIF si një nga paketat e para të investimeve. Rritja e sigurisë kibernetike, besimi dhe digjitalizimi i industrisë Agjenda digjitale për WB6 për mbështetjen e ndërtimit të kapaciteteve në besim dhe siguri, digjitalizimin e industrisë në Ballkanin Perëndimor për të siguruar që të gjithë sektorët të përfitojnë nga risitë digjitale. Fuqizohet digjitalizimi i lëvizshmërisë inteligjente dhe CCS Inteligjente për sinjalizimin në hekurudha dhe balanca gjinore.	shumëvjeçar në kuptim të nenit 8 të IPA III Rregullorja dhe neni 23 i Rregullores së Evropës Globale. Për më tepër, AT-ja e BE-së, dhe ndihma për rritjen e kapaciteteve hekurudhore për IM kryesore dhe zbatimi
Masa: Zhvillimi i një kuadri ligjor për të mbështetur bizneset e reja inovative			*Kapitulli 20 Ndërmarrja dhe Politika Industriale. Politika industriale e BE-së forcon konkurrencën, lehtëson ndryshimet strukturore dhe inkurajon një mjedis miqësor ndaj biznesit që stimulon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme*	*Objektivi nr. 5, Barazia gjinore, Objektivi nr. 8) Puna e denjë dhe rritja ekonomike Objektivi nr. 9) Inovacioni dhe infrastruktura në industri Objektivi nr. 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme, Objektivi nr. 12: Konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm.*	*Masat adresojnë të gjitha qëllimet e Marrëveshjes së Gjelbër pasi mbështet iniciativat përmes thirrjeve të saj të hapura që kanë ndikim në pikat e mëposhtme: (I) Veprimet klimatike, duke përfshirë dekarbonizimin, energjinë dhe lëvizshmërinë. (II) ekonomi rrethore, duke trajtuar mbetjet, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve*	*Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor synon të mbështesë tranzicionin e rajonit në një ekonomi digjitale dhe të sjellë përfitimet e transformimit digjital, të tilla si rritja më e shpejtë ekonomike, më shumë vende pune dhe shërbime më të mira, gjë që shkon në përputhje me misionin lëndor të vetë ligjit.*	*IPA III, 10,5 mln euro*

					(III)biodiversiteti, me synim mbrojtjen dhe rivendosjen e pasurisë natyrore të rajonit (IV) luftimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe (V) sistemeve të qëndrueshme të ushqimit.		
Masa: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale të mësuesve	Sfida kyçe 3		Asnjë rekomandim	SDG 4 dhe SDG 9. c. Për SDG 9 në kuadër të arsimit, përmendim Agjendën Digjitale të Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 1.6.2022 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe Planit të Veprimit 2022 – 2026". Në fushën e arsimit, synimi i kësaj agjende është edukimi digjital dhe aftësitë digjitale si dhe transformimi i të nxënit dhe mësimdhënies. Përshtatja dhe integrimi i teknologjisë digjitale është një aset i vlefshëm në mbështetjen e të mësuarit dhe mësimdhënies dhe objektivi kryesor është zhvillimi i aftësive digjitale në të gjithë ekosistemin arsimor duke synuar krijimin e një kulture digjitale të të mësuarit.	Asnjë rekomandim	Masa e re reformuese e propozuar për 2022-2024 Masa e reformës 19: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale "Rritja e shkrim-leximit, aftësive dhe përfshirjes digjitale; Epoka digjitale duhet të ketë të bëjë me fuqizimin dhe emancipimin, sfondi apo aftësitë nuk duhet të jenë pengesë për aksesin në këtë potencial.	Në lidhje me IPA-n nuk ka projekte të miratuara për digjitalizimin. Për sa i përket propozimeve në kuadër të IPA III MAS është përfshirë në Programin Operativ të Digjitalizimit i cili aktualisht është në pritje të miratimit. Në kuadër të këtij OP MAS ka kërkuar asistencë në lidhje me emërimin me laptopë të mësuesve për t'u mundësuar përdorimin e sistemit SMIP.

VENDIM
Nr. 13, datë 11.1.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONSTATIMIT, TË SHQYRTIMIT, TË PROPOZIMIT DHE TË VENDOSJES SË MASAVE ADMINISTRATIVE NGA AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 27, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (në vijim AIF) ndaj subjekteve të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", të ndryshuar.

KREU I
LLOJET E INSPEKTIMIT DHE PLANI VJETOR

Neni 2
Llojet e inspektimeve

Konstatimi i shkeljeve të kryera nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar, bëhet nga AIF-ja nëpërmjet:

a) inspektimit në vend;

b) inspektimit në distancë.

Neni 3
Plani vjetor i inspektimit

1. Inspektimet në vend dhe në distancë realizohen në bazë të planit vjetor të inspektimit, që miratohet nga drejtori i përgjithshëm i AIF-së.

2. Hartimi i planit vjetor të inspektimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) vlerësimin kombëtar të riskut;

b) vlerësimet sektoriale dhe analizat strategjike;

c) vlerësimet individuale të riskut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit për subjektet e ligjit;

ç) të dhëna të tjera në dispozicion të AIF-së.

Neni 4
Inspektime jashtë planit vjetor të inspektimit

AIF-ja mund të kryejë inspektime jashtë planit vjetor të inspektimit, nëse:

a) nga monitorimi e mbikëqyrja e kryer lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore dhe arrihet në përfundimin se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;

b) në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga të tretët krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore.

KREU II
PROCEDIMI ADMINISTRATIV I INSPEKTIMIT

Neni 5
Njoftimi i programit të inspektimit

1. Procedimi administrativ i inspektimit fillon, si rregull, me njoftimin e programit të inspektimit.

2. Në rastet e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit, programi i inspektimit i njoftohet subjektit në inspektim të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të inspektimit.

3. Me kërkesën e arsyetuar me shkrim të subjektit në inspektim, drejtori i përgjithshëm i AIF-së mund të zgjasë afatin e fillimit të inspektimit.

4. Për inspektimet jashtë planit vjetor të inspektimit, programi i inspektimit mund të mos njoftohet paraprakisht kur gjykohet dhe vlerësohet që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit.

5. Pavarësisht nga njoftimi paraprak, në çdo rast, grupi i inspektimit, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon verbalisht subjektin e inspektimit apo të autorizuarit prej tij për objektin e inspektimit, detyrimet e subjektit të inspektimit sipas

këtij vendimi dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

Neni 6
Përmbajta e programit të inspektimit

1. Programi i inspektimit përmban:

a) emrin apo emërtimin dhe adresën e subjektit të inspektimit;

b) objektin e inspektimit me të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete, që i nënshtrohet inspektimit;

c) bazën ligjore;

ç) përbërjen e grupit të inspektimit;

d) kohëzgjatjen në ditë të kryerjes të inspektimit;

dh) vendin apo vendet ku do të kryhet inspektimi;

e) informacionin, të dhënat e dokumentet shtesë, që duhet të përgatisë subjekti në funksion të inspektimit.

2. Gjatë kryerjes së inspektimit, grupi i inspektimit mund të kërkojë informacion, të dhëna e dokumente shtesë më shumë sesa janë përshkruar në programin e inspektimit, por, në çdo rast, duke respektuar procedurën e parashikuar për administrimin e dokumentacionit, sipas parashikimeve të nenit 10, të këtij vendimi.

3. Përmbajtja e programit të inspektimit dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse miratohen nga drejtori i përgjithshëm i AIF-së.

Neni 7
Vendi i kryerjes së inspektimit

1. Inspektimi në vend kryhet:

a) kudo ku ushtron veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ndodhen faktet objekt inspektimi;

b) në ambientet e punës së AIF-së, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur të kryhet inspektimi. Në këtë rast, subjekti i inspektimit ftohet, nëpërmjet njoftimit paraprak, të paraqitet në zyrat e AIF-së. Nëse është e nevojshme, mund të kërkohet paraqitja e dokumenteve apo e të dhënave të tjera të nevojshme për kryerjen e inspektimit në zyrat e AIF-së.

2. Inspektimi në distancë kryhet në ambientet e punës së AIF-së nëpërmjet:

a) shqyrtimit të raportimeve nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar, të të dhënave, të dokumenteve apo të raporteve të kontrollit në distancë;

b) shqyrtimit të raportimeve të autoriteteve mbikëqyrëse, të dërguara në zbatim të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar;

c) shqyrtimit të informacioneve të tjera të marra nga institucione të ndryshme, palë të treta apo që disponon vetë AIF-ja.

Neni 8
Të drejtat e subjektit në inspektim

1. Subjekti në inspektim ka këto të drejta gjatë inspektimit:

a) Të kërkojë të njihet me programin e inspektimit para fillimit të inspektimit;

b) Të kërkojë identifikimin e grupit të inspektimit;

c) Të jetë prezent dhe të ndjekë vetë ose nëpërmjet të autorizuarit prej tij të gjitha veprimet e inspektimit;

ç) Të kërkojë dhe të marrë informacion nga grupi i inspektimit për procedurën e inspektimit dhe për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;

d) Të paraqesë, me shkrim apo verbalisht, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, dokumente apo çdo provë, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse ku i mbështet ato;

dh) Të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet projektraporti dhe raporti përfundimtar i inspektimit;

e) Të paraqesë shpjegime apo kundërshtime për projektraportin e inspektimit brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kur pjesëmarrja gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, pengon kryerjen e veprimeve të inspektimit, grupi i inspektimit mund të vendosë përjashtimin nga pjesëmarrja, pasi ka marrë konfirmimin e drejtuesit të drejtorisë përkatëse. Ky veprim procedural pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.

Neni 9
Detyrimet e subjektit që inspektohet

Subjekti që inspektohet në vend apo në distancë duhet:

a) të jetë i gatshëm apo të autorizojë një apo disa përfaqësues për të komunikuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedimit administrativ të inspektimit;

b) të paraqesë dhe të vendosë në dispozicion çdo informacion, dokument, të dhëna, regjistër, material, të japë çdo shpjegim për faktet dhe rrethanat e konstatuara, brenda afateve të përcaktuara nga grupi i inspektimit;

c) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet bashkë me provat e tjera;

ç) në rastin e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit, të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e grupit të inspektimit;

d) në rastin e inspektimit në distancë, të dërgojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda afateve ligjore dhe në formën e kërkuar sipas këtij vendimi.

Neni 10
Administrimi i dokumentacionit

1. Gjatë inspektimit në vend, grupi i inspektimit ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve në përputhje me programin e inspektimit. Kërkesa bëhet me shkrim dhe administrimi i dokumentacionit pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.

2. Çdo kopje dokumenti që merret gjatë inspektimit në vend nënshkruhet nga subjekti në inspektim dhe nga grupi i inspektimit, si dhe vuloset në çdo fletë me vulën e subjektit.

3. Në procesverbalin e inspektimit, që do të nënshkruhet nga palët, evidentohet emërtimi i dokumentacionit të administruar së bashku me numrin e fletëve. Në procesverbalin e inspektimit evidentohen edhe dokumentet apo të dhënat që administrohen në formatin elektronik.

4. Në rastet e inspektimit në distancë, subjekti në inspektim dërgon dokumentet e kërkuara nga grupi i inspektimit, duke i numërtuar në çdo fletë, të firmosura nga subjekti apo personi i autorizuar prej tij dhe të vulosura me vulën e subjektit.

Neni 11
Projektraporti i inspektimit

1. Në përfundim të inspektimit në vend apo në distancë, grupi i inspektimit përgatit projektraportin e inspektimit brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i inspektimit.

2. Projektraporti i inspektimit i njoftohet subjektit të inspektuar për të paraqitur shpjegimet apo kundërshtimet përkatëse, nëse kanë të tilla.

3. Afati i paraqitjes së shpjegimeve apo i kundërshtimeve përcaktohet në shkresën përcjellëse të projektraportit të inspektimit, në varësi të llojit dhe të objektit të inspektimit, por jo më shumë se 7 (shtatë) ditë nga dita e njoftimit të projektraportit të inspektimit.

4. Nëse subjekti i inspektuar nuk paraqet në AIF shpjegimet apo kundërshtimet në afatin e përcaktuar, projektraporti i inspektimit do të konsiderohet i pranuar pa kundërshtime.

Neni 12
Raporti përfundimtar i inspektimit

1. Grupi i inspektimit, pas shqyrtimit të shpjegimeve apo të kundërshtimeve të projektraportit të inspektimit të njoftuara nga subjekti i inspektuar, harton raportin përfundimtar të inspektimit. Afati për hartimin e këtij raporti është deri në 7 (shtatë) ditë, në varësi të llojit dhe të objektit të inspektimit.

2. Raporti përfundimtar i inspektimit përmban:

a) të dhënat për subjektin e inspektuar;

b) veprimet e inspektimit dhe gjetjet e tij;

c) vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit;

ç) shpjegimet e përmbledhura të fakteve dhe të provave, vlerësimit të tyre dhe rezultatet e hetimit administrativ për të cilat mbështeten konkluzionet;

d) shpjegimet apo kundërshtimet e subjektit të inspektimit lidhur me projektraportin e inspektimit, si dhe argumentimet e grupit të inspektimit lidhur me to;

dh) kundërvajtjen apo kundërvajtjet e konstatuara;

e) masën administrative të propozuar, në përcaktimin e së cilës merren parasysh kriteret e vendosura në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative;

ë) rekomandimet që i lihen subjektit të inspektuar dhe afatet për përmbushjen e tyre;

f) përbërjen e grupit të inspektimit.

3. AIF-ja i njofton zyrtarisht subjektit të inspektuar raportin përfundimtar të inspektimit.

Neni 13
Kohëzgjatja e procedurës së inspektimit

1. Kohëzgjatja e procedurës së inspektimit në vend apo në distancë nuk mund të jetë më e gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, duke filluar nga dita e njoftimit të programit të inspektimit deri në hartimin e raportit përfundimtar të inspektimit.

2. Drejtori i përgjithshëm i AIF-së mund të miratojë zgjatjen e afatit të mësipërm në proporcion me kompleksitetin dhe volumin e procedurës së inspektimit, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

KREU III
SHQYRTIMI I KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

Neni 14
Afatet e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative nga AIF-ja bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që subjekti njoftohet me raportin përfundimtar të inspektimit dhe kundërvajtjet administrative të konstatuara.

2. Në çdo rast, shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 5 (pesë) vjet nga çasti i kryerjes.

3. Referuar kompleksitetit të çështjes, evidentuar gjatë studimit të thelluar administrativ, afati për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen subjektit brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.

Neni 15
Seanca e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të inspektimit, ku janë evidentuar kundërvajtjet administrative, bëhet në prani të subjektit në inspektim, i cili njoftohet nga AIF-ja për datën dhe orën e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative.

2. Subjekti në seancën e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative ka të drejtë të paraqesë çdo pretendim dhe dokumentacion shtesë, përveç atyre të paraqitura gjatë procedurës së inspektimit në lidhje me shkeljet e konstatuara.

3. Shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë, kur vërtetohet se kundërvajtësi ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe të arsyeshme për mosparaqitje.

Neni 16
Propozimi i komisionit

1. Raporti përfundimtar i inspektimit, ku janë evidentuar kundërvajtjet administrative, shqyrtohet nga komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, i ngritur me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AIF-së.

2. Komisioni, pasi njihet me shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të inspektimit, dëgjon argumentet dhe administron dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i propozon drejtorit të Përgjithshëm:

a) vendosjen e një ose të disa masave administrative të parashikuara në ligj;

b) pushimin e procedimit të kundërvajtjes administrative, kur, nga analizimi dhe shqyrtimi i fakteve, nuk konstatohet kryerja e kundërvajtjes administrative.

Neni 17
Vendimi për kundërvajtjen administrative

1. Drejtori i përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e propozimit të komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, pasi vlerëson praktikën e inspektimit dhe propozimin e komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, merr vendim për vendosjen e masës administrative ndaj subjektit apo pushimin e procedimit të kundërvajtjes administrative dhe njofton zyrtarisht subjektin.

2. Vendimi për kundërvajtjen administrative, përveç të dhënave të institucionit që ka nxjerrë aktin, duhet të ketë të dhënat e kundërvajtësit, shpjegimin e përmbledhur të fakteve dhe të provave, ku mbështetet vendimi, shkeljen e tyre, duke referuar dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi, masat administrative të dënimit me gjobë, cilësimin si titull ekzekutiv për masën e gjobës, si dhe të drejtat për ankimimin dhe afatet procedurale.

3. Për caktimin e llojit dhe të masës administrative merren parasysh kriteret e vendosura në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.

4. Vendimi për kundërvajtjen administrative, i vendosur nga AIF-ja përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i këtij vendimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Për njoftimin dhe afatet e njoftimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative të nxjerra nga AIF-ja zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurave Adminis--trative.

6. Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative të marrë nga AIF-ja mund të bëhet ankim në gjykatën administrative brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU IV
DISPOZITA TË TJERA

Neni 18
Shfuqizimet

Vendimi nr. 871, datë 14.12.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes të masave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", shfuqizohet.

Neni 19
Organet zbatuese

Ngarkohet Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), si autoritet përgjegjës, për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 15, datë 11.1.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRFITIMET NGA SHFRYTËZIMI I SHËRBIMEVE TË EKOSISTEMIT PYJOR, KOMPENSIMI DHE PAGESAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimi dhe pagesat, të cilat zbatohen nga ofruesit dhe përfituesit e këtyre shërbimeve.

2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **"Ofrues i shërbimeve të ekosistemit pyjor"**, këtu e në vijim "ofruesi i shërbimit", në cilësinë e pronarit ose administratorit të ekosistemit pyjor është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, bashkia ose pronari privat i pyllit, të cilët ofrojnë shërbimet në ekosistemin pyjor, sipas parashikimeve të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet";

b) **"Pagesa për shërbime në ekosistem"** ka kuptimin e shpërblimit që merr ofruesi i shërbimit për kryerjen e veprimtarive lidhur me shërbimet në ekosistem, në fondin pyjor në pronësi të tij;

c) **"Përfitues i shërbimeve të ekosistemit pyjor"**, këtu e në vijim "përfitues i shërbimit" ka kuptimin e personit fizik apo juridik, i cili i kërkon ofruesit të shërbimit të reduktojë punimet teknike apo të mbajë në gjendjen natyrale ekosistemin, në funksion të garantimit të aktivitetit që kryen përfituesi i shërbimit;

ç) **"Shërbimet e ekosistemit pyjor"**, këtu e në vijim "shërbime të ekosistemit" kanë kuptimin e dhënë sipas përkufizimit në pikën 60, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet".

II. RREGULLAT PËR PËRFITIMET NGA SHFRYTËZIMI I SHËRBIMEVE TË EKOSIS-TEMIT PYJOR

1. Shërbimet që ofrohen për përfitim në ekosistemin pyjor duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) të jenë në përputhje me objektivat e planit të mbarështimit të zonës së kërkuar;

b) të jenë në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe/ose planin e detajuar vendor për zonën, në rast se ka;

c) të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm për pyjet;

ç) të mos cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike.

2. Përfituesi i shërbimit, që kërkon të përfitojë nga shërbimet në ekosistem, paraqet në çdo rast një kërkesë me shkrim pranë ofruesit të shërbimeve, të paktën 3 (tre) muaj përpara fillimit të ofrimit të shërbimeve në ekosistem.

Në rastin kur ofruesi është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, kërkesa i drejtohet strukturës përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe vlerësohet sipas legjislacionit të posaçëm për zonat e mbrojtura.

3. Në rastin e fondit pyjor privat, kërkesa i drejtohet pronarit privat të pyllit, i cili, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, ia përcjell kërkesën me shkrim bashkisë përkatëse, brenda kufijve territorialë administrativë të së cilës ndodhet fondi pyjor në pronësi private.

4. Kërkesa shoqërohet me informacionin e nevojshëm, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Kërkesa paraqitet në formën e propozimit dhe shoqërohet me një studim, i cili përmban:

a) sipërfaqen (territorin) e fondit pyjor kombëtar të shprehur në metër katror (m^2), me kufij të përcaktuar qartë, si dhe koordinatat gjeografike në përputhje me standardin kombëtar;

b) përdorimin e tokës në sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar të njehsuar (m^2), ekonominë pyjore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat etj.;

c) treguesit identifikues (kadastralë) të ngastrave e nënngastrave;

ç) treguesit tekniko-ekonomikë;

d) treguesit tekniko-ekonomikë për kullotat e livadhet;

dh) sipas rastit, studime të detajuara për erozionin, ndërtimin e modelit hidrologjik, në rast se ka;

e) aktin e miratimit të planit të mbarështimit për sipërfaqen që preket nga ofrimi i shërbimit.

6. Për vlerësimin dhe miratimin e kërkesës për ofrimin e shërbimeve në ekosistem nga bashkia nëpërmjet strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki (në vijim SPPB) zbatohen rregullat, si më poshtë vijon:

a) SPPB-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson nëse janë në përputhje me parashikimet e planit të mbarështimit dhe të legjislacionit në fuqi për pyjet;

b) në rast se konstaton se kërkesa e paraqitur nga përfituesi nuk përmban informacionin sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, njofton subjektin përfitues për plotësimin e dokumentacionit apo të pasaktësive, brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera;

c) në rast se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti përfitues është në përputhje me parashikimet e këtij kreu, SPPB-ja vlerëson dokumentacionin dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës apo nga data e plotësimit të dokumentacionit, sipas shkronjës "b", i propozon kryetarit të bashkisë përkatëse miratimin në parim të kërkesës;

ç) kur kryetari i bashkisë shpreh paraprakisht dakordësinë, studimi i përcillet AKP-së, e cila brenda 10 (dhjetë) ditëve i përgjigjet bashkisë me aktin e miratimit ose e kthen projektin me propozime konkrete për saktësime dhe plotësime;

d) në rastin e kthimit të studimit, SPPB-ja ia përcjell menjëherë studimin për plotësimet e nevojshme kërkuesit, i cili brenda 10 (dhjetë) ditëve e rregullon dhe plotëson atë dhe e përcjell në bashki;

dh) SPPB-ja me marrjen e studimit të saktësuar e përcjell për miratim tek AKP-ja, e cila brenda 10 (dhjetë) ditëve i përgjigjet bashkisë me aktin e miratimit;

e) pas miratimit të AKP-së, kryetari i bashkisë ose personi i autorizuar prej tij nënshkruan me subjektin përfitues kontratën me shkrim për ofrimin e shërbimeve në ekosistem.

7. Për fondin pyjor privat, kërkesa dhe studimi shqyrtohen e miratohen nga SPPB-ja dhe, pas këtij miratimi, pronari privat lidh marrëveshjen me përfituesin e shërbimit. Njëkohësisht, SPPB-ja

njofton AKP-në për miratimin e kërkesës dhe studimin përkatës.

III. RREGULLAT PËR KOMPENSIMIN DHE PAGESAT NGA SHFRYTËZIMI I SHËRBIMEVE TË EKOSISTEMIT PYJOR

1. Përfituesi i shërbimit, për të cilin është miratuar kryerja e shërbimeve në ekosistem, kompenson ose kryen pagesat përkatëse ndaj ofruesit të shërbimit, sipas përcaktimeve në marrëveshjen midis tyre.

2. Ofruesi i shërbimit kompensohet për shërbimet në ekosistem nga përfituesi përmes kryerjes së veprimtarive të nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve të ekosistemit në pronësi të tij, që përfshin rehabilitimin e ekosistemit pyjor, mbrojtjen, përmirësimin dhe rigjenerimin e sipërfaqes pyjore ose kompensohet në terma financiarë nga përfituesi, për fitimin e munguar për ofruesin e shërbimit, si rezultat i mosshfrytëzimit dhe mospërdorimit të sipërfaqes pyjore, ku do të ofrohen shërbimet në ekosistem.

3. Në rast se përfituesi nuk kryen kompensimin sipas pikës 2, të këtij kreu, kryen pagesën tek ofruesi i shërbimit, ku përfshihet pagesa për shpenzimet e mëposhtme:

a) shpenzimet për investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin);

b) shpenzimet për kryerjen e projekteve tekniko-ekonomike të ndërhyrjeve;

c) shpenzimet e kryera për mbrojtjen e tokës;

ç) shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse;

d) vlerën e burimeve natyrore pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (flora spontane (BMET), fauna e egër, kullota, lënda drusore etj.;

dh) kostot e vazhdueshme për menaxhimin dhe monitorimin, kryerjen e shërbimeve kulturale në ekosistem, në përputhje me parashikimet e kontratës së nënshkruar mes palëve, sipas përcaktimeve të pikës 7, të kreut II, të këtij vendimi;

e) shpenzimet për kryerjen në mënyrë periodike të veprimtarive të nevojshme, për ofrimin e shërbimeve në ekosistem, sipas parashikimeve të këtij vendimi;

4. Kompensimi, pagesat, vlera, sasia dhe periodiciteti i kryerjes së tyre përcaktohen në modalitetet e përshkruara në marrëveshjen dypalëshe, të lidhura midis ofruesit të shërbimit dhe përfituesit të shërbimit. Llogaritja e kostove për kompensimin apo pagesat kryhet mbi bazën e parimit të fitimit të munguar për produkte apo asortimente drusore dhe jodrusore, që ofruesi i shërbimit konservon për shkak të kërkesës nga përfituesi i shërbimit, referuar tarifave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Kompensimi apo pagesa totale, që përfituesi i shërbimit i paguan ofruesit të shërbimit, kur ofrues është bashkia apo pronari privat, duhet të jetë në përputhje me studimin tekniko-ekonomik.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
FORMULARI I KËRKESËS

KËRKESË
PËR PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE TË EKOSISTEMIT PYJOR

Kryetarit të Bashkisë_____, strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki (SPPB) / ose pronarit privat të sipërfaqes pyjore_____

Subjekti/Enti_____ (përfituesi i shërbimit),, i përfaqësuar nga_____, me ID _____, i datëlindjes me adresë _____, nr. telefoni_____, kërkoj të përfitoj nga shërbimet e ekosistemit pyjor, pjesë e ekonomisë pyjore_____, në vendin e quajtur _____ me numër ngastrash_____ dhe sipërfaqe _____ , kufizimet natyrore_____

dhe koordinatat _____, në përputhje me planin e mbarështimit, të miratuar në _____, me këto specifikime:

a) mundësinë për të përfituar nga shërbimet e ekosistemit të mësipërm _____

b) kryerjen e veprimtarive që propozohen të kryhen në sipërfaqen e ekosistemit pyjor:
- kryerjen e pyllëzimeve _____ha;
- ruajtjen e sipërfaqes pyjore _____ha.
c) afatin kohor të planifikuar për të përfituar nga shërbimet e ekosistemit _____vjet.

☐ Dokumente bashkëlidhur:

☐ Kopje të shkresës së miratimit të planit të mbarështimit;

☐ Projektet tekniko-ekonomike të ndërhyrjeve që parashikohen të kryhen, të hartuara nga specialistë pyjesh, të licencuar për veprimtaritë që do të kryhen në fondin pyjor, të kërkuar për përfitim nga shërbimet e ekosistemit;

☐ Harta e shkallës 1:25000 të ngastrës ose nënngastrës kur është fond pyjor publik, si dhe vërtetim për pronësinë nga institucionet përgjegjëse kur është fond pyjor në pronësi private;

☐ Studime të detajuara për erozionin, ndërtimin e modelit hidrologjik, të miratuara, në rast se ka.

Kërkuesi
_____
Firma

Datë
____. ___.___

VENDIM
Nr. 16, datë 11.1.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2024–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, sipas tekstit dhe shtojcës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ngarkohet të bashkërendojë zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 me ministrat dhe/ose drejtuesit e institucioneve përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), si dhe negociatorin përgjegjës të secilit kriter dhe/ose kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

3. Negociatori përgjegjës për kriterin dhe/ose kapitullin e *acquis* të Bashkimit Evropian, i caktuar sipas parashikimeve të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, raporton në mënyrë periodike pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026.

4. Vendimi nr. 122, datë 1.3.2023, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2023–2025", shfuqizohet.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2024–2026
Janar 2024

Përmbledhje

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian mbetet objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisës ka përcaktuar se "*Europa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë*".[34]

Integrimi Evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i integrimit në BE përfaqëson mbështetjen për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit të plotë.

Vizioni dhe objektivat strategjikë kombëtarë për Integrimin Evropian përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2024–2026. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë për periudhën 2024–2026 është "*Shqipëria 2030: Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut*"[35]. Ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë transformimin e gjithanshëm të Shqipërisë drejt një vendi me standarde që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Procesi i negociatave dhe, më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesë më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përqasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies, konvergjencës dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian[36]. Pika 1 e tij përcakton "Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

22	SASPAC	N/A	Metodologjia për rortilen e kapacitetieve	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëzim i Kryeministrit "Për miratimin e Metodologjisë për rortilen e kapacitetieve në institucionet qendrore dhe vendore dhe të mbuluar Objektivat e Politikave të Kohezionit"	Metodologjia për rortilen e kapacitetieve në nivel qendror dhe bilal sipas objektivave specifike të politikës së kohezionit, bazuar në kateorizimin e detyrave/aktiviteteve si: - Përgatitja e dokumenteve strategjike dhe planifikuese (strategjike dhe planeve të veprimit, etj.) për zbatimin e programeve; - Përvojë në zbatimin e masave dhe ndërhyrjeve të ndryshme në dokumentet strategjike, planifikuese dhe zmonsmuese; - Përvojë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, komoditi dhe vlerësimit të dokumenteve strategjike, planifikuese dhe zmonsmuese; - Eksperienca në përgatitjen e dokumenteve për miratimi e. Sllemës së Ndihmës Shtetërore apo investimeve	Udhëzim	N/A	SASPAC	2024	Q2	Buxheti shtetë	2,280						
22	SASPAC	N/A	Metodologjia për zbatimin e Partnerit të Partnerëritë	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëzim i Kryeministrit "Për miratimin e Metodologjisë për zbatimin e Partnerit të Partnerëritë në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partnerësitë"	Metodologja për zbatimin e Partnerit të Partnerëritë, në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partnerësitë	Udhëzim	N/A	SASPAC	2024	Q3	Buxheti shtetë	1,040						
22	SASPAC	N/A	Zbatimi i mekanizmave për zhvillimin territorial	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektudhëzim i Ministrit të Ministrave "Udhëzimiforyesi për zbatimin e mekanizmave të rezvojtimin për zhvillimin territorial"	Ngritja e strukturave dhe kapacitetave për përfshirë e fondeve strukturore.	VKM	N/A	SASPAC	2025	Q1	Buxheti shtetë		780					
22	SASPAC	N/A	Bordet monitoruese	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëzim i Kryeministrit "Për Krijimin e Bordit të Monitorimit për Zhvillimin Rajonal"	Krijimi i Bordave Monitoruese Rajonale për Zhvillimin Rajonal	Udhëzim	N/A	MSHPV	2025	Q1	Buxheti shtetë		780					
22	SASPAC	N/A	Metodologjia për kontrollimet financiare	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëzim i Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë "Mbi metodologjinë për kontrollimet financiare në raste kur shkaktimet e dëftuara në Komisionin Evropian gjenden të parregullta"	Metodologjia për kontrollimet financiare kur shkaktimet e dëftuara në Komisionin Evropian janë gjetur të parregullta.	Udhëzim	N/A	MFE	2025	Q2	Buxheti shtetë		780					
22	SASPAC	N/A	Trupi Koordinues	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëzim i Kryeministrit "Për krijimin e një strukture koordinuese me Komisionin, raportuese dhe koordinuese për aktivitetet e aktiviteteve e autoriteteve programuese"	Krijimi i një Trupi Koordinues me Komisionin, për ti ofruar atij informacion dhe për të koordinuar aktivitetet e Autoriteteve Programuese	Udhëzim	N/A	SASPAC	2025	Q3	Buxheti shtetë		380					
22	SASPAC	N/A	Planet Rajonale	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektamendim i Këshillit të Ministrave "Planet Rajonale të Zhvillimit të Kohezionit"	Përcaktimi i nevojave për investime me qëllim ulim e pabarazisë në këto rajone në përputhje me parimet Evropiane dhe kombëtare të zhvillimit rajonal	VKM	N/A	MSHPV	2025	Q3	Buxheti shtetë		2,280					
22	SASPAC	N/A	Udhëmirësi	Rregullorja (BE) 2021/1059 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 mbi disponitë specifike për qëllimin e bashkëpunimit territorial evropian (Interreg) të mbështetur nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal dhe instrumentet e financimit të jashtëm	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1059/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektudhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC "Udhëmirësi mbi procedurën e përzgjedhjes së Autoriteti Menaxhues të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar "	Procedura e përzgjedhjes si Autoriteti Menaxhues i një programi bashkëpunimi ndërkufitar që do të shtrihejë si një udhëtim për të fituar kompetencat e nevojshme të Autoriteti Menaxhues për të zbatuar në politikën e kohezionit të pasmërtë.sa në Rregulloren 2021/1060 (Rregullore CPR)	Udhëzim	N/A	SASPAC	2025	Q3	Buxheti shtetë		390					
22	SASPAC	N/A	Politika e Kohezionit	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave"Udhëzimiforyesi për Norrilen e Kasaciteteve Administrative për Politikën e Kohezionit"	Mbështetja i Udhëmirësisë për ligjrigjen e Kapaciteteve Administrative që do u shërbejë të gjitha institucioneve shqiptare që do të përfshihen në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të Politikës së Kohezionit në përputhje me Rregulloren 2021/1060 (Rregullore CPR).	VKM	N/A	SASPAC	2025	Q3	Buxheti shtetë		390					
22	SASPAC	N/A	Ndrika e kuadrit të performancës	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektudhëzim i Kryeministrit "Mirratimi i Udhëmirësisë për norrilen e kuadrit të performancës"	Krijimi i komisionit të performancës e cila do të kojë monitorim, raportim dhe vlerësimin e performancës gjatë implementimit të programeve strukturore në përputhje me Rregulloren 2021/1060 (Rregullore CPR)	Udhëzim	N/A	SASPAC	2026	Q1	Buxheti shtetë			2,280				
22	SASPAC	N/A	Plani i Veprimit Kombëtar	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektamendim i Këshillit të Ministrave"Mirratimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal"	Në zbatim dhe përgjithë me politikat rajonale aktuale dhe të ardhshme të BE-së dhe kuadrin ligjor përkatës të BE-së	VKM	N/A	FSHZH	2024	Q2	Buxheti shtetë	16,800						
22	SASPAC	N/A	Kuadri institucional	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektamendim i Këshillit të Ministrave "Mirratimi i Komitetit Institucionale për zbatimin e Politikës së Kohezionit 2021-2027"	Përgatitja e komitetit Institucionale për zbatimin e Politikës së Kohezionit, duke përfshirë propozimin për ngritjen e sistemit (autoritetit koordinues, programit dhe programet operacionale, autoritetet menaxhuese, implementuese, certifikuese, audituese, si dhe autoritetet zbatuese sektoriale), duke ndryshur në konsideratë sistemet e ngjashme në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe rolin dhe detyrat tuma kundrtuar dhe në përputhje me Rregulloren 2021/1060 (Rregullore CPR).	VKM	N/A	SASPAC	2026	Q3	Buxheti shtetë			2,280				
22	SASPAC	N/A	Indikatorë performues të rëpërhitzuar	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektudhëzim i Kryeministrit"Miratimi i masave të rëpërhitzuara për zbatimin e politikës së kohezionit"	Masat e rëpërhitzuara për zbatimin e politikës së kohezionit, duke përfshirë metodologjitë kombëtare për opsionet e kostove të rëpërhitzuara	Udhëzim	N/A	MFE	2026	Q3	Buxheti shtetë			760				
22	SASPAC	N/A	Programi Operacional	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 së përcaktон dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Politike dhe Ligjore	Projektamendim i Këshillit të Ministrave "Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit"	Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit	VKM	N/A	FSHZH	2024	Q2	Buxheti shtetë	16,800						

				Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.																		
22	SASPAC	N/A	Autoritet menaxhues	Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 24 qershor 2021 që përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit, Fondin Detar të Peshkimit dhe të Akuakulturës dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.	http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1060/oj	Institucionale dhe Administrative	Projektaxhënës i Këshillit të Ministrave "Për sërcaktimin e rregullave të ofrueszimit dhe funksionimit të Autoritetit Menaxhues si dhe të organeve të ndërmjetme, kritereve që duhet të plotësojnë këto organe të ndërmjetme, mënyrën së përzgjedhjes së tyre nga Autoriteti Menaxhues si dhe rregullat e përgjithshme të aranzimit përkatës të menaxhimit dhe kontrollit të proceurarit operacional dhe të kontrollit për zbatimin e funksionit të fokusuar të procurarit nga aziendat"	Përcaktimi i rregullave të detajuara për funksionimin e autoritetit menaxhues, përfshirë funksionet zbatuese dhe mbikqyrëse si dhe rregullat e përgjithshme për sistemin e menaxhimit e të kontrollit të procurarit operacional të zbatimit nga aziendat	VKM	N/A	FSHZH	2024	Q2	Buxhet shtesë	3,300						
30	MFE	Politika e Përbashkët Tregtare	Kontrolli i eksporteve	02021R0821-20230512 - Rregullorja (BE) 2021/821 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2021 që vendos një regjim të Bashkimit për kontrollin e eksportimeve, ndërmjetësimit, asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të artikujve me përdorim të dyfishtë.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02021R0821-20230526	Politike dhe Ligjore	Projektligj për ndryshimin e ligjit nr. 46/2018 "Për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë"	Ligj	I ndërlidhshëm i lartë (e përcaktuar)	MM	2026	Q3	Buxhet shtesë			150,000				
30	MFE	Politika e Përbashkët Tregtare	Mallrat me përdorim të dyfishtë	Rregullorja e delegueit e Komisionit (BE) 2022/66 e datës 21 tetor 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) 2021/821 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me listën e artikujve me përdorim të dyfishtë	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.L_.2022.009.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AL%3A2022%3A009%3ATOC	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Këshillit të Ministrave "Për përditësimin e listës së mallrave me përdorim të dyfishtë dhe ushtarak"	VKM	E pësh (e përpunhyrë)	MM	2024	Q3	Buxhet shtesë	100,000						
30	MFE	Marrëdhëniet me Jashtë	Politika e Veçantë të Jashtëm dhe Politika Humanitare	Rekomandimet e Procesi Rasorit të Komisionit Evropian mr. Shtatorine te viti 2022 dhe 2023	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:31996R1257	Zbatuese dhe investime	Zbatimi i Udhrit të Kryeministrit nr. 194, datë 8.11.2023 për "Ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e kuadrit rregullator për bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim dhe ndihmë humanitare",	N/A	N/A	MEPJ	2024	Q3	Buxhet shtesë	1,750						
				Rregullorja (EC) Nr. 1257/96 e 20 Qershorit 2036 per ndihmat humanitare OJ L 163, 2.7.1996, p. 1-6																			
31	MEPJ	N/A	Informacioni i klasifikuar	Vendimi Këshillit 2013/488 i datës 23 shtator 2013 ne lidhje me regullat e sigurise per mbrojtjen e informacionit te klasifikuar	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013D0488	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatorve të tjera ndërkombëtare"	VKM	E pësh (e përpunhyrë)	AKSIK	2024	Q1	Buxhet shtesë	100						
31	MEPJ	N/A	Informacioni i klasifikuar	Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Bashkimit Evropian per procedurat e sigurise per shkembimin dhe mbrojtjen e informacionit te klasifikuar	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0219(01	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores për klasifikimin, punën, transmetimin fizik, dekasifikimin, zhvillesimin, auditimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", NATO, BE, shtetave dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"	VKM	E pësh (e përpunhyrë)	AKSIK	2024	Q1	Buxhet shtesë	200						
31	MEPJ	Politika e Përbashkët Tregtare	Mallrat me përdorim të dyfishtë	Pakoari e mbulsare nga Pozicioni I Perbashkët I Këshillit 2008/944/CFSP së zatecatim mesullat e aërbashkëta ati rmeuBsnë kontrollin e eksportmn të teknzlozisë dhe zaisienar ushtarakri (përdhlsimi dhe zvlverdsimi i Lsstis së Perbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian të mirakuar nga Këshilli më 21 shkurt 2022)	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022AG0361(01)	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Këshillit të Ministrave "Për sërcdhimin e listës së mallrave ushtarake dhe artikujve me përdorim të dyfishtë"	VKM	E pësh (e përpunhyrë)	MM	2024	Q3	Buxhet shtesë	100						
33	MFE	Burimet e veta GNI	Të ardhurat Kombëtare Bruto - Burimet e veta	Rezolucione i BE Nr. 540/2013 E Parlamentit Evropian dhe Këshillite datës 21 maj 2013 mbi Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian (Teksti me rëndësinë e ZEE)	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32013R0549	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Drejtorit të Përgjithshëm mbi statistikat, strukturën, aerodicitetin dhe shenimin e treguesve të cilesisë mbi të dhënat e transmetuara në Eurostat.	Udhëzim	I ndërlidhshëm i lartë (e përcaktuar)	INSTAT	2025	Q3	Buxhet shtesë		2,444					
33	MFE	Burimet e veta GNI	Të ardhurat Kombëtare Bruto - Burimet e veta	Rregullorja (BE) 2019/516 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 për harmonizimin e të ardhurave kombëtare bruto me çmimet e tregut dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 89/130/EEC, Euratom dhe Rregullores së Këshillit (KE, Euratom) Nr 1287 /2003 (Rrevalloria e GNI) (Teksti me rëndësi për ZEE-në)	https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/516/oj	Politike dhe Ligjore	Projektaxhënës i Drejtorit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Rregullores 1889/2002, në lidhje me shpërndarjen e ekëndrimeve të ndërmjetsimit financiar të mallrat në mënyrë indirekte (RSIM) brenda Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010)	Udhëzim	I ndërlidhshëm i lartë (e përcaktuar)	INSTAT	2026	Q3	Buxhet shtesë			2,444				

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 34 , datë 29.12.2023

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT NGA TJETËRSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 70, pika 3, të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

UDHËZOJNË:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve, procedurave dhe metodologjisë për zbatimin e parashikimeve të nenit 17, "Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme", të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

2. Objekti

Ky udhëzim zbatohet për individët dhe personat e tjerë fizikë të përcaktuar në paragrafin 3, si më poshtë, me qëllim llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale që rrjedhin nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme.

3. Raste përjashtimore

3.1 Nuk janë subjekte "të tatimit mbi të ardhurat personale" nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme:

a) sipërmarrësit (ndërtuesit) në fushën e ndërtimit, të regjistruar si biznes në QKB, pavarësisht nga statusi ("person juridik" apo "person fizik tregtar"), të cilët e kanë pjesë të veprimtarisë së tyre ekonomike dhe që ndërtojnë për qëllim shitjeje apo dhënie me qira;

b) investitorët në fushën e ndërtimit, të cilët financojnë produktin e ndërtimit me qëllim shitjeje, në rastet kur janë të regjistruar për qëllime biznesi në QKB (janë të pajisur me NIPT) dhe u është caktuar përgjegjësia tatimore.

3.2 Subjektet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", paragrafi 3.1 më sipër, janë pagues, të:

a) taksës vendore mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve në nenin 28, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar;

b) tatimit sipas dispozitave të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat".

3.3 Me qëllim eliminimin e mundësive për shmangie të tatimit dhe të abuzimit me parimet e ligjit tatimor, paguajnë tatim mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, personat e mëposhtëm:

a) investitorët në fushën e ndërtimit, të cilët financojnë produktin e ndërtimit, me qëllim shitjeje në rastet kur nuk janë të regjistruar në QKB dhe në administratën tatimore (nuk janë të pajisur me NIPT) dhe nuk u është caktuar përgjegjësia tatimore;

b) personat fizikë tregtarë, të cilët lejen e ndërtimit, të shfrytëzimit/përdorimit dhe regjistrimin e ndërtimeve e përfitojnë në emrin e tyre si individë, pavarësisht se në momentin që fillojnë shitjen e produktit të ndërtimit, pajisen me NIPT, "person fizik" apo pavarësisht se më pas e mbyllin NIPT-in dhe vazhdojnë shitjet po si individë.

4. Përkufizime:

a) me termin *"tjetërsim i pasurisë së paluajtshme"*, kuptohet akti i shitjes (kontrata e shitjes), shkëmbimit midis individëve, dhurimit, trashëgimisë apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme;

b) me termin "*fitim kapital i realizuar"*, kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme tokë dhe/ose ndërtesë. Në rastet kur kjo diferencë rezulton negative, atëherë fitimi kapital do të konsiderohet zero në çdo transaksion.

KAPITULLI II
TATIMI I FITIMIT KAPITAL NGA TJETËRSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

1. Të ardhurat e tatueshme nga investimi për shkak të tjetërsimit të pasurive të paluajtshme, tokë dhe ndërtesë, tatohet me normën 15 për qind të fitimit kapital të realizuar. Individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, paguan tatimin para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të pasurisë, në përputhje me aktet dhe procedurat ligjore në fuqi. Vetëm në rastet e dhurimit, trashëgimisë apo heqjes dorë nga pasuria e

paluajtshme, tatimi paguhet nga individi që përfiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Pasuria e paluajtshme, nuk regjistrohet në favor të përfituesit, pa provuar pagimin e këtij detyrimi pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK).

2. Vlera në shitje e pasurisë së paluajtshme

Vlera në shitje e pasurisë së paluajtshme përcaktohet në varësi të procesit, që ndiqet për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme.

2.1 Në rastet e shitjes me kontratë noteriale, vlera në shitje e pasurisë përcaktohet në kontratën e shitjes, e cila është nënshkruar nga palët (shitësi dhe blerësi). Kontrata shpreh sipërfaqen në metër katror të pasurisë objekt të kontratës, çmimin për metër katror dhe vlerën e saj. Kontrata shoqërohet me certifikatë/vërtetim pronësie, kartelë, hartën, planimetrinë dhe dokumentet e tjera, që shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit të fushës. Vlera në shitje e përcaktuar në kontratë krahasohet me çmimet e referencës për pasurinë e paluajtshme ndërtesat dhe sipas hartës së vlerave për pasurinë e paluajtshme tokë, siç përcaktohet në paragrafët në vijim.

Në rastin e ndërtesave, kjo vlerë në shitje, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, do të krahasohet me çmimet e referencës. Në rastet kur vlera e pasurisë sipas çmimit të shitjes për metër katror (m^2) të përcaktuar në kontratë është më e ulët se vlera sipas çmimeve referuese, atëherë si çmim i supozuar shitje do të merret në konsideratë çmimi i referencës së zonës/qytetit. Çmimeve të referencës, do t'i zbritet 1% e vlerës për çdo vit të plotë shtesë përdorimi, duke filluar nga data e fitimit të titullit të pronësisë për herë të parë. Zbritja prej 1% do të aplikohet për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme të cituara në germat "a" deri në "dh" të kësaj pike. Kjo zbritje nuk duhet të jetë më e madhe se 30% e çmimit të referencës të përcaktuar në aneksin nr. 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 7.3.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".

2.1.1 Në rastet e shitjes së ndërtesave (përjashtuar apartamentet dhe ndërtimet e përfituara me legalizim) me koeficient amortizimi mbi 50%, vlera e shitjes së pasurisë së paluajtshme për efekt të tatimit do të përcaktohet nga persona të licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, dhe do të merren parasysh nga ASHK-ja vetëm një herë (për një transaksion të realizuar). Në rastet kur vlera e ndërtesës e vlerësuar nga një ekspert vlerësues i licencuar është më e vogël se gjysma e vlerës e përcaktuar sipas çmimeve referuese, për efekt të vlerës në shitje të pasurisë, merret në konsideratë vlera e përcaktuar nga eksperti vlerësues i licencuar.

Në vijim përcaktohet çmimi referencës në varësi të formës së përdorimit dhe llojit të pasurisë së paluajtshme ndërtesa:

a) **Banesat –** çmimi i referencës së një banese përcaktohet bazuar në çmimet e referencës të parashikuara në aneksin nr. 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 7.3.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës dhe vjetërsinë e ndërtesës.

Për apartamentet e banimit në ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, çmimi për metër katror është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë. Në këtë rast, zbritja prej 1% e vlerës për çdo vit përdorimi nuk aplikohet.

Shembull nr. 1 – Vlera në shitje e banesës me kontratë shitje	
Individi AA i shet individit BB një apartament banimi, i cili ndodhet në qytetin e Tiranës, në njësinë administrative nr. 2, zona 2/4. Ku apartament ka një sipërfaqe prej 75 m^2, dhe viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2004. Apartamenti shitet me kontratën e shitjes së datës 20 gusht 2024 dhe vlera totale e shitjes së apartamentit të përcaktuar në kontratë është 7,500,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje, gjykojmë mbi llojin e pasurisë që tjetërsohet dhe mbi procesin e tjetërsimit. Duke qenë se kemi të bëjmë me llojin e pronës banesë dhe tjetërsimi i pasurisë ndodh me një kontratë shitje, atëherë për përcaktimin e vlerës në shitje do të krahasojmë çmimin e referencës së apartamentit me vlerën në kontratën e shitjes:

	* Vlera e apartamentit sipas çmimeve të referencës = 75 m² * (120,300 lekë/m² – 1% * 19 vite nga fitimi i titullit të pronësisë për herë të parë * 120,300 lekë/m²) = 7,308,225 lekë *Duke qenë se vlera sipas kontratës së shitjes është më e madhe se ajo sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera më e madhe pra 7,500,000 lekë (vlera në shitje).*

b) **Ndërtesë për veprimtari ekonomike** – çmimi referencë për m^2 sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori, përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.

Shembull nr. 2 – Vlera në shitje e ndërtesës për veprimtari ekonomike me kontratë shitje	
Individi AA, i shet individit BB një dyqan (njësi tregtare), i cili ndodhet në qytetin e Librazhdit. Ky dyqan ka një sipërfaqe prej 60 m² dhe shitet me kontratën e shitjes në datë 15.02.2024, ku përcaktohet dhe vlera totale e shitjes 3,000,000 lekë. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2015.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje, gjykojmë mbi llojin e pasurisë që tjetërsohet dhe mbi procesin e tjetërsimit. Duke qenë se kemi të bëjmë me llojin e pronës ndërtesë për veprimtari ekonomike dhe tjetërsimi i pasurisë ndodh me një kontratë shitje, atëherë për përcaktimin e vlerës në shitje do të krahasojmë çmimin e referencës së dyqanit me vlerën në kontratën e shitjes: * Vlera e dyqanit (njësisë së tregtimit) sipas çmimeve të referencës *= 60 m² x (44,000 lekë/ m²– 1%* 8 vite nga fitimi i titullit të pronësisë për herë të parë * 44,000 lekë/ m²) x 1.5* *= 3,643,200 lekë* *Duke qenë se vlera sipas çmimeve të referencës është me e madhe se ajo sipas kontratës së shitjes, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera më e madhe pra 3,643,200 lekë (vlera në shitje).*

c) **Ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume** – çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

ç) **Ndërtimi për ambiente parkimi të hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura** – çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkimi të hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbolli, minifutbolli, basketbolli, volejbolli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë të ndërtuar që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

d) **Ndërtim i destinuara për veprimtari industriale** – çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objekte të tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë. Në këtë kategori, përfshihen edhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

dh) **Ndërtimi, që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse** – çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi, që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

2.1.2 Në rastin e tjetërsimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën, kjo vlerë në shitje, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, do të krahasohet me çmimin për

metër katror sipërfaqe, të përcaktuar në hartën e vlerave sipas aktit nënligjor në fuqi në datën e lidhjes së kontratës.

Nëse çmimi për metër katror sipërfaqe sipas kontratës së shitjes të tokës, është më i vogël se çmimi për metër katror sipërfaqe, të përcaktuar në hartën e vlerave sipas aktit nënligjor në fuqi në datën e lidhjes së kontratës, për efekt të llogaritjes së tatimit do të merren në konsideratë çmimet sipas hartës së vlerave në fuqi.

Shembull nr. 3 – Vlera në shitje e tjetërsimit të tokës me kontratë shitje	
Individi AA ka përfituar 20,000 m² tokë bujqësore në zonën kadastrale 1271, Bashkia Divjakë, me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", i ndryshuar, me AMTP-në e lëshuar në vitin 1994 (data në AMTP është 2.5.1994). Në kohën e marrjes së tokës, individi AA nuk ka paguar asnjë vlerë në blerje, pasi e ka marrë tokën pa pagesë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Në vitin 2024, ky person ia shet tokën blerësit BB me kontratën e shitblerjes datë 10.1.2024, me vlerën 7,280,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje të tokës bujqësore, krahasojmë çmimin e përcaktuar në hartën e vlerave sipas aktit nënligjor në fuqi në datën e lidhjes së kontratës me vlerën e shitjes të përcaktuar në kontratë. *Vlera e tokës bujqësore, sipas hartës së vlerave* *= 20 000 m² x 364 lekë/m² = 7,280,000 lekë* *Duke qenë se vlera sipas hartës së vlerave është e barabartë me atë sipas kontratës së shitjes, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera sipas kontratës së shitjes 7,280,000 lekë (vlera në shitje).*
Vlera në blerje	Për të llogaritur çmimin minimal të blerjes së tokës, çmimi i shitjes për 364 lekë/ m², pjesëtohet me indeksin e inflacionit sipas vitit përkatës në aneksin nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Konkretisht, për vitin 1994 indeksi është 3.625. Atëherë, vlera në blerje e pasurisë prej 20 000 m² është: (20 000 m² x 364 lekë/ m²) : 3.625 = 2,008,276 lekë
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % (7,280,000 –2,008,276) x 15 % = 790,759 lekë

2.1.3 Në rast të shitjes njëkohësisht të tokës truall dhe ndërtesës brenda këtij trualli, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor, do të llogariten veçmas vlera e detyrimit tatimor nga shitja e ndërtesës, dhe vlera e detyrimit tatimor të shitjes së tokës truall. Duke qenë se llogaritja e detyrimit tatimor bëhet më vete, vlera në shitje në këtë rast do të llogaritet më vete për ndërtesën dhe më vete për tokën truall, sipas parashikimeve të paragrafit 2.1.1 për çmimet e referencës për ndërtesat dhe paragrafit 2.1.2 për çmimet sipas hartës së e vlerave për tokën.

2.2 Në rastet e shkëmbimit të pasurisë së paluajtshme, që ndodhin midis individëve si vlerë në shitje do të konsiderohet vlera e pronës që përfitohet nga procesi i shkëmbimit. Kjo vlerë në shitje e pronës, në rastin e ndërtesave do të jetë sipas çmimeve të referencës të parashikuara në paragrafin 2.1.1 dhe në rastin e përfitimit të tokës do të jetë sipas hartës së vlerave të përcaktuar në paragrafin 2.1.2.

2.3 Në rastet e trashëgimisë, dhurimit dhe heqjes dorë nga pasuria, si vlerë në shitje do të konsiderohet vlera më e madhe ndërmjet vlerës nominale dhe vlerës së tregut të pasurisë së paluajtshme.

Vlerë nominale e pasurisë së paluajtshme, do të konsiderohet vlera e fundit mbi të cilën është llogaritur tatim pranë organit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Për ndërtesat në rast se nuk ka një vlerë mbi të cilin është paguar tatim, vlera nominale do të konsiderohet kosto e shfrytëzimit në vitin e regjistrimit të aktit në regjistrin kadastral.

Vlera e tregut do të konsiderohet vlera e pasurisë sipas çmimeve të referencës të parashikuar në paragrafin 2.1.1 për ndërtesat dhe në rastin e përfitimit të tokës do të jetë sipas hartës së vlerave sipas parashikimeve të paragrafit 2.1.2.

3. Vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme

3.1 Vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme, të përfituar me një transaksion (qoftë kontratë blerje, shkëmbim, trashëgimi, dhuratë, heqje dorë apo rivlerësim i pasurisë së paluajtshme), për të cilin është

llogaritur tatimi dhe ky akt është regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, atëherë vlera në blerje do të jetë vlera sipas regjistrimit të fundit të kësaj pasurie mbi të cilën është llogaritur tatimi. Kjo vlerë, në rast se ekziston në akt tjetërsimi pasurie, i mundësohet noterëve gjatë kërkesës për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga organi kompetent për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme.

3.2 Në rastet kur nuk mund të përcaktojmë një vlerë në blerje sipas parashikimeve të paragrafit 3, atëherë vlera në blerje do të jetë si në vijim:

a) Për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara në DVASHK, të cilat nuk kanë vlerë në blerje sipas parashikimeve të paragrafit 3, ose vlera e blerjes është e shprehur në monedha të tilla, si franga ari, apo napolona floriri, si dhe për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, për efekt të përcaktimit të tatimit mbi kalimin e së drejtës së pronësisë, si vlerë në blerje (vlera e zbritshme) do të merret kosto e shfrytëzimit për metër katrorë e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi për Entin Kombëtar të Banesave, në vitin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

Nëse në rastet e trashëgimisë, dhuratave apo heqjes dorë për të cilat nuk ka qenë regjistruar vlerë e pronës, si vit për llogaritjen e kostove të shfrytëzimit do të merret data e regjistrimit të aktit.

Shembull nr. 4 – Vlera në blerje e ndërtesave të ndërtuara dhe të regjistruara në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), të cilat nuk kanë vlerë në blerje	
Individi AA, banues në Gjirokastër, ka në pronësi një apartament banimi me sipërfaqe 120 m² të përfituar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, dhe të regjistruar në DVASHK në vitin 1999. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 1999. Në vitin 2024, individi AA ia shet apartamentin individit BB me vlerën 4 300 000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje të banesës, krahasojmë vlerën e shitjes sipas kontratës, me çmimet e referencës për banesat. **Meqenëse ky apartament është përfituara me anë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, dhe jemi në rastin e shitjes së parë, çmimi i referencës për metër katror është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të referencës së zonës.* *Vlera në shitje e apartamentit që do të shesë individi AA, sipas çmimeve të referencës (viti 2024) është:* *120 m² x 47,400 lekë/ m² x 50 % = 2,844,000 lekë* *Duke qenë se vlera në shitje sipas kontratës është më e madhe se ajo sipas çmimeve të referencës, atëherë për llogaritjen e tatimit do të marrim si vlerë në shitje, vlerën sipas kontratës së shitjes, pra 4,300,000 lekë (Vlera në shitje).*
Vlera në blerje	*Duke qenë se nuk mund të përcaktojmë një vlerë në blerje sipas dispozitave të paragrafit 3.1, atëherë për përcaktimin e vlerës në blerje bazohemi në dispozitat e paragrafit 3.2, germa "a". Pra, si vlerë në zbritje do të marrim vlerën sipas kostos së shfrytëzimit, përcaktuar nga EKB-ja për vitin në të cilin individi AA e ka regjistruar apartamentin në pronësinë e tij (viti 1999):* *120 m² x 35 724 lekë/ m²= 4,286,880 lekë*
Tatimi i llogaritur	Tatimi, që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % (4,300,000 – 4,286,880) x 15 % = 1,968 lekë

b) Për tokën, nëse nuk kemi një vlerë në blerje sipas parashikimeve të paragrafit 3, si vlerë në blerje do të merret vlera e llogaritur duke përdorur indeksimin e çmimit të tokës sipas hartës së vlerave, me inflacionin mesatar vjetor të llogaritur për vitin në të cilin është fituar pronësia (aneksi nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi të përbashkët).

3.3. Në rast se kontrata paraardhëse e blerjes është kryer në monedhë të huaj (dollarë, euro etj.) kryhet konvertimi në lekë me kursin e ditës në të cilën është kryer kjo blerje.

4. Tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme në rastet e dhurimit, heqjes dorë dhe trashëgimisë

4.1 Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit dhe trashëgimisë, sipas dispozitave të kreut VI të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ose heqjes dorë nga e drejta e pronësisë në dobi të një të treti apo të bashkëpronarëve të tjerë, transaksioni konsiderohet i tatueshëm dhe për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor do të veprohet si në rastin e kalimit të së drejtës së

pronësisë, tokë dhe ndërtesë, nëpërmjet aktit të shitjes.

Raporti i vlerësimit për pasurinë e dhuruar apo hequr dorë prej saj nuk është detyrues për t'u paraqitur në dokumentacionin për kalimin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit, apo heqjes dorë. Vlera e pasurive e pasqyruar në këto raporte, si dhe në kontratat e dhurimit apo shkëmbimit, nuk është referuese për llogaritjen e fitimit kapital të realizuar.

4.2 Përjashtohen nga tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme:

a) dhurimet dhe trashëgimia e përfituar nga/ose ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë në radhë të parë dhe të dytë, sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, si dhe dhurimet dhe trashëgimia brenda lidhjes gjinore motër-vëlla;

b) dhurimet dhe trashëgimitë të marra përveç atyre të përcaktuara në shkronjën "a" deri në 5 000 000 lekë për tatimpagues për pasuritë e paluajtshme;

c) kalimi i së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve ligjorë sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, përkatësisht nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur prona rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar.

Shembull nr. 5 – Vlera në shitje e ndërtesave të dhuruara dhe vlera në blerje e ndërtesave të privatizuara	
Individi AA, Korçë, i dhuron djalit të xhaxhait, individit BB një apartament me sipërfaqe 220 m², me akt dhurimi të datës 15.01.2024. Individi AA e ka përfituar këtë apartament nga privatizimi në vitin 1992, me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, dhe e ka regjistruar në pronësi të tij pranë DVASHK-së në vitin 1999.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje të banesës, në rastet e dhurimit vlera në shitje është e barabartë me vlerën më të madhe ndërmjet vlerës sipas çmimeve të referencës dhe vlerës mbi të cilën dhuruesi ka paguar tatim për këtë pronë. **Meqenëse ky apartament është përfituar me anë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, dhe jemi në rastin e shitjes së parë, çmimi i referencës për metër katror është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të referencës së zonës.* *Vlera në shitje e apartamentit, që do të dhurojë individi AA, sipas çmimeve të referencës (viti 2024) është:* 220 m² x (45,800 lekë/m² x 50%) = 5,038,000 lekë *Duke qenë se dhuratat ndaj kushërinjve nuk janë të përjashtuara (kreu VI, ligji 29/2023), dhe njëkohësisht vlera e pasurisë së paluajtshme është më e madhe se 5,000,000 lekë, atëherë për këtë pasuri do të llogaritet tatim. Meqenëse kjo pronë do të dhurohet, si vlerë në shitje do të jetë vlera sipas çmimit të referencës prej 5,038,000 lekë (Vlera në shitje).*
Vlera në blerje	Vlera në blerje për apartamentin e përfituar nga privatizimi me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, dhe që shitet (dhurohet) për herë të parë, është e barabartë me vlerën sipas kostos së shfrytëzimit për m² të vitit në të cilin është regjistruar pasuria në DVASHK (kosto e vitit 1999). Kostoja e shfrytëzimit për qytetin e Korçës në vitin 1999 është 25,145 lekë/m². Atëherë, vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme është: 220 m² x 25,145 = 5,531,900 lekë
Tatimi i llogaritur	*Tatimi që duhet të paguajë përfituesi BB është:* (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (5,038,000 – 5,531,900) x 15 % = 0 lekë Në këtë rast tatimi është 0 lekë duke qenë se vlera në shitje është më e vogël se vlera në blerje.

Shembull nr. 6 – Vlera në shitje e ndërtesave të përfituara nga heqja dorë
Individët AA, BB dhe CC, me banim në qytetin e Kavajës, kanë në pronësi të tyre me nga 1/3 pjesë takuese secilit, një dyqan me sipërfaqe 90 m², të blerë në vitin 1995, me shumën gjithsej 900,000 lekë, shumë për të cilën është llogaritur dhe tatim. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 1992. Në datën 20.03.2024, individi AA kërkon përpara noterit që të heqë dorë nga pronësia e tij në këtë dyqan dhe për këtë qëllim do të lëshojë dhe deklaratën noteriale. Kjo pronë, nga e cila është hequr dorë përfitohet në mënyrë të barabartë nga dy bashkëpronarët e tjerë, individi BB dhe individi CC. Pjesa e pronës nga e cila hiqet dorë është 1/3 e dyqanit, pra 90 m² : 3 = 30 m² Sipërfaqja e pronës që përfitohet nga individi BB dhe individi CC është në mënyrë të barabartë, konkretisht: •Individi BB dhe individi CC, përkatësisht secili përfiton sipërfaqen: 30 m² : 2 = 15 m² Duke qenë se e ardhura nga heqja dorë është e tatueshme, individët BB dhe CC, që përfitojnë pjesët takuese përkatësisht

nga 15 m² nga heqja dorë, para se të fitojnë titullin e pronësisë, duhet të llogarisin tatimin.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje të dyqanit të pjesëve përfituese, përcaktojmë vlerën sipas çmimit të referencës së dyqanit për këto pjesë. * Meqenëse viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 1992, pra 31 vite të plota deri në datën e shitjes (20.03.2024), zbritja rezulton 1%*31 vite = 31%. Por, siç parashikohet në këtë udhëzim, kjo zbritje prej 1% e llogaritur për çdo vit të plotë nga fitimi i titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë, nuk duhet të jetë më e madhe se 30% e çmimit të referencës, në këtë rast çmimi i referencës do të zbritet me 30%. *Vlera në shitje e pjesëve takuese të dyqanit që do të përfitojnë individët BB dhe CC, sipas çmimeve të referencës (viti 2024) është:* •*Individi BB* 15 m² x (51,000 lekë/ m² – 30% * 51,000 lekë/ m²)*1.5 = 803,250 lekë •*Individi CC* 15 m² x (51,000 lekë/ m² - 30% * 51,000 lekë/ m²)*1.5 = 803,250 lekë *Si vlerë në shitje për llogaritjen e detyrimeve tatimore, do të konsiderohet vlera sipas çmimeve të referencës, pra 803,250 lekë do të jetë vlera në shitje për individin BB dhe po 803,250 lekë do të jetë vlera në shitje për individin CC.*
Vlera në blerje	Vlera në blerje në këtë rast, duke qenë se dyqani është përfituar nga një kontratë blerje në vitin 1995, për shumën 900,000 lekë për të cilën është llogaritur tatim, për përcaktimin e pjesës takuese llogarisim si në vijim: Vlera në blerje për m² = (900,000 lekë/m²) / (90 m²) = 10,000 lekë m² •Vlera në blerje për individin BB = 15 m² * 10,000 lekë/m² = 150,000 lekë •Vlera në blerje për individin CC = 15 m² * 10,000 lekë/m² = 150,000 lekë
Tatimi i llogaritur	*Tatimi, që duhet të paguajnë përfituesit nga një pronë nga e cila është hequr dorë është:* •Individi BB (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (803,250 lekë – 150,000 lekë) x 15 % = 97,988 lekë •Individi CC (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (803,250 lekë – 150,000 lekë) x 15 % = 97,988 lekë

4.3 Në rastin e shitjes së pasurisë së paluajtshme, tokë dhe/ose ndërtesë, të fituar me trashëgimi dhe vendime gjyqësore, si vlerë në blerje do të konsiderohet:

a) Kur ndërtesa dhe/ose toka kanë vlerë sipas akteve noteriale ose të rivlerësimit të regjistruar në DVASHK, para, gjatë ose pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë, si vlerë në blerje (vlerë e zbritshme) do të merret vlera e ndërtesës dhe/ose tokës sipas këtyre akteve, të regjistruar në DVASHK.

Shembull nr. 7 – Vlera në blerje e ndërtesave të trashëguara, rivlerësuara	
Tre vëllezërit AA, BB dhe CC, banues në Peshkopi, kanë në pronësi të tyre një apartament me sipërfaqe 120 m², të cilin e kanë përfituar me kontratën e shitblerjes, datë 20.05.2017, me vlerën 3,200,000 lekë. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2014. Në datën 05.04.2020, bashkëpronarët, duke përfituar nga ligji për rivlerësimin e pasurisë, bëjnë rivlerësimin e pasurisë së tyre në vlerën 4,800,000 lekë. Në vitin 2024, bashkëpronari AA vdes. Dy bashkëpronarët e tjerë nxjerrin dëshminë e trashëgimisë, të cilën e regjistrojnë po atë vit (2024) në DVASHK. (Trashëgimia ndërmjet vëllezërve sipas kreut VI, të ligjit 29/2023 është e përjashtuar nga llogaritja e tatimit të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.) Në vitin 2024, bashkëpronari BB kërkon t'ia shesë pjesën e tij në bashkëpronësi individit DD me kontratën e shitjes datë 23.01.2024, me vlerën 2,200,000 lekë.	
Vlera në shitje	Vlera në shitje e pjesës që do të shesë individi BB sipas çmimeve të referencës (viti 2024) është: Pjesa në bashkëpronësi e individit BB përbëhet nga: a. Sipërfaqja e përfituar me kontratën e shitblerjes: 1/3 pjesë e 120 m² = 40 m² Vlera në shitje sipas çmimeve të tregut të lirë është: 40 m2 x (49,000 lekë/m² – 1% * 9 vite * 49,000 lekë/m²) = 1,783,600 lekë b. Sipërfaqja e përfituar nga dëshmia e trashëgimisë: 1/6 pjesë e 120 m² = 20 m²

	Vlera në shitje sipas çmimeve të tregut të lire është: 20 m² x (49,000 lekë/m² – 1% * 9 vite * 49,000 lekë/m²)= 891,800 lekë •Vlera totale në shitje është: 1,783,600 lekë + 891,800 lekë = 2,675,400 lekë Duke qenë se vlera sipas çmimeve të referencës është me e madhe se vlera në kontratën e shitjes, atëherë si vlerë në shitje për llogaritjen e detyrimit tatimor marrim vlerën sipas çmimeve të referencës, pra vlerën 2,675,400 lekë.
Vlera në blerje	Duke qenë se veprimi i fundit për të cilën është paguar tatim, i regjistruar në kartelën e pasurisë është rivlerësimi i pronës atëherë si vlerë në blerje është vlera e rivlerësuar e pjesës së pronës që do të shesë bashkëpronari BB. Vlera e blerjes për m²: 4,800,000 lekë : 120 m² = 40,000 lekë/m² Atëherë, vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme është: 40,000 lekë/m² x 60 m² = 2,400,000 lekë
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi BB është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (2,675,400 lekë – 2,400,000 lekë) x 15% = 41,310 lekë

b) Kur ndërtesa nuk ka vlerë të regjistruar në blerje, si vlerë në blerje për pasurinë e paluajtshme ndërtesë, të fituar me trashëgimi, do të merret vlera sipas kostos së shfrytëzimit të vitit në të cilin është regjistruar dëshmia e trashëgimisë.

Shembull nr. 8 – Vlera në blerje e ndërtesave të përfituara nga trashëgimia	
Individi AA, me banim në Fier, ka në pronësi të tij një ndërtesë banimi me sipërfaqe 98 m², pa vlerë të regjistruar në DVASHK, të fituar me dëshmi trashëgimie dhe e regjistruar kjo dëshmi në DVASHK në datën 15.8.2008. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2005. Individi AA kërkon ta shesë këtë pasuri individit BB me kontratën e shitjes datë 23.01.2024 me vlerën 5,000,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për përcaktimin e vlerës në shitje do të krahasojmë çmimin e referencës në momentin e shitjes së apartamentit me vlerës në kontratën e shitjes: 98 m² x (53,100 lekë/m² – 1% * 18 vite përdorimi * 53,100 lekë/m²) = 4,267,116 lekë Duke qenë se vlera në kontratën e shitjes është më e madhe se vlera sipas çmimeve referuese, si vlerë në shitje për llogaritjen e detyrimit tatimor, do të marrim vlerën në kontratën e shitjes, pra vlerën 5,000,000 lekë.
Vlera në blerje	Vlera në blerje është vlera sipas kostos së shfrytëzimit të vitit 2008, vit në të cilin është regjistruar dëshmia e trashëgimisë, pra vlera 33,499 lekë/m2 Vlera e pasurisë së paluajtshme në blerje është: 98 m² x 33,499 lekë/m² = 3,282,902 lekë
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (5,000,000 lekë – 3,282,902 lekë) x 15 % = 257,565 lekë

c) Për pasurinë e paluajtshme tokë të fituar me trashëgimi, në rastet kur nuk kemi vlerë në blerje sipas parashikimeve të germës "a", të paragrafit 4.3, si vlerë në blerje do të merret vlera e llogaritur duke përdorur indeksimin e çmimit të tokës sipas hartës së vlerave, me inflacionin mesatar vjetor të llogaritur për vitin në të cilin është regjistruar dëshmia e trashëgimisë (aneksi nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi të përbashkët).

Shembull nr. 9 – Vlera në blerje e tokës së përfituara nga trashëgimia	
Individi AA, me banim në njësinë administrative Qerret të rrethit Kavajë në qarkun Durrës, ka përfituar pasuri të paluajtshme tokë bujqësore me sipërfaqe 1 200 m², me akt trashëgimie të vitit 2009, të cilën e ka regjistruar në DVASHK në vitin 2010. Këtë sipërfaqe toke individi AA ia shet individit BB me kontratë shitblerje në datën 23.01.2024, me vlerë 427,200 lekë.	
Vlera në shitje	Për përcaktimin e vlerës në shitje, do të krahasojmë çmimin sipas hartës së vlerave në fuqi në momentin e shitjes së tokës, me vlerës në kontratën e shitjes. Vlera në shitjes sipas hartës së vlerave:

	1,200 m² x 339 lekë/m² = 406,800 lekë Duke qenë se vlera sipas çmimeve të referencës (hartës së vlerave) është më e vogël se vlera në kontratën e shitjes, si vlerë në shitje marrim vlerën në kontratën e shitjes, pra vlerën 427,200 lekë.
Vlera në blerje	Vlera në blerje e tokës bujqësore për efekt të llogaritjes së tatimit, do të indeksohet me indeksin e vitit të aktit të përfitimit të pronësisë (indeksi i vitit 2009, që është 1.432): 1,200 m² x 339 lekë/m² : 1.432 = 284,078.2 lekë
Tatimi i llogaritur	**Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është**: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15% (427,200 – 284,078.2) x 15 % = 21,468 lekë

5. Tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme në rastet e shkëmbimit

5.1 Rastet e shkëmbimeve të pasurisë së paluajtshme, që ndodhin midis individëve janë subjekt i tatimit mbi fitimin kapital të realizuar nga diferenca midis vlerave sipas çmimeve të referencës, të pronave që shkëmbehen.

Shembull nr. 10 – Tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme në rastet e shkëmbimit	
Individi AA banues në Tiranë, në rrugën "Komuna e Parisit" (zona fiskale 5/3), ka në pronësi të tij një apartament me sipërfaqe 140 m² (viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2017), të cilën e ka blerë me kontratë shitblerje në 17.05.2020, në shumën 12,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është llogaritur mbi vlerën 12,000,000 lekë) dhe një dyqan me sipërfaqe 120 m² (viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2017), të cilin e ka blerë me kontratë shitblerje në vitin 7.09.2019, me vlerën 23,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është i llogaritur mbi vlerën 23,000,000 lekë). •Këto dy pasuri, individi AA ka rënë dakord t'i shkëmbejë me një hotel 5-katësh në Librazhd, që është në pronësi të individit BB, me kontratë këmbimi të hartuar në zyrën e noterit në datë 25.02.2024. •Hoteli përbëhet nga një sipërfaqe hotelerie 4,000 m² (4 kate x 1,000 m²) dhe nga dyqane e restorante në katin e parë me sipërfaqe 1,200 m². Individi BB e ka blerë hotelin nga privatizimi në 1.2.1993, me një vlerë 15,000,000 lekë (vlera e fundit për të cilën është llogaritur tatim) dhe viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 1993.	
Vlerat e pasurisë që do shkëmbejë individi AA	*A. Vlera e pasurive që do këmbejë individi AA me çmimet referuese është:* *a) Apartamenti në pronësi të individit AA:* *140 m² x (164,800 lekë/m² – 1% * 6 vite përdorim * 164,800 lekë/m²) = 21,687,680 lekë* *b) Dyqan në pronësi të individit AA:* *120 m² x (164,800 lekë/m² – 1% * 6 vite përdorim * 164,800 lekë/m²) x 2 (koeficienti ndaj banesës) = 37,178,880 lekë* *Vlera e pasurive, që do të shkëmbejë individi AA, sipas çmimeve referuese është:* *21,687,680 lekë + 37,178,880 lekë = 58,866,560 lekë* *Vlera 58,866,560 lekë është vlera totale e pasurisë sipas çmimeve të referencës që shkëmben individi AA dhe shërben si vlerë në shkëmbim.*
Vlerat e pasurisë që do shkëmbejë individi BB	*B. Vlera e pasurive, që do shkëmbejë individi BB me çmimet referuese është:* *a) Hoteleri:* *4,000 m² x (44,000 lekë/m² – 1% * 30 vite * 44,000 lekë/m²) x 1.5 (koeficienti ndaj banesës) = 184,800,000 lekë* *b) Dyqane e restorante:* *1,200 m² x (44,000 lekë/m² – 1%*30 vite * 44,000 lekë/m²) x 1.5 (koeficienti ndaj banesës) = 55,440,000 lekë* *Vlera e pasurive, që do të shkëmbejë individi BB, sipas çmimeve referuese është:* *184,800,000 lekë + 55,400,000 lekë = 240,200,000 lekë* *Vlera 240,200,000 lekë është vlera totale e pasurisë sipas çmimeve të referencës, që shkëmben individi BB dhe shërben si vlerë në shkëmbim.*
Tatimi i llogaritur	Nëse do të ketë diferencë midis vlerave që shkëmbehen, kjo diferencë do të tatohet. Në rastin konkret, vlera në shkëmbimi e pasurisë që shkëmben individi BB (hotelit 5-katësh në Librazhd), është më e lartë se vlera në shkëmbim e pasurisë që shkëmben individi AA (dyqanit dhe apartamenti në Tiranë), prandaj kjo diferencë do tatohet. Konkretisht, kjo diferencë, është:

	240,200,000 lekë – 58,866,560 lekë = 181,333,440 lekë Mbi këtë diferencë llogaritet tatim, i cili paguhet nga individi që përfiton nga kontrata e shkëmbimit pasurinë e paluajtshme, e cila ka vlerë më të lartë sipas çmimeve referuese. Pra, në këtë rast, tatimi paguhet nga individi AA, i cili nëpërmjet shkëmbimit ka realizuar një fitim në vlerë prej 181,333,440 lekë. Vlera e tatimit është: *181,333,440 lekë x 15 % = 2,720,016 lekë*

5.2 Në rastet e shitjes së pasurisë së paluajtshme, që vjen nga një kontratë shkëmbimi për të cilën në momentin e shkëmbimit nuk është llogaritur dhe paguar tatim, si vlerë në blerje (vlerë e zbritshme) do të merret vlera sipas përcaktimeve të pikës 3, "Vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme", e regjistruar në DVASHK për pasurinë e paluajtshme, që është përdorur për shkëmbim.

Shembull nr. 11 – Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme që vjen nga një kontratë shkëmbimi, për të cilën në momentin e shkëmbimit nuk është llogaritur dhe paguar tatim	
Individi BB, në Tiranë, në rrugën "Komuna e Parisit" (zona fiskale 5/3), ka në pronësi të tij një apartament me sipërfaqe 140 m² (viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2017), dhe një dyqan me sipërfaqe 120 m² (viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2017), të cilat i ka përfituar nga një kontratë shkëmbimi me individin BB, kontrata e shkëmbimit është e datës 25.02.2024 (shembulli 10). Në shkëmbim, Individi BB i ka dhënë individit AA një hotel 5-katësh në Librazhd, një sipërfaqe hotelerie 4,000 m² (4 kate x 1,000 m²) dhe nga dyqane e restorante në katin e parë me sipërfaqe 1,200 m². Individi BB e ka blerë këtë hotel nga privatizimi në 01.02.1993, me një vlerë 15,000,000 lekë (vlera e fundit për të cilën është llogaritur tatim) dhe viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 1993. Në vitin 2024, me kontratën e shitjes të datës 10.11.2024, individi BB ia shet apartamentin dhe dyqanin e tij individit CC me vlerën 50,000,000 lekë.	
Vlera në shitje	*Krahasojmë vlerën në shitje të pasurive të paluajtshme sipas kontratës me vlerën sipas çmimeve të referencës të pasurive të paluajtshme pronave që po shiten. Vlera e pasurive që po shet individi AA, sipas çmimeve referuese është:* *a) Apartamenti:* *140 m² x (164,800 lekë/m² – 1% * 6 vite përdorim * 164,800 lekë/m²) = 21,687,680 lekë* *b) Dyqani:* *120 m² x (164,800 lekë/m² – 1% * 6 vite përdorim * 164,800 lekë/m²) x 2 (koeficienti ndaj banesës) = 37,178,880 lekë* *Vlera e pasurive në shitje sipas çmimeve të referencës është:* *21,687,680 lekë + 37,178,880 lekë = 58,866,560 lekë* *Duke qenë se vlera në kontratën e shitjes është më e vogël se vlera sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje marrim vlerën sipas çmimeve të referencës, pra vlerën 58,866,560 lekë.*
Vlera në blerje	*Vlera në blerje do të jetë vlera në blerje e llogaritur sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, të llogaritur mbi pasurinë e paluajtshme, që është përdorur për shkëmbim.* *Konkretisht, pasuria e paluajtshme që individi BB, ka përdorur për shkëmbim është hoteli 5-katësh në Librazhd, të cilin e kishte blerë nga privatizimi në 1.2.1993, me një vlerë 15,000,000 lekë (vlera e fundit për të cilën është llogaritur tatim).* •*Vlera në blerje në këtë rast është 15,000,000 lekë.*
Tatimi i llogaritur	*Duke qenë se në momentin e shkëmbimit, individi BB nuk ka paguar tatim, atëherë tatimi që duhet të paguajë shitësi BB gjatë kësaj kontrate shitje është:* *(vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15%* *(58,866,560 lekë – 15,000,000 lekë) x 15% = 6,579,984 lekë*

5.3 Në rastet e shitjes së pasurisë, që vjen nga një kontratë shkëmbimi për të cilën në momentin e shkëmbimit është llogaritur e paguar tatim, si vlerë në blerje (vlerë e zbritshme) do të merret vlera sipas përcaktimeve të pikës 3, "Vlera në blerje e pasurisë së paluajtshme", e regjistruar në DVASHK për pasurinë e paluajtshme që është përdorur për shkëmbim..

<table>
<tr><th colspan="2">Shembull nr. 12 – Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme që vjen nga një kontratë shkëmbimi, për të cilën në momentin e shkëmbimit është llogaritur dhe paguar tatim</th></tr>
<tr><td colspan="2">Individi AA, ka në pronësi të tij një hotel 5-katësh në Librazhd me një sipërfaqe hotelerie 4,000 m² (4 kate x 1,000 m²) dhe nga dyqane e restorante në katin e parë me sipërfaqe 1,200 m², të cilin i ka përfituar nga një kontratë shkëmbimi me individin BB, kontrata e shkëmbimit është e datës 25.02.2024 (shembulli 10). Në shkëmbim, Individi AA i ka dhënë individit BB, një apartament me sipërfaqe 140 m², të cilin e ka blerë me kontratë shitblerje në 17.05.2020, në shumën 12,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është llogaritur mbi vlerën 12,000,000 lekë) dhe një dyqan me sipërfaqe 120 m², të cilin e ka pas blerë me kontratë shitblerje në vitin 7.09.2019, me vlerën 23,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është i llogaritur mbi vlerën 23,000,000 lekë).
•Në vitin 2024 me kontratën e shitjes së datës 09.12.2024, individi AA ia shet hotelin individit CC me vlerën 220,000,000 lekë.</td></tr>
<tr><td>Vlera në shitje</td><td>Krahasojmë vlerën në shitje të pasurisë së paluajtshme sipas kontratës me vlerën sipas çmimeve të referencës të pasurisë së paluajtshme që po shitet. Vlera e pasurive që po shet individi AA me çmimet referuese është:
a) Hoteli:
4,000 m² x (44,000 lekë/m² – 1% * 30 vite * 44,000 lekë/m²) x 1.5 (koeficienti ndaj banesës) = 184,800,000 lekë
b) Dyqane e restorante:
1,200 m² x (44,000 lekë/m² – 1%*30 vite * 44,000 lekë/m²) x 1.5 (koeficienti ndaj banesës) = 55,440,000 lekë

Vlera e pasurive që po shet individi BB, sipas çmimeve referuese është:
184,800,000 lekë + 55,440,000 lekë = 240,240,000 lekë
Duke qenë se vlera në kontratën e shitjes është më e vogël se vlera sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje marrim vlerën sipas çmimeve të referencës, pra vlerën 240,240,000 lekë.</td></tr>
<tr><td>Vlera në blerje</td><td>Vlera në blerje do të jetë vlera në blerje e llogaritur sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, të llogaritur mbi pasurinë e paluajtshme që është përdorur për shkëmbim.
Konkretisht, pasuria e paluajtshme që individi AA, ka përdorur për shkëmbim janë:
•apartament me sipërfaqe 140 m², të cilin e ka blerë me kontratë shitblerje në 17.05.2020, në shumën 12,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është llogaritur mbi vlerën 12,000,000 lekë), si dhe
•një dyqan me sipërfaqe 120 m², të cilin e ka pas blerë me kontratë shitblerje në vitin 7.09.2019, me vlerën 23,000,000 lekë (tatimi i fundit i regjistruar për këtë pasuri është i llogaritur mbi vlerën 23,000,000 lekë).
Vlera në blerje në këtë rast është:
12,000,000 lekë + 23,000,000 lekë = 35,000,000 lekë.</td></tr>
<tr><td>Tatimi i llogaritur</td><td>Tatimi i llogaritur për shitësin AA është:
(vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15%
(240,240,000 lekë – 35,000,000 lekë) x 15% = 30,786,000 lekë
Por, duke qenë se gjatë shkëmbimit, individi AA ka paguar tatim për shkëmbimin në vlerën 2,720,602 lekë, nga tatimi i llogaritur në këtë kontratë shitje, do të zbritet edhe tatimi i paguar gjatë shkëmbimit.

Tatimi që duhet të paguajë shitësi BB është:
Tatimi i llogaritur në shitje – tatimi i paguar në shkëmbim
30,786,000 lekë – 2,720,602 lekë = 28,065,398 lekë</td></tr>
</table>

5.4 Nëse pasuria e paluajtshme tokë, që është përdorur për shkëmbim me pasurinë që shitet, nuk ka vlerë paraardhëse, atëherë si çmim në blerje do të merret çmimi i llogaritur duke përdorur indeksimin e çmimit të tokës sipas hartës së vlerave, me inflacionin mesatar vjetor të llogaritur për vitit në të cilin është regjistruar kontrata e shkëmbimit në DVASHK.

6. Raste të veçanta për tatimin mbi të ardhurat personale, që rrjedhin nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme

6.1 Shitja e një pasurie të paluajtshme të përfituar nga një kontratë shkëmbimi truall me ndërtesë

6.1.1 Në momentin e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk lind detyrim për llogaritje të fitimit kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme, si për shoqëritë e ndërtimit ashtu edhe për pronarët e truallit pavarësisht nga statusi. Në këtë rast, fitimi kapital lind në momentin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme të fituar nga shkëmbimi.

6.1.2 Në rastin e shitjes së një pasurie të paluajtshme të përfituar nga një kontratë shkëmbimi truall me ndërtesë, për të llogaritur fitimin kapital të realizuar, vlera në blerje dhe vlera në shitje përcaktohet si

në vijim:

a) Vlera në blerje, do të konsiderohet vlera e pjesës së truallit, që i takon sipërfaqes së ndërtesës që shitet.

i. Vlera e truallit, për metër katror të dhënë në këmbim të përfitimit të sipërfaqes së banimit/tregtisë/shërbimit, përcaktohet bazuar në vlerën, që ka patur trualli i dhënë në transaksionin e fundit përpara shkëmbimit. Kur pronari i truallit, e ka përfituar këtë truall me një transaksion (qoftë kontratë blerje, shkëmbim, trashëgimi, dhurim, heqje dorë apo rivlerësim i pasurisë së paluajtshme), për të cilin është llogaritur tatimi dhe ky akt është regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, vlera në blerje do të jetë vlera sipas regjistrimit të fundit të kësaj pasurie mbi të cilën është llogaritur tatimi. Kjo vlerë në rast se ekziston një akt tjetërsimi pasurie, i mundësohet noterëve gjatë kërkesës për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme nga organi kompetent për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme,

ii. Në rastet kur për truallin e këmbyer nuk ekziston një vlerë sipas parashikimeve të paragrafit (i), si vlerë e truallit për metër katror të dhënë në këmbim të përfitimit të sipërfaqes së banimit ose tregtisë ose shërbimit do të konsiderohet vlera, sipas çmimeve për m^2 sipërfaqe trualli të dhënë siç parashikohet në hartën e vlerave të tokës në Republikën e Shqipërisë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi në momentin e regjistrimit të kontratës së shkëmbimit ndërmjet investitorit dhe pronarit të truallit në organin përgjegjës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

b) Vlera në shitje e ndërtesës përcaktohet në kontratën e shitjes, e cila është nënshkruar nga palët (shitësi dhe blerësi). Kontrata parashikon sipërfaqen në metër katror të pasurisë objekt të kontratës, çmimin për metër katror dhe vlerën e saj. Kontrata shoqërohet me certifikatën e pronësisë/vërtetimin hipotekor, kartelën, hartë, planimetrinë (sipas rastit) dhe dokumentet e tjera, që shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme sipas legjislacionit të fushës.

Kjo vlerë në shitje e përcaktuar në kontratën e shitjes, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, krahasohet me çmimet e referencës. Në rastet kur vlera e pasurisë sipas çmimit të shitjes për metër katror (m^2) të përcaktuar në kontratë është më e ulët se vlera sipas çmimeve referuese, atëherë si çmim i supozuar shitje do të merret në konsideratë çmimi i referencës së zonës/qytetit.

<table>
<tr><th colspan="2">Shembull nr. 13 – Fitimi kapital nga shitja e ndërtesave të përfituara nga një kontratë shkëmbimi truall me ndërtesë</th></tr>
<tr><td colspan="2">Individi AA ka në pronësi të tij një apartament në qytetin e Beratit, me sipërfaqe 72 m² të cilin e ka përfituar nga një kontratë shkëmbimi truall me ndërtesë. Këtë apartament ja shet individit CC me kontratë shitje të datës 12.1.2024, me çmimin 3,700,000 lekë.
•Në lidhje me kontratën e shkëmbimit sqarojmë se individi AA e ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me kompaninë e ndërtimit "BB sh.p.k" në datë 5.7.2014 dhe e ka regjistruar në DVASHK në datën 20.9.2016. Trualli objekt i kësaj kontrate ka një sipërfaqe prej 720 m² dhe ndodhet në qytetin e Beratit. Këtë truall, pronari i truallit e ka përfituar si trashëgimtar nga babai dhe nuk kemi as vlerë në blerje dhe as tatim të llogaritur më parë për këtë tokë.
•Në këmbim të këtij trualli, pronari i tokës ka përfituar 4 apartamente nga shoqëria ndërtuese me kontratë shkëmbimi dhe janë regjistruar në DVASHK në datën 20.09.2016. Apartamentet e ndërtuara kanë një sipërfaqe përkatësisht 56 m², 72 m², 74 m² dhe 86 m².</td></tr>
<tr><td>Vlera në shitje</td><td>Për të përcaktuar vlerën në shitje të banesës, krahasojmë vlerën e shitjes sipas kontratës, me çmimet e referencës për banesat.
Vlera e apartamentit, sipas çmimeve të referencës është:
72 m² x (41,400 lekë/ m² – 1% * 7 vite përdorimi * 41,400 lekë/ m²)
= 2,772,144 lekë
Duke qenë se vlera me çmimet e referencës është më e vogël se vlera e pasqyruar në kontratën e shitjes, atëherë si vlerë në shitje do të merret vlera në kontratën e shitjes, pra vlera 3,700,000 lekë (vlera në shitje).</td></tr>
<tr><td>Vlera në blerje</td><td>Si vlerë në blerje do të llogarisim vlerën, sipas çmimit të pjesës së truallit që i takon apartamentit prej 72 m² që shet individi AA.
Vlera e truallit në datën 20.9.2016, kur është bërë regjistrimi në DVASHK-në i kontratës së këmbimit, ka qenë 4,183 lekë m². Pra, vlera totale e truallit ka qenë 720 m² x 4,183 lekë/m² = 3,011,760 lekë. Kjo vlerë trualli është këmbyer me: 56 m² + 72 m² + 74 m² + 86 m² = 288 m² sipërfaqe ndërtimi.
Pra, për rrjedhojë vlera e 1 m² sipërfaqe ndërtimi të përfituar është:
3,011,760 lekë : 288 m² = 10,457.5 lekë m²</td></tr>
</table>

	Meqenëse individi AA shet vetëm 72 m², vlera që do të llogaritet si çmim blerjeje për këtë apartament do të jetë: 10,457.5 lekë/m² x 72 m² = 752,940 lekë
Tatimi i llogaritur	*Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është:* *(vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 %* *(3,700,000 – 752,940) x 15% = 442,059 lekë*

6.2 Shitja njëkohësisht e tokës truall dhe ndërtesë

Në rast të shitjes njëkohësisht të tokës truall dhe ndërtesës brenda këtij trualli, për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor, do të llogariten veçmas vlera e detyrimit tatimor nga shitja e ndërtesës, dhe vlera e detyrimit tatimor të shitjes së tokës truall.

Në këtë rast, vlera në shitje dhe vlera në blerje do të llogariten më vete për ndërtesën dhe më vete për tokën truall, përkatësisht sipas parashikimeve të paragrafit 4 dhe paragrafit 5. të këtij udhëzimi.

Shembull nr. 14 – Vlera në shitje e tjetërsimit njëkohësisht të tokës truall dhe ndërtesës brenda këtij trualli, me kontratë shitje	
Një individ AA, banues në Pogradec, ka në pronësi të tij një banesë 2-katëshe, e cila është ngritur mbi një sipërfaqe toke prej 100 m², si dhe një sipërfaqe trualli të lirë 300 m², përreth kësaj ndërtese, të përfituar në vitin 2007 me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2004. Këtë pronë, individi AA ja shet blerësit BB me vlerën 7,500,000 lekë, me kontratën e shitjes datë 13.1.2024. *Në këtë rast detyrimi tatimor llogaritet si shumë e: •detyrimi tatimor të llogaritur për ndërtesën 200 m² (100 m² x 2 kate sipërfaqe ndërtimi), dhe •detyrimi tatimor i llogaritur për sipërfaqen totale të truallit prej 300 m².	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në blerje krahasojmë vlerën e pronës bazuar në çmimet referuese me vlerën në kontratën e shitjes. *a. Vlera në shitje e ndërtesës:* Duke qenë se në kontratën e shitjes vlera është përcaktuar për të gjithë pasurinë (truall + ndërtesë), për të përcaktuar vlerën e ndërtesës, nga vlera e përgjithshme e përcaktuar në kontratë zbresim vlerën e truallit sipas hartës së vlerave (400 m² truall x 220 lekë/m² = 88,000 lekë), pra vlera e ndërtesës sipas kontratës së shitjes është: 7,500,000 – 98,400 = 7,401,600 lekë Vlera në shitje e ndërtesës sipas çmimeve të referencës për vitin 2024 është: 200 m² x (49,900 lekë/m² - 1%* 19 vite*49,900 lekë/m²) = 8,083,800 lekë Duke qenë se vlera e ndërtesës sipas çmimeve të referencës është me e madhe se ajo në kontratën e shitjes, si vlerë në shitje për ndërtesën merret ajo sipas çmimit të referencës, pra vlera 8,083,800 lekë. *b. Vlera në shitje e truallit* Në këtë rast do të jetë çmimi i përcaktuar sipas hartës së vlerave të llogaritur më lart, i cili korrespondon dhe me vlerën në shitje të zbritur për truallin nga kontrata e shitjes. 400 m² truall x 220 lekë/ m² = 88 000 lekë
Vlera në blerje	Vlera në blerje, duke qenë se pasuria e paluajtshme nuk ka vlerë paraardhëse, do të merret: *a. Vlera në blerje e ndërtesës:* Në lidhje me ndërtesën do të llogaritet vlera sipas kostos së shfrytëzimit të vitit të regjistrimit të pronësisë mbi këtë pasuri të paluajtshme (kosto e vitit 2004): 200 m² x 29,166 lekë = 5,833,200 lekë *b. Vlera në blerje e truallit* Në lidhje me truallin, duke qenë se trualli është përfituar sipas VKKP-së në vitin 2007, vlera në blerje është: 400 m² x 220 lekë/m² : 1.514 (indeksi i vitit 2007) = 58,124 lekë
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: a. Tatimi llogaritur për ndërtesën (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % *(8,083,800 lekë – 5 833 200 lekë) x 15 % = 337,590 lekë* b. Tatimi llogaritur për truallin (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % *(88,000 lekë –58,124 lekë) x 15 % = 4,481 lekë* •Detyrimi tatimor gjithsej është: (detyrimi tatimor për ndërtesën + detyrimi tatimor për truallin) *337,590 lekë + 4,481 lekë = 342,071 lekë*

6.3 Shitja e pasurive të paluajtshme të përfituara nga Enti Kombëtar i Banesave

Enti Kombëtar i Banesave (EKB), të gjitha kontratat, që lidh me qytetarët për shitblerjen e banesave, i vlerëson dhe i shet me koston reale të të gjitha shpenzimeve direkte, që janë bërë për ndërtimin e apartamentit. Vlerësimi i apartamentit, që i dorëzon qytetari EKB-së, bëhet duke shumëzuar sipërfaqen e shfrytëzimit të apartamentit me koston e shfrytëzimit, të vitit kur është marrë në dorëzim banesa e re e ndërtuar nga EKB-ja me fonde shtetërore, në të cilën është trajtuar qytetari që e dorëzon këtë apartament.

Shembull nr. 15 – Vlera në blerje e ndërtesave të përfituara nga EKB, kundrejt një shume dhe prone	
Qytetari AA, banues në Divjakë, në vitin 2016 merr nga EKB-ja një apartament dy dhoma dhe një kuzhinë me sipërfaqe 110 m^2. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2015. Qytetari në kontratën e shitjes së bërë me EKB-në në datën 20.5.2016, i ka dorëzuar EKB një apartament një dhomë dhe një kuzhinë me sipërfaqe 60 m^2, si dhe detyrohet t'i shlyejë EKB edhe shumën 2,200,000 lekë. Qytetari AA, në datën 15.1.2024, ia shet apartamentin me sipërfaqe 110 m^2 qytetarit BB me kontratë shitje me vlerën 7,000,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje, krahasojmë çmimin e referencës së apartamentit me vlerës në kontratën e shitjes: *Llogarisim vlerën në shitje me çmimin referues:* *110 m^2 x (40,100 lekë/m^2 – 1% * 8 vite përdorimi * 40,100 lekë/m^2)* *= 4,058,120 lekë* *Duke qenë se vlera sipas kontratës së shitjes është më e madhe se ajo sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera sipas kontratës së shitjes 7,000,000 lekë (vlera në shitje).*
Vlera në blerje	Për të llogaritur çmimin e blerjes së apartamentit, në këtë rast llogaritet shuma e paguar ndaj EKB-së si dhe vlera e apartamentit të dhënë në këmbim duke u bazuar në koston e shfrytëzimit të vitit në të cilin është marrë në dorëzim banesa e re e ndërtuar nga EKB-ja (kosto e vitit 2016). *60 m^2 x 37,983 lekë/m^2 = 2,278,980 lekë* *Vlera në blerje është:* *2,278,980 lekë + 2,200,000 lekë= 4,478,980 lekë*
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % *(7,000,000 –4,478,980) x 15 % = 378,153 lekë*

Shembull nr. 16 – Vlera në blerje e ndërtesave të përfituara falas nga EKB	
Individi AA, me banim në Lezhë, i persekutuar politik, me kontratën e shitblerjes, datë 23.2.2002, ka përfituar falas nga EKB-ja një banesë me sipërfaqe 98 m^2, të cilën e ka regjistruar në DVASHK në vitin 2008. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2001. Në datën 17.1.2024, individi AA nënshkruan një kontratë shitblerje me individin BB, të cilit i shet shtëpinë më vlerën 5,700,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje, krahasojmë çmimin e referencës së apartamentit me vlerës në kontratën e shitjes: *Llogarisim vlerën në shitje me çmimin referues:* *98 m^2 x (56,000 lekë/m^2 – 1% * 22 vite përdorimi * 56,000 lekë/m^2)* *= 4,280,640 lekë* *Duke qenë se vlera sipas kontratës së shitjes është më e madhe se ajo sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera sipas kontratës së shitjes 5,700,000 lekë (vlera në shitje).*
Vlera në blerje	*Vlera në blerje për banesën, e cila nuk ka vlerë të përcaktuar në blerje (pasi është marrë falas), është e barabartë me vlerën sipas kostos së vitit në të cilin është regjistruar pasuria në DVASHK (kosto e vitit 2008):* *98 m^2 x 33,745 lekë/m^2 = 3,307,010 lekë*
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % *(5,700,000 lekë – 3,307,010 lekë) x 15% = 358,949 lekë*

Shembull nr. 17 – Vlera në blerje e ndërtesave të përfituara nga EKB-ja me statusin e të pastrehut
Enti Kombëtar i Banesave (EKB) në qytetin e Bilishtit, në vitin 2015 i shet individit AA një banesë me sipërfaqe 98 m^2 me kontratë shitblerje datë 11.7.2015. Viti i fitimit të titullit të pronësisë së kësaj prone për herë të parë është viti 2014. Në kontratë thuhet se vlera e apartamentit sipas shpenzimeve të EKB-së ka kushtuar 1,800,000 lekë. Duke qenë se individi AA, thuhet në kontratë, ka statusin si i pastrehë, nga vlera e apartamentit do t'i falen 30% e shumës, pra 540,000 lekë, dhe vlera përfundimtare, që duhet të shlyejë individi AA për EKB është 1,260,000 lekë.

Individi AA, në vitin 2024, vendos ta shesë apartamentin e tij dhe me kontratën e shitblerjes datë 22.04.2024, këtë apartament ia shet individit BB në vlerën 3,430,000 lekë.	
Vlera në shitje	Për të përcaktuar vlerën në shitje, krahasojmë çmimin e referencës së apartamentit me vlerës në kontratën e shitjes: *Llogarisim vlerën në shitje me çmimin referues:* *98 m^2 x (35,000 lekë/m^2 – 1% * 9 vite përdorimi * 35,000 lekë/m^2)* *= 3,121,300 lekë* *Duke qenë se vlera sipas kontratës së shitjes është më e madhe se ajo sipas çmimeve të referencës, si vlerë në shitje për llogaritjen e tatimit merret vlera sipas kontratës së shitjes 3,430,000 lekë (vlera në shitje).*
Vlera në blerje	*Vlera në blerje për banesën e blerë nga EKB-ja me kontratën e shitjes së datës 11.7.2010, është vlera që ka paguar në fakt individi AA, pas faljes 30 % të bërë, pra vlera 1,260,000 lekë.*
Tatimi i llogaritur	Tatimi që duhet të paguajë shitësi AA është: (vlera në shitje – vlerën në blerje) x 15 % *(3,430,000 lekë – 1,260,000 lekë) x 15 % = 325,500 lekë*

6.4 Shitja e detyruar e pasurive të paluajtshme nga personat juridikë publikë apo subjekte të barazuar me ta (zyrë përmbarimi)

Nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij udhëzimi rastet e shitjes së detyruar të pasurive të paluajtshme nga personat juridikë publikë apo subjekte të barazuar me ta (zyrë përmbarimi), kur procedura e shitjes është e parashikuar në akte ligjore e nënligjore.

Shembull nr. 18 – Shitja e detyruar e pasurive të paluajtshme nga personat juridikë publikë apo subjekte të barazuar me ta (zyrë përmbarimi)	
Individi AA ka në pronësi të tij një apartament me sipërfaqe 89 m^2, të cilin e ka vënë në hipotekë bankare për kredinë e marrë nga banka "Zeta" në shumën 1,000,000 lekë. Individi AA, huamarrës në bankë, nuk shlyen dot kredinë e cila në dhjetor të vitit 2014 ka arritur shumën 3,500,000 lekë. Banka, nëpërmjet një vendimi gjykate të datës 5.1.2024 ka nxjerrë në ankand apartamentin e debitorit AA. Nëpërmjet ankandit banka ia shet pasurinë individit BB për shumën 4,000,000 lekë, nga të cilat 3,500,000 lekë i arkëton në llogari të saj dhe 500,000 lekë ia kthen debitorit AA.	
Shitje e përjashtuar	*Shitja e bërë me ankand nga banka të apartamentit të individit AA, nuk është subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale nga kalimi i së drejtës së pronësisë.*

6.5 Pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi është objekt i tatimit, sipas këtij udhëzimi, vetëm në rastet kur plotësohen një nga këto dy kushte:

a) nga ndarja në natyrë e pasurisë krijohet pabarazi e pjesëve, sipas kuptimit të nenit 207 të Kodit Civil; dhe

b) vlera e kompensimit të pjesëve ideale pas pjesëtimit, për bashkëpronarët që nuk marrin pjesë në natyrë nga pasuria, është më e madhe se vlera e këtyre pjesëve ideale në kohën e krijimit të bashkëpronësisë.

6.6 Rastet e shitjes/dhurim/shkëmbim apo heqjes dorë të pasurive të paluajtshme nga personat juridik sipas përcaktimeve të kreut II të Kodit Civil nuk janë objekt i dispozitave të këtij udhëzimi.

6.7 Aktmarrëveshjet e ndërmjetësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 10385/2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar, për kalimin mbi të drejtën e pronësisë të pasurive të paluajtshme midis individëve, i nënshtrohen dispozitave të këtij udhëzimi.

KAPITULLI III
PAGESA E TATIMIT TË KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË

1. Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Vetëm në rastet e trashëgimisë dhurimit dhe heqjes dorë, ky tatim paguhet nga individi që përfiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

2. Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) llogarisin dhe arkëtojnë detyrimin tatimor përkatës, sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim. Pagesa e detyrimit tatimor bëhet para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme, në DVASHK, në përputhje me aktet ligjore. DVASHK-të, mbledhin tatimin e tjetërsimit kalimit të së drejtës së

pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe e derdhin atë brenda datës 20 të muajit pasardhës në llogarinë e organit tatimor.

3. Brenda datës 20 të çdo muaji pasardhës, DVASHK-të dërgojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore evidencën (manuale ose elektronike), e cila përmbledh emrin e individit tatimpagues si dhe shumën e llogaritur të tatimit mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë.

4. Në rastet e shitjes me rezervë të pronës, të parashikuar nga nenet 746–749 të Kodit Civil, tatimi i kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme paguhet në momentin kur paguhet kësti i fundit sipas çmimit të kontratës (plotësimi i kushtit), vërtetuar kjo me deklaratë noteriale midis palëve, përjashtimisht nëse palët kërkojnë me vullnetin e tyre kalimin e pronësisë në momentin e nënshkrimit të kontratës (pa u plotësuar kushtet), tatimi paguhet në momentin e paraqitjes së aktit për regjistrim në ASHK, pavarësisht se kur është parashikuar pagimi i kështit të fundit.

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet udhëzimi nr. 29, datë 30.07.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me fillimin e efekteve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS
Dallëndyshe Bici

ANEKSI NR. 1

Indeksimi i çmimit të tokës bujqësore me inflacionin mesatar vjetor

Vitet	Inflacioni mesatar	Koeficient i ndërmjetëm	Indekset 2011
1989			
1990	1.8	1.0183	37.817
1991	104.5	2.0450	18.492
1992	236.6	3.3656	5.494
1993	30.9	1.3089	4.198
1994	15.8	1.1580	3.625
1995*	6.0	1.0601	3.419
1996	12.8	1.1276	3.032
1997	32.9	1.3294	2.281
1998	21.6	1.2163	1.875
1999	0.4	1.0040	1.868
2000	0.1	1.0005	1.867
2001	3.1	1.0313	1.810
2002	5.2	1.0522	1.720
2003	2.4	1.0237	1.680
2004	2.9	1.0287	1.634
2005	2.4	1.0237	1.596
2006	2.4	1.0237	1.559
2007	2.9	1.0294	1.514
2008	3.4	1.0336	1.465

2009	2.3	1.0228	1.432
2010	3.6	1.0356	1.383
2011	3.5	1.0345	1.337
2012	2.0	1.0204	1.310
2013	1.9	1.0194	1.285
2014	1.6	1.0163	1.265
2015	1.9	1.0188	1.241
2016	1.3	1.0128	1.226
2017	2.0	1.0201	1.202
2018	2.0	1.0203	1.178
2019	1.4	1.0141	1.161
2020	1.6	1.0162	1.143
2021	2.0	1.0203	1.120
2022	6.7	1.0672	1.049
2023**	4.9	1.0495	1.000

Shënim.

* Për vitet 1995–1990 është përdorur norma e inflacionit të fund-vitit, në mungesë të të dhënave për normën mesatare të inflacionit.

** Për vitin 2023 është përdorur norma e inflacionit vjetore mesatare e janar–tetor 2023 (rifreskimi i fundit i këtyre indekseve është kryer më 6, dhjetor 2023).

URDHËR
Nr. 8, datë 11.1.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 12.1.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 862, datë 29.12.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Kulturës, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Zerina Bruci.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Kulturës do të ushtrohen për periudhën nga data 3 janar 2024 deri më datën 31 dhjetor 2024.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 3.1.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

VENDIM
Nr. 113, datë 11.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE NR. 99, DATË 16.10.2020 "AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE 'MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA 'TË GJELBRA', TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKOMIQËSOR, OSE BIZNESE EKZISTUESE TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË BIZNESE 'TË GJELBRA' DUKE FUTUR ELEMENTE *GO-GREEN* NË TO"', I NDRYSHUAR

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Ervin Mete kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Inida Methoxha anëtare;
- Znj. Brikena Qela anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 11.12.2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit", mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 30400, datë 1.9.2023 'Kërkesë për shtyrjen e afatit të autorizimit të ndihmës shtetërore"'.

Baza ligjore për njoftimin e ndihmës: vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2022, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023".

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar; dhe

VËREN SE:

1. Bashkia e Tiranës, me shkresën nr. 30400/2, datë 26.10.2023, ka njoftuar ndryshimin e skemës ekzistuese të shoqëruar me formularin e thjeshtuar të njoftimit, në vijim të kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 15837/1, datë 17.10.2023, si edhe në përputhje me nenin 11, të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit"'.

2. Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2023, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023–2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023" është miratuar vazhdimi i zbatimit të skemës ekzistuese për vitet 2024–2025, në vlerën 18.000.000 lekë në vit, të autorizuar me vendimin e KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbra', të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbra' duke futur elemente *go-green* në to"', i ndryshuar.

3. Në bazë të nenit 11 të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit"', ndryshimi i skemës ekzistuese njoftohet sipas formularit të thjeshtuar të njoftimit, kur skema e njoftuar parashikon rritjen e buxhetit të një skeme të miratuar me më shumë se 20 për qind. Skema e njoftuar për vitin 2024 dhe 2025 është buxhetuar në vlerën prej 18 mln lekësh në vit, me rritje me 50 për qind të ndihmës të autorizuar me vendimin e KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbra', të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbra" duke futur elemente *go-green* në to"', i ndryshuar, në vlerën 12 mln lekë në vit.

Komisioni shqyrtoi njoftimin e ndihmës shtetërore të sipërcituar dhe vlerësoi së është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4, të kreut II "Përshkrimi i masës", të vendimit të KNSH-së nr. 99, datë

16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja 'të gjelbra', të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese 'të gjelbra' duke futur elemente *go-green* në to"', i ndryshuar, në:

"Kohëzgjatja: plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2020–2025."

2. Bashkia e Tiranë,s brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura, në përputhje me pikën 7, të nenit 11, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore"'.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Ervin Mete

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Ahmet Mançellari, Inida Methoxha

VENDIM
Nr. 114, datë 11.12.2023

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "BIZNESET EKOINOVATIVE"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Ervin Mete	kryetar;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Brikena Qela	anëtare;
Znj. Inida Methoxha	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 11.12.2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit"', mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Shkodër lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për bizneset ekoinovative.

I. Procedura

1. Bashkia Shkodër, me shkresën nr. 15974, datë 2.11.2023, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023–2025", i ndryshuar.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi*: promovimi i një modeli të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të NMV-ve një vlerë të shtuar në treg, si edhe ndërtimi i kapaciteteve të të rinjve me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të gjelbër.

3. *Vlera e ndihmës dhe baza ligjore:* plani i ndihmës shtetërore është hartuar në bazë të vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023–2025", i ndryshuar. Skema në total ka vlerë të përgjithshme të planifikuar në buxhet 2,600,000 lekë dhe parashikohet të mos kalojë shumën 520,000 lekë për përfitues.

4. *Kohëzgjatja:* plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2023–2024.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia Shkodër.

6. *Përfituesit:* përfitues do të jenë shtetasit shqiptar të moshës 18–30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese ekoinovative.

7. *Shtrirja territoriale:* projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Shkodër.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

8. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, pra nëse plani: ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje; ka ndikim potencial në konkurrencë dhe tregti në rajon; që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

9. Neni 4, pika 1, ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të

tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.".

10. Gjithashtu, neni 71 "*Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike*", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[39], përcakton se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.".*

11. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë *të gjitha*_kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

12. Plani i njoftuar i ndihmës shtetërore aktivizon burime shtetërore në formën e grantit për të përballuar shpenzimet në asete të prekshme/paprekshme, duke i ofruar një avantazh ekonomik ndërmarrjeve, nëpërmjet reduktimit të kostos së investimit që do të duhej të mbuloheshin me burimet financiare të ndërmarrjes. Skema është selektive, pasi do të mundësohet vetëm për përfituesit e përzgjedhur të skemës dhe që do të zbatojnë projekte të reja investimi. Masa ka efekt në konkurrencë, sepse përfshin të gjithë sektorët e ekonomisë dhe ndërmarrjet aktive në sektorë që janë të hapur për konkurrencë dhe tregti ndërkombëtare.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore, e cila në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

13. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

"Ndihma 'de minimis' është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.".

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës *'de minimis'",* vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës *de-minimis* përcaktohet si vijon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit", të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: "1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente".

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 605/2016, ndihma "*de minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon *14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë*, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është në vlerën e pagës minimale bruto;

b) ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 2 vjet, duke plotësuar këtë kusht ligjor;

c) ndihma është transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin

[39] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare'".

8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e planit të ndihmës shtetërore në formën e grantit të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023–2025", i ndryshuar.

2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës "*de-minimis*" dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Shkodër.

3. Bashkia e Shkodrës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e kryera dhe rezultatet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e planit të ndihmës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të këtij plani.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Ervin Mete

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Ahmet Mançellari, Inida Methoxha

VENDIM
Nr. 302, datë 23.10.2023

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS "AREA" PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË 16.2.2023 "MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI ME HYRJEN NË FUQI TË VKM-së NR. 67, DATË 8.2.2023"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 33, pika 2, 67, 87, 88 dhe 181, germa "b", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 67, datë 8.2.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi'", të ndryshuar; neneve 15 dhe 16 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/30 prot., datë 16.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA 'Për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 'Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023'"",

konstatoi se:

- Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), me shkresën nr. 1810/176 prot., datë 24.2.2023, depozitoi në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 27, datë 16.2.2023 dhe me shkresën nr. 1810 prot., datë 7.3.2023, plotësoi kërkesën fillestare të datës 24.2.2023 duke shtuar disa argumente në mbështetje të kërkesës së paraqitur më herët.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 129, datë 7.4.2023, ndër të tjera, vendosi: *(1) Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqatës "AREA" për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023"; dhe (2) Të pezullojë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës "AREA", për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023.*

- Në vijim të procesit, para se ERE të shprehej me vendimmarrjen e sipërcituar mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 27/2023, u vlerësua e nevojshme t'i kërkohet palëve të interesit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet shkresës nr. 930/5 prot., datë

13.3.2023, qëndrimi i saj në lidhje me sa deklaruar nga shoqata "AREA" gjatë periudhës së diskutimeve të projekt aktit në lidhje me efektet apo afatet juridike të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, të sipërcituar, pasi shoqata "AREA" ka depozituar në ERE të gjitha dokumentet për shkak se deklaronte se vullneti i MIE-s në lidhje me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67/2023 ka qenë hyrja në fuqi në muajin janar 2023.

- ERE, me shkresën nr. 930/5 prot., datë 13.3.2023, vlerësoi të nevojshme marrjen e qëndrimit të MIE-s në lidhje me sa deklaruar nga shoqata "AREA" gjatë periudhës së diskutimeve si dhe në lidhje me efektet juridike të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, së sipërcituar, përpara se ERE të shprehet me vendim mbi kërkesën e AREA-s.

- MIE, me shkresën nr. 2750/1 prot., datë 12.4.2023, ktheu përgjigje në vlerësimin tonë jo shteruese, ku ndër të tjera është shprehur se: *qëllimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67/2023, është në harmoni me konceptin e përgjithshëm të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i cili parashikon që Këshilli i Ministrave harton metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike që i paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi. Ndryshimi i referuar (nga ERE)... është bër*ë *në "vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë", të ndryshuar, i cili përcakton çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi.*

- Duke marrë në konsideratë përgjigjen e MIE-s, së sipërcituar, u vlerësua i nevojshëm vijimi i komunikimit me shoqatën "AREA" dhe palët e tjera të mundshme, për shkak të kompleksitetit të çështjes, si dhe me qëllim dhënien në mënyrë sa më objektive dhe transparente, por edhe shteruese të vlerësimeve tona në lidhje me kërkesën për rishikimin e vendimmarrjes së datës 16.2.2023.

- Në vijim të procedurës dhe në zbatim të nenit 29 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, me shkresën nr. 930/24, datë 19.9.2023 u zhvillua seanca dëgjimore me palët e interesit duke njoftuar të gjitha palët që mund të kenë interes për këtë çështje duke përfshirë dhe ankuesin. Shoqata "AREA" me shkresën e depozituar në ERE, me nr. 930/24 prot., datë 9.9.2023 me lëndë: *Njoftim për zhvillimin e një seance dëgjimore "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet Prodhuesve me Përparësi me hyrjen në fuqi të VMK-së nr. 67, datë 8.2.2023"* kërkoi një; *mundësi e dytë për zhvillimin e seancës dëgjimore në pamundësi të ishte prezente.* Seanca e parë dëgjimore teknike u zhvillua më datë 29.9.2023, me objekt diskutimi lidhur me kërkesën e shoqatës AREA "Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023", me palë të pranishme nga ERE, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a., në mungesë të përfaqësuesve të shoqatës AREA dhe MIE-s dhe më datë 4.10.2023 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore teknike me pjesëmarrje të ERE-s, shoqatës AREA, MIE-s, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. me të njëjtin objekt diskutimi si në seancën e zhvilluar më datë 29.9.2023.

- Duke marrë në konsideratë faktin, se nëpërmjet komunikimeve shkresore por edhe nëpërmjet seancave dëgjimore me palët e përfshira (sipërcituar), të cilat kanë paraqitur provat e tyre, vlerësohet se kanë rënë shkaqet për pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me vendimin nr. 129/2023, e për pasojë pika 2 e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s nr. 129, datë 7.4.2023: *(2) Të pezullojë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me kërkesën e shoqatës 'AREA', për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, 'Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023'",* duhet shfuqizuar.

- Së fundi, me shkresën nr. 1810/189 prot., datë 23.10.2033, të shoqatës "AREA", u kërkua nga ankuesi (AREA): *(i) shtyrja e vendimmarrjes për shkak të pamundësisë të jetë prezent si dhe (ii) vënia në dispozicion të diskutimeve të seancës dëgjimore teknike datë 4.10.2023*, me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për t'u dëgjuar por edhe për sigurimin e provave të nevojshme që palët kërkojnë gjatë një procedure administrative, si dhe shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me propozimin, në lidhje me kërkesën e shoqatës "AREA", vlerësojmë shtyrjen me 30 ditë kalendarike të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 129, datë 7.4.2023.

2. Pranimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e vendimmarrjes përfundimtarë të Bordit të ERE-s, "Mbi kërkesën e shoqatës 'AREA' për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023, 'Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023"'.

3. Bordi ERE-s do të shprehet brenda 30 ditëve kalendarike mbi kërkesën e shoqatës AREA, "Për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.2.2023 'Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023"'.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqatën "AREA" dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 303, datë 23.10.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "IDI 2005" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "TEKSOEN 1"

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a" dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/18 prot., datë 18.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi licencimin e shoqërisë 'IDI 2005' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik 'Teksoen 1', me kapacitet të instaluar 2 MW",

konstatoi se:

- Shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.8.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Teksoen 1", me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier dhe Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 255, datë 23.8.2023 vendosi të fillojë procedurën e licencimit për shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Teksoen 1", me kapacitet të instaluar 2 MW.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.8.2023 dhe 25.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresat nr. 2033/3 prot., dhe nr. 2033/4 prot., datë 12.9.2023, ERE i njoftoi shoqërisë fillimin e procedurës dhe i evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim, ndërsa me shkresën nr. 2102 prot., datë 4.9.2023, ERE i është drejtuar edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) duke i njoftuar fillimin e kësaj procedure.

- Shoqëria, me shkresat nr. 2033/5 prot., datë 12.9.2023 dhe nr. 2033/6 prot., datë 15.9.2023, depozitoi dokumentacion plotësues, i cili rezultoi jo i plotë për këtë aplikim. ERE me vendimin e Bordit nr. 282, datë 25.9.2023, vendosi të zgjasë deri në 30 ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare në lidhje me aplikimin e shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k.

- ERE, me shkresën nr. 2033/13 prot., datë 3.10.2023, njoftoi shoqërinë për zgjatjen e vendimmarrjes mbi aplikimin e shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k. për t'u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Teksoen 1" me kapacitet të instaluar 2 MW.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033/17 prot., datë 17.10.2023, përcolli në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Aplikuesi ka depozituar në ERE, Kontratën me nr. 2306 rep, nr. 1235 kol., datë 25.5.2023, "Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 3038, Njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë "IDI 2005" sh.p.k.".

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "IDI 2005" sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; dhe pikën 2.1, germat "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Aplikuesi ka depozituar në ERE VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN300920220011, datë 26.10.2022, Komisioni 80, kjo VNM konsiderohet e vlefshme, por duke qenë se shoqëria nuk ka filluar punimet e ndërtimit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024, datë e cila përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Teksoen 1" me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të informacionit sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "IDI 2005" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 304, datë 23.10.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME LICENCIMIN E SHOQËRISË "GEALB ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET "GURI I BARDHË 1" DHE "GURI I BARDHË 2"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 14, pika 2 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/10 prot., datë 20.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi

licencimin e shoqërisë 'Gealb Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet 'Guri i Bardhë 1' dhe 'Guri i Bardhë 2"',

konstatoi se:

- Shoqëria "Gealb Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., datë 17.8.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1" dhe "Guri i Bardhë 2" dhe Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 256, datë 23.8.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Gealb Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1" dhe "Guri i Bardhë 2", me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.8.2023 dhe 25.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën me nr. 2042/3 prot., datë 30.8.2023 dhe e-mail-in me nr. 2042/5 prot., datë 19.9.2023, nr. 2042/8 prot., datë 13.10.2023, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2042/4 prot., datë 15.9.2023, nr. 2042/6 prot., datë 21.9.2023, nr. 2042/7 prot., datë 2.10.2023, nr. 2042/9 prot., datë 16.10.2023 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Gealb Energy" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1 germat: "a", "b", "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat: "b" dhe "c"; për pikën 2.1, germat, "a", "b", "c", "d" dhe "e".

- Shoqëria ka depozituar vërtetimin që rezulton se ka detyrime ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ka deklaruar se këto detyrime do t'i shlyejë para fillimit të ndërtimit. Vlen të theksohet se ky vërtetim është një nga kërkesat e rregullores për licencim (neni 9, pika 1.3, germa "a"), si e tillë lind nevoja që ky vërtetim të depozitohet në ERE sikurse kërkuar nga rregullorja dhe të kërkohen shpjegime përse nuk është kryer pagesa për sa kohë shoqëria ka aplikuar ë ERE për t'u licencuar.

- Në nenin 14, pika 2, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencim kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjitha sa më sipër, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes përfundimtare të Bordit mbi licencimin e shoqërisë "Gealb Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1", "Guri i Bardhë 2", në rrjedhën e përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet të instaluar 9300 kW.

- Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria "Gealb Energy" sh.p.k. duhet të depozitojë vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si një nga kërkesat e rregullores për licencim pranë ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi licencimin e shoqërisë "Gealb Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet "Guri i Bardhë 1" dhe "Guri i Bardhë 2", me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria "Gealb Energy" sh.p.k., duhet të depozitojë vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj organeve të

sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si një nga kërkesat e rregullores për licencim pranë ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Gealb Energy" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 305, datë 23.10.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "M.C. ENERGJI GOJAN" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA "HEC GOJAN"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2277/1 prot., datë 19.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'M.C. Energji Gojan' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Gojan",

konstatoi se:

- Shoqëria "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2277 prot., datë 12.10.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Gojan", në pellgun ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh", në zonën e Gojan-Gjegjanit, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW.

- Aplikuesi ka depozituar në ERE Kontratën e Koncesionit e formës BOT me nr. 2515 rep., nr. 1181 Kol., datë 6.11.2017, "Kontratë koncesionit e formës 'BOT' (ndërtim-operim-transferim) për objektin 'Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan"', të nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe subjektit për qëllime të veçanta "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, e ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 2 rep., nr.2/3 kol., datë 3.1.2019 dhe me kontratën shtesë nr. 1990 rep., nr. 1465 kol., datë 7.12.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Shoqëria ka plotësuar kapacitetin e instaluar të HEC-it prej 14,99 MW në formatin e aplikimit, por nga kontrata e koncesionit, si dhe lejet përkatëse (VNM dhe leja për përdorim të burimit ujor), rezulton se kapaciteti i HEC "Gojan" është 15 MW, ndaj ERE-s do të marrë në konsideratë këtë kapacitet.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "M.C. Energji Gojan" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b" dhe "d", për pikën 2, germa "e".

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se dokumentet janë depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pika 3 të rregullores, duhet të depozitohen në formatin origjinal ose fotokopje e njësuar me origjinalin dokumentet në vijim:

- plani i biznesit;

- kontrata e koncesionit me MIE-n, së bashku me dy amendimet e saj;

- shkresa e OST sh.a. për miratimin në parim të pikës së lidhjes;

- leja për përdorimin e burimit ujor.

- Po ashtu, nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/ informacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- *germa "c":* të depozitohet në ERE struktura e shoqërisë, ku të jetë përfshirë stafi teknik, ose marrëveshjen/aktin e dakordësisë së ortakut të vetëm të saj të shoqërisë "M.C. Inerte" sh.p.k., për vënien në dispozicion të stafit të tij për mbarëvajtjen e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- *germa "a":* të depozitohet në ERE vërtetimi që shoqëria nuk ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- *germa "b":* të depozitohet në ERE dokumentacioni përkatës që vërteton mbulimin nga ana financiare të vlerës totale të investimit të projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- *germa "a":* të bëhen saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetit të instaluar të secilës, duke mbajtur në konsideratë që totali i kapacitetit të tyre nuk duhet të tejkalojë totalin e kapacitetit të instaluar të centralit të përcaktuar në kontratën e koncesionit. Po ashtu, subjekti duhet të plotësojë dhe vitin e ndërtimit të veprës, si dhe datën e fillimit të operimit.

- *germa "c":* të depozitohet në ERE miratimi përfundimtar/marrëveshja e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe të bëhen sqarimet përkatëse pse ky miratim është për kapacitetin prej 15.3 MW, ndërkohë që në kontratën e koncesionit, VNM-në dhe lejen e përdorimit të burimit ujor kontatohet se kapaciteti i instaluar i HEC është 15 MW.

- Shoqëria në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, duhet të informojë ERE-n nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", me kapacitet të instaluar 15 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 306, datë 23.10.2023

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "DRAGOBIA ENERGY" SHPK, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, pika 1 e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, germat "a" dhe "b" dhe 10 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/10 prot., datë 20.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Dragobia Energy' sh.p.k. për marrjen e autorizimit

nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.8.2023, i licencuari "Dragobia Energy" sh.p.k. dhe koncesionari "Gener 2" sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve të luajtshme e të paluajtshme (nëpërmjet barrësimit/hipotekimit) të shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k., në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 6.9.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit, në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 2048/4 prot., datë 14.9.2203 iu drejtua shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe i evidentoi dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2048/7 prot, datë 28.9.2023 dhe nr. 2048/8 prot., datë 5.10.2023, dhe nr. 2047/9 prot., datë 17.10.2023, depozitoi në ERE dokumentacion plotësues.

- ERE, me shkresën nr. 2281 prot., datë 13.10.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e kësaj procedure.

- Nga analiza përfundimtare e aplikimit, rezulton se shoqëria "Dragoabia Energy" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h" dhe "j"; pikën 3; pikën 4; dhe pikën 6, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016.

- Vlerësojmë që vullneti i bankave (Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka e Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a. ku të shprehet gatishmëria për të garantuar veprimtarinë e licencuar në rastin kryerjes së transferimit, të parashikohet si pjesë përbërëse e kontratës finale që do të nënshkruhet midis palëve, e të depozitohet në ERE.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/ miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse (nëpërmjet hipotekimit), në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a. (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Shoqëria duhet të dorëzojë kontratën finale të nënshkruar, ku të përfshihet vullneti i bankave (Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka e Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.) mbi gatishmërinë për të garantuar veprimtarinë e licencuar në rastin e kryerjes së transferimit, si pjesë përbërëse të saj.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet hipotekimit të aseteve të paluajtshme të shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta, në rast se do të ndodhi transferimi i këtyre asteve nëse kjo kërkohet.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kudër të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Dragobia EnergY" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ASETET E HEC DRAGOBIA + HEC ÇEREM

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Furnitori
1	PROJEKTI HEC DRAGOBIA (KOMPLET)			
1.1	HEC ÇEREM			
1.1.1	Rrugë Aksesi	ml	1	"Gener 2" shpk
1.1.2	Vepra e Marrjes	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.3	Stacioni i Pompimit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.4	Dekantuesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.5	Tuneli	ml	2,558	"Gener 2" shpk
1.1.6	Baseni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.7	Tubacioni i Presionit	ml	1,513	"IMK" sha (Industria Metalurgjike Kosovë)
1.1.8	Godina e Centralit Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.9	Godina e Gjeneratorit dhe Transformatorit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.10	Vendroje tek Godina e Centralit Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.11	Vendroje Tubacioni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.12	Vendroje tek Vepra e Marrjes Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2	HEC DRAGOBIA			
1.2.1	Rrugë aksesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.2	Vepra e Marrjes	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.3	Kabina Elektrike	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.4	Kanali Transportues	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.5	Dekantuesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.6	Tuneli Dragobi	ml	2,472	"Gener 2" shpk
1.2.7	Baseni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.8	Tubacioni i Presionit	ml	378	"IMK" sha (Industria Metalurgjike Kosovë)
1.2.9	Godina e Centralit	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.2.10	Vendroje tek Dekantuesi Dragobi	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.2.11	Vendroje tek Godina e Centralit Dragobi	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.3	LINJA E TRANSMETIMIT			
1.3.1	Linja nëntokësore Hec Çerem - Hec Dragobi - Nënstacion Shoshan	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.2	Linja ajrore Nënstacion Shoshan - Nënstacion Bajram Curri	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.3	Linja nëntokësore Shtylla Fundore nr. 1 - Nënstacioni Bajram Curri	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.4	Nënstacioni Shoshan	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.5	Nënstacioni Bajram Curri (Traku Shtesë)	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.4	TURBINAT			
1.4.1	Turbinat për HEC Cerem (Tipi pelton) përfshirë gjeneratorët, panelet, çelat dhe të gjithë aksesorët e tjerë sipas specifikimeve teknike të projektit	copë	2	"Koessler" GmBH
1.4.2	Turbinat për HEC Dragobi (Tipi francis) përfshirë gjeneratorët, panelet, çelat dhe të gjithë aksesorët e tjerë sipas specifikimeve teknike të projektit	copë	3	"Koessler" GmBH

FIRMOSET NGA INVESTITORI
Subjekti "DRAGOBIA ENERGY" shpk

Datë 5.6.24

"DRAGOBIA ENERGY"
NUIS K92025004T

TIRANA BANK S.A.
BANKA E TIRANËS SH.A.

ASETET E HEC DRAGOBIA + HEC ÇEREM

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera Aseti
1	PROJEKTI HEC DRAGOBIA (KOMPLET)	Lekë	3,570,418,040
1.1	HEC ÇEREM	Lekë	1,042,382,919
1.1.1	Rrugë Aksesi	Lekë	33,017,668
1.1.2	Vepra e Marrjes	Lekë	110,496,178
1.1.3	Stacioni i Pompimit	Lekë	39,871,486
1.1.4	Dekantuesi	Lekë	82,071,740
1.1.5	Tuneli	Lekë	511,824,392
1.1.6	Baseni i Presionit	Lekë	21,714,532
1.1.7	Tubacioni i Presionit	Lekë	171,003,222
1.1.8	Godina e Centralit Çerem	Lekë	69,100,749
1.1.9	Godina e Gjeneratorit dhe Transformatorit	Lekë	814,887
1.1.10	Vendroje tek Godina e Centralit Çerem	Lekë	941,640
1.1.11	Vendroje Tubacioni i Presionit	Lekë	1,001,525
1.1.12	Vendroje tek Vepra e Marrjes Çerem	Lekë	524,900
1.2	HEC DRAGOBIA	Lekë	1,648,095,839
1.2.1	Rrugë aksesi	Lekë	15,244,402
1.2.2	Vepra e Marrjes	Lekë	171,307,743
1.2.3	Kabina Elektrike	Lekë	138,122
1.2.4	Kanali Transportues	Lekë	92,220,759
1.2.5	Dekantuesi	Lekë	90,571,387
1.2.6	Tuneli Dragobi	Lekë	878,258,768
1.2.7	Baseni i Presionit	Lekë	50,079,984
1.2.8	Tubacioni i Presionit	Lekë	166,220,257
1.2.9	Godina e Centralit	Lekë	182,735,161
1.2.10	Vendroje tek Dekantuesi Dragobi	Lekë	609,674
1.2.11	Vendroje tek Godina e Centralit Dragobi	Lekë	709,582
1.3	LINJA E TRANSMETIMIT	Lekë	339,844,163
1.3.1	Linja nëntokësore Hec Çerem - Hec Dragobi - Nënstacion Shoshan	Lekë	70,787,329
1.3.2	Linja ajrore Nënstacion Shoshan - Nënstacion Bajram Curri	Lekë	66,831,944
1.3.3	Linja nëntokësore Shtylla Fundore nr. 1 - Nënstacioni Bajram Curri	Lekë	26,362,976
1.3.4	Nënstacioni Shoshan	Lekë	155,369,737
1.3.5	Nënstacioni Bajram Curri (Traku Shtesë)	Lekë	20,492,176
1.4	TURBINAT	Lekë	540,095,120
1.4.1	Turbinat për HEC Cerem	Lekë	230,677,700
1.4.2	Turbinat për HEC Dragobi	Lekë	309,417,420
	TOTALI	Lekë	3,570,418,040

FIRMOSET NGA INVESTITORI
Subjekti "DRAGOBIA ENERGY" shpk

Datë 5.10.25

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 621 (4264), datë 10.10.2023, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Suzana Tafili, e datëlindjes 29.3.1960, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të bashkëjetuesit të saj, shtetasit Maliq Pepa.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 6145, datë 21.11.2023, vendosi shpalljen të zhdukur, më datë 1.12.2017, të shtetasit Hasim Loshi, i biri i Ahmetit dhe Rabes, i datëlindjes 11.5.1948, lindur dhe banues në Tiranë, dhe caktimin e shtetases Zhaneta Loshi si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në emër të shtetasit Hasim Loshi.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2024 - Numri: 11
Datë: 2024/01/17 16:49:38
d2995e2b-03fe-4196-b138-e6615b28ce03

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 800 lekë